monumentet



DO NOT COPY

1/1982

DO NOT COPY

ERTINA E PARË: Banesë e hapur e gjysmës së parë
të shek. XIX në qytetin e Korçës (pas restaurimit).

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1/1982 (23)

KOLEGJIUMI I REDAKSISE

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi», Nr. 7

Tirazhi 1005 copë | Formati 70 x 100/12 | Stash 2204-72

Shtypur në Kombinatin Poligrafik: Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë 1982

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

	Artikuj	Faqe
Vera BUSHATI	– Banesa pastas në vendin tonë	5
Halil MYRTO	– Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit (vazhdim).	11
Kasëm BIÇOKU	– Rrugët nëpër vilajetin e Krujës të shek. XV dhe lokalizimi i Shufadasë.	41
Pirro THOMO	– Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre.	63
Valentin VOSHTINA	– Kulla me mure rrethues në Mat.	105
Abdulla BIRAÇI	– Probleme dhe aspekte të çvendosjes, rivendosjes dhe të restaurimit të një tymtari.	113
	Kronika e punimeve restauruese për vitet 1980 – 1981	119
	KRONIKË E BIBLIOGRAFI	
	P. THOMO	
Emin RIZA	– «Banesa fshatare e Shqipërisë veriore» 285 f. Shtëpia Botuese «8 Nëntori», Tiranë, 1981	133
Emin RIZA	– Katër numra të revistës shkencore «Kultura Popullore».	137
Aleksandër MEKSI	– H. und H. Buschhausen, Die Marienkirche von Apollonia in Albanien, Byzantiner, Normanen und Serben in Kampf um die via Egnatia, Wien 1976, verlag der Österreichisschen Akademie der Wissenschaften (me 246 f. dhe 50 tab.).	141
Aleksandër MEKSI	– P.A. Vokotopoullou, I EKKLISIASTIKI ARKITEKTONIKI EIS TIN DHITIKI STEREAN ELLIADHA KAI TIN IPEIROU APO TON TELLOUS TON 7ou MEHRI TON TELLOUS TON 10ou AIONOS (Instituti i Studimeve bizantine, Thesaloniki 1975 (me 231 fq. dhe 59 tab.).	169

TABLES DES MATIERES

Articles

Page

Vera BUSHATI — L'habitation pastas dans notre pays 5

Halil MYRTO — Cartes des monuments de la région de Durrës. 11

Kasëm BIÇOKU — Voies qui traversaient «le vilayet» de Kruja au XV ème siécle et la localisation de Shufada. 41

Pirro THOMO — Les habitations ouvertes dans la ville de Korça et les problèmes de leur restauration. 63

Valentin VOSHTINA — Les «Kulas» à des murs fortifies à Mat. 105

Abdulla BIRAÇI — Problèmes et aspects du déplacement, de l'installation et de la restauration d'une cheminée. 113

Chronique des travaux de restauration des années 1980 — 1981 119

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

P. THOMO

Emin RIZA — «L'habitation paysanne de l'Albanie du nord» 285 pages. La maison d'editions «8 Nëntori» 1981. 133

Emin RIZA — Les quatres premieres numeros de la revue scientifique «La culture populaire». 137

Aleksandër MEKSI — H. und H. Buschhausen, Die Marienkirche von Apollona in Albanien, Byzantiner, Normanen und Serben in Kampf um die via Egnatia. Wien 1976, Verlag der Österreichisschen Akademie der Wissenschaften (avec 246 p. et 50 tab.). 141

Aleksandër MEKSI — P.A. VOKOTOPOULLOU, | EKKLISIASTIKI ARKITEKTONIKI EIS TIN DHITIKI STEREAN ELLIADHA KAI TIN IPEIROU, APO TON TELLOUS TON 7ou MEHRI TON TELLOUS TON 10ou AIONOS (Institut des etudes byzantines, Thessaloniki 1975 (avec 231 p. et 59 tab.). 169

DO NOT COPY

monumentet

DO NOT COPY

Vera BUSHATI

BANESA PASTAS NË VENDIN TONË

Banesa pastas paraqet një tip të njohur dhe të përhapur në tërë pellgun e Mesdheut, pa një përkatësi të caktuar etnike. Përhapja e saj e gjerë e gjen shpjegimin në formën racionale dhe kushtet e përngjashëm shoqërorë e gjeografikë në tërë këtë zonë, veçanërisht gjatë periudhës helenistike kur marrëdhëniet formë – etnos u zbehën së tepërmi.

Këtë banesë e gjejmë në disa shembuj, ku më pak e ku më tepër të ruajtur, edhe në vendin tonë. Në Apoloni, Nikae (Klosi i rr. Fierit), Antigone (Jerma e rr. Gjirokastrës) dhe ka mjaft gjasë në qytetet ilire në Zgërdhesh e Persqop.[1]

Banesa në Apoloni e zbuluar në vitet 1923-24 krijon së bashku me një banesë tjetër të tipit me peristil një bllok standart të sistemit ortogonal të qytetit. Prania e këtyre dy tipave peristil – pastas ngjitur me njeri tjetrin, duke marrë parasysh se në këtë kohë diferencimi shoqëror shprehet dhe në krijimin e rajoneve të veçantë me pjesëtarë të një shtrese ose të së njëjtës zeje, tregon se tipi i banesës me pastas bashkëjetoi me atë me peristil. Në drejtim të përcaktimit të shtresës shoqërore që i përket ky tip banese mendojmë se banesa pastas është shtëpi e shtresave të mesme qytetare.

Në drejtim të shtresëzimit shoqëror duket se ky është kufiri i sipërm për banesën tip pastas, e cila paraqitet racionale, me diferencim shoqëror, por pa pretendime për jetë lluksoze dhe njëkohësisht ky është kufiri minimal për banesën me peristil me pretendime për lluks e cila në variantet më të zhvilluar merr tipare pallati.

Banesa tip pastas në Apolloni ka trajtën e një drejtkëndëshi (30 x 12.5 m) me shtrirje jug-perëndim-verilindje (fig. 1). Ajo kufizohet në ballin e ngushtë, nga jugperëndimi, me rrugën ose më saktë me kunetën e saj anësore, të cilën e kalon me një urëz të vogël, të zakonshme për sistemin rrugor të Apollonisë[2]. Nga juglindja ajo ndahet me një rrugicë 0,70 x 1,20 m e gjerë, për kullimin e ujërave dhe kalim, nga banesa me peristil, ndërsa në veriperëndim ballit të gjerë duket se i mbështetet një oborr i zakonshëm për këtë tip banese[3]. Këtij konturi i brendashkruhen katër elementë kryesorë: 1) banesa e mirëfilltë e pronarit të shtëpisë; 2) grupi i cili përmbledh ambientet e shërbimit dhe punishten e dyqanin; 3) koridori në formë të shkronjës «L» që i veçon dhe njëkohësisht i ndërlidh ambientet me njeri tjetrin; 4) oborri.

Banesa e mirëfilltë përbëhet prej tre ambientesh të cilët mund të komunikojnë me njeri tjetrin. Prej tyre ambienti kryesor (1), ku janë gjetur dhe mozaikë, ka trajtë kuadratike me sipërfaqe rreth 36 m^2, ndërsa dy të tjerët të përzgjatur. Përsa i përket funksione-

1) Banesa e Apolonisë tek L. Rey, **Feuilles de la mission française a Apollonie d'Illirie et a Durazo (1923-1924),** Albania, 1925, Milano-Roma f. 11 v. Banesa e Nikaes tek L. Papajani **Disa monumente të arkitekturës në Klos,** Monumentet, 11, f. 23, Banesa e Antigonesë tek Dh. Budina, **Antigonea,** Iliria II, f. 269, Banesa në Zgërdhesh, S. Islami, **Qyteti ilir në Zgërdhesh,** Monumentet, 1, f. 23.

2) B. Dautaj, **Një rrugë kryesore në Apolloni,** Monumentet 7-8, f. 55.

3) L. Rey. **Po aty.**

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

ve mendohet se ky ambient ka shërbyer për pritje-ndejtje dhe dy të tjerët për fjetje të çiftit dhe të fëmijëve. Disa gjurmë të zbehta që i mbështeten murit anësor të lenë të mendosh për një banjë që komunikonte nga brenda me dhomën e fjetjes. Në ndërtimet ndihmëse diferencohet grupi i ambienteve të shërbimit dhe grupi i punishtes dhe dyqanit. Në grupin dy kthinësh të ambienteve të shërbimit të çonte një koridor i vogël (6), i lidhur me koridorin në formë të shkronjës L. Nevoja e ndërtimit të tij lindi nga synimi për veçimin e plotë të krahut të sipërm nga lëvizjet e personelit shërbyes, pasi në të kundërt ai mund të eleminohej lehtësisht. Njeri prej ambienteve (4) e ka dyshemenë me kalldrëm dhe në të shihen gjurmët e disa pythosave që flasin për funksionin për gatim e depo ushqimore. Së fundi ambienti tjetër (5) duket se shërbente për fjetjen e personelit shërbyes.

Grupi prej 3 ambientesh (7, 8, 9) që lidhen me një hajat (11) të veçuar nga koridori kryesor, përbëhet prej dyqanit dhe punishtes. Llogjikisht do ta mendonim ambientin 7 dyqan, 9-punishte dhe 8-depo. Kjo shpjegon dhe praninë e hajatit (11) i cili e shkëput për klientët dyqanin nga banesa.

Skema funksionale e banesës ka qënë e tillë. Klientët pasi kalonin kunetën (13) me anë të urës

hynin në hajat (11) dhe më tej në dyqan (7). Vetë i zoti i shtëpisë, artizan dhe tregëtar, dhe personeli ndihmës kalonin nga brenda, prej koridorit (6), në punishte e depo (8, 9) ose në dyqan (7). Për të hyrë në banesë pas hajatit kalohej porta (15). Prej këtej personeli shërbyes kalonte në koridorin e vogël (6) dhe më tej në depon e kuzhinës (4) ose ambientin e fjetjes (5), ndërsa të zotët e shtëpisë në ambientet e banesës së mirfilltë (1-3) ose oborr (16). Përveç kësaj në banesë mund të kalohej dhe nga rrugica (12) e cila në brrylin e koridorit kishte një derë të vogël. Kalimi nga ky drejtim ishte i përshtatshëm për furnizimin nga rruga verilindore pasi kështu evitohej një brryl i gjatë.

Siç e vemë re një ndër elementet kryesorë organizues të banesës është koridori i cili kryen të gjitha ndërlidhjet e duhura dhe veçon banesën e mirëfilltë nga ambientet ndihmëse dhe të shërbimit, duke i dhënë kompozimit një formë racionale dhe kompakte. Gjithashtu koridori ka shërbyer për marrjen dritë të një sërë ambientesh që nuk vështronin jashtë.

Një skemë të ngjashme paraqet dhe një prej banesave të zbuluara në Antigone, e quajtura «Shtëpi e zejtarit» (fig. 2). Banesa në fjalë edhe në këtë rast na paraqitet e bashkëngjitur me një banesë me peristil. Nga zbulimet arkeologjike janë përftuar objekte që tregojnë qartë se të dyja banesat janë punishte – banesa artizanësh. Ky fakt flet më qartë se në Apoloni për grupimin në rajone të caktuara sipas zejeve të njëjta, duke krijuar në këtë mënyrë punishte e tregje të specializuara për një lloj prodhimi dhe krahas kësaj një diferencim të saktë shoqëror. Përveç kësaj në këtë mënyrë krijohet shkëputja e qendrës tregëtare nga qendra shoqërore dhe copëzimi i saj në nënnjësi. Shkëputjen e dyqanit dhe punishtes nga banesa e mirëfilltë e vemë re në të dy rastet, por ndërsa banesa e parë si bërthamë kompozicionale ka oborrin peristil tek banesa e dytë tiparet e një banese pastas kristalizohen më mirë.

Koridori elementi kryesor ndërlidhës, ka formën e shkronjës L (1). Në të majtë të tij ndodhet punishtja me dyqanin (2), ndërsa në fund depoja (3) me përmasa të vogla ku janë gjetur mjaft objekte të përfunduara. Hyrja ashtu si në Apoloni për në dyqanin punishte kryhet nga rruga, gjë që flet se këto banesa nuk komunikonin me dritare nga jashtë dhe dritën e merrnin nëpërmjet koridorit. Në të djathtë të koridorit ndodhet një ambient (4) që lidhej me një të dytë, ndërsa në anën e pasme ndodhej oborri i shtëpisë (5) që mund të shërbehej nga koridori. Banesa e mësipërme ashtu si ajo e Apolonisë kishte formë të përzgjatur (25 x 15 m), ndryshe nga ajo me peristil që paraqitet kuadratike.

Banesat që përshkruam në Apoloni dhe Antigone bënin pjesë në një sistem urbanistik të rregullt ortogonal.

Banesa e zbuluar në Nikae (Klos i rrethit të Fierit) (fig. 3) i përshtatet një sistemi të çrregullt urba-



Fig. 3

PHOTOCOPY

nistik. Në të djathtë të koridorit (3) gjenden ambientet ndihmëse. Koridori ka formë të zgjatur dhe të çrregullt duke marrë mbi vehten e tij dhe deformimet planimetrike të konturit të banesës. Ambientet veç njerit kanë planimetri kuadratike. Koridori përfundon me oborrin në trajtë pyke të rrethuar me mur (4). Ambienti i parë që komunikon me koridorin mund të ketë qënë dyqan ose depo (1). Në shpinë atij i mbështetet një ambient i dytë i cili nuk komunikon me koridorin dhe mund të themi se është kuzhina (2). Në këtë mendim na shtyn dhe prania e një stere (5) në cakun e jashtëm, e cila e merrte ujin prej çatisë së banesës. Ambientet e radhës së majtë janë të lidhur me koridorin (3). Kështu që edhe këtu elementi kryesor organizues mbetet koridori. Në vështrim të parë koridori duket linear por mendojmë se hapja për t'i shërbyer kuzhinës është bisht i koridorit në formën e shkronjës L. Banesa e mësipërme mendojmë se i përket një caku më të ulët të shtresave të mesme qytetare se ato të Apolonisë e Antigonesë.

Një studim më i gjerë duke kërkuar dhe shembuj të tjerë banesash mund të na çojë në një rikonstruksion hipotetik të banesës pastas të lidhur me veçoritë gjeografike ekonomike e shoqërore të mjedisit tonë.

DO NOT COPY

Vera BUSHATI

DO NOT COPY

L'HABITATION PASTAS DANS NOTRE PAYS

RESUME

L'habitation Pastas représente un type connu et que l'on trouve dans toute la Méditerranée, sans une appartenance précise ethnique.

Nous rencontrons cette habitation dans certains exemples, plus ou moins conservés même dans notre pays, à Apolonie, Nikae (Klos du district de Fieri), Antigone (Jerma du district de Gjirokastra) et il est bien possible dans les villes illyriennes de Zgërdhesh et de Persqop.

L'habitation à Apolonie crée de même qu'une autre habitation du type péristylon un bloc standard du système ortogonal de la ville. La présence de ces deux types péristyle-pastas l'un près de l'autre prenant en considération qu'à cette époque la différenciation de classes sociales s'accompagne aussi de la création des régions à part avec des membres d'une souche ou de la même profession artisanale, prouve que le type de l'habitation à pastas a cohabité avec celle à péristyle. Dans le sens de la définition de la souche sociale à laquelle appartient ce type, nous pensons qu'elle doit être une habitation des couches moyennes de la ville. Dans le sens de la couche sociale, il semble qu'elle est la frontière supérieure pour l'habitation type pastas qui se présente comme rationnelle avec la différenciation sociale, mais sans prétentions pour une vie de luxe et étant en même temps la frontière minimale pour l'habitation à péristyle avec des prétentions pour une vie de luxe, qui dans ses variantes les plus avancées prend les dimensions d'un palais.

L'habitation type pastas en Apolonie a la forme d'un rectangle (30 x 12,5 m) avec une position sud-ouest-nord-est (fig. 1). A l'intérieur du contour se dessinent quatre éléments principaux: 1) l'habitation proprement dite du patron de la maison; 2) le groupe qui contient les pièces des services, l'atelier et la boutique; 3) le couloir en forme de la lettre «L» qui distinguent et relient en même temps les pièces entre elles; 4) la cour.

L'habitation proprement dite est composée de trois pièces qui peuvent communiquer entre elles.

Le schémas fonctionnel de l'habitation a été la suivante: Les clients après avoir passé (13) par le pont entraient dans la holle (11) et plus loin dans la boutique (7). Le maître de la maison, artisan et commerçant, et le personnel de service passaient de l'intérieur, par le couloir (6), dans l'atelier et le magasin (8, 9) ou bien dans la boutique (7). Pour entrer dans l'habitation après le halle on passait la porte (15). De là le personnel de service passait dans le petit couloir (6) et puis dans l'office et la cuisine (4) ou bien dans la chambre à coucher (5) tandis que les maitres de la maison dans les pièces proprement de l'habitation (1-3) ou dans la cour (16) En outre, on pouvait entrer à l'habitation par la petite porte au coin du couloir de la ruelle (12). Le passage ici était convenable pour l'arrivée de la rue du nord-est, car ainsi on évitait un long détour.

Comme on peut le remarquer, un des éléments principaux de l'organisation de l'habitation est le couloir qui assume toutes les fonctions de liaison nécessaire, met à part l'habitation proprement dite des pièces accessoires et de service, donnant à l'ensemble une forme rationnelle et compacte. Le couloir a servi aussi pour donner de la lumière aux pièces qui n'avaient pas de vue à l'extérieur.

Un schémas semblable présente une des habitations découvertes à Antigoné, nommée «la maison de l'artisan» (fig. 2). L'habitation en question se présente aussi jointe à l'habitation à péristyle.

Le couloir, l'élément principal de liaison, a la forme de la lettre «L» (1). A sa gauche se trouve l'atelier et la boutique (2), tandisqu'au fond se trouve le magasin (3) ayant de petites dimensions et où ont été découverts des objets inachevés. L'entrée dans la boutique et l'atelier de même qu'à Apolonie se fait par la rue, fait qui signifie que ses pièces ne communiquaient pas avec des fenêtres à l'extérieur et prenaient la lumière par le couloir. A droite du couloir se trouve une pièce (4) qui communique avec une autre, tandis que dans la partie derrière se trouve la cour de la maison (5) qui peut servir de couloir. Cette habitation tout comme celle de Apolonie avait une forme allongée aux dimensions 25 X 15 m.

L'habitation découverte à Nikae (Klos du district de Fieri) (fig. 3) est conforme à un système irrégulier urbanistique. A droite du couloir (3) se trouvent les pièces accessoires. Le couloir a une forme allongée et irrégulière prenant sur lui aussi les déformations planimétriques des contours de l'habitation. Les pièces, sauf une, ont une planimétrie quadratique. Le couloir se termine avec la cour en forme d'un recoin encerclé d'un mur (4). La première pièce qui communique avec le couloir a dû être une boutique ou un office (1). Près de celle-ci se trouve la seconde pièce qui ne communique pas avec le couloir et nous pouvons dire que c'est la cuisine (2). Notre idée en est renforcée par l'existence d'une serre (5) face extérieure qui prenait l'eau par le toit de la maison. Les pièces se trouvant à gauche sont liées avec le couloir. (3). De la sorte, même ici l'élément principal en est le couloir.

DO NOT COPY

monumentet

DO NOT COPY

Halil MYRTO

HARTË E MONUMENTEVE DHE E GJURMËVE ANTIKE E MESJETARE TË RRETHIT TË DURRËSIT

II

4. ZONA KODRINORE E KAVAJËS

*) SHKËMBI I KAVAJËS (PETRA)

44. Mbetje ndërtimesh antike e mesjetare

Kjo është pika më veriore e kodrave të Kavajës. Kodra këtu përfundon me një shkëmb të lartë në breg të detit, që ka faqe të thikta në anën perëndimore dhe jugore. Shpina e Shkëmbit të Kavajës, megjithëse e vogël, por deri diku e dystë dhe e butë, do të lejonte në të ndonjë ndërtim.

Ky vend strategjik në burimet antike njihet me emrin Petra.[1] Ky duket se është dhe pozicioni i kishës së Shën Nikollës, që përmendet në mesjetë lidhur me luftërat normano-bizantine në territorin e Shqipërisë.[2] Edhe më pas, në Atlantin e Kamocios (1571), gjejmë të shënuar në juglindje të gjirit të Durrësit një kishë me emrin «S. Nicola»,[3] që përsëri mund të identifikohet me pozicionin e Shkëmbit të Kavajës. Në Petra e vendos kishën e Shën Nikollës edhe Gulielmi i Pulies[4]. Po ashtu, këtë mendojmë se ka parasysh edhe Barleti kur bën fjalë për kripore të ndodhura «ndërmjet një mali e vendi, i cili nga njera anë e ka emrin Selitë, nga tjetra Shën Nikollë, vend shumë i njohur për shkrepat, por edhe i palavdi për rrethimin e dikurshëm dhe fatin e senatit romak»[5]

Në shpatin jugor të Shkëmbit kemi vërejtur një sasi të madhe fragmentesh qeramike antike, të dala në sipërfaqe nga rrëshqitja e dheut. Ato janë kryesisht fragmente kalipteresh të harkuara, disa me shpinën të lyer me një bojë të kuqe, si dhe fragmente enësh me vernik të zi e kafe.

Më 1973 në qafën që lidh shpinën e butë të Shkëmbit me kodrën prapa, u krye një sondazh dhe u zbulua qeramikë e periudhës qytetare ilire, e shekujve të parë të e.s. dhe qeramikë mesjetare, por jo mure.[6] Materiali që provon për mbetje të një ndërtese gjendet më lart, pikërisht mbi shpinën e Shkëmbit. Këtu në një sipërfaqe prej rreth 700 m²

*) Numri rendor i qendrave që përshkruajmë vazhdon nga pjesa e parë e këtij artikulli dhe u korespondon shënimeve në hartë (tab. I)

1) Caes., **B. Civ.,** III, 42, 1; Lucan, Phars, VI, 101-102. Shih për këtë identifikim L. Heuzey-H. Daumet, **La mission archéologique de Macèdoine,** Paris 1876, f. 367.

2) A. Comnene, **Alex.,** V. 390. Shih për këtë dhe A. Ducellier, **La façade maritime de l'Albanie au moyen age,** Thessaloniki, 1981, f. 35.

3. **Atlante del Camozio** (1571); **Citta, forteze ed altri luogi dell' Albania, Epiro e Livadia,** Venezia, 1704, nr. 33

4. G. Apulus, IV, 459.

5. M. Barleti, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë, 1964, f. 100.

6. F. Tartari, **Lëndë arkeologjike nga Petra (Shkëmbi i Kavajës)** në «Buletin Arkeologjik» nr. 3, Tiranë 1975, f. 39; **Petra,** «Iliria» VI, 1976, f. 350.

shihen të shpërndara fragmente të shumta tullash e tjegullash. Tullat, që kanë një trashësi prej 4 cm, kanë qënë të lidhura me llaç gëlqereje gatuar me rërë të trashë, që formonte fuga horizontale të barabarta me trashësinë e tullave. Fragmentet e tjegullave përfaqësojnë dy tipe: të harkuara dhe të sheshta, me buzë pak të kthyera dhe që përshkohen në faqe nga brazda të bëra me gishta para pjekjes. Këtu kemi gjetur dhe një fragment kolone mermeri të bardhë me rremba gri, me gjatësi 0.80 m dhe diametër 0.45 m.

Ka të dhëna gojore se kohë më parë këtej është marrë material për ndërtimin e kishës së Shën Nikollës në Kavajë. Vendasit ruajnë për këtë pikë mikrotoponimin «Kisha». Ky është pikërisht vendi, mendojmë, ku duhen kërkuar mbetjet e kishës së Shën Nikollës, e përmendur këtu, siç e thamë, që në shekullin XI.

GOLEM

45. **Varrezë e shekujve të parë të erës sonë**

Para 20 vjetësh në parkun para shkollës së mesme bujqësore të Golemit, në thellësinë rreth 1 m, dolën varre me tjegulla në formë çatie.[7]

SEFERAJ

46. **Altar varri me mbishkrim**

Fshati Seferaj ndodhet mbi kodrat e veshura me ullinj e pemë të tjera frutore në lindje të Golemit. Këtu, në «Bregun e Qishës», para shumë vjetësh janë zbuluar varre që përmbanin si inventar enë balte. Në fundin e këtij bregu është gjetur dhe një altar varri me mbishkrim latin.[8]

TILAJ

47. **Varrezë antike**

Në këtë fshat kodrinor, mbi Golem, është evidentuar një varrezë që ka dhënë materiale të shekujve V-II p.e.s.[9]



Fig. 1

48. **Mbetje të një ndërtese antike**

Në vendin e quajtur Vrap është zbuluar një pjesë dyshemeje me mozaik prej copërash tulle të thyera (rreth 3 x 3 x 2 cm).[10]

KANAPARE

49. **Mbetje rrënojash të një kishe dhe një varrezë mesjetare**

Mbi një kodër të rrumbullakët, kurrizi i së cilës zbret butë nga ana e veriut, ndërsa bie thikë nga tri anët e tjera, ruhen në sipërfaqe mbeturina themelesh të ndërtuara me gurë të çrregullt e llaç gëlqereje. Pak më poshtë këtyre rrënojave gjatë ndërtimit të rrugës së re të fshatit u hasën varre. Shumica e tyre duket se ka qënë pa konstruksion. Por ka pasur edhe një pjesë që ishin të mbuluar me tjegulla. (Tab. I).

Për datimin e kësaj varreze dhe si pasojë edhe të mbeturinave të rrënojave të kishës pranë saj, siç njihet nga mikrotoponimi, ndihmon gjetja në

7. Në muzeun e Durrësit ruhet një koleksion veglash bujqësore me prejardhje nga kjo varrezë. Në gjetjet bën pjesë dhe një fibul me këmbë të përthyera, e shekujve IV-VI (S. Anamali-F. Prendi, **Vazhdimësia e kulturës ilire në kulturën e hershme mesjetare shqiptare»**, «Konf. e Parë e Studimeve Albanologjike (1962), Tiranë 1965, f. 471).

8. H. Ceka-S. Anamali, **Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë** «B.Sh.Sh.» 1, 1961, f. 117-118; H. Myrto, **Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës dhe Durrësit,** «Monumentet» 7-8, f. 249.

9. Materiali është kryesisht qeramikë dhe përfaqësohet nga skyfosa me vernik të zi të shkëlqyeshëm, të datuar në shekujt V-IV p.e.s. si dhe pjata me buzë të kthyera nga jashtë, amfora, skyfosa e peshore të shekujve IV-II p.e.s (A. Hoti, **Rezultatet e kërkimeve arkeologjike në zonën e Kryemëdhenjve të rrethit të Durrësit,** kumtesë në sesionin shkencor të muzeut arkeologjik të Durrësit, 1979).

10. A. Hoti, **Po aty,**

DO NOT COPY

një varr e një vathi bronxi (Fig. 1) i përafërt me vathë të gjetur në vise të tjera të Ballkanit[11] dhe të Europës Qendrore[12], që u takojnë shekujve X-XII.

SPANJO

50. Gjurmë ndërtimi antik

Tek Kodra e Qenze (ose dhe Kodra e Qytezës) shihen në sipërfaqe fragmente të shumta tullash dhe tjegullash të periudhës helenistike. Midis tyre kemi gjetur një fragment soleni me emrin e prytanit Γαΐος.[13])

ZIG-XHAFAJ

51. Vendbanimi i fortifikuar ilir

Njoftimet e para për një fortesë të vogël në katundin Zig-Xhafaj i kemi prej Leon Hezeit; këtë ai e shënon «akropol helenistik» dhe nuk jep hollësira të tjera.[14] Ky fshat ndodhet katër kilometra në verilindje të Kavajës mbi kurrizin e kodrave që vijojnë drejt veriperëndimit. Për herë të parë këtë qendër e kemi vizituar në vitin 1972.[15]

Nga vëzhgimi i mbetjeve në vend dhe i terrenit duket se pjesa më e lartë e kodrës së Zig-Xhafajt (239 m mbi nivelin e detit) ka qënë rrethuar me mure mbrojtëse në anën veriore, perëndimore dhe jugore. Nga ana e lindjes, e veriut dhe e veriperëndimit ajo zbulon shpate shkëmbore mjaft të pjerrëta. Në një trakt muri të mbetur, si dhe në gjurmë të tjera të tij që vërtetohen, vërehet se ka elemente që e bashkërendisin këtë fortifikim me tipe të tilla ndërtimesh të periudhës qytetare ilire, të shekujve IV-II p.e.s. Në disa fragmente solenesh të gjetura këtu kemi lexuar emrin e prytanit eponym dyrrahas, Ἀριστόδαμος.[16])

Nga vrojtimet tona dhe materiali arkeologjik i grumbulluar aty, kemi nxjerrë si përfundim se në Zig-Xhafaj gjatë shekujve IV-II p.e.s. ka ekzistuar një qytezë ilire, që siç duket ka shërbyer si vendbanim, qendër administrative dhe vendstrehim, në raste luftërash, për banorët e zonës përreth. Me pozicionin e saj gjeografik, kjo fortesë kontrollonte dhe një nga kalimet e lehta prej fushës së Kavajës për në luginën e Erzenit e Ndroq.

ÇETË

52. Kisha mesjetare e Shëna Premtes

Këtë kishë (fig. 2) që është i vetmi monument i ruajtur tërësisht në këmbë i arkitekturës romanikogotike në vendin tonë, duke u nisur nga rrethanat historike, A. Meksi e daton në gjysmën e dytë të shekullit XIII, kur pas pushtimit anzhuin, në Durrës u vendosën peshkopë katolikë.[17] Një kohe të mëvonëshme siç duket i përkasin afresket me mbishkrime në gjuhën greke që ruhen në të.



Fig. 2

11. N. Milatiç, **Elementi della cultura di Koettlach in Bosnia e Erzegovina,** «Balcanoslavica», 6, Beograd 1978, f. 98, 99.
12. L. Niederle, **Rokovset Slavaskych Starzitnest,** Pragë, 1953, f. 357-359.
13. H. Myrto, **vep. cit.,** f. 249.
14. L. Heuzey-H. Daumet, **vep. cit.** dhe L. Heuzey, **Operations militaires de Jules Cesar,** Paris 1866 (shih hartën).
15. H. Myrto, **vep. cit.** f. 247-49, fig. 1, 2, 3 dhe tab. II, III.
16. Njihen monedha të Dyrrahut me emrin e këtij prytani eponym, që u takojnë viteve 250-200 p.e.s. (H. Ceka, **Datimi i drahmeve të Dyrrahit e Apollonisë,** «Studime historike» 1966, III, f. 33; **Thesari i Jubicës,** «Iliria» 1, 1971, f. 88; **Le trésor numismatique de Bakerr,** «Studia Albanica» 1972, f. 52.
17. A. Meksi, **Dy monumente mesjetare të Kavajës,** kumtesë dorëzuar në muzeun etnografik të Kavajës (e pabotuar).

DO NOT COPY

Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Ambienti i altarit ka qënë i pajisur me një ikonostas druri me ikona të piktorit Kostandin Shpataraku.

53. Varrezë antike

Rreth 700 m në jug të kishës, te kodra e Varreve, shihet qeramikë e periudhës romake, e dalë në sipërfaqe nga veprimi i përroit dhe nga hapja e rrugës së re. Pak më poshtë kësaj pike buzë rezervuarit, nga hapja e një kanali, kanë dalë dy varre të mbuluar me tjegulla të harkuara, me orientim lindje-perëndim.

Në altarin e kishës është gjetur dhe një stelë varri me tri figura njerëzish në reliev dhe me mbishkrim latin, që tani ruhet në muzeun arkeologjik të Durrësit.[18]

MENGË

54. Shpella karstike

Rreth 12 km në juglindje të Kavajës shtrihet një brez i ulët kodrinor me përbërje shkëmbinjsh gipsorë, ku njihen katër shpella karstike, tri pranë fshatit të Menges dhe një tjetër 2-3 km më tej, në Zikular.[19]



Fig. 3

Këto përbëhen nga galeri horizontale dhe përshkohen në taban nga rrëke uji. Gjerësia maksimale e tyre arrin 4-7 m, ndërsa lartësia 3 deri 4 m. Vendevende galeria paraqitet mjaft e ulët dhe e ngushtë. Në raste të tjera ajo përmban xhepa me përmasa më të mëdha. Në dy prej tyre kemi mundur të hyjmë 100-150 m.[20] Brenda jemi ndeshur me pamjen e bukur të stalaktiteve.

Pranë njerës, e quajtur Shpella e Kripës, gjendet një burim nga del ujë i kripur. Aty, në faqen e një sopi jo të lartë, nga rrëshqitja e dheut kanë dalë fragmente të një qeramike të rëndomtë mesjetare. Pranë Shpellës së Gipsave, në vendin e quajtur Merhoraj, shihen në sipërfaqe fragmente tjegullash të shekujve të parë të e.s.

LIS-PATROS

55. Mbetje të një fortifikimi ilir

Në krye të së përpjetës që duhet të ngjitë udhëtari për të arritur nga Menga në fshatin kodrinor të Lis-Patrosit, ekziston një vend i quajtur Paraporta e kalasë. Pak më poshtë këtij vendi dhe në një drejtim me vijën e kreshtës shkëmbore që i qëndron si paraprirë këtu majës së lartë (398 m mbi nivelin e detit), aty ku është hapur rruga e re, kemi vërejtur blloqe gurësh të latuar, kuadratikë (1.30x0.50x0.40 m dhe 0.28 x 0.38 x 0.40 m). Këto blloqe duket se përfaqësojnë këtu mbeturina të një muri 15 m të gjatë, që mbyllte kalimin, duke lënë të lirë rrëzë shpatit një hapësirë prej 2 m, në të cilën vërehet kalldrëm. Nga pjesët e mbetura, duket se kalldrëmi ka qënë i shtruar me gurë e pllloça.[21]

Përreth shihen fragmente qeramike antike, si fragmente solenesh të tipit helenistik. (Tab. II), fragmente pitosi e amfore.

Dyqind metra më poshtë, shtegu që i ngjitet kësaj majëkodre duket se është ndërprerë përsëri nga një mur, që linte kalim siç duket vetëm për kalldrëmin e përmendur. Muri ka mbetur në një gjatësi prej 4 m dhe lartësi 0.50 m. Ai është ndërtuar me dy këmishë prej blloqesh gjysmë të punuar dhe me hapësirën midis tyre të mbushur me gurë të vegjël e mesatarë. Gjerësia e tij është 2.20 m. Pranë vërehen përsëri fragmente solenesh dhe fragmente pitosi.

18. F. Miraj, **Stelë varri e fshatit Çetë,** «Adriatiku», 30 Korrik, 1981.
19. H. Myrto, **Shpellat karstike të Menges,** «Adriatiku», 11 Janar 1979 dhe 31 Janar 1982.
20. Në ekspeditë merrnin pjesë F. Tartari, F. Shaka dhe autori.
21. Në Menge një trakti të tillë kalldrëmi i thonë Vrom. Fjala «vrom» në leksikun e zonës do të thotë rrugë fshati, shteg, në një vend të dystë.

BOMOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

Në fasadën e një shtëpie më lart, në fshat, kemi parë një bllok guri të latuar, kuadratik (0.90 x 0.30 x x 0.25 m). Në faqen e dukshme të tij është gdhendur shkronja Θ (Fig. 3). Na thanë se guri është marrë nga muret e sipërpërmendur, që kohë më parë ruheshin në një lartësi të dukshme.

Nga këto të dhëna, jemi të mendimit se këtu kemi të bëjmë me mbeturina muresh fortifikues të tipit «barrierë». Funksioni i tyre, mendojmë ka qënë për të siguruar mbrojtjen e pjesës së sipërme të kodrës, ku është fshati, nga ndonjë rrezik që mund t'i kanosej nga poshtë dhe, po ashtu, për të bllokuar një nga kalimet prej fushës së Kavajës për në zonën e Pezës. Koha që i përkasin mendojmë se është ajo e shekujve IV-II p.e.s.

56. Gjurmë ndërtimi

Në njërën nga shtëpitë që ndodhen pikërisht në syprinën e kësaj kodre, ruhet një kapitel (Fig. 4). Vendgjetja e tij i përket një pike pranë, ku vërehen gjurmë ndërtimi: një pjesë e vogël muri (me gjerësi 0.50 m) ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje, si dhe fragmente tjegullash solene me buzë pak të harkuara. Ato përfaqësohen këtu nga fragmente të vogla, megjithatë në të dallohen vija të bëra me gishta para pjekjes.

Kapiteli është prej guri gëlqeror (B. 29 x 29 cm; diam. i b. 21 cm dhe L. 32 cm). Ai është zbukuruar me dy radhë prej tetë gjethesh akanthi secila dhe me voluta në katër cepat. Gjethet duket se janë të tipit me gjëmba të mprehtë. Në punimin e tij është përdorur turjela. Nga këto karakteristika jemi të mendimit se i përket antikitetit të vonë, shekullit V të e.s.

57. Mbeturina të manastirit të Petras

Rreth 3 km nga kjo pikë, në një luginë të pyllëzuar me shkurre, pranë një përroi të thellë, vërehen rrënojat e manastirit të Petras. Në gjendjen e tanishme, të mbuluar me ferra, ato duket se shtrihen në një sipërfaqe prej 200-300 m^2.

Në vend shihet një trakt muri me drejtimin jug-veri, i gjatë 2.40 m, i gjerë 1.10 m, i lartë 1 m. Muri është ndërtuar me gurë shtufi të vegjël dhe me madhësi mesatare, të lidhur me llaç gëlqereje. Gurët janë vendosur në rreshta gati të rregullta, me ndërfutje fragmentesh tulle e tjegulle.

Fragmentet e tullave janë prej një balte rozë, me trashësi 3.5-4.8 cm. Një tullë jo e plotë drejtkëndëshe ka përmasat 13 x 3.5 cm.

Emri i sotëm i fshatit Lis-Patros duket se vjen nga emrat e fshatrave Ilias dhe manastiri i Petras, të përmendur që në shekullin XV.[22]

22. H. Inalçik, **Hiçri 835 Suret-i Defter-i-Sancak-i Arvanid,** Ankara, 1954, nahija e Tomonishtës. Shih për manastirin e Petros edhe F. Cordignano, **Geographia Ecclesiastica d'Albania,** Roma, 1934, f. 260 (36).



Fig. 6

MLIK

58. Gjurmë të një fortifikimi ilir

Një vendbanim i vogël antik, që ruan gjurmë fortifikimi është vërejtur edhe në fshatin Mlik, rreth 15 km në juglindje të Kavajës. Kodra e Qishës në afërsi të këtij fshati që kufizohet nga përrenj e gryka të thella, ka formë pak a shumë piramidale dhe arrin lartësinë 447 m mbi nivelin e detit. Maja e saj, me ndonjë shesh apo teracë të vogël, që ka një sipërfaqe prej 0.7 ha mbrohet nga veriperëndimi prej një kreshte të thepisur shkëmbore (Fig. 5). Në anën jugore e juglindore të saj, në një vijë që ndjek konturin e terrenit, vërehen të shpërndara blloqe të mëdha gurësh.

Në anën veriore që është e pyllëzuar dendur me shkurre, mund të ndiqen me vështirësi mbeturinat e një muri pothuaj të rrafshuar, me gjatësi rreth 100 m dhe gjerësi mbi 2 m, që i afrohet nga perëndimi kreshtës shkëmbore. Tek ky mur janë përdorur gurë të çrregullt me madhësi të vogël e mesatare. Tre grumbuj të mëdhenj gurësh që shtrihen në distanca 30 m njera nga tjetri, anash linjës së këtij muri, nga jashtë, logjikisht i kemi marrë për mbeturina kullash.

Hyrja më e lehtë brenda këtij territori gjendej nga ana lindore, nga ana e fshatit të sotëm të Mlikut. Një portë natyrale në shkëmb e rregulluar edhe nga dora e njeriut, gjendet në krahun jugor të kreshtës shkëmbore.

Qeramika përfaqësohet kryesisht nga tjegulla dhe tulla të shekujve IV-II p.e.s. (Tab. II). Shihen gjithashtu edhe fragmente pitosash, amforash dhe enësh të vogla balte me vernik të zi, kafe e të kuq.

Në të njëjtën kohë këtu bie në sy dhe material ndërtimi i shekujve të parë të e.s. si dhe i antikitetit të vonë, shekujt V-VI të e.s., siç janë tjegullat e sheshta me buzë të harkuara në formën e quajtur «kokë zogu» e të zbukuruara në sipërfaqe me tufa vijash të valëzuara e zig-zake.

Nga këto të dhëna jemi të prirur që në shekujt IV-II p.e.s. këtë majëkodre ta konsiderojmë të fortifikuar dhe të rifortifikuar përsëri në periudhën e vonë antike. Në pjesën më të sipërme të vendit ruhen mbeturina themelesh të ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Këtë pikë vendasit e njohin me emrin «Muret e Qishës».

5. ZONA FUSHORE E KAVAJËS

QERRET

60. Mbetje të një kishe antike e vonë dhe mesjetare

Në të djathtë të rrugës automobilistike Golem-Kavajë, përballë Malit të Robit (kuota 62 m), në fushë, rreth 700 m nga buza e detit, në një sipërfaqe të gjerë (fig. 6) gjenden fragmente materiali ndërtimi dhe enësh balte. Materiali i përket kryesisht antikitetit të vonë dhe mesjetës. Megjithatë vihet re edhe qeramikë e shekujve të parë të e.s., e përfaqësuar sidomos nga fragmente tullash e tjegullash (Tab. II).[23]

Duke u nisur nga mbeturinat e themeleve, detajet arkitektonike dhe nga të dhëna të tjera, kemi shfaqur mendimin se këtu ruhen rrënojat e një kishe paleokristiane me vazhdimësi deri në mesjetën e mesme dhe se ky është vendi i kishës së Shën Todrit që përmendet në shekullin XI.[24]

Pranë kësaj pike, me rastin e ndërtimit të rrugës së re Durrës-Kavajë më 1901, janë zbuluar

23. H. Myrto, **vep. cit.,** f. 250-252.

24. H. Myrto, **Po aty.** Përsa i përket themelit në formë gjashtëkëndëshi, që në rastin e parë e kemi marrë si themel të një baptisteri të veçuar nga kisha, nga një hetim më i imët, kemi ndryshuar mendim: ky themel duhet t'i përkasi vetë absidës së kishës.

DO NOT COPY

themele muresh dhe është gjetur një thesar i vogël.[25]

61. Gjurmë të rrugës «Egnatia»

Nga vendi i quajtur «Qisha» e Qerretit deri tek përroi i Fosës në drejtim të Kavajës, në një distancë prej 4-5 km, mund të ndiqen gjurmët e një rruge të lashtë të shtruar me kalldrëm. Për këto gjurmë kemi shfaqur mendimin se i përkasin rrugës «Egnatia».[26]

RRAKULL

62. Trakt muri antik

Në të majtë të rrugës që të çon në Karpën, në thellësinë 1.5 m, është zbuluar një trakt muri i ndërtuar me blloqe të mëdhenj kuadratikë (0.80 x 0.50 x x 0.35 m dhe 0.50 x 0.40 x 0.30 m). Disa prej tyre në njerën faqe paraqesin gjurmë llaçi. Lartësia e pjesës së zbuluar të murit është 1 m, kurse gjerësia 0.60 m.

Mbi murin u gjetën fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të erës sonë, vegjë e funde amforash dhe fragmente enësh të vogla me vernik të kuq e kafe, po ashtu dhe një kosore hekuri.

KRIPORE

63. Depua e kripës

Në Atlantin e Kamocies gjejmë të shënuar në të njëjtin drejtim ku ndodhet sot Kriporja e Kavajës, fjalën «Saletta».[27] Sot këtu është ende në këmbë gëdina e vjetër e depos së kripës (Fig. 7) Mbi portën e saj ruhet një mbishkrim turqisht tepër i dëmtuar. Para portës janë ngulur dy kolona graniti.

Jo më tepër se 200 m në jugperëndim të depos së Kripës nga punimet për ndërtimin e rezervuarit të



Fig. 7

peshkimit, është evidentuar një ujësjellës me qyngja balte, që duket se vjen nga kodra e Karpenit dhe vazhdon në drejtim të bregut të detit. Me ujësjellës prej qyngjash balte të kësaj natyre jemi ndeshur edhe në pika të tjera të rrethit të Durrësit.

KAVAJË

64. Altarë varresh dhe pllaka me mbishkrime latine e greke

Lajmin e parë mbi një objekt sepulkral antik të zbuluar në afërsi të Kavajës e jep Hani.[28] Ai përmend një gur varri të punuar keq, me tri figura në basoreliev dhe me mbishkrim latin. Krahas tij, Hezej shton dhe një altar shumë të vogël portativ, një pllakë mermeri me mbishkrim latin si dhe një pllakë tjetër me mbishkrim grek.[29] Në mbishkrimin e altarit të vogël Hezei sheh të përmendet fisi AEMILIA. Mbishkrimi i tretë, që është greqisht mban datën 17 Shtator 531.[30]

Interesant është fakti se në të njëjtën kohë me këtë mbishkrim greqisht të periudhës së hershme bizantine në Kavajë, në Durrës vazhdojnë të shkruhen lapidarë latinisht.[31]

25. L. Rey, **Répertoire topo-bibliographique des antiquités de l'Albanie** «Albania», 1932, 4.
26. H. Myrto, **vep. cit.** f. 252.
27. Shih shënimin 3.
28. J.G. Hahn, **Studime shqiptare** (përkthim në Arshivin e Institutit të Historisë në Tiranë, A-III-6), f. 119.
29. L. Heuzey-Daumet, **vep. cit.,** f. 390-392, nr. 175, 176, 177.
30. Shih për këto mbishkrime dhe L. Rey, **vep. cit.,** si dhe P.C. Sestieri, **Mbishkrime latine të Shqipërisë,** në «Studime e tekste», Dega II arkeologjike, nr. 1, Tiranë 1943. Një pllakë dhe një altar varri me mbishkrime latine të gjetura vitet e fundit në periferinë e qytetit të Kavajës, janë në studim nga V. Toçi.
31. L. Heuzey-H. Daumet, **vep. cit.,** f. 391.

DO NOT COPY

65. Gjurmë ndërtimesh antike

Rreth 2 km në jugperëndim të Kavajës, në vendin e quajtur Bullutaj apo Blerime, 1 km nga rruga automobilistike që del prej Kavajës në drejtim të Rrogozhinës në një sipërfaqe prej 5 ha shihet një shumicë fragmentesh qeramike masive ndërtimi, e përfaqësuar nga fragmente solenesh me buzë pak të harkuara ose me buzë të ngritura vertikalisht lart si dhe fragmente tullash. Përveç këtyre vërehen fragmente amforash dhe enësh të vogla me vernik ngjyrë kafe të dobët.

BUKAQ

66. Qeramikë antike

Ky fshat gjendet mbi një sop apo kodrinë të ulët 1/2 ore në perëndim të Kavajës. Të dhënat gojore flasin për themele të vjetra, varre dhe për një «kolonë», që nuk kemi mundur t'i vërtetojmë. Në sipërfaqe kemi vërejtur fragmente qeramike të antikitetit të vonë.[32].

SHTODHËR

67. Varrezë e shekujve të parë të erës sonë

Në faqen perëndimore të kodrinës së Shtodhërit, fshati i parë në të majtë të rrugës automobilistike që del nga Kavaja në drejtim të Rogozhinës dhe jo më larg se 2-3 km nga ky qytet, janë zbuluar rastësisht varre të mbuluar me tjegulla.[33] Kjo pikë ndodhet pikërisht poshtë vendit që mban emrin e një kishe të Shën Todrit, nga e cila siç duket i ka mbetur emri fshatit.

KRYELUZ

68. Gjurmë ndërtimesh antike

Në bregun e majtë të lumit të Darçit, aty ku nga lugina e tij ky del në fushën e Kavajës, në një sipërfaqe të sheshtë prej afërsisht 4 ha, që shtrihet deri rrëzë kodrinës së Kryeluzit, shihet një shumicë fragmentesh qeramike antike (Tab. II). Ky vend ndodhet 200-300 m në anën juglindore të urës hekurudhore dhe të asaj automobilistike (Tab. III). Në dy kanale kullues që kalojnë këtu paralelisht me hekurudhën, kemi vënë re se shtresa që përmban fragmente tullash dhe tjegullash antike, fragmente enësh balte e copëra qelqi arrin deri 1.80 m thellësi.

Në sasi të mëdha vërehen fragmente tullash me trashësi 3.5-5 cm dhe 7.5 cm[34] Tjegullat mund të ndahen në tre tipe (Tab. II); solene (60-70 cm x x 38-40 x 2-2.5 cm), të zbukuruara në faqe me 2-3 vija të cekta të bëra me gishta para pjekjes; tjegulla të sheshta me buzë të ngritura vertikalisht lart; tjegulla të harkuara që kanë të vizatuar nga brenda një shenjë sinusoidale të bërë me dy gishta para pjekjes.

Llaçi që vërehet ngjitur pas tullave është përgatitur me gëlqere, të përzierë herë me rërë të imët e të pastër dhe herë me rërë të papastër, të trashë e me guralecë.

Tullat dhe tjegullat e Kryeluzit mendojmë se paraqesin karakteristika të njohura në të tilla materiale ndërtimi të përdorura në vendin tonë gjatë shekujve I-III dhe IV të erës sonë.[35] Në Durrës tulla dhe tjegulla të ngjashme janë gjetur në nekropolin e shekujve I-III e.s. pranë kënetës së dikurshme.[36] Tjegulla si këto dhe kaliptere të vizatuara nga brenda pranë buzës me shenjën që përmendëm, shihen edhe në termat publike të Durrësit që u takojnë shekujve të parë të e.s.[37] Material si ky dhe që datohet në

32. Midis këtyre përmendim një fragment buze pitosi zbukuruar me vija të valëzuara me incizim.
33. Tjegullat e varrezës së Shtodhërit janë solene pak të harkuara me buzë të kthyera lehtë nga brenda, që e kanë trashësinë sa vetë ajo e tjegullës, 2 cm. Gjerësia e tyre është 40 cm. Në faqe dhe në shpinë janë zbukuruar me breza në trajtë sinusi ose sinusi të dyfishtë (Tab. II). Po ashtu ka dhe tjegulla me kurriz të harkuar që e kanë gjatësinë e harkut 26 cm. Inventar në varret e zbuluar nuk është gjetur.
34. Një tullë e plotë në trajtë katrori, 27 x 27 x 3.5 cm, ka në faqe dy kanale diagonalë.
35. A. Mano, **Të dhëna mbi qeramikën masive të Apollonisë përdorur si material ndërtimi,** «Studime historike» 1965/1, f. 59, 65-67, dhe Tab. II, XII-XV.
36. F. Tartari, **Rezultatet e gërmimeve të vitit 1971 në skajin verilindor të qytetit të Durrësit,** «Buletin arkeologjik» 1971, f. 103, 115.
37. V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir në Dyrrah nën dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** «Konf. e Parë e Stud. Alb. (Nëntor 1962)», Tiranë 1965, f. 462.

DO NOT COPY

fillimin e shekullit IV të e.s. është gjetur dhe pak më tej Kryeluzit, në Harizaj (shih më poshtë).

Edhe qeramika e përdorimit të përditëshëm e Kryeluzit datohet në shekujt e parë të erës sonë.[38] Në faqet e kanaleve, në thellësinë 1-1.20 m, duket një brez toke zallishte me mbeturina të theksuara zjarri dhe vende vende kocka njerëzish.

Në bregun tjetër të lumit, nga ana e Kavajës, rreth 150 m mbi urën e hekurudhës dhe po kaq larg nga lumi, një kanal kullues në thellësinë 1 m pret një kalldrëm të ndërtuar me gurë të mëdhenj e zhavor. Ky duket se ka një gjerësi më të madhe se 6 m. Ndërtimi dhe drejtimi i tij na bëjnë të mendojmë se i takon «Via Egnatias» që pikërisht këtu siç duket e kapërcente lumin e Darçit mbi një urë.[39] Më në fund, shtojmë se largësia e këtij vendi nga Durrësi, simbas gurëve të distancave në rrugën hekurudhore, është ekzaktësisht 23 km.

Nga sa thamë më lart, mund të nxjerrim si përfundim se në këtë pikë ka shumë mundësi të ndodhemi para gjurmëve të stacionit të parë të rrugës Egnatia pas Durrësit. Distanca e këtij stacioni nga «Dyrratio» në Tabula Peutingeriana është dhënë baraz me XV m.p[40]) (Tab. III) që bëjnë rreth 23 km.

Në Tabula Peutingeriana këtij stacioni nuk i është vënë emri. Aty mungon edhe distanca prej Durrësit apo udhëkryqit pranë tij deri në vendin ku dega e rrugës që shkon për Apoloni pret lumin Genus (Tab. III) dhe ku tek Anonimi i Ravenës gjejmë të shënuar «Genesis fl.»[41]

Për korigjimin e këtyre boshllëqeve të Tabulas, që mund të jenë shkaktuar gjatë rikopjimeve të saj, janë bërë përpjekje të ndryshme. Kështu është plotësuar distanca prej Durrësit deri në bregun e Genusit, duke zhvendosur shifrën e parë të rrugës «Egnatia», atë prej 15 mijë hapash.[42] Tani vonë është shfaqur mendimi se kjo distancë duhet plotësuar me shifrën e dytë të rrugës «Egnatia» me atë prej XXVI m.p., duke zhvendosur gjithashtu edhe të parën.[43]) Një përpjekje tjetër është ajo e disa studiuesve që kanë supozuar se Genusi në antikitet kalonte nëpër fushën e Kavajës dhe derdhej në gjirin e Durrësit. Në këtë mënyrë është shfaqur mendimi se stacioni i Tabulas me shifrën XV ndodhej në breg të Genusit (diku pranë Harizajt) dhe, prandaj, mbante emërin e atij lumi.[44] Në pajtim me këtë mendim është edhe ai që stacionin «Genesis fl» dhe pikën ku rruga bregdetare ndahej nga «Via Egnatia» i merr jo larg njera tjetrës.[45] Duke arsyetuar po në këtë mënyrë për rrjedhjen e Genusit në periudhën antike, kohët e fundit është sugjeruar se stacioni në fjalë, me emrin e Genusit, duhet kërkuar pranë Shtodhërit.[46]

Po të pranohet identifikimi ynë i stacionit me distancë XV m.p. nga Dyrrahi me Kryeluzin, në bregun e majtë të Darçit, atëhere në përgjithësi në llogaritjet dhe supozimet e sipërpërmendura nuk ka veçse një mospërputhje prej dy-tre km. Përsa i përket rrjedhjes së Genusit në periudhën antike, ne jemi të mendimit se është pak a shumë po shtrati i sotëm. Prandaj emri i stacionit në Kryeluz, nuk mund të jetë «Genusi».[47]

HARIZAJ

69. Varre të shekujve të parë të erës sonë

Nga hapje taracash në Kodrën e Vake, 300 m në lindje të hekurudhës, janë zbuluar dy varre.[48]

38. Nga anët e mëdha vërehen fragmente amforash. Vërehen po ashtu mori fragmente enësh të vogla tavoline, nga një herë të lyera edhe me një vernik të hollë në ngjyrë të kuqe a kafe të çelët, vegje brinake, fragmente **terrasigillata** dhe copëra flakonesh qelqi.
39. C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien 1920, f. 119 përmend një urë mbi Darç, që e datonsi të mbarimit të kohës së lashtë.
40. **Tab. Peut.,** në «Ilirët dhe Iliria», Tiranë 1965, f. 312.
41. Ravenatis Anonymi, **Cosmographia,** V. 13.
42. K. Miller, **Itineraria Romana,** Stutgard 1919, 519.
43. H. Ceka, **Dega jugore e rrugës Egnatia,** Monumentet 2, Tiranë 1971, f. 29.
44. G. Veith, **Der Feldzug von Dyrrhachium zwischen Caesar und Pompeius,** Wien 1920, f. 36, 37 dhe 59.
45. C. Praschniker, **vep. cit.,** f. 125-126.
46. N.G.L. Hammond, **A History of Macedonia,** vol. I, Oxford 1972, f. 23 dhe 26.
47. Tradita gojore ruan për këtë vend toponimin Margullidë dhe kujtimin e një panairi që zhvillohej aty.
48. Si shtroje e varrit të parë shërbente një tjegull solene e tipit të shekujve të parë të e.s. Ajo ka përmasat 0.70 x 0.40 x 0.025 m dhe është e zbukuruar me braza paralele të bëra me gishta para pjekjes. Po në atë varr u gjet një tullë trekëndëshe me përmasat 21 x 21 x 29 x 4 cm. Si inventar i këtij varri na është dorëzuar një monedhë bronxi e Konstantinit të Madh (305-337).

FOTOCOPY

DO NOT COPY



Fig. 8

LUZ I VOGËL

70. Sopi i Luzit

Rreth 500 m në perëndim të rrugës automobilistike Kavajë – Gosë, në drejtim të lagjes së Ujqëve, është një sop në fushë, me diametër afërsisht 100 m dhe lartësi 5 m. Në sipërfaqen e papunuar të sopit kemi vërejtur fragmente tjegullash të shekujve të parë të e.s., fragmente enësh të holla balte dhe një fragment pitosi.

71. Mbetje të një ndërtese të shekujve të parë të e.s.

Një kilometër e gjysmë në perëndim të rrugës automobilistike që përmendëm më lart dhe në të majtë të rrugës që të çon për në Luz të Vogël, me rastin e hapjes së një kanali kullues, 1 m i thellë, është parë një themel muri me gurë.[49]

LUZ I MADH (SHKOZET)

72. Dysheme e një ndërtese antike

Në vitin 1973, nga dystimi i një sopi të vogël në fushën që zinte dikur këneta e Zhabjakut, rreth 2.5 km në perëndim të rrugës automobilistike Kavajë-Rogozhinë, u zbulua një dysheme 5 x 5 m, e shtruar me tulla trungpiramidale. E shtruar në këtë mënyrë (Fig. 8), ajo të kujton formën e hojeve të bletës. Tullat kanë baza në formë gjashtëkëndëshi të rregullt (e poshtmja me brinjët 3.1 cm, e sipërmja 3.6 cm, lartësia 4.5 cm). Këto kanë qënë ngjitur mbi një shtresë llaçi gëlqereje të përzier me rërë të trashë e thërmia qeramike. Ky tip tulle është njohur në Durrës, por nuk dimë të jetë njohur në ndonjë qendër tjetër antike të vendit.

Mbi dyshemenë e zbuluar dhe përreth u vërejtën një shumicë fragmentesh qeramike.[50] Një copë tulle me trashësi 4.5 cm mban një kryq në reliev. Disa fragmente tjegullash janë zbukuruar me tufa vijash paralele që duken të incizuara me një mjet si pirun. Nga sa shihet, mendojmë se këtu ndodhemi para mbetjeve të një **«villa rustica»** e shekujve II-V e.s.

GOSË

73. Varrezë e shekujve të parë të e.s.

Në të majtë të rrugës që shkon për Rogozhinë para disa vjetësh janë hasur varre të shekujve të parë të e.s.[51]

---

49. Përreth kishte fragmente qeramike të ngjashme me ato të Kryeluzit. Ndërmjet tyre ka fragmente të trasha pitosi, fragmente pjatash prej balte të kuqe, vegje me kanelyra dhe të lyera me një bojë kafe, funde me këmbë të lartë si të gotave të pijes etj. Në mes të një fundi tasi me këmbë unazore është incizuar shenja. Δ.
50. Fragmentet e enëve të baltës që shihen këtu janë si ato të Kryeluzit. Kemi gjetur vegje brinake në ngjyrën natyrale të baltës dhe fragmente **terrasigillata** me ngjyrë të kuqe e kafe. Një fragment pareti pitosi me trashësi 3.5 cm na njeh me një formë restaurimi antik të këtyre enëve. Ky fragment përbëhet nga dy copë të thyera që janë tejshpuar në dy-tri pika e në të është derdhur plumb. Këto pika janë lidhur pastaj, si nga faqja e jashtme edhe e brendshme, me shirita po prej plumbi.
51. Inventari i tyre ruhet në muzeun arkeologjik të Tiranës.

DO NOT COPY

ROGOZHINË

74. Gjurmë rrënojash antike

Në lugun që formohet me kodrën e Tunelit në veri dhe me kodrën e Sokolit në anën lindore e jugore, nga punimet bujqësore kanë dalë materiale ndërtimi të fragmentuara, një gur mermeri me mbishkrim latin dhe objekte të tjera, që shihen të shpërndara në një sipërfaqe prej 1-2 ha.[52]

Brenda një përroi të vogël, që i shkon anash kësaj sipërfaqeje, në thellësinë 1.5 m, kemi vërejtur një trakt muri me gjerësi 0.60 m, ndërtuar me gurë shtufi të vegjël e mesatarë të palidhur me llaç.

Guri me mbishkrim (Tab. IV) i gjetur aty pranë, (0.86 x 0.26 x 29 m) ka përafërsisht trajtë paralelopipedi i prerë rrafshët vetëm në anën e majtë (të shikuesit) si dhe në anën e sipërme, ku ka në qendër një gropëz drejtkëndëshe. Në pjesën e poshtme të faqes së parme ruan linja të një kornize, ndërsa pjesa e sipërme ku është dhe mbishkrimi paraqitet e gufmuar. Poshtë mbishkrimit është paraqitur një figurë në trajtën e një pasqyre. Guri duket se është i ripërdorur.

Mbishkrimi vazhdon edhe në faqen e djathtë anësore. Atë e lexojmë në këtë mënyrë:

D(OMINO) N(OSTER) GAL(ERIO) VAL(ERIO)
M(AXIMIANO) INV(ICTO) AVG(VSTO) ETD(OMI-
NO) N(OSTER) GAL(ERIO) [VALERIOMAXIMIA-
NO] AVG(VSTO) E(IS) I(NDEX) V(ICI) S(ITV) ET
MAI (RVM) [ET SOR] ORORVM

Nga ky lexim del se mbishkrimi ka karakter votiv. Ai u është kushtuar perandorëve me origjinë ilire Galer, i cili sundoi në tetrarki pas abdikimit të Dioklecianit (305-311) dhe nipit të tij, djalit të motrës, që ai e adoptoi dhe i dha emrin e vet, edhe ky Cezar (305-309)[53] dhe August (309-313), po ashtu nënave dhe motrave të tyre, të cilat në të dy rastet ishin nëna e bija. Koha e mbishkrimit duhet të jetë viti 310 ose 311, kur Galeri I jetonte dhe Galeri II e kishte marrë titullin august.

Gropëza që paraqet guri në pjesën e sipërme tregon se mbi të do të ketë qënë vendosur ndonjë skulpturë simbolike. Nuk përjashtohet që në këtë rast të kemi të bëjmë dhe me një gur miliar por nuk shohim tregues të plotë për ta thënë me siguri.

Materiali i ndërtimit që shihet në sipërfaqe, përfaqësohet nga fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të e.s. Një fragment tjegulle e sheshtë, me trashësi 2 cm, mban një vulë të pjesëshme epigrafike: **SANO...** Shtojmë se këtu janë të dukshme edhe gjurmët e një zjarri shkatërrimtar. Përzier me këto gjurmë kemi vërejtur kocka njerëzish dhe një majë heshte hekuri (Tab. III).

Duke gjykuar në tërësi nga karakteri i qeramikës si dhe nga mbishkrimi, jemi të mendimit se ato i përkasin një vendbanimi të vogël përbri rrugës «Egnatia», i shekujve II-IV e.s. Ka mundësi që fundi i tij të ketë ardhur me dhunë.

75. Një trakt muri dhe një altar varri me mbishkrim

Kjo pikë ndodhet 2 km në të dalë të Rrogozhinës me drejtim për në Kavajë, tek vendi i quajtur Bishti i Zhurit, 30 m në të majtë të rrugës automobilistike. Këtu, nga hapja e një kanali me drejtim lindje-perëndim, në thellësi 3 m, ka dalë një trakt muri i ndërtuar me tulla, mjaft material i fragmentuar ndërtimi dhe një altar varri me mbishkrim latin.

Trakti i murit u pa në faqen veriore të kanalit për 4 m gjatësi, në thellësinë 1.80 m. Muri ka qënë ndërtuar me tulla të vendosura në radhë të rregullta. Lidhja e tyre është bërë me llaç gëlqereje përzier me pluhur tullash. Llaçi formonte fuga me trashësi sa tullat, 3.5 cm. Sipër këtij trakti u vërejt një shtresë dheu me mbeturina të theksuara zjarri.

Midis materialit të rxjerrë në sipërfaqe u gjetën tulla të mëdha (46 x 46 x 6 cm), të përdorura siç duket për shtroje dyshemeje. Tulla të tilla të zbuluara në Apoloni u përkasin shekujve të parë të e.s.[54]

Karakteristike janë një numër tullash të vogla paralelopipedi (11 x 7 x 2.7 cm dhe 9.5 x 6 x 3 cm) (Tab. II). Tulla të ngjashme, por me përmasa 8.7 x 5 x 0.2 cm janë përdorur në shtrimin e një dyshemeje me motivin «kurriz peshku» në termat publike të Dyrrahut. Në Romë ato kanë qënë një prodhim i rrallë dhe përdoreshin për shtrim dyshemesh në godinat e rëndë-

52. Kemi mbledhur fragmente kotylesh me vernik të zi, fragmente enësh me vernik të kuq, vegje me kanelyra, vegje me motiv litari, një unazë hekuri etj. (Tab. IV).
53. Orosi, VII, 25.
54. A. Mano, **Vep. cit.**, f. 68.

sishme, siç është rasti në Vila Adriana.[55] Në sipërfaqe shihen dhe mjaft fragmente enësh balte.[56]

Rreth 40 m më në lindje, po në atë kanal, u zbulua një altar me mbishkrim, që u gjet **in situ** (në thellësinë 1.80 m), i vendosur mbi bazamentin e tij. Altari është prej mermeri të bardhë me rremba gri 1.20x0.60x0.80 m) (Fig. 9). Në anën e përparme të tij, brenda një kornize katrore 55 x 55 cm përmbahet një mbishkrim latin në 8 rreshta. Në pjesën e sipërme altari është i rrumbullakuar dhe ka tri gropëza të vogla të vendosura në formë trekëndëshi. Kjo e dhënë na bën të mendojmë se mbi të ka qënë vendosur një tripod.

Bazamenti mbi të cilin ishte vendosur altari, është prej guri gëlqeror dhe ka formën e paralelopipedit 1.28 x 0.64 x 0.30 m. Në faqen e sipërme të bazamentit, ku ishte mbështetur altari, u gjet një petëz prej plumbi, i përdorur siç duket me qëllim për ta përforcuar lidhjen midis tyre. Këtë qëllim tregojnë siç duket dhe katër gropëza të vogla me gjurmë plumbi që shihen në mesin e katër anëve të poshtme të altarit si dhe katër të tjera në një drejtim me to tek bazamenti.

Mbishkrimi 8 rreshtësh paraqitet i dëmtuar, tepër i fshirë sidomos në rreshtat e sipërm:

. . . . . ET CAIVS
. . . . . .
FILIOCAIS...
E(IVS)I(NDEX)N(ATALIBVS)DIVSVITALIS. . . .

Tripodi mbi altar tregon se kushtuesi i ishte drejtuar Mërkurit, në këtë rast ndoshta si mbrojtës i udhëtarëve.

76. **Mbetje ndërtesash antike**

Kjo pikë ndodhet në juglindje të Rogozhinës, 300 m në të majtë të rrugës që shkon për Peqin, përkundrejt fshatit Thanaj që ndodhet në bregun tjetër të Shkumbinit. Vendasit i thonë Çezma e Thatë. Në këmbët e kodrës vërehen mbeturina muresh të ndërtuar me gurë të rregullt të vegjël, të lidhur me llaç gëlqereje dhe fragmente tjegullash karakteristikë për shekujt e parë të e.s.



Fig. 9

Rreth 100 m poshtë kësaj pike, në fushë, në një sipërfaqe afërsisht 0,8 ha, vërehen përsëri fragmente tullash, tjegullash dhe enësh balte të ngjashme me ato që përmendëm në dy pikat e tjera të Rogozhinës. Gjurmë ndërtimesh me tulla janë ngritur dhe në anën e djathtë të rrugës.

Një tubacion prej qyngjesh balte konstatohet në thellësinë 0.80 m, i shtrirë nga këmbët e kodrave në drejtim të rrugës. Qyngjet e baltës së këtij ujësjellësi kanë përmasat: gjatësi 33 cm, diametri i madh 12 cm, diametri i vogël 10 cm.

Ndërtesat që nënkuptohen këtu nga gjurmët që përmendëm më lart duket se ndodheshin përbri rrugës Egnatia,[57] e cila këtu ka mundësi të ketë pasur po linjën që ka rruga e sotme. Qyngjet e baltës mendojmë se i përkasin një ujësjellësi mesjetar.

55. G. Lugli, **La tecnica Edilizzia Romana,** Roma, 1957, f. 551.
56. Nga fragmentet e qeramikës së përdorimit të përditëshëm në këtë pikë përmendim një fragment vegjeje amfore me një vulë të pjesëshme me mbishkrim: L. FOS... Edhe këtu kemi gjetur vegje brinake, që brithi lart përfundon me majucë.
57. Për një kthesë të mundshme të rrugës «Egnatia» në këtë pikë për të kapërcyer lumin në drejtim të fshatit Thanaj, shih N.G.L. Hammond, **vep. cit.,** f. 3.

DO NOT COPY

6. ZONA KODRINORE E KRYEVIDHIT

KARPËN

77. Varrezë antike; një këmbanë kishe mesjetare

Ky fshat ndodhet rrëzë kodrave, në skajin më verior të këtij masivi, jo larg bregut të detit. Nga punimet bujqësore këtu është vërtetuar ekzistenca e një varreze antike. Varret kanë qënë mbuluar me tjegulla dhe janë datuar në shekujt I-III e.s.

Në këtë fshat është gjetur dhe një këmbanë bronxi, që mban datën: MCCCCLXV (1465).[58] Aty gjenden dhe rrënojat e një kishe mesjetare.

KEPI I LAGJIT

78. Gjurmë të një ndërtese antike

Në faqen e butë të kodrës që zgjatet në veri të kalasë së Turrës, buzë gjirit të vogël dhe shumë të bukur të Bardhores, gjendet një burim që vendasit e thërrasin «Krroi i Carinës». Burimi është përgjysmë i mbuluar me një kube të vogël prej gurësh të crregullt të lidhur me llaç dhe ka ujë të preferuar.

Në anën veriore të tij, në një sipërfaqe prej 0.2-0.3 ha vërehen gurë të vegjël e mesatarë dhe fragmente tullash e tjegullash.[59] Tjegullat duket se në më të shumtën e rasteve janë tipike për shekujt I-IV e.s., por vërehen edhe fragmente tjegullash të zbukuruara me incizim tufa vijash paralele, që mendojmë se u përkasin shekujve V-VI të e.s.

79. Kalaja e Turrës

Mbeturinat e kësaj kalaje mesjetare në kepin e Lagjit nuk janë studiuar. Vetë emri i këtij kepi përmendet që nga mesi i shekullit XIV, me një skelë sekondare që frekuentohej nga raguzanët.[60] Por toponimi «Carinë» që kemi gjetur në gjirin e vogël, nga ana veriore, dëshmon ndoshta se është përdorur si skelë dhe ka pasur një zyrë doganore kohë më parë, që në periudhën e sundimit serb të Stefan Dushanit, apo më parë, në kohën e sundimit bullgar.

Në burimet historike nuk bëhet fjalë për kështjellë në kepin e Lagjit, por flitet për fillimin e ndërtimit të një kështjelle nga shqiptarët më 1364 në jug të Durrësit, në kepin e Meliarit (caput Meliarum).[61] Pastaj, në shekullin XV, flitet për ekspedita raguzane ndaj domeneve të Nikita Topisë, në kepin e Melies.[62] Në një dokument të shekullit XVI në kepin e Lagjit gjejmë të shënuar «Castel di Raguseo», ndërsa në veri të tij, brenda gjirit të Durrësit, një pikë bregdetare mban emrin «Mulir».[63] Emri i fshatit Turnah, i regjistruar këtu nga turqit më 1431-32,[64] mendojmë se ka në rrënjë «turris» dhe indirekt dëshmon për ekzistencën e një kulle apo kështjelle.

Emri Melie ose Meliar, me sa kemi mundur të hetojmë, nuk ruhet në toponiminë e zonës. Dhe as gjurmë të ndonjë kështjelle tjetër, përveç asaj të Turrës, nuk kemi hasur. Për mendimin tonë «Meliari» nuk është gjë tjetër veçse «muliri» dhe do ta identifikonim me kepin e vogël të Barbahutës në Karpën. Por ky kep, gjeografikisht është vështirë të ndahet nga njësia më e madhe, e njohur si kepi i Lagjit. Nga kjo do të thoshnim se kështjella për të cilën bëhet fjalë në burimet është vetë kalaja e Turrës.

80. Varrezë e periudhës qytetare ilire

Në një rrpirë kodre, tek vendi i quajtur Hurat e Bejës, në fshatin Bardhor, kemi vërejtur një grumbull fragmentesh qeramike antike dhe kocka të dala në sipërfaqe nga rrëshqitja e dheut. Mbi një fragment barku pitosi dallohet një mbishkrim i realizuar me gërvishtje:

---

58. F. Tartari, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit,** «Adriatiku» (almanak), Durrës, 1980, f. 75.
59. Qeramika e përdorimit të përditëshëm në këtë pikë përfaqësohet nga fragmente pitosash e amforash, nga fragmente enësh me ngjyrën natyrale të baltës dhe nga fragmente **pseudoterrasigillata.** Një fragment buzë pitosi është zbukuruar nga sipër me një tufë vijash të valëzuara. Kurse një fragment amfore është zbukuruar me tre breza paralele prej gropëzash të bëra me gishta.
60. A. Ducellier, **La façade...,** f. 576.
61. **Acta et diplomata res Albania mediae aetatis illustration,** Vjenë 1913, II. Shih dhe A. Ducellier, **La façade...,** f. 477.
62. **Po aty,** f. 576.
63. Shih shën. 3 më lart
64. H. Inalçik, **Suret-i defter-i...,** nahija e Izminit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ΧΑΙΡΕΑΣΚ

Materiali mendojmë se i përket një varreze dhe datohet në shekujt III-I p.e.s.

HAJDARAJ

81. Çekan guri

Në këtë fshat që ndodhet rreth 6 km në jugperëndim të Kavajës, rrëzës lindore të kodrave të Kryevidhit është gjetur një çekan sopatë prej guri të lëmuar.[65] Vendi i gjetjes është rreth 1 km në jugperëndim të shkollës së fshatit. Në anën e përroit nga vendasit është hapur një gurore. Kërkimet tona në atë territor nuk kanë dhënë rezultat për gjurmë prehistorike.

82. Varrezë

Në lagjen e Gjeçe para 15 vjetësh janë gjetur varre që na janë përshkruar «të mbuluara me pllaka guri». Nga inventari i tyre është ruajtur vetëm një lakrimore balte me trup gati sferik.[66] Ky objekt mendojmë se e daton varrezën në shekujt V-IV p.e.s.

RRETH – GRETH

83. Gjurmë ndërtimesh antike

Ky fshat ndodhet në anën perëndimore të këtyre kodrave, rreth 6 km në verilindje të kalasë së Bashtovës. Këtu, në fundin e kodrës së quajtur «Boka» rrëzë rrypit të fushës që e ndan këtë vend nga buza e detit, vërehen mbetje ndërtimesh antike. Vende vende aty ku gërryerjet e erozionit janë më të theksuara, shihen mbeturina muresh me blloqe gurësh të vegjël kuadratikë të latuar, si dhe me tulla. Këto gjurmë shtrihen në një sipërfaqe prej 2-3 ha. Në sasi të konsiderueshme bien në sy fragmente solenesh. Po ashtu shihen dhe fragmente kalipteresh të tipit «korintik». Nga enët e baltës përmendim fragmente pitosash e amforash si dhe fragmente enësh të vogla me ngjyrën natyrale të baltës ose të lyera me vernik kafe. Këto gjurmë mendojmë se u përkasin shekujve IV-I p.e.s.

ZHABJAK

84. Qeramikë masive dhe objekte të tjera

Nga gjetje rasti dhe sondazhe të kryera në këtë fshat është grumbulluar një material me interes arkeologjik. Përveç fragmenteve prej enësh balte të datuara në shekujt III-I p.e.s., si dhe në shekujt e parë të erës sonë, është gjetur dhe një solenë e plotë (0.70 x 0.42 x 0.035 m)[67]

Spanesh – Kazije

Ndërmjet fshatrave Spanesh dhe Kazije, në veri të rezervuarit, kanë dalë në sipërfaqe tulla të mëdha (44 x 44 x 6 cm), prej një balte të kuqe e pjekur shumë mirë, me disa brimëza të vogla në sipërfaqe. Gjenden gjithashtu fragmente lastrash mermeri dhe fragmente tjegullash të sheshta të zbukuruara në sipërfaqe me vija të valëzuara që kryqëzohen. Ngjitur pas tullave dhe lastrave të mermerit ruhen mbeturina llaçi gëlqereje përzier me pluhur tulle.

Pak më lart, në afërsi të Spaneshit, tek vendi i quajtur Ftohosinë, shihen në sipërfaqe fragmente qeramike të shekujve të parë të e.s. Në afërsi kemi gjetur një vegjë amfore me vulë epigrafike: DORA. .

LINËZ

85. Objekte prehistorike

Në faqen jugore të masivit të kodrave të Kryevidhit, jo shumë larg fshatit Ballaj dhe bregut të djathtë të Shkumbinit, tek vendi i quajtur Linëz, është gjetur një sopatë bipene hekuri si dhe një varëse bronxi e tipit «kafaz» (Tab. II) që datohen në shekujt VIII-VII p.e.s. Jo larg këtij vendi është gjetur kohët e fundit një çekan-sopatë guri me brimë, si ai i Hajdarajt.

BALLAJ

86. Gjurmë ndërtimesh antike

Në kodrinën e ulët pranë urës së Çopanit, që është pika më juglindore e këtij masivi kodrinor, jo më larg se 100 m nga bregu i Shkumbinit, nga pu-

65. V. Toçi, **Të dhëna mbi elementin ilir...**, f. 103.
66. Në pjesën më të gjerë përshkohet nga dy breza verniku kafe të dobët.
67. S. Hidri, **Zhabjaku në hartën arkeologjike,** «Adriatiku», 12 Maj 1977 dhe kumtesë në sesionin shkencor të muzeut arkeologjik të Durrësit, 1979 (e pabotuar).

nimet bujqësore kanë dalë në sipërfaqe materiale ndërtimi dhe fragmente enësh balte antike. Ato vazhdojnë poshtë, në këmbët e kodrës duke zënë afërsisht një sipërfaqe prej 2-3 ha. Në një pikë brenda kësaj sipërfaqeje është zbuluar një pjesë dyshemeje e shtruar me llaç përzier me pluhur tulle.

Në përgjithësi fragmentet e tullave dhe të tjegullave u përkasin shekujve të parë të e.s. (Tab. II)[68]

Në fundin e kodrinës, jo më larg se 30 m nga shtrati i lumit, në një gropë të thellë 5 m, doli një trakt muri i ndërtuar me tulla e llaç gëlqereje, të cilin mundëm ta ndiqnim në një gjatësi deri 4 m. Trashësia e tullave, që janë prej një balte jo të pastër dhe të pjekura dobët është 8-10 cm, e fugave të llaçit 2 cm.

Fundi i kësaj grope që ka një nivel me shtratin aktual të lumit, është lymor me ngjyrë të verdhë në okër. Ky fakt mund të merret si provë e kalimit të lumit në këtë vend që para ngritjes së qendrës që përfaqësohet nga gjurmët e mësipërme.

Këto gjurmë na shtyjnë të mendojmë se është kjo pikë siç duket që në antikitet mbante emrin «Genus».[69] Por ka mundësi që emrin e Shkumbinit të Lashtë ta ketë mbajtur gjithë zona breglumore Ballaj-Rreth-Greth (për mendimin tonë Shkumbini në antikitet është derdhur pranë kënetës së Rreth-Grethit). Sidoqoftë gjurmët e ndërtimeve të shekujve të parë të e.s., që vërehen në Luzin e Vogël, në Luzin e Madh dhe Ballaj (shih hartat, Tab. II), mendojmë se tregojnë drejtimin e degës së rrugës Egnatia për Apoloni, pas kthesës që bënte ajo në bregun e Darçit.

VILË – BASHTOVË

87. Varrezë antike

Pranë shkollës 8 vjeçare të fshatit Vilë, me rastin e hapjes së themeleve për ndërtimin e godinave të reja të banimit, u zbuluan disa varre. Nga inventari i tyre ruhen në muzeun historik të fshatit një lekyt dhe një ojnohe me vernik të zi, që datohen në shekujt III-I p.e.s.

Ky vend ndodhet rreth një kilometër e gjysmë nga kalaja e Bashtovës.

88. Gjurmë të një ndërtese antike

Në faqen e «shpatit të Vilës», një kodër e butë e me pjerrësi të vogël, rreth 2 km nga bregu i Shkumbinit, vërehen fragmente materiali ndërtimi dhe qeramikë antike shpërndarë në një sipërfaqe prej 0.2 ha. Vendi njihet me emrin «Trojzë».[70]

Vërehen me shumicë fragmente solenesh dhe kalipteresh të shekujve të parë të e.s. Ndër fragmentet e tullave karakteristike janë ato me formë rrethore (20 x 3.5 cm).[71] Enët e baltës përfaqësohen nga fragmente amforash si dhe enësh tryeze të lyera me vernik kafe ose të kuq.[72]

Jemi të mendimit se këtu, në Trojzet e Vilës, ndodhemi para mbeturinave të një **villa rustica** e shekujve I p.e.s.-I e.s. që mund të ketë mbijetuar edhe më pas.[73]

89. Kodra e Gjone

Kodra që ngrihet në anën veriore të kalasë së Bashtovës, jo më larg se 1 km prej saj, ruan gjurmë ndërtimesh antike. Këto gjurmë vërehen në faqen veriore e perëndimore, si dhe në anën e saj jugore. Në faqen veriore shihen fragmente tullash e tjegullash të periudhës qytetare ilire, të shpërndara në një sipërfaqe prej 2-3 ha. Po ashtu shihen të shpërndarë edhe blloqe të mëdhenj gurësh gjysmë të punuar.

Linja e këtyre gurëve mund të ndiqet mirë në faqen veriperëndimore. Blloqet (100 x 50 x 40 cm) që shihen vende vende në sipërfaqe, formojnë një linjë e cila vazhdon afërsisht 200 m. deri në shpatin e kodrës që bie thikë mbi rrugën e Rreth-Grethit.

68. Kemi mbledhur veqje amforash, një kandil balte me trup gati bikonik lyer me vernik kafe të dobët, fragmente kupash **pseudoterrasigillata,** fragmente vorbesh dhe copëra flakonesh qelqi ngjyrë vjollcë dhe jeshile të hapët.
69. Shih dhe H. Ceka, **Dega Jugore e rrugës...**
70. H. Myrto, **Vila, një toponim 2000 vjeçar,** «Bashkimi», 22 Qershor 75.
71. Janë të ngjashme me ato që vërehen në termat e Dyrrahut, të datuara në shekujt e parë të e.s. (V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe...,** f. 462).
72. Një pjesë e vogël janë me vernik të zi. Një fragment kupe terrasigillata e kuqe në kafe ka zbukurime në relievi: një sërë rrathësh, një pjesë krahu shpendi dhe pikëza të vogla në trajtë gjysmësferike. Përveç qeramikës kemi parë dhe copra flakonesh qelqi transparent me një nuancë bojëqielli. Midis këtij materiali kemi gjetur dhe një monedhë argjendi romake e periudhës së fundit republikane.
73. Për origjinën latino-romane të këtij toponimi, shih E. Çabej, **Studime rreth etnologjisë së gjuhës shqipe XXVII,** «Studime Filologjike», 1968, 1, f. 121 dhe E. Lafe, **Toponimes latino-romains sur le territoire albanais,** «Studia Albanica» 1973, 1, f. 165-166.

Në anën jugore të kodrës, me rastin e hapjes së rrugës së re, doli një shtresë e dendur tullash, tjegullash solene dhe kaliptere të tipit «korintik».[74]

Në se bllokët e gurëve dhe linja që përcaktojnë ato përfaqëson gjurmët e një fortifikimi antik, do të sqarohet nga gërmimet. Qeramika që shihet në sipërfaqe flet për një vendbanim të periudhës qytetare ilire. Në këtë rast, kjo kodër, me lumin Genus (Shkumbinin) që kalonte rrëzës së saj jugore e perëndimore (shih «shënime gjeografike» në numrin e kaluar), na duket se është pika më e përshtatshme për t'u identifikuar me Asparagun e përmendur prej Cezarit.[75]

90. Kalaja e Bashtovës

Kalaja e Bashtovës (60 x 30 m) gjendet në fushë, jo më tepër se 400-500 m nga bregu i djathtë i Shkumbinit dhe 3-4 km nga grykëderdhja e tij. Kohët e fundit një studim të plotë mbi këtë kala ka paraqitur Gj. Karaiskaj.[76] I mbështetur në burimet dhe në teknikën e ndërtimit, autori është i mendimit se datën e ndërtimit të saj duhet ta kërkojmë ndërmjet viteve 1467-1478 dhe se autorët e ndërtimit janë venecianët.[77] A. Dyselie është i mendimit se i përket «epokës së dinastisë justiniane».[78]

Po të marrim parasysh rezultatet e studimeve që provojnë se Shkumbini në zonën e grykëderdhjes shton tokë në kurriz të detit,[79] në kohën e ndërtimit kështjella nuk duhet të ketë qënë larg bregut. Përsa i përket zhvendosjes së rrjedhjes së Shkumbinit nga shtrati i tij «i vdekur» në veriperëndim të kalasë, për në shtratin e sotëm, jemi të mendimit se kjo ka ndodhur në fillimin e erës sonë. Por një degë e tij mund të ketë vazhduar edhe më pas në shtratin e vjetër, ose mund të jetë rikthyer. Prandaj edhe pozicioni fillestar i kalasë ka mundësi të ketë qënë në deltën e formuar midis rrjedhjes kryesore të Shkumbinit dhe një dege të tij të vjetër. Në këtë mënyrë do të justifikohej edhe pozicioni i saj në fushë, që është një dukuri e rrallë për kohën.

Ekzistenca e gjurmëve të një ndërtimi të periudhës bizantine provohet këtu nga detaje arkitektonike të inkastruara në mure me qëllim dekoracioni.[80] Asaj periudhe mendojmë se i takojnë dhe një kapitel e një kollonë mermeri që janë gjetur në territorin e kalasë.[81] Kapiteli (B. 75 x 75 cm, diam. b. 45 cm, L. 45 cm) është me pulvino dhe i zbukuruar me gjethe akanthi të stilizuara. Kolona rrethore ka sipërfaqe të sheshtë dhe vjen e ngushtuar pak nga kreu (gjatësi 2.40 m, diam. 0.32 m).

Për datimin e kështjellës Gj. Karaiskaj u ka bërë një analizë të hollësishme të dhënave që vijnë nga burimet e shkruara, si dhe të dhënave arkitektonike. Megjithatë jo çdo argument i paraqitur na duket plotësisht i qëndrueshëm. Kështu, mospërmendja e kështjellës së Bashtovës në defterin e regjistrimit të tokave prej turqve më 1431-32, por vetëm e fshatit Bashtovë me 13 shtëpi merret si argument i mos ekzistencës së saj në atë kohë. Mirëpo në atë dokument jo rregullisht përmenden edhe emrat e kështjellave, krahas atyre të fshatrave, siç, e pohon dhe vetë autori (po aty).

Edhe mungesa e emrit të kësaj kështjelle në listën e fortesave të bregdetit shqiptar që pretendohen prej venecianëve në fundin e shekullit XIV, kur tregëtimi i drithërave kalon këtu nga dora e raguzanëve në të tyren, nuk na duket një argument plotësisht i qëndrueshëm për mosekzistencën e saj në atë kohë. Në atë listë nuk figuron as kalaja e Turrës e shënuar më pas si «Castel di raguseo» dhe që duket se i përket shekullit XIV.

Së fundi, mendojmë se duhet vërejtur edhe më tepër fakti se rëndësia e skelës në grykëderdhjen e Shkumbinit erdhi duke u rritur në shekullin XIV; nga mesi i atij shekulli ndjehet interesimi i të huajve për të dhe në dhjetëvjeçarin e gjashtë të atij shekulli ajo arrin kulmin në eksportin e drithërave.[82] Kjo

74. Bashkë me këtë material kemi gjetur një fund kotyleje me vernik të zi, vegje skyfosi me vernik të zi në kafe, si dhe një terrakotë. Kjo me sa duket është një dash ose qen.
75. Caes. **Vep. cit.** III, 41, 1; 76, 1 dhe 2. Shih për identifikimin e Bashtovës me Asparagun L. Heuzey, **Les operations...**; «Ilirët dhe Iliria», treguesi i emrave f. 527); H. Ceka, **Dega jugore...**
76. Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Bashtovës,** Monumentet 5-6, 1979.
77. **Po aty,** f. 68.
78. A. Ducellier, **La façade...,** f. 35-36. Shih **Po aty** dhe sprovën për identifikimin e kësaj kështjelle me qëndrën e rëndësishme të Vregosë, një nga tregjet kryesore të bregdetit shqiptar që nga shekulli XIII.
79. Këtë çështje e kemi diskutuar në pjesën e parë të këtij artikulli, botuar në numrin e kaluar (shih «shënime gjeografike»)
80. Gj. Karaiskaj, **vep. cit.,** f. 61.
81. Kapiteli ruhet në muzeun historik të fshatit, kurse kolona në muzeun arkeologjik të Durrësit.
82. Shih shën. 75, më lart. Këtë fakt e përmend dhe Gj. Karaiskaj, **po aty,** (shih shën. 14, 15).

Bototeka

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

na duket si një kohë që lypte aty ngritjen e një kështjelle. Por në atë kohë vendi sundohej nga feudali shqiptar Vlash Mataranga dhe, prandaj, një iniciativë e tillë do t'i takonte vetëm atij.

Duke pasur respekt për kompetencat e autorit të sipërpërmendur në këtë fushë, me vërejtjet që parashtruam kemi qëllim vetëm të shprehim se, për mendimin tonë, lidhur me datën e ngritjes së kalasë së Bashtovës ka ende vend për kërkime.

91. Ura e Bashtovës

Mbi Shkumbin, në një pikë ndërmjet Ballajt dhe kështjellës ruhen tri bazamente të këmbëve të një ure të vjetër (Fig. 10). Gjerësia e lumit këtu është rreth 50 m dhe bazamentet gjenden nga një në secilin breg e një në mesin e lumit.

Bazamenti i mesit që ruhet në një lartësi deri në 1 m (Fig. 11). është trajtuar me kënde të mprehta dhe me kthesa për të evituar goditjet e rrjedhjes; si shpori edhe shuarsi paraqesin formë trekëndëshi. Gjatësia nga njeri skaj në tjetrin është 10 m, gjerësia 6 m. Ndërtimi konsiston nga një veshje anësore prej bllokesh kuadratike të latuara (0.50 x 0.38 x 0.20 dhe 0.40 x 0.20 x 0.20 m). Këto janë vendosur në rreshta të rregullta dhe janë lidhur me llaç gëlqereje të fortë. Në lartësinë e mbetur ruhen katër radhë gurësh. Bërthama e brendshme, me aq sa mundëm të hetojmë, konsiston nga mbushje prej gurësh të vegjël të thyer përzier me llaç gëlqereje të bollshëm.

Bazamentet e këmbëve anësore (Fig. 12) paraqesin të njëjtën teknikë ndërtimi, me përjashtim të formës së tyre që i përngjan më tepër trapezit, me bazën e gjerë nga ana e bregut. Nga ana e lumit linja e tyre paraqitet e lakuar, gjë që na lejon të supozojmë se ura ka qënë ndërtuar mbi harqe.

Prashniker e përmend këtë urë si të ndërtuar me të njëjtën teknikë si ajo e Darçit dhe e daton «në mbarimin e periudhës së lashtë».[83] Ky datim përputhet me mendimin e tij që vetëm në periudhën e vonë antike Shkumbini e ka lënë fushën e Kavajës dhe është kthyer në shtratin e sotëm. Gj. Karaiskaj është i mendimit se ajo i përket periudhës së vonë romake.[84]

Argumentat që kemi paraqitur mbi rrjedhjen e këtij lumi në antikitet, si dhe gjurmët e shekujve të

83. C. Praschniker, **vep. cit.**, f. 126
84. Gj. Karaiskaj, **po aty,** f. 59

parë të e.s. që evidentohen në Kryeluz, Luz i Vogël, Luz i Madh dhe Ballaj na shtyjnë të mendojmë, siç e kemi thënë më lart, kjo është dhe linja e rrugës bregdetare që ndahej nga «Egnatia» dhe merrte drejtimin e Apollonisë. Ura e Bashtovës kuptohet që ka qënë në funksion të kësaj rruge. Kjo arsye, si dhe vetë teknika e ndërtimit, me elemente që e paralelizojnë me ura të tjera të shekujve I-IV mbi Shkumbinin e Mesëm,[85] e kundërshtojnë mendimin e shfaqur nga Prashniker.

E krahasuar me urat e sipërpërmendura, kjo paraqet më tepër ngjashmëri në teknikën e ndërtimit me urën e Keçit, e shekullit IV. Por i mungon një element i saj, brezat e tullave që në urën e Keçit përshkojnë muraturën, dy rreshtash në bërthamë dhe pesë në fasadë. Mungesa e këtij elementi në pjesët e mbetura të urës së Bashtovës na shtyn të zgjedhim si datë më të përshtatshme të ndërtimit të saj shekullin e tretë, më me probabilitet periudhën e fundit të tij. Kjo është dhe një kohë që trafiku Dyrrah-Apoloni-Aulonë duhet të ketë pasur një farë rritje.[86]

Përsa i përket një kalldrëmi që është vërtetuar në fushë (në thellësinë 1 m)[87] dhe drejtimi i të cilit tregon se lidhte kalanë me këtë urë, mendojmë se i përket kohës së kalasë. Kjo tregon se ura do të ketë qënë në përdorim edhe në mesjetë.

PËRFUNDIME

Përmbledhja në këtë shkrim shkurtazi e monumenteve dhe e gjurmëve të lashta e mesjetare të njohura që ndodhen tej qytetit të Durrësit, në rrethin e tij,*) përveç vlerësimeve që jemi munduar të bëjmë gjatë paraqitjes së lëndës, na jep mundësi të përpiqemi për të nxjerrë dhe disa përgjithësime përfundimtare, natyrisht me aq sa mund të pretendohet për një hartë të kësaj natyre.

Përsa i përket prehistorisë, megjithëse të dhënat e deritanishme në këtë trevë janë të kufizuara, të bie në sy fakti se ato kanë ardhur duke u shtuar.

Si gjetje rasti, ato përfaqësojnë periudhën e neolitit të mesëm (prefëset e strallit në Shijak), atë të neolitit të vonë (çekanët e gurit të lëmuar në Manës, Hajdaraj, Ballaj), periudhën e bronxit të vonë (sopatat e tipit «shqiptaro-dalmat» në Borçë e Rrushkull) dhe periudhën e hekurit të hershëm (varësja e bronxit e tipit ojnohe në Armath, sopata bipene prej hekuri dhe varësja e bronztë e tipit «kafaz» në Bashtovë). Gjeografikisht vendgjetjet e këtyre objekteve lokalizohen në dy zona: në kodrinat e zonës fushore të bregut të djathtë të rrjedhjes së poshtme të Erzenit dhe në zonën kodrinore që ngrihet në të djathtë të rrjedhjes së poshtme të Shkumbinit. Të dyja këto zona, me kodrat e buta që ngrihen mbi fushat breglumore, gëzojnë kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë primitive dhe, si pasojë edhe të jetës sedentare. Një faktor tjetër gjeografik që i karakterizon këto qendra, është edhe afërsia me bregun e detit.

Në tërësi objektet që përmendëm qëndrojnë në unitet me kulturat përkatëse të vërtetuara nga zbulimet e bëra në gjithë vendin tonë. Sopatat e bronzit dhe objektet e periudhës së hershme të hekurit dëshmojnë më tepër për një lidhje me grupin kulturor ilir qendror. Por varësja e bronztë e tipit ojnohe, si në formë edhe në zbukurim, paraqet ngjashmëri me një enëz të zbuluar në Gërmenj të Lushnjës.[88] Në këtë mënyrë, për rastin tonë, kemi së paku një element që dëshmon se në periudhën e hershme të hekurit Shkumbini nuk ka përbërë një kufi të prerë për kulturat e zhvilluara në dy brigjet e tij.

Deri tani dëshmi të kulturës ilire në prag të kolonizimit janë objektet e hekurit të hershëm (shekujt VIII-VII) që përmendëm si dhe tumat e vërtetuara në fushën e Erzenit të Poshtëm.[89] Por këto nuk mund të jenë të vetmet. Varfëria arkeologjike që paraqitet në këtë drejtim, gjen shpjegim nga që tej Durrësit, në rrethin e tij, nuk janë bërë ende gërmime të rregullta dhe nga që në qendrat e periudhave pasardhëse njohim pothuaj vetëm sipërfaqen.

85. A. Baçe në A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo. **Historia e Arkitekturës Shqiptare (maket)** Tiranë 1980, f. 187.
86. Për rëndësinë e portit të Aulonës në vitet 288-333, shih N.G.L. Hammond, **A. History...**, vëll. I, pjesa e dytë, f. 1.
87. Këtë kalldrëm e përmend dhe Gj. Karaiskaj, **po aty,**

*. Duhet të falenderoj drejtorin e muzeut arkeologjik të Durrësit V. Toçi, për sugjerimet e vlefshme, sh. A. Bojaxhi, punonjës në këtë muze që më ka shoqëruar në disa ekspedita përnjohëse, si dhe shokët punonjës të bujqësisë e arsimtarë në fshatra që më kanë dhënë njoftime me interes.

88. Zh. Andrea, **Një varrezë e dystë në fshatin Gërmenj,** «Iliria» 1, 1981, f. 222, Tab. II, 7
89. Për gjurmë të një kulture dhe të importit helen brenda në Durrës që para vitit 627 p.e.s shih V. Toçi, **Popullsia ilire e Dyrrahut në dritën e të dhënave historike-arkeologjike,** «Kuvendi i I i studimeve ilire», Tiranë 1974, f. 378.

DOKUMENT

Dihet se Epidamni u kolonizua nga grekët më 627 p.e.s.[90] Për periudhën e parë të historisë së tij, shekujt VI-V p.e.s. njoftimi që kemi është shumë konçiz: «me kalimin e kohës Epidamni u bë i fuqishëm e me shumë banorë» thotë Tukididi.[91] Edhe arkeologjikisht Durrësi i asaj periudhe njihet pak; mund të themi sapo ka filluar të njihet.[92]

Gjetjet në rrethin e tij që i përkasin asaj periudhe, siç pamë, janë një reliev i Herakliut me mbishkrim në alfabetin arkaik të Korintit në Shijak dhe objekte qeramike që vijnë nga varreza, në Tilaj e Hajdaraj. Numri i pakët i qendrave, edhe në këtë rast, mendojmë se shpjegohet me arsyet e sipërpërmendura. Megjithatë ekzistenca e një pike kulti (siç e kemi supozuar), qoftë edhe 12 km tej Durrësit, që (nga mbishkrimi) duket se frekuentohej edhe nga banorët kolonistë të Epidamnit, është një farë dëshmie e marrëdhënieve paqësore, do të thoshnim dhe e një linje uniteti kulturor midis qytetit dhe prapatokës së tij të afërt. Është pikërisht kjo, prapatoka e afërt, që përbën një nga faktorët që e fuqizuan Epidamnin në atë periudhë, natyrisht në sajë të marrëdhënieve të mira të vendosura midis parisë së qytetit dhe aristokratisë fisnore ilire.[93]

Mirëpo në gjysmën e dytë të shekullit V p.e.s. këto marrëdhënie tronditen rëndë. «Thonë se për shkak të grindjeve të brendshme që patën për një kohë të gjatë midis tyre, epidamnasit u shkatërruan në një luftë me barbartë fqinjë dhe e humbën fuqinë e madhe të tyre», vazhdon Tuhididi (po aty). Kjo luftë duket se merr fund me fitore për ilirët fqinjë, tek të cilët aristokracia e Epidamnit shtërngohet të kërkojë strehim, pas fitores së kryengritjes së demosit. Ata ndihmojnë për rivendosjen e pushtetit oligarqik në qytet dhe fitojnë disa të drejta, midis të cilave edhe për t'u ngulur aty.[94] Kjo kohë dhe fillimi i shekullit të ri është dhe koha e kalimit të shoqërisë ilire në shoqëri skllavopronare, po ashtu dhe e krijimit të një formacioni shtetëror ilir.[95] Për prapatokën e afërt të Dyrrahit krijohen kushte të reja shoqërore e politike: nga njera anë, kjo zonë tani e ndien më fuqishëm vetë zhvillimin ekonomik e kulturor të Dyrrahut (që merr ky qytet sidomos që pas Luftës së Peloponezit); nga ana tjetër, mbi të tani ushtrohet gjithnjë e më tepër kontrolli i shtetit ilir, aq sa vetë Epidamni nga fundi i shekullit IV p.e.s. njeh sovranitetin e mbretit të tij.[96]

Gjurmët që u përkasin shekujve IV-II p.e.s dëshmojnë për një zhvillim relativisht të vrullshëm të jetës fshatare në afërsi të Durrësit, si dhe për një rritje të nivelit ekonomik e kulturor.

Qendrat e banuara të kësaj periudhe përfaqësohen nga mbetje fortifikimesh ilire (Zig-Xhafaj, Mlik, Lis-Patros) ose nga gjurmë të tyre (Kepi i Rodonit). Ato përfaqësohen dhe nga gjurmë ndërtimesh të zakonshme (Kepi i Rodonit, Hamallaj, Vrrin, Shkëmbi i Kavajës, Spanjo, Rreth-Greth, Bashtovë, Ballaj) si dhe nga varreza (Kepi i Rodonit, Armath, Rubjekë, Terezijë, Vrrin, Tilaj, Bardhore, Zhabjak, Vilë). Ato i gjejmë si në afërsi imediate me Durrësin (Vrrini), edhe më tej, në fushë, rrëzë kodrave apo bregut të detit. Por i gjejmë dhe në majë kodrash deri diku të largëta siç është rasti i vendbanimeve të fortifikuara. Vetë shpërndarja e gjithë këtyre gjurmëve në këtë terren gjeografik dhe prania kudo e një numri fragmentesh enësh balte qilari e transporti dëshmojnë, së pari, për një zhvillim bujqësor.

Funizimi i këtyre qendrave të vogla fshatare me enë e vazo luksi, me figura të kuqe, ose më pas me zbukurime në reliev të tipit Megarë apo me vernik të zi e kanelyra, sigurisht bëhej nga Dyrrahu. Edhe tjegullat duket se merreshin në Dyrrah. Kjo provohet, së paku, nga fragmentet me vula të gjetura në Zig-Xhafaj e Hamallaj. Por tjegullat e Mlikut, me format e veçanta të buzëve dhe me mungesën e vulave, dëshmojnë ndoshta për një prodhimtari lokale.

Megjithëse monedha të shekujve IV-III p.e.s. deri tani, janë gjetur vetëm në Vrrin, që është dhe i vetmi vend ku është kryer një gërmim i rregullt shkëmbimi tregëtar për të gjithë këtë zonë mendojmë se tanimë kryhej nëpërmjet monedhës.

Ndikimi kulturor i Dyrrahut pasqyrohet dhe në relievet e mbishkrimet e gjetura kryesisht në Kepin e Rodonit, por edhe në Bardhore (kepi i Lagjit). Me-

90. Thuc. I, 24. Për themelimin e kësaj kolonie në një vendbanim të mëparëshëm ilir, shih Ap., **B. Civ.,** II, 73 si dhe Stef. Byz., s.v. «Dyrrahion».
91. Thuc. **Po, aty.**
92. Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhen një numër vazosh të tipit korintik, të zbuluara në varre, që datohen në shekullin VI p.e.s.
93. Shih për këtë mendim, shih S. Anamali, **Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apoloni, në «B.Sh.Sh.»** 1 1956, f. 6.
94. S. Anamali, **vep. cit.** (që citon Elianin) dhe H. Ceka, **Probleme të numismatikës...,** f. 31.
95. S. Islami, **Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare,** «Kuvendi i I i studimeve ilire», Tiranë 1974, f. 93.
96. **Po aty,** f. 95.

Botim

gjithatë kultura ilire e ruan origjinalitetin e saj edhe në këtë trevë kaq të afërt me koloninë më të madhe greke të Adriatikut. Pa marrë në analizë materialin qeramik, qoftë dhe sipërfaqësor, si elemente origjinale të kulturës ilire në zhvillim mund të përmendim bustin e gruas së Shetajt në Kepin e Rodonit dhe stoli e armë ilire në Armath, Vrrin e Rubjekë.

Deri ku mund të jetë shtrirë hinterlandi i pushtetit politik të Dyrrahut, kjo është vështirë të përcaktohet, aq më tepër se kufiri i tij në epoka të ndryshme ka ndryshuar. Ai mund të jetë zgjeruar në një periudhë, ndërsa në një tjetër është ngushtuar ose likuiduar fare, siç është rasti kur vetë Dyrrahu njeh sovranitetin e mbretit ilir. Sidoqoftë, pika të tilla strategjike, veçanërisht për sigurimin e lundrimit, si Kepi i Rodonit (ku vërehen gjurmë fortifikimesh) edhe ai i Lagjit, duhet të kenë qënë nën kontrollin e këtij qyteti për kohën që ai ruante një autonomi. Nën kontrollin e Dyrrahut ka qënë siç duket edhe Asparagu, për të cilin kemi shfaqur mendimin se duhet kërkuar në kodrinën përballë kalasë së Bashtovës.

Tjetër mendim kemi për mbetjet e fortifikimeve në Zig-Xhafaj, Mlik e Lis-Patros (Tab. II), të cilat ndodhen mbi majëkodrash të vendosura 4-8 km larg rrugës kryesore që kalon në fushën e Kavajës dhe pranë shtigjeve e qafave që të çojnë në brendësi të vendit. Ato në Zig-Xhafaj e në Mlik duket se kanë karakter kështjellash të vogla (περιπόλια) të destinuara për mbrojtjen e popullatës përreth në raste luftërash, mundet edhe si pika administrative e religjioze.

Mliku paraqet një mbrojtje natyrore dhe gjurmë fortifikimi të drejtuara kundër zonës së ulët, ndërsa zbulon një lidhje të lehtë me kodrat prapa që vijojnë në drejtim të Pezës. Edhe kështjella në Zig-Xhafaj, me pozicionin gjeografik dhe me planimetrinë e saj, të le përshtypje se mbrohet nga zona e ulët bregdetare më tepër se sa e mbron atë. Kurse mbeturinat e mureve të tipit «barrierë» në Lis-Patros flasin qartë se kanë pasur si destinacion të kontrollonin kalimin që vinte nga poshtë, nga lugina që e lidh me fushën e Kavajës.

Kështu, të tria këto pika me gjurmë fortifikimesh të shekujve IV-II p.e.s., duken si avanposte të drejtuara përkundrejt zonës fushore e bregdetare me prapashpinë masivin kodrinor ndërmjet rrjedhjes së mesme të Shkumbinit dhe asaj të Erzenit. Nga ky këndvështrimi, ato duket se plotësojnë një grupim fortifikimesh ilire me ato që janë të njohura në krahun e djathtë të luginës së mesme të Shkumbinit dhe në luginën e Erzenit.[97] Në këtë rast, ky rreth i fortifikuar do të qëndronte si bërthamë e një zone më të gjerë ku shtriheshin parthinët.[98] Ngritja e këtij sistemi mund të shpjegohej me shtimin e rrezikut të depërtimit maqedon në brendësi të tokës ilire, veçanërisht kur ky rrezik nga fundi i shekullit IV p.e.s. ndjehet edhe në bregdet.[99]

Kemi shfaqur mendimin se fundi i fortifikimit ilir në Zig-Xhafaj do të ketë ardhur me luftërat iliro-romake ose maqedono-romake në truallin e Ilirisë. Por mundet që fortifikimet e tjera, ose edhe ai, të kenë marrë përsëri një rëndësi në mesin e shekullit I p.e.s., kur kryengritja e fuqishme e parthinëve mori karakterin e një lufte të vërtetë.[100]

Gjurmët që i përkasin periudhës së pushtimit romak na njohin me një panoramë tjetër. Një pjesë e tyre duket se kanë karakteristika të përbashkëta. Ato ndodhen në fushë ose rrëzë kodrinave a pranë bregut të detit (Rubjekë, Qerret,[101] Koxhas, Hardhishtë, Tilaj, Spanjo, Luz i Madh, Rogozhinë, Vilë, Bardhore, Spanesh). Materiali i ndërtimit i përdorur në to, tulla dhe tjegulla, veçanërisht tullat dekorative, është material i kushtueshëm për kohën dhe tregon se nuk kemi të bëjmë me rrënoja të thjeshta fshatare. (Këtë e tregon dhe varri monumental i Hardhishtës). Gjetja në to e një numri të madh fragmentesh enësh qilare dhe sidomos fragmente enësh luksi të tipit **terrasigillata** si dhe prej qelqi, na e përforcon këtë mendim.

Nga ana tjetër, pozicioni i tyre (si në fshatin

97. N. Ceka, Ll. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike,** Monumentet 1, 1971; N. Ceka, **Vështrim arkeologjik mbi rrethin e Elbasanit,** Monumentet 3, 1972 dhe Gj. Karaiskaj, **5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** Tiranë 1981, f. 45.
98. Për shtrirjen e tyre shih, N. Ceka, **Vendi dhe roli i parthinëve në Ilirinë e Jugut në shekujt III-I p.e.s,** në «Konf. e dytë e Studimeve Albanologjike», Tiranë 1969, f. 347.
99. S. Islami, **Shteti ilir, vendi dhe roli i ij...,** f. 94.
Lidhur me fortifikimet në luginën e Shkumbinit është shfaqur mendimi se «duhet që kemi dhe një veprimtari të organizuar nga ana e shtetit ilir kundër invazionit të shtetit maqedon të kohës së diadohëve (N. Ceka, **Vështrim...,** f. 11).
100. N. Ceka, **Vendi dhe roli i parthinëve...,** f. 351.
101. Këtë qendër (në pjesën e parë të këtij artikulli) e kemi datuar në shekujt I-II e.s. Kohët e fundit aty kemi gjetur një monedhë bronzi të perandorit Dioklecian, si dhe vazo, që e zgjasin kohën e saj deri në fundin e shekullit III e fillimin e shekullit IV. Edhe këtu vihen re mbeturina të theksuara të një zjarri shkatërrimtar.

Dokotoky

Vilë), pajisja e tyre me banja, që mund të mënkuptohet nga prania e tullave të rrumbullakta dhe e qyngjeve prej plumbi (Vilë, Koxhas), si dhe afërsia me rrugët kryesore që i lidhnin me qytetin, janë karakteristika të njohura për vilat bujqësore romake.[102] Në këtë mënyrë në mbetjet e rrënojave të qendrave të sipërpërmendura jemi të prirur të shohim mbeturina vilash romake, qendra latifundesh.

Datimi i tyre fillon që mbas mesit të shekullit I p.e.s. (Vilë e Spanjo) dhe vazhdon deri në shekullin IV (Qerret) dhe shekullin V (Luz i Madh). Ato mendojmë se përbëjnë një dëshmi të grumbullimit të tokave në pak duar, në duart e latifondistëve, dhe, si rrjedhim të prishjes këtu të bashkësive të lira fshatare. Kjo ishte një nga pasojat më të rënda që solli për popullsinë e kësaj zone, ndoshta më shpejt dhe më gjerësisht se në zonat e tjera të vendit, pushtimi romak.

Tjetër karakteristikë paraqesin mbetjet e ndërtimeve të kësaj periudhe në Kryeluz, Ballaj, ndoshta dhe Gjuricaj. Nga pozicioni i tyre, nga shtrirja më e gjerë e gjurmëve, si dhe nga të dhënat burimore, kemi shfaqur mendimin se ato duhet të identifikohen me stacione rrugore.

Prapatoka e afërt e Durrësit njohu në shekullin II dhe ndërtimin e një nga veprave inxhinierike më madhështore të vendit tonë, ndoshta më madhështorja, ujësjellësi i Durrësit, me tunelin e tij të gjatë në kodrat e Arapajt dhe Rrashbullit.

Kjo zonë në këtë kohë përshkohej po ashtu nga rrugë të tilla të rëndësishme, si rruga Egnatia, dega që shkëputej prej saj në Kryeluz për të shkuar në Apoloni, rruga Dyrrah-Lis dhe rruga që ndiqte luginën e Erzenit me drejtim të Krrabës. Gjurmë të rrugës Egnatia njohëm në afërsi të Kavajës, kurse si mbetje nga rruga për Apoloni kemi urën e Bashtovës.

Duke vështruar hartën të bie në sy shtimi në këtë periudhë i vendbanimeve veçanërisht bri rrugës Egnatia dhe degës që shkonte për Apoloni: Shkëmbi i Kavajës, Golem, Qerret, Rakull, Kavajë, Shtodhër, Kryeluz, Harizaj, Gosë, Rogozhinë dhe Luz i Vogël, Luz i Madh, Ballaj e Vilë). Siç e thamë më lart, një pjesë e tyre mund të identifikohen me stacione rrugore ose me vila latifundistësh. Por një pjesë mund të jenë thjeshtë vendbanime fshatare, të parëndësishme si stacione, ose pika me ndërtesa kulti.

Objekte sepulkrale me mbishkrime latine (me një përjashtim të vetëm në Kepin e Rodonit) deri tani janë njohur vetëm në zonën e Kavajës, dhe këto në pika bri rrugës Egnatia. Kohë më parë është shfaqur mendimi se objekte të tilla tregojnë që në periudhën perandorake popullsia koloniale e Dyrrahut u përhap edhe në këtë fushë.[103] Ka shumë mundësi që pronarët e latifundeve përreth Durrësit të kenë qënë kryesisht kolonizatorë, por popullsia e stacioneve rrugore që përmendëm, si dhe masa e skllevërve apo kolonëve që punonin në latifundet ka qënë vendase dhe ajo mbeti e paromanizuar.

Megjithëse kërkimet janë ende në hapat e para për të provuar sa thamë më lart, disa fakte nuk mund të mos vërehen. Pikësëpari të bie në sy se në të gjitha qendrat e shekujve të parë të e.s. si në stacionet rrugore, edhe në ato që i kemi quajtur — Vila, qeramika e rëndomtë ruan dhe, siç dihet, ripërtërin elemente vendase, të tilla siç janë p.sh. vegjet brinake. Një vazhdimësi të traditës vërejmë edhe në stolitë ilire, siç është fibula me këmbë të përthyer e shekullit IV në Golem. Po ashtu, veglat e punës tregojnë tipare të periudhës paraardhëse dhe paraqesin ngjashmëri me gjetjet në qendrat e tjera të kësaj periudhe në brendësi të vendit (shih Rakull, Golem).

Një karakteristikë tjetër dëshmitare e traditës vendase ilire është dhe riti i varrimit, që në të gjitha rastet, edhe në qendrat bri rrugës Egnatia, është paraqitur vetëm me vendosje kufome, në kohën kur në Durrës ndeshet edhe ai me djegje, si rit në këtë kohë i preferuar më tepër nga romakët.

Shekulli I katërt i e.s. e pasqyron në një farë mënyre krizën e përgjithshme të perandorisë romake edhe në qendrat e njohura përreth Durrësit. Kushtimin që u bëhet në Rogozhinë dy perandorëve në fillimin e këtij shekulli, e konsiderojmë si një shpreje të shqetësimit të banorëve vendas dhe si një shpresë të tyre për ndryshimin e gjendjes nën perandorët me origjinë ilire. Gjurmët e zjarrit shkatërrimtar që vërehen bri rrugës Egnatia si në Rogozhinë e Kryeluz, por edhe në Vila të këtij rrethi (Qerret) mund të merren si prova të shkatërrimit të tyre me dhunë ose si rezultat i ndonjë kryengritjeje të skllevërve e kolonëve, ose si rezultat i dyndjes së parë të barbarëve në këtë trevë në çerekun e fundit të shekullit IV e.s. Saktësime përsa i përket kohës së këtyre shkatërrimeve, edhe shkakut, do të bëhen natyrisht me gërmimet e rregullta në të ardhmen.

---

102. **Enciclopedia Italiana,** Roma 1937, vëll. XXX, f. 352.
103. L. Heuzey-H. Daumet, **Mission...,** f. 351.

Lulëzimi që vërehet në Dyrrah në antikitetin e vonë, shekujt V-VI e.s. pasqyrohet edhe në rrethinat e tij. Mbetje ndërtimesh të kësaj kohe janë ato që shihen në Gjuricaj, në Lis-Patros, Qerret e Mlik. Kapitelet e gjetura në dy fshatrat e parë i përkasin një niveli të lartë artistik, që nuk bie aspak më poshtë nga niveli i veprave bashkëkohore të kësaj gjinie të gjetura brenda në Durrës. Fakti i vërtetimit të shkrimit greko-bizantin më parë në Kavajë se në Durrës mendojmë se dëshmon për një mjedis jo aq konservator ndaj latinishtes sa Durrësi.

Përsa i përket mesjetës, kemi bashkërenditur këtu monumentet e njohura dhe disa të dhëna të reja. Por kemi lënë pa përfshirë dhe disa rrënoja kishash dhe varreza krishtere e myslimane, që mendojmë t'i paraqesim në një shkrim të veçantë.

Monumentet mesjetare që përmendëm, qofshin kala apo kisha, nga ana arkitektonike dëshmojnë për ndikime me origjinë lindore ose perëndimore, gjë që është e shpjegueshme me vetë kushtet historike të Durrësit në mesjetë. Megjithatë në ato nuk mungojnë dhe elementet e arkitekturës shqiptare, që i vënë në unitet me veprat bashkëkohore të gjithë vendit. Veç kësaj ato paraqesin një karakteristikë të përbashkët që na duket me interes të veçantë. Në të gjitha rastet, si monumentet që ruhen në këmbë edhe ato që shfaqin vetëm gjurmë (herë-herë dhe detaje arkitektonike siç e pamë) gjenden mbi rrënoja antike ose shumë afër tyre. Këtë dukuri e pamë në Kepin e Rodonit, në Shkëmbin e Kavajës, në Qerret (të Kavajës), në Kanapare, Çetë, Lis-Patros, Mlik, në Kepin e Lagjit etj. Ky fakt na duket se nuk mund të mos merret si ripërtëritje dhe vazhdimësi e një tradite.

Në se për fortifikimet një përputhje e tillë shpjegohet dhe me kushtet e terrenit e pozicionin gjeografik, nuk ka përse të ishte medoemos kështu dhe me monumentet e kultit. Kishat e Shën Nikollës në Kepin e Rodonit dhe në Shkëmbin e Kavajës, kushtuar shenjtorit mbrojtës të lundrimit, mendojmë se flasin për një traditë që me krishterimin pësoi ndryshime, por nuk u mohua plotësisht. Të tilla raste kemi dhe në Kanapare, Qerret të Kavajës, Lis-Patros, Çetë, Karpën e Mlik.

Këmbana e vitit 1465 e gjetur në Karpën, ku ruhen rrënojat e një kishe mesjetare, paraqet një problem të veçantë. Vetëm 33 vjet më parë ky fshat lishte me katër shtëpi.[104] Po të besojmë se këmbana është inaguruar në këtë fshat vitin e prodhimit të saj, si shpjegohet zmadhimi dhe pasurimi i tij në ato vite luftërash aq sa të ndërtonte një kishë e ta paiste me një këmbanë të madhe? Të dhënat arkeologjike në të ardhmen do të hedhin më tepër dritë siç duket mbi burimet historike të periudhës së lavdishme të luftërave të popullit tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut.

U munduam të hidhnim një vështrim mbi monumentet dhe gjurmët antike e mesjetare në territorin më të afërt me Durrësin, qyteti më i vjetër i vendit tonë, që arriti të quhej një qytet me shumë banorë që nga fundi i shekullit V p.e.s. që në fundin e shekullit IV e.s. është kryeqendra e Epirit të Ri, «metropol i Ilirikut», kryeqendra e temës së Durrësit në shekullin VIII i vlerësuar më pas dhe si një «Kostandinopol i dytë». Në përfundim të këtij vështrimi që paraqitëm, do të thoshnim se ndërmjet këtij qyteti dhe prapatokës së tij të afërt nuk ka ekzistuar asnjë herdek ndarës. Të dhënat e hedhin poshtë mendimin e shfaqur dikur se tej Durrësit, në fshatrat, nuk paraqitet asnjë gjurmë e qytetërimit antik.[105] Përkundrazi, ato vazhdojnë natyrshëm, duke filluar nga periferia e këtij qyteti deri në kufijtë e rrethit të tij administrativ që morrëm në studim. Vazhdimësia e tyre është e dukshme në hapësirë edhe në kohë.

Jemi të vetëdijshëm se, nëpërmjet zbulimeve të ardhshme këto të dhëna do të vijnë duke u pasuruar e duke u sqaruar më tej.

104. H. Inalçik, **Hiçri 835 Sureti...**, nahija e Izmirit.
105. L.M. Ugolini, **Albania Antica**, Roma 1927, f. 170.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


HARTE
E MONUMENTEVE DHE E GJURMEVE ANTIKE E MESJETARE TE RRETHIT TE DURRESIT.
DETI ADRIATIK
DURRESI
KAVAJA
RRETHI I TIRANES
RRETHI I ELBASANIT
RRETHI I LUSHNJES
RROGOZHINA
L. I SHKUMBINIT
Shtrati i vjetër i SHKUMBINIT
Shpjegim
TUME ILIRE
FORTIFIKIM ILIK
GJETJE TE RASTIT
GJURME RRENOJASH
DETAJ ARKITEKTONIK
MBISHKRIM
VARRE ANTIKE
TRAKT I RRUGES EGNATIA
TRAKT I UJESJELLESIT ANTIK
PUSETA TE TUNELIT TE UJESJELLESIT ANTIK
KALA MESJETARE
URE
KISHE OSE RRENOJA KISHE

DO NOT COPY


KANAPARE
LIS - PATROS
RROGOZHINE
KRYELUZ
RROGOZHINE
MLIK
MLIK
KANAPARE
MLIK
RROGOZHINE
QERRET
BALLAJ
BALLAJ
KRYELUZ
LINEZ

DO NOT COPY


DYRRATIO
XV
XXV
GENESIS FL
A
B
ZONA
E KAVAJES
V
DETI ADRIATIK
256
200
50
ZIG - XHAFAJ
239
LIS - PATROS
398
Perroi i Leshnices
Lumi i Darçit
KAVAJE
50
KRYELUZ
440
MLIK
LUZ I VOGEL
100
50
100
266
LUZ I MADH
RROGOZHINE
BALLAJ
50
Lumi i Shkumbinit
Shkalla 1:200 000
Shpjegim
MBETJE FORTIFIKIMESH ILIRE
GJURME RRENOJASH TE SHEKUJVE TE PARE TE E.SONË
GJURME TERRUGES EGNATIA

Halil MYRTO

DO NOT COPY

LA ZONE DE COLLINE DE KAVAJA

RESUME

Le rocher de Kavaja *(Petra)*

44. Céramique de la période hellénistique, des premiers siècles de notre ère et médiévale. Les traces des constructions que l'on voit au plus haut sommet, sur le revers du Rocher de Kavaja, on pense les rattacher aux restes de l'église de Shën-Nikolla, mentionnée dans les sources dès le XIe siècle.

45. Golem. *Cimetière des premiers siècles de notre ère.*

46. Seferaj. *Des tombes des premiers siècles de notre ère et une pierre tombale avec une souscription latine, publiée.*

47. 48. Tilaj. *Des tombes des siècles V-II avant notre ère et un plancher couvert de mosaïques faits avec des morceaux de tuiles, dans les premiers siècles de notre ère.*

49. Kanapare. *Près des ruines d'une église médiévale des tombes sans constructions couvertes de tuiles, qui de par la découverte d'une boucle d'oreille (Fig. 1) sont datées du X au XIIes siècles.*

50. — Spahjo; *Dans la colline de la cité l'on voit en surface des fragments de tuiles hellénistiques, dont (une porte un sceau avec le nom* ΓΑΙΟϚ, *prytam eponym de Dyrrah de la moitié du Ier siècle avant notre ère.*

51. Zig-Xhafaj. *La fortification illyrienne doit être construite vers la fin du IVe siècle avant notre ère et s'est poursuivie jusqu'au IIe siècle avant notre ère. Parmi les tuiles découvertes il y en a qui portent le nom* Αριστοδομδ, *prytan de Dyrrah dans les années 250 — 200 avant notre ère.*

52, 53. Çetë. *Dans ce village près de Kavaja, se trouve une église du XIIIe siècle qui est le seul monument qui tient debout de l'architecture romano-gothique dans notre pays.*

Près de l'église ont été découvertes des tombes des premiers siècles de notre ère. Dans la place de l'autel, a été découverte une plaque tombale avec trois figures en relief et avec une souscription latine.

54. Menge. *Dans la chaîne des collines en gypse, à 12 km au sud-est de Kavaja ont été découvetes quatre cavernes quartstiques, à galeries horizontales.*

55, 56. Lis-Patros. La seule issue qui monte au sommet d'un flanc (398 Mètres au dessus du niveau de la mer) garde des traces de murs du type barrière, construits avec des blocs de pierres rectilignes. L'un d'entre eux porte la lettre Θ.

On peut voir aussi de la céramique construite dans les premiers siècles de notre ère; on a trouvé aussi un chapiteau en pierre calcaire orné de feuilles de akanthi du Ve siècle de notre ère.

57. A environ trois kilomètres de là on y conserve un tract mural du monastère de Patros citée dans les sources du XVe siècle.

58. Mlik *On y remarque des traces de constructions de la période hellénistique, des premiers siècles de notre ère allant jusqu'aux V-VIes siècles. Les restes des murs prouvent qu'elle a été fortifiée dans les IV-II siècles avant notre ère, ainsi que dans la haute antiquité.*

59. Au centre on y conserve les ruines d'une église médiévale.

5. La zone de plaine de Kavaja

60, 61. Qerret. *Entre la montagne de Robi et la mer ont été découverts les fondements d'une église et du matériel en céramique de la période paléochrétienne. On y a découvert également deux colones en marbre, L. Rey, en 1901 a découvert les fondements et a été trouvé un petit trésor avec anneau épiscopal et des monnaies médiévales. Nous sommes de l'avis que s'est précisément ici que devait se trouver l'église de Shën-Todri, citée au XIe siècle. A proximité on constate des traces de la voi Egnatia.*

62. Rrakull. *A côté de la rue actuelle Durrës-Kavajë, ont été découvertes des parties de murs, de la céramique des premiers siècles de notre ère ainsi que des faucilles de fer.*

63. Le magasin du sel, environ 4 km plus loin, est une construction de la période turque. Il a été découvert également du aqueduc en tyaux de céramique qui va en direction du bord de la mer.

64, 65. Kavajë. *Ont été découvertes des plaques tombales avec des souscriptions latines, ainsi qu'une pierre tombale avec la souscription grecque du IVe siècle de notre ère. Ont été découvertes également des restes de constructions des premiers siècles de notre ère.*

67. Shtodhër. *Des tombes des premiers siècles de notre ère couvertes de tuiles.*

68. Kryeluz. *Les traces des constructions antiques que l'on constate sur la rive gauche du fleuve Darç, s'étendent sur une superficie de 4 ha. Il semble qu'elles représentent la station de la rue avec XV m. p. de distance de Durrës, que à Tabula*

Peutingeriana manque de nom. L'effondrement de cette habitation semble être venu à cause d'une incendie.

69. Harizaj. *Des tombes des premiers siècles de notre ère. On y a découvert une pièce de monnaie du grand Constantin.*

72. Luz i Madh. *Au milieu de la plaine qui s'étend entre les collines de Kavaja, à l'ouest, de celles de Kryevidh à l'est, pas très loin de la rive de Shkumbini fut découvet un plancher avec de petites tuiles en forme de tronc de pyramides. Le matériel de la céramique date dans les II au IVes siècles de notre ère.*

74, 75. Rrogozhinë. *A deux points proches près de la rue qu'on estime qu'elle suit la voie Egnatias, ont été découvertes des restes de constructions des premiers siècles de notre ère et une pierre dédicale ainsi qu'un autel tombale avec une souscription latine. La pierre semble être dédiée à l'empereur. Galerius et à son neveu de même nom, qui régnèrent à la tetrarchie proclamée par Dioclécioni, après son abdication.*

Sont caractéristiques une typologie de tuiles petites en forme de parallélopipède dont on se servait probablement pour couvrir le plancher avec le motif du dos du poisson.

6. La zone de colline de Kryevidh.

77. Karpën. *Cimetière des premiers siècles de notre ère. On y a découvert une cloche en bronze qui port l'année MCCCCLXV.*

79. Kalaja e Turrës *au cap de Lagji nous pensons qu'il faut l'identifier au château dont il est question dans les sources, au cap de Melie.*

81, 82. Hajdaraj *Marteau en pierre polie, avec un trou au milieu de la période du haute néolithe. A été découverte aussi un cimetière avec une Lakrimore du Ve siècle avant notre ère.*

85. Linëz. *Marteau-hache en pierre polie, avec un trou, hache en fer bipene en un collier en bronze du type* kafaz *des VIII--VIIes siècles avant notre ère.*

86. Ballaj. *Des traces de constructions durant les premiers siècles de notre ère ont été découvertes à l'extrémité du sud-est de ces collines, qu'il faut identifier à la station «Genusus» qui est citée dans les sources antiques.*

87, 88. Vilë. *Ont été découvertes des tombes de céramiques des III-I siècles avant notre ère. Les restes d'une construction sur le flanc de Vilë des siècles les avant notre ère – au Ier siècle de notre ère nous font penser à une* Villa Rustica.

89. Kodra e Gjone. *Kodra e Gjone à l'est du chateau de Bashtova, garde des traces de la période hellenistique. Sa position géographique peut être identifiée à l'Asparagu, cité à la moitié du Ier siècle avant n.è.*

90. Kalaja e Bashtovës. *Elle doit appartenir aux années 1467--1478 par GJ. Karajskaj ne nous parait pas très convaincant. Il y a lieu de croire qu'elle a été construite un siècle avant par le féodal albanais Vlash Matranga.*

91. Le pont de Bashtova. *Pas très loin du chateau, sur le fleuve Shkumbini, on remarque les trois supports desarches d'un pont de la fin du III e siècle de notre ère.*

CONCLUSIONS

Quant à la préhistoire, bien que les données actuelles dans cette contrée soient limitées, il est à souligner le fait qu'elles vont toujours augmentant. En tant que des trouvailles de l'occasion, elles représentent la période du néolithe moyen (prefëset e strallit à Shijak), celle du néolithe récent (les marteaux de pierre polies à Manëz, Hajdaraj), la période du bronze récent (les haches du type «albano-dalmates» à Borçë et Rrushkull) la période du fer antique (Le collier du type ojhone *en bronze à Armath, la hache bipene en fer et le collier en bronze du type «kafaz» à Bashtovë). Géographiquement les lieux de ces objets trouvés se localisent dans deux zones: dans les collines de la zone de plaine de la rive droite du cours inférieur du fleuve Erzen et dans la zone de colline qui s'élève à droite du fleuve Shkumbini sur sa rive gauche. Ces deux zones avec les petites collines jouissent de conditions favorables pour le développement de l'agriculture et de l'élevage primitif, et, en conséquence de la vie sédentaire. Ces zones se trouvent près du bord de la mer.*

Les objets que nous avons cité en général forment une unité avec les cultures respectives vérifiées par les fouilles faites dans notre pays entier. Les haches de bronze et les objets de la haute période du fer témoignent davantage pour un rattachement au groupe culturel central illyrien. Mais le collier en bronze du type ojnohe *aussi bien en forme que dans ses ornements, a des éléments ressemblants avec un petit récipient découvert à Gërmenj de Lushnja. De la sorte nous avons, dans notre cas concret, nous avons au moins un élément qui témoigne de la période lointaine du fer. Shkumbini n'a pas été une ligne de séparation pour les cultures développées sur ses deux rives.*

Jusqu'à ce jour, comme témoignage de la culture illyrienne au seuil de la colonisation sont les objets de la haute période du fer (les VIII-VII siècles) que nous avons cités et les tumulus découverts dans la plaine de Erzeni i Poshtëm. Mais ils ne peuvent être les seuls. La pauvreté archéologique qui se manifeste en ce sens, s'explique par le fait qu'au delà de Durrës, dans ses environnements, n'ont pas encore eu lieu des fouilles régulières et que les centres des périodes qui les ont précédés. on connaît seulement la superficie.

Les trouvailles de la période archaïque dans la région de Durrës se composent par un relief de Heraclite avec un souscription de l'alphabet de Corynthe, trouvé à Shijak et les objets de céromique provenant des cimetières, de Tilaj et de Hajdaraj. Le nombre restreint des centres, nous pensons que même dans ce cas, s'explique par les mêmes arguments cités ci-contre. Cependant l'existence d'un objet de culte, ne serait-ce qu'à 12 kilomètres de Durrës, de par l'inscription semble être fréquenté

DOWNLOADED BY

DOKTORIK

aussi par les habitants colonistes d'Epidam, est un témoignage et un lien d'une unité culturelle entre la ville et de son térritoire tout autour de lui. C'est présicément lui, le proche térritoire, qui constitue un des facteurs qui reforcèrent Epidamus, dans la période, naturellement grâce aux bonnes relations établies entre les nobles de la ville et de l'aristocratie des tribus illyriennes.

Mais durant la seconde moitié du Ve siècle avant notre ère ces relations furent lourdement secouées. «On dit, à cause des malentendus internes qu'eurent pendant bien longtemps entre eux, les habitants d'Epidamus furent détruits dans une lutte avec les barbares voisins, chez lesquels l'aristocratie d'Epidamus fut obligée de demander refuge, après la victoire de l'insurrection de démos. Ils aident à l'instauration du pouvoir oligarchique dans la ville et obtiennent certains droits, dont celui de s'y établir. Cette époque et le début du nouveau siècle est l'époque du passage de la société illyrienne en société esclavalagiste, et de la création d'une formation d'était illyrien. Ainsi des conditions nouvelles sociales et politiques sont créées pour les proches environnements de Dyrrah: d'une part cette zone sent la puissance de son développement économique et culturel, et de l'autre sur lui s'exerce toujours davantage le contrôle de l'Etat illyrien, au point que Epidam à la fin du IV siècle avant notre ère reconnaît la souveraineté de son propre roi.

Les découvertes qui reviennent aux IV-II siècles avant notre ère témoignent pour un développement relativement impétueux de la vie paysanne à proximité de Durrës, ainsi que pour un accroissement du niveau économique et culturel. Les centres habités de cette période sont représentés par des rester de fortifications (Zig-Xhafaj, Mlik, Lis-Patros) ou de leurs traces (le Cap de Rodone). Ils sont représentés par des traces de constructions normales (Le Cap de Rodone, Hamallaj, Vrrin, Shkëmbi i Kavajës, Spanjo, Rreth-Greth, Bashtovë, Ballaj) ainsi que par des cimetières (Le Cap de Rodone, Armath, Rubjekë, Terezijë, Vrrin; Tilaj, Bardhore, Zhabjak, Vilë). On les trouve aussi bien tout près de Durrës (Vrrini) que loin, dans la plaine aux pieds des collies ou au bord de la mer. Nous les trouvons également aux sommets des collines, voire assez éloignées comme c'est le cas des lieux habités fortifiés. La répartition de toutes ces traces sur ce terrain géographique et la présence un peu partout d'un nombre de fragments de récipients de cuisine et de transports témoignent en premier lieu d'un développement de l'agriculture.

Le ravitaillement de ces petits centres avec des récipients et vasses de luxe, avec des images rouges, ou plus tard avec des ornements en relief du type Megarë ou bien avec du verni et des canelures était fait certainement de Dyrrah. Même les tuiles semblent être prises à Dyrrah. Cela est argumenté du moins, par les fragments et les sceaux trouvés à Zig-Xhafaj et Hamallaj. Mais les tuiles de Mlik avec les formes particulières à leurs cotés et l'absence des sceaux, témoignent peut-être d'une production locale. Cependant les monnaies des IV-III siècles avant notre ère jusqu'à présent, ont été trouvées uniquement à Vrrin, qui est le seul endroit ou des fouilles régulières ont été faites. L'échange commerciale pour toute cette zone nous pensons qu'il devait se faire par la monnaie.

L'influence culturelle de Dyrrah se reflète même dans les reliefs et les souscriptions découvertes surtout au Cap de Rodone, mais aussi à Bardhore (Le cap de Lagji). La culture illyrienne garde son originalité même dans cette contrée si proche de la plus grande colonie grecque de l'Adriatique. Sans prendre en analyse le matériel de la céramique ne serait-ce qu'en surface, en tant qu'éléments originaux de la culture illyrienne en développement, nous pouvons citer le buste de la femme de Shetaj au Cap de Rodone et des ornements et des armes illyriens à Armath, Vrrin et Rubjekë.

Jusque ou pouvait s'étendre le Hinterland de Dyrrah, cela est difficile à préciser, d'autant plus que ses frontières, dans les diverses époques ont dû changer. Il a pu s'élargir dans une époque, et dans une autre il a dû se limiter ou disparaître complètement, comme c'est le cas ou Dyrrah lui même reconnaît la souveraineté du roi illyrien. Quoi qu'il en soit, de tels points stratégiques, surtout pour protéger la navigation, comme le Cap de Rodone (ou des traces de fortifications ont été découvertes) et celui de Lagji doivent avoir été sous le contrôle de cette ville durant la période qu'elle gardait encore son autonomie. Sous le contrôle de Dyrrah a du être apparamment aussi Asparagu, pour lequel nous pensons qu'il faut le chercher dans la petite colline en face du chateau de Bashtova.

Mais nous sommes de l'avis qu'il en est autrement quant aux restes des fortifications à Zig-Xhafaj, Mlik et Lis-Patros (Tab. III), qui se trouvent aux sommets des collines établies de 4 à 8 km loin de la route principale qui traverse le plaine de Kavaja et près des passages des cols qui mènent à l'intérieur du pays. Celles de Zig-Xhafaj et de Mlik semblent avoir un caractère de petits châteaux destinés à défendre la population tout autour en cas de guerre, et il se peut comme des centres administratifs et religieux.

Mlik présente une défense naturelle et des traces de fortifications dirigées contre la zone de plaine, et offre un léger lien avec les collines derrière en direction de Peza. Même le château à Zig-Xhafaj de par sa position géographique et de sa planimétrie, donne l'impression de se défendre de la basse zone maritime plus que de la défendre. Tandis que les restes des murs du type «Barrière» à Lis-Patros témoignent clairement qu'ils avaient comme destination de contrôler le passage d'en bas, avec la colline qui la relie à la plaine de Kavaja.

Ainsi, ces trois points avec des traces de fortifications des IV-II siècles avant notre ère semblent comme des avant postes dressés contre la basse zone de plaine et maritime ayant derrière le massif des collines entre le cours moyen de Shkumbini et celui d'Erzeni. Dans ce cas ce cercle fortifié résiderait comme un noyau d'une zone plus vaste ou se trouvaient les partines.

La mise sur pied de système peut s'expliquer par la menace du danger de la pénétration des macédoniens à l'intérieur des territoires illyriens, surtout quand une telle menace à la fin du IVe siècle avant notre ère pouvait venir de la mer.

NNous avons exprimé notre ponit de vue que la fin de la fortification illyrienne à Zig-Xhafaj doit être issue des guerres Illyro-romaines ou macédoino-romaines sur le territoire de l'Illyrie. Mais il se peut que les autres fortifications, même celle-ci aient pris une importance à la moitié du Ier siècle avant notre ère quand la puissante insurection des parthines prit le caractère d'une véritable guerre.

Les traces qui appartiennent à la période de l'occupation romaine nous présentent un autre panorama. Une partie semble avoir des caractéristiques communes. Elles se trouvent dans les plaines ou aux pieds des collines et près du bord de la mer (Rubjekë, Qerret, Koxhas, Hardhishtë, Tilaj, Spanjo, Luz i Madh, Rrogozhinë, Vilë, Bardhore, Spanesh). Le matériel pour leur construction, les briques et les tuiles, surtout les briques décoratives, est un matériel coûteux pour l'époque et prouve qu'il ne s'agit pas de simples ruines paysannes. En témoigne la tombe monumentale de Hardhishta). La découverte ici d'un grand nombre de récipients de cuisine et surtout des récipients de luxe du type Terrasigillata ainsi que des récipients en verre, vient renforcer cette idée.

D'autre part leur position comme dans la village Vilë, leur equipement avec des bains, qui peut être sousentendu de l'existence des briques rondes et des tuyaux de plomb (Vilë, Koxhas), ainsi que leur proximité près des rues principales qui les liaient à la ville, sont des caractéristiques connues pour les villas agricoles romaines. De la sorte des découvertes dans les ruines des centres précités, nous avons tendance à voir des restes de villas romaines, des centres de latifudes.

Leur datation commence après la moitié du Ier siècle a.n.ère. (Vilë, Spanjo) et se poursuit jusqu'au IVe siècle a.n. ère. (Qerret) et au Ve siècle (Luz i Madh). Nous avons lieu de croire qu'ils forment un témoignage de la concentration en peu de mains des terres, dans les mains des latifondistes et, en conséquence de la destuction ici des communautées libres paysannes. Ce fut une des plus lourdes conséquences qui entrainèrent pour la population de cette zone plus vite que pour une autre et à plus vaste échelle que dans les autres zones l'occupation romaines.

Une autre caractéristique présentent les restes des constructions de cette période à Kryeluz, Ballaj et il se peut aussi à Gjuricaj. De par leur position, de la plus grande répartition des traces, ainsi que des données des informations, nous avons éxprimé le point de vue qu'il faut les identifier aux stations des routes.

Les proches environs de Durrës connurent au IIe siècle la construction d'une oeuvre ingénénieurique grandiose, peut-être la plus grandiose, l'aqueduc de Durrës avec le long tunel dans les collines d'Arapaj et Rrashbull. Cette zone était parcourue par des voies importantes comme celle Egnatia, sa branche qui se détachait à Kryeluz pour aller en direction de l'Apolonie, la rue Dyrrah-Lis et la voie qui suivait la vallée d'Erzen en direction de Krraba. Des traces de la voie Egnatia furent découvertes aussi à proximité de Kavaja, et comme des restes de la rue d'Apolonie nous avons le pont de Bashtova.

En regardant la carte on est frappé par l'accroissement des habitats surtout tout au long de la voie Egnatia et de la branche qui menait en Apolonie (Shkëmbi i Kavajës, Golem, Qerret, Rrakull, Kavajë, Shtoshër, Kryeluz, Harizaj, Gosë, Luz i vogël, Luz i madh, Ballaj et Vilë). Comme nous l'avons déjà dit une partie peut être identifiée aux stations de la route ou aux villas des latifondistes. Mais une partie peut-être aussi simplement des habitations paysannes ou des centres ou des objets de culte.

Des objets de sépulture avec des souscriptions latines (à une seule exception au Cap de Rodone) jusqu'à présent ont été découverts dans la zone de Kavaja et cela tout au long de la voie Egnatia. Il y a de cela bien tu temps qu'on avait exprimé le point de vue selon lequel de tels objets prouvent que durant la période de l'empire la population coloniale de Dyrrah s'étendit aussi sur la plaine. Il est foret possible que les latifondistes aux environs de Durrës aient été des colonisateurs, mais la population des stations de route que nous avons mentionnées, ainsi que la masse des esclaves ou des colons qui travaillaient dans le latifundis, a été autochtone et ne fut pas romanisée.

Bien que les recherches soient encore à leurs débuts, pour pouvoir argumenter ce qui a été déjà dit ci-contre, on ne peut pas ne pas remarquer certains faits. D'abord ce qui frappe aux yeux c'est que tous les centres durant les premiers siècles de notre ère ainsi que les stations des routes et ceux que nous avons nommés Vila, la céramique garde et, comme on le sait, rénove des éléments autochtones. Nous constatons une continuité de la tradition même dans les ornements illyriens, comme c'est la fibula avec la jambe courbée du IVe siècle à Golem. De même les outils de travail gardent des traits de la période qui les précède et présentent des approches avec les découvertes dans les autres centres de cette période à intérieur du pays (voir Rrakull, Golem).

Une autre caractéristique qui témoigne de la tradition autochtone illyrienne est le rite de l'enterrement, qui dans tous les cas, même tout au long de la voie Egnatia, s'est présentée seulement avec le placement du cadavre à une époque ou à Durrës on le faisait aussi bruler, un rite plutôt préféré par les romains.

Le IVe siècle de notre ère reflète en quelque sorte la crise générale de l'empire romain même dans les centres aux environs de Durrës. Les traces du feu dévasteur on les constate longeant le voie Egnatia comme à Rrogozhine et Kryeluz, mais aussi à Vila de cette région, (Qerret) peuvent être prises comme des preuves de leur destruction par la violence ou par la suite d'une insurrection et des esclaves et des colons, ou comme le résultat des affuts premiers des barbares dans cette contrée au dernier quart du IVe siècle de notre ère. Des précisions quant à l'époque de ces destructions, ou de leurs causes, vont être données par la suite des fouilles régulières dans l'avenir.

DOKTORAT

Le progrès que l'on voit à Dyrrah dans la haute antiquité les V-VIes siècles de notre ère, se reflète même dans ses alentours. Des restes de constructions de cette époque sont constatés aussi à Gjuricaj, Lis-Patros, Qerret et Mlik. Les chapiteau trouvés dans les deux premiers villages appartiennent à un haut niveau artistique, qui n'est point au-dessous des oeuvres de cette même époque et de ce genre découvertes à Durrës. Le fait de la reconnaissance de l'écriture greco-byzantin d'abord à Kavajë et ensuite à Durrës nous pensons qu'elles témoignent d'un environnement pas aussi conservateur face au latin que celui de Durrës.

En ce qui concerne le moyen-âge, nous avons mis ensemble ici les monuments connus et quelques nouvelles données. Mais n'y sont pas comprises aussi quelques ruines d'églises et des cimetières de chrétiens et musulmans, que nous comptons présenter dans une étude à part.

Les monuments du moyen-âge, ainsi que les monuments qui sont debout et ceux qui ont leur traces (parfois même des détails architectoniques comme nous l'avons vu) se trouvent sur les ruines antiques ou tout près d'elles. Nous avons vu ce phénomène au Cap de Rodone, au Shkëmbi i Kavajës, à Qerret (Kavajë), à Kanapare, Çetë, Lis-Patros, Mlik, au Cap de Lagji etc.

Si pour les fortifications une telle conformité aussi par les conditions du terrain et de la position géographique, il ne pouvait pas ne pas en être ainsi pour les objets du culte. Les églises de Shën-Nikolla au Cap de Rodone et au Shkëmbi i Kavajës, dédiées au saint de la défense de la navigation, nous pensons qu'elles parlent d'une tradition qui avec la christianisations subit des modifications, mais ne fut pas renié complètement. De tels cas nous avons à Kanapare, Qerret de Kavaja, Lis-Patros, Çetë, Karpën et Mlik.

Notre but était de donner un aperçu sur les monuments et les traces antiques et du moyen-âge sur les proches environs de Durrës, sur la ville la plus ancienne de notre pays; qui réussit à devenir une ville de beaucoup d'habitants dès la fin du Ve siècle avant notre ère, et que, à la fin du IVe siècle de notre ère fut le chef-lieu du Nouveau Epire «Metropole de l'Illyrie», le chef-lieu de la contrée de Durrës au VIIIe siècle, estimé par la suite comme un «second Constantinople». A la fin de cet aperçu que nous avons présenté, nous voudrions dire qu'entre cette ville et ses environs proches il n'y a pas existé d'obstacles qui les séparait. Les données rejettent la thèse exprimée avant comme quoi au delà de Durrës il n'y a pas de traces de la civilisation antique. Tout au contraire cette civilisation se poursuit naturellement, allant de la périphérie de cette ville jusqu'à ses frontières administratives. Leur continuité est manifeste en espace et dans le temps.

DO NOT COPY

Nr. 1 1982

monumentet

DO NOT COPY

Kasem BIÇOKU

RRUGËT NËPËR VILAJETIN E KRUJËS TË SHEK. XV DHE LOKALIZIMI I SHUFADASË

Nëpër dokumenta të shek. XV e XVI kemi gjetur të dhëna me interes për gjurmimin e traseve të rrugëve mesjetare, sidomos të rrugëve që kalonin nëpër krahinat e Krujës, burime këto që nuk janë shfrytëzuar në këtë drejtim në studimet e deritanishme.[1]

Krahinat e ndryshme mesjetare që vareshin nga Kruja dhe fshatrat e tyre i njohim kryesisht nëpërmjet regjistrave kadastralë osmanë, burime këto shumë të rëndësishme dhe të pa zëvendësueshme për studimin e një varg problemesh. Nga këto regjistra kemi të dhëna edhe mbi rrugët, lokalizimi i të cilave bëhet duke njohur mirë burimet në fjalë. Regjistri më i hershëm, e si i tillë më i rëndësishmi, i zbuluar deri tani, i përket vitit 1431-1432,[2] dhe është i dyti i hartuar pas pushtimit të Krujës në vitin 1414-1415. Për nga lloji ky regjistër është përmbledhës dhe ka të shënuar timaret në bazë të emrit të spahijve, fshatrat, numrin e familjeve dhe shumën e detyrimeve të tyre, pronat hassa si dhe shënime të ndryshme që përmbajnë historikun e formimit të timarit, ndryshimet që kanë pësuar gjatë viteve të mëvonëshme etj. Një tjetër regjistër i shekullit XV, ku janë përfshirë vise të Krujës, i përket marsit të vitit 1467[3] dhe është i llojit të hollësishëm, ku, krahas të dhënave të tilla si të regjistrit të vitit 1431-32, ka të shënuar emrat

1. Studimi i J. Adamit, **Historia e rrugëve të Shqipërisë. Rrugët e Shqipërisë gjatë mesjetës dhe pushtimit turk**, në «Buletinin për shkencat shoqërore», 1953, III, f. 28-30, jep drejtimet e rrugëve mesjetare që kalonin nëpër trevën e Krujës: rruga për në lindje Durrës-Fushë e Tiranës-Dibër, rrugën tregtare nëpër tokat e Gjon Kastriotit, si pikënisje të së cilës merrte në grykën e Drinit skelën e Shufadasë, duke e nxjerrë atë jashtë trevës së Krujës, si dhe rrugën mbi Qafën e Krrabës që lidhte sipas tij Shkodrën e Lezhën me Tiranën, Elbasanin dhe Shqipërinë e Jugut. Edhe pse ai nuk ka folur për rrugën Durrës-Lezhë përfundimet e tij në vija të përgjithshme qëndrojnë. Kurse në drejtim të lokalizimit të traseve të rrugëve për zonën e Krujës, të degëzimeve të tyre, ka ndryshime nga që J. Adamit i kanë munguar të dhënat burimore, të cilat do të ndihmonin atë të dallonte devijimet e mëvonëshme që kanë pësuar trasetë e rrugëve. Në këtë drejtim të dhënat burimore që ne kemi përdorur lejojnë të ndiqen jo vetëm trasetë e rrugëve mesjetare por mendojmë edhe të periudhave më të hershme. Problemet që po trajtojmë në këtë artikull i kemi shtjelluar më parë në gazetën «Kastrioti»: **Në gjurmë të rrugëve, në gjurmë të historisë,** 20.5.1977, f. 7-8; **Shufadaja, qendër tregtare dhe doganore e Kastriotëve,** 3.6.1977, f. 6-7; **Kruja, qendër e rëndësishme administrative gjatë mesjetës,** 1.7.1977, f. 6-7, etj.

2. H. Inalçik, **Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid,** Ankara 1954. Shfrytëzuar sipas përkthimit shqip që gjendet në Institutin e Historisë.

3. **Regjistri i Dibrës i vitit 1467.** Shfrytëzuar sipas përkthimit shqip që gjendet në Institutin e Historisë.

e kryefamiljarëve dhe të specifikuara llojet e detyrimeve e të taksave. Të tillë janë edhe regjistrat e viteve 1580 dhe 1583.[4] Regjistrat në fjalë, të mbështetur edhe në burime të tjera, ofrojnë të dhëna me interes në disa drejtime.

Kruja, sipas regjistrit të vitit 1431-32, ishte qendër vilajeti, e përfshirë në sanxhakun e Shqipërisë me qendër në Gjirokastër. E tillë ajo kishte qënë që me pushtimin prej turqve. Vilajeti i Krujës përfshinte mbi 200 fshatra, me të cilët qenë formuar 65 timare,[5] pesë prej të cilëve ishin shënuar në regjistër në fletën e vilajeteve të tjera[6] dhe nga shënimet kuptohet se i përkisnin vilajetit të Krujës, që kufizohej në jug me atë të Pavlo Kurtikut. Shtrirja jugore e vilajetit të Krujës arrinte pak a shumë në kufirin e sotëm të rretheve Tiranë-Elbasan, përfshinte krahinën e Shijakut, që, si zonë kontakti me vilajetin fqinjë të Pavlo Kurtikut, disa fshatra të saj si Pjeshkëza, Shutëli etj. ishin përfshirë në timaret e këtij vilajeti.[7] Shtrirja perëndimore e vilajetit të Krujës arrinte deri pranë Durrësit (që ishte nën pushtimin venedikas), përfshinte krahinën e Ishmit deri në derdhjen e lumit Mat. Në lindje kufizohej me vargmalet Krujë-Dajt, kurse në veri me lumin Mat. Ky lumë shërbente si kufi ndarje me një tjetër njësi administrative, të ndarë në vilajete, të përfshirë në një regjistër të veçantë të emërtuar «defteri i vendit të Gjonit»,[8] (Gjon Kastriotit) ku gjendeshin të shënuar dhe fshatrat e vilajetit të Dhimitër Jonimës që shtrihej nga Lezha në Rubik.

Përcaktimi i trasesë së rrugëve kërkon edhe identifikimin e lokalizimin e emrave të disa vendeve që kanë regjistrat. Kjo ka vështirësitë e saj, sepse shumë emra janë zhdukur e zëvendësuar me të tjera dhe shpesh për të njëjtën qendër banimi përdoren emra të ndryshëm të lagjeve apo të kishave (në vilajetin e Krujës më 1431-1432 rreth 1/10 e fshatrave dalin me emra të institucioneve fetare). Emrat e vendeve nga regjistrimi në regjistrim shpesh dalin më shumë lëkundje. Këtë e ilustron mjaft mirë rasti i krahinës mesjetare të Misjes, që shtrihej në masivin kodrinor nga kepi i Rodonit deri në rrugën e sotme Vorë-Durrës e Vorë-Fushë Krujë, ndërmjet dy lumenjve Erzen e Ishëm, pozicion që ndoshta i ka dhënë asaj emrin mesjetar Misje, si vend ndërmjet dy lumenjve. Gjatë një kohe shumë të shkurtër, tre vjet, më 1580 dhe 1583, fshatrat e saj kanë qënë të regjistruar tërësisht dy herë dhe afro 1/3 e emrave të tyre kanë lëkundje dhe paraqiten respektivisht në format: Mondoh e Hundek, Zumanë e Dhumanë, Muzhaq e Selitë, Shakariq e Shamriq, Kolovac e Mallvac, Mellkoç e Mallkuç, Maraq e Mazan, Bërezi e Bret.[9] Më 1467 kemi Birat, Bujlla, Bobotish, Bobiq;[10] më 1568 e 1571 Mozhol (Muzhl), Belanik, Erlez (Lalz) e Belen[11] dhe në dokumentet perëndimore të fillimit të shek. XV Shën Anastasi, Shën Kolli, Shnandou, e Shën Maria.[12] Kjo e fundit del në bregdet dhe nuk ka të bëjë me Lalzin që njihet edhe me emrin Shën Mëri.

Puna për lokalizimin e emrave të vendeve që kanë regjistrat kërkon njohjen e kritereve të harti-

4. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit viti 1580.** Shfrytëzuar sipas përkthimit shqip që gjendet në Institutin e Monumenteve dhe në Muzeun e Skënderbeut. Regjistrin e vitit 1583 e kemi shfrytëzuar nëpërmjet punimit të S. Pulahës, **Mbi gjendjen në vitet 20-30 të shek. XV në tokat shqiptare dhe mbi qëndrimin e klasës feudale kundrejt pushtimit osman,** «Studime historike», 1970, nr. 4, f. 119-122. Si bazë kemi marrë regjistrin e vitit 1580 që është më i hershmi, i pashfrytëzuar dhe me të dhëna më të plota.
5. **Defter-i Sancak-i Arvanid,** tim. 253, 260, 273-335.
6. **Po aty,** tim. 253, 260, 273-275.
7. **Po aty** tim. 240.
8. **Po aty,** tim. 335. Shih K. Biçoku, **Mbi shtrirjen e sanxhakut të Shqipërisë dhe disa çështje lidhur me regjistrimet e tokave shqiptare gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XV,** në «Studime historike» 1974, nr. 3, f. 89-90; Po ai, **Pozita administrative e politike e krahinës së Misjes dhe rëndësia e saj në veprimtarinë e Gjon Kastriotit e të Skënderbeut në vitet 30 të shek. XV,** në «Studime historike» 1973, nr. 2, f. 31-41.
9. Sipas regjistrit të vitit 1580 fshatrat e Misjes ishin: Mondoh, Klos (Kelos), Bizë, Kurator, Ishporan, Bujtulë, Zumanë, Selitë-Muzhak, Shendvlash, Kuriq, Shakariq, Bubiq (Bubqi), Lapesh, Laç, Kalovac, Melkoç, Maraq, Kojnas, Shënmëri ndryshe Lalëz, Berez, Muzhin, Manes, truallishtja Sava-Koshta që varej nga fshati Lapesh, Shendkryq, Popotesh. Marqinet dhe truallishtja Paraspor që varej nga fshati Popotesh. Shih shën. 14
10. **Regjistri i Dibrës,** f. 170-171.
11. A. Matkovski, **Kryengritje të panjohura në Sanxhakun e Ohrit në vitet 1566-1574,** «Studime historike» 1973, nr. 3, f. 55, 62.
12. A. Dyselie, **Gjendja e kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumentave raguzane,** «Studime historike» 1977, nr. 1, f. 123-127.

PHOTOCOPY

mit të tyre, të formimit të timareve të funksionarëve në fshatra të krahinave të ndryshme dhe të formimit të timareve të spahinjve të thjeshtë me fshatra që gjendeshin zakonisht pranë njeri tjetrit, kërkon përdorimin me kujdes të shënimeve të ndryshme që gjenden në to etj. Kështu p.sh. timarit të subashit të Krujës, si kompensim për qytetin e Krujës që iu hoq, iu dhanë 8 fshatra pranë njeri tjetrit dhe që ishin në varësi të një fshati. Po të nisesh thjeshtë nga emri i fshatit nga vareshin të tjerët, Gjon Kllojke (me sa duket emri i kryetarit të fshatit), mendon për fshatin Kllojkë të zonës së Shëngjergjit të Tiranës. Kurse si nga shënimet ashtu edhe nga emri i fshatit Burizanë (Buruze), del se gjendeshin në afërsi të qytetit të Krujës.[13]

Krahinat e përfshira në vilajetin e Krujës përbënin padyshim një unitet të formuara historikisht, të përcaktuar nga kushtet gjeografiko-natyrale, të lidhura me njera tjetrën e të përfshira në të njëjtat njësi administrative. Kur Kruja bënte pjesë në Sanxhakun e Shqipërisë gjatë shek. XV edhe ato ishin të përfshira në atë sanxhak dhe më pas, kur Kruja kaloi në sanxhakun e Ohrit, edhe ato u përfshinë në këtë njësi administrative. Për këto lidhje të tyre dëshmojnë edhe rrugët që kalonin në ato vise.

Të dhënat burimore mbi rrugët i kemi për tri krahina mesjetare të Krujës: Misjen, për shtrirjen e saj dhe fshatrat që gjendeshin në të i kemi dhënë më lart; Kurbinin, zona ndërmjet lumit Drojë e Mat, dhe Rindishta, viset në jug të Kurbinit, në lindje të Misjes dhe në perëndim të vargmalit Krujë-Dajt.[14] Në regjistrin e vitit 1431-32 emrat e krahinave nuk përmenden, kurse në regjistrat e tjerë emrat e tyre janë shënuar. Nga regjistrimi në regjistrim në zonat e kontaktit të këtyre krahinave disa fshatra gjenden të shënuar herë në njërën krahinë e herë në tjetrën. Kështu fshatrat e zonës së Nojës më 1580 përfshiheshin në Kurbin, kurse më 1467 ishin me Rindishtën. Më 1580 skela e Ishmit që gjendej në Misje bashkë me dalanet e Ishmit, Dares e Dadanit ishin të regjistruara në Kurbin, pas fshatit Bushnesh, sepse së bashku bënin pjesë në zeametin e sulltanit. Po kështu edhe fshatrat midis Ishmit e Drojës, zonë kontakti ndërmjet atyre tri krahinave, kanë lëkundje nga njeri regjistrim në tjetrin.

Krahina e Misjes kishte një pozitë të veçantë edhe prej rrugëve që kalonin nëpër të në dy drejtime të rëndësishme: njera Durrës-Lezhë dhe tjetra nga skelat e rëndësishme të Rodonit e të Ishmit për t'u bashkuar me të parën.

Rruga që vinte nga Durrësi, kalonte në jug të Misjes dhe e lidhte këtë me krahinën e Skurjes (zona e Shijakut). Për lidhjen e ngushtë të këtyre dy krahinave flasin edhe burimet e shkruara. Në dokumentat e viteve 30 të shek. XV del se ato zotëroheshin së bashku.[15] Edhe në regjistrin e vitit 1580 taksa

---

13. **Defter-i Sancak-i Arvanid,** tim. 276 dhe shën. **Akçehisar.**

14. Në regjistrat e shek. XVI fshatrat e këtyre krahinave i kemi të regjistruara tërësisht. Ato të Misjes i kemi dhënë më lart (shih shënimin 9 dhe tekstin përkatës). Më poshtë po japim emrat e fshatrave të dy krahinave të tjera, sipas regjistrit të vitit 1580.

Kurbini përfshinte fshatrat: Poshnesh, Shillas e truallishten Senë, Dulbinisht e truall. Marçë, Miljot e truall. Guras, Shufadë, Laç, Gjimrë (Gjikëzhë), Selitë e truallishtet e Leshit e të Sulet-Dodbër (Çivlet-Dorber), Kurbin, Shkretë, Kuqan, Malibardhë, Burishtë, Daullë, Logopaq, Madesh, Ismaq, Zheq, Ishklaz e truall. Kitmizë, Bëred, Gjonëm, Përrak e truall. Shënd-Thimi, Nuajë, Mavroshiq, Gallatë, Madmurë, Shënmërije e truall. Dekelet, Gizi, Velizë, Iskotin, Llashtë, Kaçolan e truall. Bresti i Madh. Janë regjistruar në Kurbin edhe skela e Ishmit bashkë me dalanet e Ishmit, të Dares e të Dadanit.

Rindishta përfshinte fshatrat: Rodesh. e truall,. Barushë (Tarushë), Kalimastrat, Krujë dhe livadhet pranë saj të Petanit, të Domit e të Shënd Lleshit, Shumini e vendi Rigan, Virjon e truall. Mondekli, Bogomish, Priskë e Vogël, Shënkoll, Simdpogata, truallishtet Bas, Muzhakë e Ranë, Barkanesh, Tumjan, Çetë, truall. Mollë (që varej nga Kruja), Ishtepan, Klosh, Garbe, Shëngjergj-Kuriq, Kakariq, Pinar, truall. Zezë, Buranë, Kurt-Asan, Golemas, Kalimet, Izgurdesh, Lungoç, Budili e truall. Shin-Gare, truall. Izgafnar, Qinam e truall. Pavël, Luz, Bërar, Minjollë e truall. Shelgjet që ishte «midis dy lumenjve».

Në kllapa janë dhënë ato raste, kur, në pasqyrën përmbledhëse që ka regjistri në krye të çdo nahije (krahine), emrat e fshatrave kanë ndryshim me ato që janë shkruar në regjistër, kur janë shënuar fshatërat, kryefamiljarët, detyrimet etj.

15. K. Biçoku, **Pozita administrative,** f. 31.

PO-KOPJE

e dhenve që vilej nga banorët e atyre dy krahinave ishte llogaritur në shumën e përbashkët të 5000 akçeve.[16]

Ashtu si rruga për në viset veriore edhe ajo që vinte nga Rodoni e lshmi e lidhnin ngushtësisht Misjen me Krujën e viset e tjera të saj.[17] Dokumentat perëndimore tregojnë se pas pushtimit të Krujës, Rodoni ishte nën varësinë e qeveritarit turk të Krujës,[18] kurse Gjon Kastrioti më 1420 shkruante se Rodoni ishte «tokë turke» dhe se skela e atyshme ishte në përdorim të turqve.[19] Edhe në regjistrin e vitit 1431--32 dalin të shënuara në vilajetin e Krujës fshatrat e Misjes, dëshmi kjo e varësisë së saj ndaj Krujës. Emrat e shumë prej tyre janë të njëjtë apo kanë ndonjë lëkundje të lehtë me ato të regjistrave të vitit 1580 e 1583 dhe respektivisht dalin në format Mondikle e Mondoh, Klos e Klos, Kurtsan e Kuratër, Shoran e Shporan, Budjela e Bojtula, Thumanë e Zumanë, Muzak e Selita-Muzak, Shëndulash e Shënvlash, Sharmik e Shamriq, Buzhik e Bubiq, Magol e Mallkuç, Lakjet e Laç, Maljet e Mezhan, Prizde e Brezi, Manës e Manës, Lapësh e Llapësh, Marqinet e Marqinet.[20] Po kështu edhe krahina e Kurbinit, nga kalonte rruga Durrës-Lezhë, ishte e lidhur me Krujën. Fshatrat e saj ishin të regjistruar më 1431-32 dhe emra të tyre gjenden edhe në regjistrat e viteve 1580 e 1585 respektivisht me format Bushnesh e Poshnesh, Shilje e Shillaz, Denjashish e Dulbinish, Siltë e Selitë, Lishnash e Lesh, Dubresh e Çivlet-Dorber, Zhili e Zhej, Berat e Beret, Gjonëm e Gjonëm, Pirak e Përrak, Shën Tomi e Shën Thimi, Mavroshin e Mavroshiq, Marmur e Madmur, Valjezë e Velizë.[21] Gjithashtu nuk përjashtohet mundësia që Maljet e Lakjet e regjistrimit të 1431-32 të kenë qënë Miloti e Laçi i Kurbinit. Veç këtyre në regjistrin e vitit 1431--32 ekzistojnë edhe një numër fshatrash, emrat e të cilëve nuk gjenden në regjistrat e shek. XVI, që lokalizohen në ato dy krahina, si dhe një numër tjetër emra fshatrash që nuk lokalizohen por që janë në timaret e formuara me fshatrat e lokalizuar në ato krahina.[22]

Banorët e krahinës së Misjes në dokumentet e shek. XV e XVI dalin si të panënshtruar e kryengritës. Për nënshtrimin e tyre turqit ndërmorrën masa të ndryshme, duke përfshirë edhe ndërtimin e kalasë së Ishmit, punimet e së cilës filluan në verë të vitit 1572 dhe përfunduan në fillim të vitit 1574.[23] Nëpër këtë krahinë kryengritëse kalonte traseja e rrugës Durrës-Lezhë-Shkodër e cila, sipas të dhënave të regjistrit të vitit 1580, ishte e shtruar me kalldrëm, e paisur me ura dhe karvanet e udhëtarët qarkullonin nëpër të si verës ashtu edhe dimrit.

Duke u nisur nga Durrësi, rruga futej në pjesën jugore të krahinës së Misjes, vijonte rrëzë vargut kodrinor të saj në drejtim të Vorës, prej nga kthente drejt veriut për në Prezë e Budull. Duke filluar nga këto fshatra regjistri i vitit 1580 na jep të dhëna direkte për rrugën.

Administrata qendrore e Perandorisë Osmane i ka kushtuar vëmendje mirëmbajtjes dhe sigurimit të qarkullimit nëpër rrugën Durrës-Lezhë-Shkodër. Në kuadrin e këtyre masave, veç kujdesit që duhej të tregonte «gjithë popullsia e vendit»[24] banorët e disa fshatrave u liruan nga disa detyrime si kompensim për punën që ata duhej të bënin për mirëmbajtjen e pjesëve të ndryshme të rrugëve dhe sigurimin e kalimit nëpër to dhe në regjistra u shënuan si dervenxhinj (ruajtës rrugësh).

Me këtë funksion, sipas regjistrit të vitit 1580, në krahinën e Misjes dalin të ngarkuar banorët e fshatit Berezi (Prezë) për pjesën e rrugës nga Sava-Koshta, që varej nga fshati Lapesh i Misjes, deri në vendin e quajtur Riglatë: «Ishte e domosdoshme dhe e rëndësishme që të mbaheshin nën roje e nën kon-

16. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit i vitit 1580,** f. 119 b.
17. Për rëndësinë e krahinës së Misjes, pjesë e së cilës ishte Rodoni, shih edhe P. Thomo, **Kalaja e Skënderbeut në kepin e Rodonit,** në «Konferencën e dytë të studimeve albanologjike», I, Tiranë 1969, f. 263-268; A. Dyselie, **Dalja në de' e principatës së Kastriotëve prej fundit të shek. XIV deri në vdekjen e Skënderbeut,** «Konferenca e II», I, f. 121-137; Po ai, **Gjendja e kepit të Rodonit,** f. 123-127.
18. A. Dyselie, **Gjendja e kepit të Rodonit,** f. 126-127.
19. J. Radonić, **Gjuragj Kastriot Skanderbeg i Arbania u XV vjeku** Beograd 1942, nr. 2.
20. **Defter-i Sancak-i Arvanid,** tim. 276, 282, 283, 301, 291, 324, 284, 278, 329, 290, 321, 316, 299, 300, 281, 286, 310, 316, 334.
21. **Po aty,** tim. 327, 314, 311, 276, 315, 279, 278, 273, 325.
22. K. Biçoku, **Pozita administrative,** f. 33-38.
23. A. Matkovski, **Vep. cit.,** f. 59-60.
24. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit, viti 1580,** f. 73 a.

DOKTORATURA

troli pikat e rrezikshme që ndodhen në rrugën e karvaneve që të çon në skelën e Durrësit dhe të Lezhës, duke filluar nga Savakosa e deri në vendin e quajtur Riglatë. (Banorët) e fshatit të mësipërm patën marrë përsipër që të bënin roje në këto vende pa lejuar që të prekej pasuria dhe jeta e ndonjerit, gjithashtu patën marrë përsipër që kur të prisheshin urat në pikat e sipërpërmendura, ata do t'i ndërtonin, po kështu do të ndërtonin ura e kalldrëme në disa baltovina».[25] Po këtë gjë duhej të bënin edhe banorët e fshatit Bojtula (Budull): «Ky fshat ndodhet mbi rrugën e karvaneve që çon nga Durrësi për në skelën e Lezhës. Gjatë kësaj rruge nga Riglata në kodrën e Mondoklit ndodhen baltovina e vende të vështira për t'u kaluar. Për këtë shkak rrallë qëllonte që të mos ndodhnin këtu ngjarje të papëlqyera. Kështu që në stinën e dimrit kalimi nëpër këtë rrugë ishte e vështirë. Banorët e këtij fshati muarrën përsipër që të ruanin këto vende të ndërtonin kalldrëme e ura në baltovinat dhe t'i ndreqnin kur të prisheshin... Kundrejt këtyre shërbimeve në regjistrin e vjetër...»[26]

Pas këtyre të dhënave, që kanë të bëjnë me fshatrat e Misjes, në dokumentin në fjalë shënohet se për ruajtjen e rrugës ishin caktuar edhe banorët e fshatit Minjollë të krahinës së Rindishtës: «Ky fshat është derbend që në kohën e vjetër. Në regjistrin e vjetër shënohet se duke qënë ky fshat një pikë e rrezikshme mbi rrugën e karvaneve Durrës-Lezhë dhe Shkodër rrallë qëllonte që të mos ndodhnin këtu ngjarje të papëlqyeshme, prandaj ishte më se e nevojshme që të bëhej fshat derbend. Për këtë qëllim patën ardhur këtu banorë nga fshatra përreth dhe patën marrë përsipër, me kusht që fshati të bëhej derbend, të ruanin e mbronin vendin nga Istoku i Madh e deri te prroi i Kukërit dhe nga Klashenica deri në Sinë pa lejuar që të cënohet pasuria dhe jeta e ndonjerit».[27] Vendndodhja e fshatit Minjollë duhet kërkuar diku ndërmjet lumenjve Ishëm e Drojë se vetëm në këtë zonë mund të kalonte rruga Durrës-Lezhë nëpër krahinën e Rindishtës.

Lokalizimi i fshatit Minjollë, banorët e të cilit prej kohësh kishin qendër dervenxhinj e si të tillë ishin shënuar edhe në «regjistrin e vjetër», duhet parë edhe me disa të dhëna të tjera më të hershme. Në dokumentet e viteve 70 të shek. XVI banorët e fshatit «Belen (Bilaj) të Misjes» ishin dervenxhinj në rrugën që lidhte qendrën e sanxhakut, Ohrin, me kalanë e sapo ndërtuar të Ishmit. Kjo rrugë kalohej me vështirësi sepse shkonte nëpër pyje dhe banorët rreth saj ishin kryengritës. Prandaj banorët e fshatit Belen duhej të ndreqnin rrugën, të prisnin pyjet buzë saj, të bënin ura të reja e të meremetonin të vjetrat dhe të zotoheshin «se askujt nuk do t'i dëmtohej as pasuria, as jeta do t'i kërcënohej».[28] Padyshim emri Belen ka të bëjë me Bilain, emri i të cilit më 1467 del në formën Bilanik[29] dhe më 1431-32 Drujë.[30] Emri Drujë është përdorur deri vonë për fshatin Derven. Me këtë emër (Drujë) ai gjendet i shënuar edhe në disa harta të shek. XX. Banorët e tij emrin Drujë e shpjegonin nga që vendi ka qënë me drunj (pyll). Gjatë mesjetës, siç del në dokumenta të fillimit të shek. XVII, fshati Bilaj del i vendosur në dy anët e lumit: Bilaj i Poshtëm, në anën e majtë të lumit Ishëm (fshati i sotëm Bilaj) dhe Bilaj i Sipërm në anën e djathtë të tij,[31] Derveni i sotëm, Pranë këtij ndodhet fshati Micajnë, sot lagje e Burizanës, që pa dyshim ka të bëjë me Minjollën e vitit 1580. Për këtë dëshmojnë toponimet e sotme; prroi i Kukës, që ndan Micjanën me qendrën e vet Burizanën, të kujton prroin e Kukërit të 1580, dhe kodra Shninë ka të bëjë me Sinën. Prroi i Kukërit dhe Sina shënohen më 1580 si kufij të rrugës që duhej të ruanin banorët e fshatit Minjollë. Mos përmendja e emrit Bilaj në regjistrin e vitit 1580 tregon se fshati Minjollë dhe Beleni i dokumentave pak më të hershme (të viteve 70), konsideroheshin si një fshat, me sa duket i përbërë nga disa lagje, pak larg njera tjetrës, që kishin emra të veçantë. Prandaj fshati del i shënuar nëpër regjistra me emra të ndryshëm. Me kalimin e kohës e rritjen e popullsisë, lagjet u konsideruan si fshatra të veçanta. Kështu p.sh. në shek. XVII kemi Bilaj i Poshtëm dhe Bilaj i Sipërm. Kurse në ditët tona banorët e njërës mbajtën emrin Bilaj, të tjetrës ruajtën emrin Drujë që më pas, u zëvëndësua me emrin Derven, të detyrës së ruajtësve të rrugës që kishin banorët e tij. Kështu nga një qendër banimi me disa emra, me sa duket të lagjeve të ndryshme të saj, dolën tri fshatra me emra të

25. **Po aty,** f. 188 a,
26. **Po aty,** f. 181 b,
27. **Po aty,** f. 129 a.
28. A. Matkovski, **Vep. cit.,** f. 62.
29. **Regjistri i Dibrës,** f. 171
30. **Defter-i Sancak-i Arvanid,** tim. 328.
31. **Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII,** vëll. I, Tiranë 1963, f. 139-141.

DOKUMENT

veçantë: Drujë (Derven), Bilaj, dhe Minjollë (Micjanë). Edhe sot ruhet kujtimi i shpërnguljes së një pjese të banorëve të fshatit Micjanë për në Drujë (Derven).

Pas këtyre të dhënave mund të ndjekim drejtimin e rrugës Durrës-Lezhë dhe bashkimin me të të rrugëve të tjera, si degëzime të saj.

Rruga Durrës-Lezhë pasi kishte kaluar nëpër fshatin Budull, diku pranë fshatit të sotëm Mërqinë, bashkohej me rrugën që vinte nga kepi i Rodonit e Ishmi, merrte drejtimin për në Bilaj, kalonte lumin Ishëm e arrinte në Derven dhe Burizanë ku dhe sot ruhen gjurmët e një banje të kohës romake e natyrisht i një stacioni antik, me sa duket Pistumi.[32] Pozicioni natyror i Burizanës e bënte atë një nyje ndërlidhje në rrugën Durrës-Lezhë me degëzime të tjera rrugësh. Të dhënat burimore të viteve 70 për fshatin Belen tregojnë qartë se rruga nga kalaja e Ishmit për në Ohër kalonte nëpër këtë fshat, rrjedhimisht edhe në Burizanë.[33] Si qendër rrugore e një stacioni antik, e Pistumit, ajo ka qënë e lidhur me rrugë me qytetin ilir të Albanëve. Prandaj mund të konsiderohet e sigurtë që rruga nga Burizana shkonte në Zgërdhesh, devijonte në drejtim të Qafës së Tujanit, ku kthente për në lindje, drejt qendrës së sanxhakut, Ohrit.

Që rruga kalonte në këtë drejtim sigurohemi nga të dhënat e regjistrit të vitit 1580. Sipas tij banorët e fshatit Tujan duhej të kujdeseshin për ruajtjen e rrugës, detyrë që ata e kishin prej kohësh: fshati «Tumjan ... që në kohë të vjetra është derbend».[34] Kjo rrugë ka funksionuar edhe gjatë shekujve të mëparëshëm. Dëshmi e sigurtë e kësaj janë të dhënat e regjistrit të vitit 1467. Sipas tij banorët e fshatrave Guri i Bardhë, Klos e Bulqizë[35] ishin caktuar me detyrën e ruajtësve të rrugës (dervenxhinj). Nga Qafa e Tujanit, si rrugë karvanesh, ajo krijonte lidhjen më të shkurtër me viset lindore. Ajo ka funksionuar njëkohësisht me rrugën e luginës së Shkumbinit. Për këtë na sigurojnë të dhënat e regjistrit të vitit 1467 sipas të cilit edhe fshati Xhurat (Xhyrë) i vilajetit të Çermenikës ishte shënuar si «fshat derbend».[36] Dihet se rruga nëpër luginën e Shkumbinit ishte më e mirë dhe rrihej si nga karvanet ashtu edhe nga karrot.

Burizana del si vend kryqëzimi i dy rrugëve shumë të rëndësishme që lidhnin krahina të tëra shqiptare. Po këtu zbriste një degëzim i rrugës që kalonte në fshatin Picrragë për të lidhur Krujën me viset perëndimore, kurse me viset veriore ajo lidhej me rrugën Durrës-Lezhë në afërsi të Mamurrasit. Kurse një rrugë tjetër, gjurmët e së cilës ruhen edhe sot, e lidhte Krujë me Zgërdheshin.

Pas Burizanës, duke marrë drejtimin për në veri, rruga futej në krahinën e Kurbinit dhe, duke kaluar rrëzë kodrave, lidhte fshatrat më të rëndësishme të saj.

Regjistri i vitit 1580 ka ndonjë të dhënë me interes edhe për këtë pjesë të rrugës që kalonte nëpër Kurbin. Kështu për banorët e fshatit Milot shënohej se: «Të lartëpërmendurit kanë marrë përsipër që të ndërtojnë tri ura mbi baltovinat që janë mbi pjesën e rrugës që fillon nga fshati Shillaz e mbaron deri poshtë Dulbinishtit. Gjithashtu kanë marrë përsipër të meremetojnë (urat) kur të prishen. Këto ndodhen në rrugën e karvaneve e cila kalon nga Durrësi në Lezhë dhe deri në skelën e Shkodrës. Për mirëmbajtjen e këtyre pikave duhet të kujdesen financat e shtetit dhe gjithë popullsia e vendit».[37] Në Milot ishte «trapi mbi lumin Mat»,[38] që shërbente për kalimin e tij, aty ndaleshin dy rrugë: njera për në Lezhë e Shkodër dhe tjetra në drejtim të Rubikut për në viset verilindore të tokave shqiptare.

Si një burim shumë i rëndësishëm i dorës së parë, bëhen të dhënat e regjistrit të vitit 1580 për të zgjidhur problemin e lokalizimit të skelës e të qendrës së rëndësishme doganore të Kastriotëve, Shufadasë, dhe, bashkë me këtë, të rrugës tregtare që lidhte këtë skelë me viset e tjera.

E lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e Kastriotëve, Shufadaja ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e historianëve. Duke përdorur të dhënat e dokumentave raguzane e venedikase janë bërë përpjekje për të treguar vendndodhjen e saj. Nëpërmjet këtyre dokumentave fitohet një e dhënë e sigurtë:

32. L. Papajani, G. Pani, **Një banjë antike në Borizanë,** «Kastrioti» 12.8.1977, f. 7.
33. Për të kaluar nga Qafa e Tujanit për në Ishëm rruga që na japin dokumentat e viteve 70 të shek. XVI nga Bilaj (detyrimisht nga Burizana e sotme) ishte pak më e gjatë, por ishte e shtruar dhe e sigurtë. Gjatë verës duhej të kishte prerje më të shkurtra nga Qafa e Tujanit për në Prezë e Ishëm dhe nga Kruja e Zgërdheshi për në Prezë.
34. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit, viti 1580,** f. 122 b.
35. **Regjistri i Dibrës... i vitit 1467,** f. 4, 6, 8.
36. **Po aty,** f. 6.
37. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit, viti 1580,** f. 73 a
38. **Po aty,** f. 73 a

DOKUMENT

se Shufadaja ndodhej në grykën e një lumi pranë Lezhës dhe ishte qendër e banuar. Në bazë të tyre mendohej se gjendej në grykën e lumit Drin, kurse më pas zuri vend mendimi se duhet të ishte në Ishëm.[39]

Përveç të dhënave të mësipërme, për lokalizimin e Shufadasë rëndësi vendimtare marrin ato të regjistrit të vitit 1580. Në këtë regjistër në krahinën e Kurbinit, ndërmjet fshatrave Milot e Laç, është shënuar fshati Shufada.[40] Këto të dhëna e bëjnë plotësisht të pranueshme vendndodhjen e Shufadasë në grykën e lumit Mat.[41] Pranë saj kanë qënë edhe kriporet e Kastriotëve të ngritura nga Gjoni.[42]

Mospërmendja e emrit Shufada në regjistrin e vitit 1431-32 dhe në atë të vitit 1467, pa përjashtuar mundësinë e regjistrimit në to me emër tjetër, duhet të ketë ardhur nga që ishte si e izoluar, larg qendrave të tjera të banimit. Rrjedhimisht në kohën kur janë bërë regjistrimet ajo ka qëndruar e fshehur, jashtë kontrollit të administratës osmane. Vendndodhja e Shufadasë larg qendrave të tjera të banuara, në thellësi të fushës, del mirë i shprehur në regjistrin e vitit 1580. I regjistruar si një fshat i vogël, në krahasim me të tjerët, në lindje të saj gjendeshin tokat e fshatit të sotëm Gurrëz, që më 1580 përmendet si vend i pabanuar dhe si tokë buke e fshatit Milot.[43] Ky fshat ishte qendra e banimit më e afërt e Shufadasë.

Lokalizimi i Shufadasë në grykën e lumit Mat plotëson kuadrin e qendrave tregtare të vendit tonë para pushtimit osman dhe arrihet në përfundimin se të gjitha grykat e lumenjve tanë nga Buna deri në Vjosë kanë patur qendra tregtare dhe vende të përshtatshme për ankorimin e anijeve të kohës. Me fuqizimin e klasës sundimtare shqiptare, sidomos gjatë shek. XIV dhe me kalimin në fund të këtij shekulli në duart e Venedikut të qyteteve bregdetare si Durrësi, Lezha, Ulqini, Tivari si dhe të Shkodrës, qendrat tregtare, që ishin nëpër grykat e lumenjve dhe të tjera jashtë kontrollit venedikas, filluan të loznin një rol të rëndësishëm në veprimtarinë ekonomike e politike të sundimtarëve shqiptarë dhe të vendit tonë.

Me caktimin e Shufadasë në grykën e Matit del akoma më mirë rëndësia e veçantë e vijës bregdetare, që shtrihej nga Rodoni deri në Mat, për lidhjet tregtare me botën e jashtme, e bashkë me to edhe të rrugëve tokësore. Sipas një marrëveshje tregtare të vitit 1420 të Gjon Kastriotit me Raguzën,[44] ai u garantonte tregtarëve raguzanë siguri kalimi nëpër tërë tokën e tij nga Shufadaja deri në Prizren dhe Rodonin (Radunja) e tregon si tokë të pushtuar nga turqit. Kështu që rruga tregtare e Shufadasë, duke

39. Këtë problem e ka trajtuar gjerësisht A. Dyselie, **Dalja në det,** f. 131-132; **Gjendja në kepin e Rodonit,** f. 123, **Le façade maritime de l'Albanie au moyen age,** Thessaloniki 1981, f. 539, 576.

40. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit, viti 1580,** f. 73 b.

41. Në artikullin tonë të botuar në gazetën «Kastrioti» më 20 Maj 1977 **Në gjurmë të rrugëve...,** f. 8, kemi shkruar se emri i Shufadasë «në derdhjen e lumit Mat... ruhet sot në toponiminë e vendit (Shufadë)». Po kështu edhe në artikullin **Shufadaja...** të botuar në «Kastrioti» më 3 Qershor 1977, f. 6, kemi shkruar se vendndodhja e Shufadasë «ishte në grykën e lumit Mat, ku edhe sot ruhet emri dhe kujtimi se diku aty ka qënë një qendër e banuar». Këtë informim na e kishte dhënë një i ri nga fshati Gurëz. Verifikimet e mëvonëshme më të gjera nuk na e siguruan informimin e mësipërm. Haxhi Goci në artikullin **Shufadaja-skelë e rëndësi-e Kastriotëve** «Ylli» 1982, nr. 1, f. 30 shkruan se në grykën e lumit Mat «ruhet ende sot një mikrotoponim me emrin Shufadë».

42. M. Barleti, **Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut,** Tiranë 1964, f. 100: «Këto kripore shumë të bukura ai i kishte në një vend që quhet Kampupeshkupi, ndërmjet një mali e vendi, i cili nga njera anë e ka emrin Selitë nga ana tjetër Shën Nikollë, vend shumë i njohur për shkrepat». Selita gjendet edhe sot pranë Laçit, kurse Shën Nikolla duhet të jetë Miloti se kështu është quajtur kisha e tij. Kampupeshkupi duket e formuar nga dy fjalë: fusha (kampu) e Pushkupi që ndoshta mund të ketë ndonjë lidhje me Bushneshin e sotëm. Nuk duhet përjashtuar mundësia edhe për Shënkollin e Lezhës.

43. **Regjistri i Sanxhakut të Ohrit viti 1580,** f. 73 ab

44. J. Radonic, **Vep. cit.,** nr. 2

DO NOT COPY

nisur nga gryka e lumit Mat, arrinte në Milot ku bashkohej me rrugën Durrës-Lezhë për t'u lidhur me viset e tjera të vendit. Nga Miloti merrte drejtimin e Rubikut për të dalë në Prizren e viset e tjera verilindore të tokave shqiptare.[45]

Nga regjistri i vitit 1580 kemi dhe një të dhënë për rrugën që ngjitej mbi malin e Krujës, rrugë që ekziston edhe sot. Për mirëmbajtjen e saj qenë caktuar 10 banorë të qytetit, duke i lëruar nga taksat e detyrimet e tjera.[46]

Veç të dhënave direkte mbi rrugët, regjistrat që kemi shfrytëzuar kanë edhe të dhëna të tjera që ndihmojnë për të gjurmuar rrugët mesjetare. Kështu p.sh. ndërsa më 1580 fshatrat e zonës së Nojës dalin të regjistruar në Kurbin, më 1467 nuk përfshiheshin në të por në zonën e Krujës.[47]) Nga kjo kuptohet se një rrugë e lidhte atë zonë me Krujën. Kjo rrugë ndiqte rrjedhën e Drojës. Po kështu mund të kapet dhe drejtimi i trasesë së rrugës që lidhte vilajetin e Krujës me rrugën e rëndësishme të luginës së Shkumbinit në vilajetin e Pavlo Kurtikut. Më 1431-1432 u formua një timar i madh me 14 fshatra të vilajetit të Krujës dhe me 20 fshatra të vilajetit të Pavlo Kurtikut, në nahijen e Bogdan Ripes që përfshinte krahinën e Krrabës. Krijimi i një timari të tillë tregon qartë se në zonën e atyre fshatrave kalonte rruga që lidhte vilajetin e Krujës me atë të Pavlo Kurtikut. Disa nga ato fshatra si Krraba, Mamël etj. gjenden në rrugën e karvaneve që ka lidhur Tiranën me Elbasanin.[47/1])

Treva e Krujës, në raport me viset e tjera të vendit, zinte një pozitë shumë të rëndësishme nga rrugët që kalonin nëpër të e që mbikqyreshin mirë nëpërmjet kështjellës së Krujës. Në roje të rrugëve kanë shërbyer dhe kështjella të tjera më pak të rëndësishme si Preza e Petrela që duhen konsideruar të varura nga Kruja dhe që mund të shikoheshin prej saj e të komunikonin menjëherë me të nëpërmjet sinjaleve që jepeshin në mesjetë me tym gjatë ditës dhe me zjarre gjatë natës. Po kështu Kruja mund të komunikonte edhe me Durrësin, Rodonin, Shufadanë, Lezhën dhe nga mali i Krujës, me viset lindore të vendit. Rrugët që kalonin nëpër trevën e Krujës lidhnin Durrësin, nëpërmjet Milotit me Lezhën e Shkodrën dhe, duke kaluar nëpër Mirditë me viset verilindore të vendit, lidhnin viset veriperëndimore e qendrore nëpërmjet Qafës së Tujanit me Dibrën e Ohrin dhe nëpërmjet Krrabës me luginën e Shkumbinit.

Gjurmimi e studimi i mëtejshëm i këtyre rrugëve nga specialistët përkatës do të sillte një kontribut me vlerë si për të njohur të kaluarën e krahinave të Krujës ashtu edhe për historinë tonë mesjetare në përgjithësi. Duke u ndalur mbi këto çështje kemi dashur të vinim të dukje vlerën e madhe që kanë burimet dokumentare mesjetare për njohjen e rrugëve e të theksonim se ndarjet administrative në mesjetë, siç ishte rasti i vilajetit të Krujës të shek. XV, nuk ishin të rastit, por bazoheshin mbi lidhjet e krahinave të formuara historikisht.

Për të ndihmuar gjurmimin e studimin e këtyre rrugëve nga të tjerë dhe punën që duhet bërë në raste të tilla për identifikimin e lokalizimin e emrave të një numri fshatrash të krahinave të Krujës, po japim një listë me emrat e fshatrave të vilajetit të Krujës të regjistrimit të vitit 1431-1432, si më i hershmi i zbuluar deri tani. Fshatrat i kemi shënuar sipas renditjes që kanë në regjistër dhe i kemi paisur me ato të dhëna e shënime që ndihmojnë për një punë të pavarur e me kritere sa më shkencore.

45. Pranë Rubikut sot është një vend i quajtur Derven, dëshmi kjo e kalimit të rrugës aty. Për vijimin e saj të mëtejshëm në drejtim të Prizrenit, shih J. Adam, **Vep. cit.**, f. 28-29.

46. **Regjistri i sanxhakut të Ohrit vitit 1580,** f. 117 b: «Në malin e Okçe-Hisarit ndodhet mekami i Sari-Salltekut, ku në çdo kohë vijnë për vizitë njerëz nga të katër anët e vendit. Rruga që u përmend më lart është shumë e vështirë dhe e keqe, prandaj ata që vijnë për vizitë hiqnin mundime. Dhjetë personat e mësipërm, shumica e të cilëve janë të çliruar nga taksat që në kohën e vjetër, patën marrë përsipër që rrugën e lartpërmendur ta sheshojnë e ta rregullojnë kur prishet».

47. **Regjistri i Dibrës, viti 1467,** f. 23.

47/1. **Defter-i Sancak-i Arvanid,** tim. 253; J. Adam, **Vep.cit.** f. 30.

DO NOT COPY

Fshatrat e vilajetit të Krujës[48]

1	2	3	4	5	6
276[49]	Kasale	38	1	2537	
	Kus'lar	34	1	2727	
	Siltë	5		220	
	Shin — Tom	11	2	1047	
	Gjonom	31	2	3216	
	Lalm'lar	41		2530	
	Plesh	17	2	1043	
	Andronik'ler	23	2	1494	
	(Pj)Pëlnek	24	1	1454	
	Priskë	13	3	1583	vreshtë 2 copë
	Shindesmije	16		1102	
	Shin Nikollë	8		490	
	Pinar	9		870	
	Gjasor	12		852	10 ullinj
	Balnon	7	1	667	
	Minikë	2		96	
	Shindullash[50]	truall			
	Kimbezë[51]	4		178	
	Klos	7	2	465	
	Gjinkere	3		270	
	Gjon Kllojkë[52]	14	2	1422	

48. Tabela është formuar duke shënuar numrin e timarit (1), emrin e fshatit ose të truallishtes (2), numrin e shtëpive (3), numrin e vejushave (4), shumën e detyrimeve në akçe (5), që duhej të paguanin banorët e fshatit, dhe pronat hassa të timarlinjve (6). Me germat (Pj) kemi shënuar rastet kur në timar nuk është përfshirë i gjithë fshati por vetëm një pjesë e tij, dhe nënkuptohet se ai fshat është i regjistruar edhe në timare të tjera. Kurse me (truall) kemi shënuar truallishtet, vendet e braktisura.
49. Timar i subashit të Krujës.
50. Shënimi tregon se më parë ka qënë fshat.
51. Fshati Kimbezë, Klos e Gjinkere kanë të shënuar se nuk kanë qënë të regjistruar më parë.
52. Shënimet tregojnë se nga ky fshat vareshin gjithë fshatrat e tjerë që vijojnë dhe që i janë dhënë si kompensim subashit për qytetin e Krujës, banorët e të cilit qenë liruar nga detyrimet për të ruajtur kalanë. Për tre fshatrat që pasojnë shuma e të ardhurave është llogaritur së bashku në 1920 akçe.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
	Shin-Istefan	6			
	Buruze	5	1		
	Beshkek	10			
	Hvaresh	13	1	1111	
	Mavroshin	8		939	
	Piskashesh	4		565	
	Shin Andre	4		370	
277	Krujë	125	19		
278	Berat	30	1	2123	
	Lanë	38	1	2837	
	(Pj) Farkë	12		745	1 vreshtë
	Sharmik	11		655	
	Karpene	10		905	
279[53]	Zhili	26	3	2010	7 ullinj, 6 arra
	Iskonjan	8	1	755	
	Lipe	9	1	671	
	Piçal	12		600	
	Fank	3		191	
280[54]	Iskonjan	8	1	755	
	Bogan	40			
281[55]	Sondin	13		860	
	Bodinad	4		377	
	Murdar	3		91	
	Izgurtin	2		206	
	Manës	5		368	
	Gror	14		974	
	Shindelli	8	1	992	27 ullinj, 3 arra
282	(Pj) Asan	12	1	985	
	Boranë[56]	13			24 ullinj, 5 pemë

53. Timar i djalit të dizdarit, kurse fshati Zhili më pas i është dhënë personave që qëndronin në kala.
54. Timar i krijuar pas regjistrimit, me fshatra që iu muarrën spahinjve të tjerë. Fshatit Bogan i mungon shuma e të ardhurave.
55. Timar i djalit të dizdarit. Një nga dy fshatrat e fundit të këtij timari është shtuar më pas. Inalçiku ka shënuar fshatin Gror, kurse duhet të jetë Shindellia sepse në fund të timarit janë llogaritur 6 fshatra me 41 shtëpi gjithsejt.
56. Shuma e të ardhurave për të dy fshatrat është llogaritur e shënuar së bashku: 1230 akçe.

1	2	3	4	5	6
	(Pj) Kurtsan	5			
283	(Pj) Asan	12	2	1372	
	(Pj) Kurtsan	14		1065	
284	Shin Gjergji	18	1	1250	30 ullinj
	Muzak[57]	5		360	
	Shin Todor[57]	10	1	840	
285	Poljë	13	1	767	
	Uskotar	9		455	
	Moranë	7		480	
286	Kolaksh	37	3	2544	
	Ashagi Kushar	17	2	1427	
	Lapishi[58]	20	1	2081	
	Manës Bisqar[58]	truall.			
287	Parroz	9		722	
	Shin Korena	8	1	681	
	(Pj) Shandre	9	1	762	
	Ostermash	11	1	881	10 ullinj, 1 arrë
	Ustof	truall.			10 fiq, 2 arra
	Sadak	4		614	2 ullinj, 1 vresht
	Kishë	1		124	
	Buçë	2		225	7 ullinj, 1 vresht
288	Gjonëm	7	2	727	3 fiq, 4 dardha, 1 vreshtë
	Kalomit	5	3	468	
	Preskop	11		922	3 ullinj, 3 arra
	Petril	3	2	335	
289	Patize	7	1	354	
	Mumajzë	5		637	
	Shin Istefan	10	1	1081	1 vreshtë
290	Lapesh	20	1	2081	
	Manës Visqar	truall.			
	Lopsh	6	2	926	

57. Më vonë fshati Muzakë bashkë me fshatin Polja iu dha të vllait të kadiut, me që u emërua imam. Shin Todor mban njëherësh cilësimet fshat e kishë.
58. Të dy këto janë shtuar pas regjistrimit.

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
	Lopsh[59]	12	1	1381	
	Kozan	6		531	
291	Dom	8		1185	1 mulli
	Budjelë	19	2	4436	30 ullij, 3 mana, 1 vreshtë
	Buljash[60]	10		700	
292	Perpidash	9		750	
	Vurd	6		493	
	Sadid	7	1	659	
	Vepsh	3		195	
	Dimandad	5		453	
	Olseno (Kalonbijash)	truall		263	
293	Jukaru Kushar	9	2	892	10 ullinj
	Kirashovë	8	1	556	3 arra
	Simahor	10		580	
294	Shinak	3		146	
	Selbijud	12		830	6 ullinj, 1 vresht
	Lugad	4	2	380	
	Kafaresh	2		48	
295	Dudenjas	10		920	10 ullinj, 1 vreshtë
296	Mazerak	9		910	
	Shotik	4	2	529	
	Kirpulish	4	1	458	
	Mersulesh	5		556	
297	Çavish'lar	29	1	2364	1 vreshtë
298	Muhalin	21		1269	3 ullinj
	Dufin	9		553	
	Kisha Shin-Todor	1		70	
299[61]	(Pj) Prizde	14		1075	10 ullinj
300	(Pj) Prizde	12	1	831	7 [illegible] nj

59. Pas regjistrimit i është dhënë një ruajtësi të kalasë. Fshatrat Lapesh, Lopsh e Lopsh duhen konsideruar jo si i njëjti vendbanim, por si fshatra pranë njeri tjetrit apo si lagje të një fshati të shpërndarë.
60. Ka qënë i paregjistruar dhe me të u formua më pas një timar i veçantë.
61. Timar i peshkopit. Kuptohet se qendra e tij ka qënë në Prezë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
	Vishen	5		335	
	Ruvaçisn	4		429	6 ullinj, 1 vresht
301	Shoran	9		515	
	Persulesh	9	2	674	5 ullinj, 1 vresht, 3 mana
	Magol	5		373	
	Ishkifat[62]	4	1	331	
	Rijbas	4		334	
	Markinisht	5		373	
302	Ribë	8		660	1 vreshtë
	Karançë (Tudë)	6	2	432	
	Shin Gjergj	3		274	
303	Blumbe	3	1	257	
304	Tuzan	2	1	212	
305	(Pj) Farkë	5	1	626	1 vreshtë
306	Kance	12	1	1019	
	Manes	15	4	1149	1 vreshtë
307	Bishtiz	10		790	
	Lijet	5		225	
	Karpunar	9		784	
308	(Pj) Ishte-banoz	9	1	660	
	Barbaz	6	2	581	
	Shin Nikollë	6		620	6 ullinj, 1 vreshtë
	Betlijan	4		320	
309	Bilur	3		332	
310	Kokunje	5	1	392	1 vreshtë, 6 mana, 3 arra
	Mazerak	9	1	566	
	Jastroz	4		241	6 ullinj
	Bigalish	3		215	
	Sutinë	4		224	
	Barbash	2		150	
	Shabshakol	8		700	
	Sanaze	4		223	
	Turishde	9		625	2 ullinj, 1 vreshtë
311[63]	Donjan	14	1	1634	34 ullinj, 5 mana

62. Tre fshatrat e fundit janë shtuar më pas.
63. Spahinjtë që kanë patur këtë timar kanë shërbyer në kala. Në këtë timar fshati Lonkovë është shtuar gjatë regjistrimit, kurse fshatrat Lankoç e Rurinash pas tij.

1	2	3	4	5	6
	Denjanish	18		1257	10 ullinj
	Ishitisht	7	2	697	14 ullinj
	Shindel	8	1	992	27 ullinj
	Starle	2		162	
	Lankove	2		190	
	Lankoç	2			
	Rurinash	2			
312	Priskë	32	2	2752	45 ullinj, 5 arra, 1 vreshtë
313	(Pj) Shandre	9		935	
	Lishmas	6	1	551	
	(Pj) Ishtebanoz	19	6	2024	1 vreshtë
314	Marmur	17		1195	
	Shilje	3		322	
	(Pj) Brace	truall			
315	Dubresh	1		123	
	Balid	15	3	2038	
316	Maljet	7		840	
	(Pj) Ishkiz	10		1170	1 vreshtë
	Romce	3		265	
	Markinishte[64]	truall			
317[65]	Ishkifat	4	1	331	
	Rijbas	4		334	
	Moknar	16	2	2003	6 ullinj, 7 arra, 1 vreshtë
	(Pj) Pelnek	2	1	216	
	Rakise	truall			
	Brace	31	2	2517	
	Ishkifat			3131	
	Rijibas	4		334	
	Blumbe	3	1	257	
318	Bogonid	7		592	1 vreshtë, 5 pemë
	Sumenat	8		791	3 ulli

64. Shtuar pas regjistrimit.
65. Pas regjistrimit fshatrat Ishkifat e Rijbas iu dhanë një shigjetari të caktuar në Krujë, kurse me fshatrat Braçe, Ishkifat e Rijibas u krijua një timar i ri. Fshati Blumbe është shtuar më pas.

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
	Brace	2		176	
	Gjonëmë	6		436	
	Baldran	6		332	
319	Barbucë	16	2	1532	
320	Sunjel	14	3	1651	
	Kokunjë	truall			
	Sutinë (truall)	3		300	
	(Pj) Barkin[66]	4	1	868	5 ullinj, 4 pemë
	(Pj) Barkin	7		710	
321	Lakjet	23	3	2795	6 ullinj, 10 pemë, 1 vreshtë
	Zizë[67]	10		826	
322	Ozgurtash	18	1	2341	70 ullinj, 10 pemë, 1 vreshtë
	Silte	19	1	2916	
	Borzol	12	1	1442	1 vreshtë, 1 mulli
	Mishqetë	14	1	896	1 vreshtë, 3 pemë
323[68]	Binad	12	1	1328	20 ullinj
	Dom	3		320	
	Çiken	truall		270	
	Brace	31	2	2517	
	Gurkani	4	1	401	
324[69]	Suket	8	1	671	10 ullinj, 10 arra
	Binad	12	1	1328	20 ullinj
	Hameken	truall			
	Thumanë	3	1	321	
	Dom	3		420	
	Thumanë	3	1	321	
	Suket	8	1	671	10 ullinj, 10 arra
	Marmur	17		1195	

66. Këto dy pjesë fshati janë shtuar pas regjistrimit.
67. Shtuar në kohën e regjistrimit.
68. Pas regjistrimit këtë timar e mori djali i dizdarit të Krujës.
69. Disa nga fshatrat e këtij timari janë shtuar pas regjistrimit. Gjithashtu pas regjistrimit, meqënëse spahiu i këtij timari u bë dizdar i Krujës (dhe kuptohet mori timarin e këtij), fshatrat e këtij timari iu dhanë spahinjve të ndryshëm.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
325	Kakarik	9	1	836	2 ullinj, 11 pemë, 1 vreshtë
	Valjezë	15		1372	7 ullinj, 1 vresht
	(Pj) Ishkilaz	5		410	
	Shin-Gjin[70]	9		816	
326	Rodemesh	28	1	3661	20 ullinj, 1 vreshtë
	Bogomish	8		1200	
	Çiflig[71]	livadh			
327	Bushanesh	27	3	2363	
328	Ushak	5		465	
	Fikefen	3	1	342	
	Pleshirud	13		1050	
	Druzë	3	1	241	
	Plesh-ruvaçish	4	2	753	
	Bikbelesh	1		49	
329	(Pj) Virjon	15		1171	
	(Pj) Mondikle	7		90 5	
	(Pj) Barkin	4	1	898	5 ullinj, 4 pemë
	Buzhik[72]	truall			
330	(Pj) Virjon	14	1	1185	
	(Pj) Barkin	7		710	
	(Pj) Mondikle	8		554	
331	(Pj) Ishtepaz	8	2	600	
332	Mulet	12	3	1028	
	(Pj) F[illegible]e	5	1	495	
333	(Pj) Ishteban[oz]	15	1	898	
	Iskozir	2	1	265	
	Isdardanesh[73]			30	
334	Moknar	16	2	2003	
	Markinishte	5		373	
335 [75]	Donjan	14	1	1634	34 ullinj , mana,1 vreshtë
	Moknar	16	2	2003	6 ullinj, 2 arra, 1 vreshtë

70. Shtuar pas regjistrimit, mban shënimin «Fshati Shin Gjin Kishë».
71. Mban shënimin «livadh i fshatit të mësipërm».
72. Është shënuar «shtegu i Buzhikut» (Buzhik Gjeçudu).
73. Është cilësuar si fshat, por nuk ka të shënuar numrin e familjeve.
74-75. Timare të krijuar pas regjistrimit.

1	2	3	4	5	6
25376)	Selbe	41			
	Litenij				
	Darshen	29	4		
	Horshen	28			
	Shin Gjergj-Ashkale	16			
	Lekanesh	20			
	Konijë	10			
	Dernë	80	2		
	Parpunet	45			
	Dom	28			
	Orsulë	26			
	Korë	27	1	2721	1 vreshtë
	Çorulje	31		3465	
	Murs	2			
	Fag	12			
	Katune Muzak	60			
	Gajton	7			
	Lesani	44			
	Gursi	8			
	Shën Mëri	8			
	Kilnosh	4			
	Bicosh	14			
	Kurt	74			
	Branesh	15			

DO NOT COPY

76. Në fillim të këtij timari është shënuar «nahija e Krujës» e nën të janë regjistruar 10 fshatra të kësaj nahije, të ardhurat e të cilëve janë llogaritur së bashku (15.000 akçe), si dhe katër fshatra të tjerë të së njëjtës nahije, si shtesë e mëvonëshme, dy të fundit nga të cilët (Murs e Fag) mbajnë shënimin se kanë qënë të paregjistruar. Kurse 20 fshatrat e tjerë, nga Katune Muzak e deri në fund, mbajnë në krye shënimin e nahijes Bogdan Ripe, që përfshihej në vilajetin e Pavlo Kurtikut, të ardhurat e të cilëve janë llogaritur bashkërisht në 15.000 akçe. Fshati Liteni nuk ka të shënuar numrin e shtëpive.

DO NOT COPY

1	2	3	4	5	6
	Çizakunesh	23			
	Gjonëm	14			
	Shelbon	6			
	Bet	6			
	Karaban	12			
	Borozij	6			
	Balitzë	11			
	Shën Gjon	17			
	Ishtiman	35			
	Mamël	40			
	Kozan	49			
260[77]	Bazire				
	Krapkos				
	Ishtepaz				
	Burzove				
	Çuzel				
	Darsen				
	Murs				
	Lika-Ishkallë				
	Orsula				
	Fagu				
	Fojenez				
273[78]	Subgan	18		2066	1 vreshtë
	Luz	12	1	832	
	Shindelli	15		1444	20 ullinj

77. Ky timar është formuar më 1450 kur trupat osmane mbanin të rrethuar Krujën. Nga emrat e disa fshatrave kuptohet se i përkisnin vilajetit të Krujës. Mbi to nuk ka ndonjë të dhënë tjetër.

78. Të tre këto timare (tim 273-275) i përkisnin vilajetit të Krujës. Shih K. Biçoku, **Mbi shtrirjen e Sanxhakut të Shqipërisë**, f. 87. Fshati Luz e Shindelli pas regjistrimit dalin në zotërim të një personi, po kështu në zotërim të një tjetër personi dalin fshatrat Iskafnar, Darda bashkë me fshatrat Suket e Thumanë që u shtuan në këtë timar pas regjistrimit.

1	2	3	4	5	6
	Iskafnar	2		217	
	Persak	22		1707	
	Dardë	8		862	
	Brace	truall			
	Hinkorfe	8	1	681	
	Kirashovë	8	1	556	3 pemë
	Suket	8	1	671	10 ullinj, 11 mana
	Thumanë	3	1	321	
274	Kurvazis	7	1	542	
	Çirme	9	1	1049	1 ulli, 1 vreshtë
275	Berzhite	20	5	1995	5 ullinj

DO NOT COPY

DO NOT COPY


Lezhë
Rubik
L. Matit
Milot
Shufadaja
Shullaz
Laçi
Mamurras
KURBIN
Minjollë
Burizan
Krujа
L. Ishmit
Dërven
MISJA
Bilaj
Zgërdhesë
RIDISHTA
Klos
Bulqizë
Gur i Bardhe
Budulla
Prezë
Tujani
L. Erzenit
SKURJA
DURRES
Ndroqi
Petrela
Dorzi
Krrabë
Librazhdi
Vrap
Xhyrë
ELBASAN
L. Shkumbinit
Pegini
ADRIATIKU
DETI
Prezë – Fshat dervenxhinjësh
Shkalla 1:500000

Kasem BIÇOKU

DO NOT COPY

LES VOIES QUI TRAVERSAIENT «LE VILAYET» DE KRUJA AU XVème SIECLE ET LA LOCALISATION DE SHUFADA

RESUME

L'article traite des voies qui traversaient le vilayet de Kruja au moyen-âge, surtout la voie Durrës-Lezhë et ses branches, ainsi que la localisation du centre commercial et douannier des Kastriotes – de Shufada. Leur localisation s'est faite sur la base des sources écrites, tels que les registres des cadastres ottomans des années 1431-32, 1467, 1580 et 1583, auxquels viennent s'ajouter d'autres documentations.

Les régions comprises dans le vilayet de Kruja (ayant pour frontières, au sud, les régions actuelles de Tirana-Elbasan et au nord, le fleuve de Mati) sont considérées par l'auteur comme une unité historique déterminée par les conditions géographiques et naturelles. Quant aux voies traversant ces régions, elles sont considérées comme un facteur très important de la création et du maintien de cette unité.

Au début on fournit des données puisées dans les sources en question et l'on pose le problème des difficultés pour la localisation des villages et des emplacements. Les noms des villages varient dun registre à l'autre. Un vif témoignage en est le cas de la région médiévale de Misje, dont les villages dans un lapsus de temps relativement court (trois ans: 1580-1583) ont été enregistrés deux fois et 1/3 d'entre eux paraissent sous des noms différents.

Les données sur les voies ont été effectuées sur trois régions médiévales par l'auteur dans le district de Kruja: Misja, Rindishta, et Kurbini. La région de Misja était comprise dans le massif des collines à partir du cap de Rodone jusqu'au chemin actuel Vorë-Durrës et Vorë-Fushë-Krujë, entre les fleuves Erzen et Ishëm; Kurbini s'étendait entre les fleuves Drojë et Mat et Rindishta à l'est de Misja, au sud de Kurbini et à l'ouest de la chaîne des montagnes Krujë-Dajt. Les noms des villages de ces trois régions ont été relevés tels quels dans le registre de l'année 1580, qui n'est pas publié et mis en exploitation jusqu'à ce jour.

Des données précises ont été tirées, surotut sur la voie Durrës-Lezhë-Shkodër. D'après ces données, il ressort que la route était pavée, avec des ponts et était parcourue par des caravanes et des voyageurs aussi bien en été qu'en hiver.

Traitant de la localisation de la voie, dans un article il est mentionné qu'elle partait de Durrës en direction du nord-est pour arriver au village actuel de Vora. Cette partie de la voie servait de frontière entre Misja et l'autre région médiévale de Skurja. Elles étaient également étroitement liées l'une avec l'autre comme il ressort des documents des XV et XVI èmes siècles.

De Vora, la voie se dirigeait vers le nord vers Preza et Budull. A partir de ces villages, les données sur la voie sont plus directes. De par cette documentation il ressort clairement l'attention qu'attachait l'administration turque à l'entretien et aux mesures de sécurité pour la circulation dans la voie Durrës-Lezhë-Shkodër. Dans le cadre de ces mesures, outre la grande attention dont devait faire preuve «toute la population du pays», les habitations de certains villages furent libérés de certaines obligations pour pouvoir s'occuper de l'entretien et de la sécurité tout au long du trajet, et dans le registre ils figurent comme des gardes des rues (dervenxhinj). Comme tels apparaissent les habitants des villages Preza, Budull de Misja. Même les habitants de Bilaj de Misja, comme il ressort de la documentation antérieure assumaient la même fonction. Toujours dans le cadre du registre de 1580 il ressort que les habitants du village Minjollë de Rindishta qui est localisé à Burizanë, dont actuellement un quartier porte le nom Miciane, faisaient la même besogne. Ayant pour base ces données et bien d'autres, on a réussi à tracer le parcours de cette voie de Durrës à Lezhë et ses déviations et ses liens avec les autres voies.

Après avoir traversé le village Budull, quelque part près du village Murqinë, la voie Durrës-Shkodër après avoir croisé la voie qui venait du cap de Rodone et d'Ishmi se dirigeait vers Bilaj, traversait le fleuve Ishëm pour aboutir à Derven et Burizanë. Chez se dernier on constate même aujourd'hui les traces d'un bain du temps des romains et naturellement d'une station antique, apparamment de Pistumi. Burizana actuel apparait comme un centre de croisement des voies Durrës-Lezhë et de l'autre voie très importante de Dibra et d'Ohri qui passait par Zgërdhesh et le col de Tujan, virant vers l'est vers Dibra et Ohri. D'après le registre de 1580 les habitants de Tujan s'occupaient depuis longtemps déjà de l'entretien de la rue. Une autre branche de la rue se croisait à Burizanë qui descendait de Picrragë, pour relier Kruja avec les régions de l'ouest, tandis qu'elle était reliée aux régions de l'est avec la voie Durrës-Lezhë, à proximité de Mamurras.

Après Burizanë, se dirigeant vers le nord la voie Durrës-Lezhë parcourait la région de Kurbini. Pour garder et entretenir la voie étaient désignés les habitants de Milot, qui assuraient également le passage du fleuve de Mati. La, la route se divisait en deux: l'une pour Lezhë et Shkodër et l'autre en direction de Rubik pour les régions du nord-est. A Milot se croisait aussi la voie de Shufada.

Dans ce registre on cite même la voie qui mène à la montagne de Kruja. Outre les données directes dans cet article, on fournit des données sur d'autres registres qui aident à découvrir les voies médiévales comme par exemple celle qui reliait le vilajet de Kruja avec la vallée de Shkumbini.

A la fin de cet article il est dit que la contrée de Kruja, par rapport aux autres régions du pays, occupait une place centrale dûe aux diverses voies qui la parcouraient. Elles reliaient Durrës, par l'intermédiaire de Milot avec Lezha et Shkodra, pour passer à Mirdita, avec les régions du nord-est du pays, liaient les régions du nord-ouest et centrales par le col de Tujan, avec Dibra et Ohri et par l'intérmédiaire de Krraba, avec la vallée de Shkumbini.

Dans cet article on attache de l'importance aussi à la localisation du port et du centre douannier des Kastriotes, Shufada, et, par la même occasion de la voie commerciale qui le reliait avec les autres régions.

Très attachée à l'activité des Kastriotes, Shufada a attiré depuis longtemps l'attention des historiens. Se servant de la documentation de Raguse et de Venise, des efforts ont été faits pour préciser son emplacement. De cette documentation il y en a un fait qui est sûr: que Shufada se trouvait à l'embouchure d'un fleuve près de Lezha et qu'elle était un centre habité. Sur cette base on a lieu de croire que Shufada se trouvait à l'embouchure du fleuve Drini, mais par la suite on pensa que se devait être sur le fleuve Ishëm.

A part les données ci dessus mentionnées, les données du registre de 1580 prennent une importance particulière et décisive. On y trouve cité le village Shufada dans la région de Kurbini entre les villages Milot et Laç. Ces données rendent acceptable l'emplacement de Shufada à l'embouchure du fleuve Mati. C'est là qu'il faut chercher les séleries construites par Gjon Kastrioti.

Avec la localisation de Shufada se termine le cadre des centres commerciaux de notre pays avant l'occupation ottomane, et l'on aboutit à la conclusion que sur toutes les embouchures de nos fleuves de Buna jusqu'à Vjosa ont existé des centres de commerce et des endroits convenables pour les navires de l'époque. Avec la consolidation de la classe féodale albanaise, surtout durant le XIV ème siècle et le passage aux mains de Venise des villes maritimes, les centres de commerce, qui se trouvaient à l'embouchure des fleuves et autres hors du contrôle des vénitiens, commencèrent à jouer un rôle important dans l'activité économique et politique des chefs albanais de notre pays.

PHOTOCOPY

DO NOT COPY

Pirro THOMO

BANESAT E HAPURA NË QYTETIN E KORÇËS DHE DISA PROBLEME TË RESTAURIMIT TË TYRE

Çështja e banesës së vjetër korçare, tipat më të përdorshëm, karakteri dhe procesi i përpunimit dhe zëvendësimit të tyre ndonëse janë prekur në literaturën tonë shkencore, ende nuk kanë marrë zgjidhje përfundimtare. Në studimin e E. Rizës dhe B. Strazimirit, «Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës»[1], na jepet një tablo e plotë e arkitekturës së banesës tipike korçare, e cila mbizotëroi në ndërtimet e këtij qyteti gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Aty përmendet për herë të parë prania e banesave të hapura në qytet, ku përfshiheshin banesat me hajat e çardak,[2] përpara se tipi i ri i banesës të bëhej mbizotërues. Por gjerësia e problematikës së kapur në këtë trajtesë, mungesa e materialit të gjerë faktik, si dhe theksimi i dukurisë më tipike të qytetit, krijimi i një fizionomie urbanistike e arkitektonike të re gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX nuk i ka lejuar autorët e mësipërm të zgjerohen më shumë në këtë problem.

Materiali i ri i gjurmuar këto vitet e fundit, dëshmitë e shumta të dala gjatë punimeve restauruese në banesat e vjetra, na japin mundësi ta rimarrim këtë problem në studim dhe të hedhim dritë mbi një tip banese të përhapur në qytetin e Korçës, në një periudhë historike ende të hershme të zhvillimit të Korçës si qytet.

Dokumentet historike dhe njoftimet nga udhëtarët e ndryshëm, ndonëse jo të shumta, si dhe gjurmët materiale të ruajtura deri në ditët tona, na japin mundësi të skicojmë një tablo të përafërt të karakterit ekonomiko-shoqëror dhe urbanistiko-arkitektonik të Korçës deri në mesin e shekullit XIX.

Gjatë kësaj periudhe Korça ruante tiparet e një qendre të vogël, qoftë nga numri i popullsisë, ashtu dhe nga shtrirja dhe aktiviteti[3]. Qyteti formohej prej tre bërthamave kryesore, të ndara qartë nga njera tjetra, në dy ansamble të banuara, të quajtura Varosh e Kasaba dhe nga qendra tregëtaro-zejtare ose Tregu i Qytetit. Një ndarje e tillë veçonte jo vetëm ansamblet për nga karakteri i tyre, por edhe lagjet e banuara me popullsi të besimeve të ndryshme, gjë që theksonte dasitë fetare.

E ndodhur në një pozitë të favorshme, Korça gjatë kësaj periudhe do të ketë ruajtur rëndësinë e saj si qendër administrative e krahinës përreth, karakter të cilin do ta ketë pasur që herët. Mbas vendosjes së pushtimit osman në këtë zonë, Korça del në dokumentet e kohës si një qendër me kështjellar e kadi,[4] ndërsa në shekullin XVIII zanatçinjtë e Voskopojës mësonin zanatin dhe mirnin leje për ushtrim profesioni në Korçë[5], ndonëse Voskopoja ishte ende një qendër e madhe kulturore dhe ekonomike.

1. E. Riza-B. Strazimiri, **Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës,** «Monumentet» Nr. 3, 1972, f. 119-134.
2. **Po aty,** f. 121.
3. Z. Shkodra, **Rreth kumtesës «Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut sipas një dokumeni të shek. XVII»,** Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shk. shoq. Nr. 4, 1958, f. 256. Sipas udhëpërshkruesve të fillimit të shek. XIX Korça nuk i kalonte të 3.000 banorët (Feliks de Bozhur, M.W. Like). Pukëvili po për këtë periudhë e jep numrin e popullsisë rreth 9.100 banorë (1.300 shtëpi). Ndërsa në vitin 1879 Korça numronte 1.500 shtëpi me 13.000 banorë (shih P. Pepo, **Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit,** dok. 166, Mars 1879, Arkivi i Institutit të Historisë).
4. **Regjistri i Përmetit dhe i Korçës,** përkthim në Arkivin e Institutit të Historisë.
5. Z. Shkodra, **art. cit.** f. 265.

Pamja e qytetit të kësaj periudhe nuk duhet të ketë ndryshuar shumë nga ajo e qendrave të tjera qytetare të kohës. Pjesa e populluar më dendur, Varoshi, ishte ndarë në «mëhallë», që mbanin emrat e familjeve më në zë, si Manço, Mano, Pençi, etj. Ansambli ishte mjaft i ngjeshur me ndërtime. Ai përshkohej nga rrugë të ngushta e gjarpëruese, me gjerësi që luhatnin nga 2-4 m. Ndërtimet e vogla, shpesh dykatëshe, ndërtoheshin ngjitur ose pranë njera tjetrës, duke krijuar një masë kompakte. Oborret, zakonisht të vegjël, rrallë dilnin në pjesën e përparme, por dhe në të tilla raste ato rrethoheshin me mure të ulët, që lejonin të dukej pamja e banesës. Më shpesh banesat dilnin me një faqe ose me dy në rrugë, duke e gjallëruar atë me përpunimin e pasur të pamjeve, me ballkonet dhe erkeret që rinin pezull mbi rrugë.

Një gjallëri të madhe kishte tregu i qytetit, i cili ndahej në dy pjesë nga lumi i Moravës. Tregu do të ketë ruajtur vendin e vjetër, të ndërtuar pranë xhamisë së Mirahorit, ndërtimit më të vjetër në qytet (1498). Pranë, më 1784[6] u ngrit kulla e sahatit e cila, si dhe në qendrat e tjera Tiranë, Kavajë, Peqin, Elbasan, Prizren, Shkup etj. krijonte theksimin urbanistik të ansambleve tregëtaro-zejtare[7]. Pamja e pazarit të Korçës, si rezultat i zjarreve të herëpasherëshme[8], ka ndryshuar plotësisht. Por mundësia e djegieve dhe përsëritja e shpeshtë e zjarreve, lenë të mendohet për ndërtimet prej druri që formonin pazarin. Aktiviteti ekonomik i qytetit kryhej kryesisht në pazar. Aty bëhej shkëmbimi i produkteve bujqësore dhe të zejtarisë. Gjatë kësaj periudhe në Korçë numëroheshin disa organizata esnafore[9], të cilat ndikonin fuqishëm në jetën ekonomike e shoqërore të qytetit.

Në këtë kuadër të përgjithshëm ekonomiko-shoqëror dhe urbanistiko-arkitektonik, gjeti përhapje dhe një tip i caktuar banese, banesa me treme të hapura, tiparet e të cilave përputheshin me këtë shkallë zhvillimi të qytetit.

Banesa të tilla, siç dëshmojnë shembujt e ruajtur dhe gjurmët e zbuluara, kanë qënë të shumta në qytetin e Korçës. Më poshtë do të analizojmë disa prej tyre, të cilat bartin në vetvehte tiparet më thelbësore të këtij tipi, pasqyrojnë rrugën e zhvillimit dhe të



Fig. 1

ndryshimeve që pësuan ato në kohë dhe, së fundi, u janë nënshtruar punimeve të rëndësishme restauruese.

Banesa Nr. 1 (Rr. S. Peci, Nr. 23). Është një ndër banesat më të vjetra që ruhen nga ky grup dhe duhet t'i përkasë fundit të shekullit XVIII. Në gjendjen e sotme ajo ruhet e cunguar nga ndërtimi ngjitur me të i një banese të re, ndërsa e gjithë pjesa e prapme e saj ka marrë një zhvillim të madh planimetrik si rezultat i shtesave të mëvonëshme dhe ka pësuar gjithashtu ritrajtime të rëndësishme (Tab. I, Fig. 1, 2).

Pjesa e vjetër që ka mbetur është dykatëshe. Në katin e sipërm çardaku i hapur ze një vend të konsiderueshëm dhe lidhet me dy ambiente banimi. Njeri prej tyre merr dritë nëpërmjet çardakut, ndërsa i dyti del tej planit të çardakut në pamjen ballore të banesës. Në gjendjen e sotme nuk mund të gjykojmë në se kjo skemë përsëritej edhe në krahun tjetër, për të na dhënë skemën e njohur me çardak në qendër, apo kemi patur të bëjmë me një kompozim asimetrik me çardak në një krah. Kompozimin dhe pamjen fillestare e ruan vetëm ambienti i ballit. Ai ka në pjesën fundore bllokun e musandrave, të përpunuar edhe me pjesë të gdhendura, që rrethon raftet e hapura, dollape në mur, tavan dërrase etj.

Kati përdhe ka të njëjtin kompozim planimetrik. Ai përbëhet nga hajati i hapur, «dhomës së dimrit» që del në pjesën e dalë të banesës dhe qilarit. Dhoma e dimrit është e shtruar me dysheme, e pajisur me tavan dërrase, oxhak dhe dollape në mur.

6. N.D.N., **Korça edhe katundet e Qarkut,** Korçë 1923, f. 48.
7. S. Dashi, **Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë,** Monumentet, Nr. 12, 1976.
8. Mbahen mend tre zjarre të mëdhej që dogjën pazarin e Korçës në vitin 1822, 1858 dhe 1879 (P. Pepo, **Kodiku i Mitropolisë ...** (vep. cit.) dok. 41, 42, 193).
9. P. Pepo, **Kontribut mbi historinë e tregut të Korçës e të Voskopojës,** Korça e Re, Almanak, Korçë, 1964, f. 164.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

Banesa është ndërtuar me gurë të lidhur me baltë dhe të përforcuar me breza druri. Masa e plotë e muraturës nuk arrin të thyhet nga dritaret e vogla, me mbulesë harku, e të mbrojtura me kafazë druri, që dalin në pamjen kryesore. Ajo kontraston ndjeshëm me sipërfaqen e hapur të çardakut pranë saj. Streha mjaft e dalë e çatisë, me elemente të gdhendur, mbron muraturën dhe çardakun nga faktorët atmosferikë.

Banesa Nr. 2 (Rr. Jeronim De Rada Nr. 5). Ndonëse ruhet mjaft e fragmentuar paraqet interes për përhapjen e banesave të hapura në Korçë dhe, në mënyrë të veçantë, për kompozimin dhe trajtimin arkitektonik e dekorativ të ambienteve, në një periudhë të caktuar të zhvillimit të tyre, që kap dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIX (Tab. II; Fig. 3).

Nga banesa ruhet e pa prekur nga ndryshimet e mëvonëshme dhe me të gjithë elementet formues fillestarë një pjesë e katit përdhe. Ajo përbëhet nga hajati i hapur që shkon gjatë gjithë ballit të banesës, një ambienti kryesor banimi dhe nga një e ndarë e vogël, përbri tij. Një pjesë e katit përmban bodrumin ose qilarin, me hyrje nga hajati nëpërmjet një qepeni të hapur në dysheme.

Ambienti kryesor i katit përdhe do të ketë shërbyer si dhomë ndenje dhe gatimi. Ai është shtruar me dysheme dhe pajisur me tavan të thjeshtë dërrase. Blloku i musandrave ze një faqe të ambientit. Ai përbëhet nga hambari i drithit, magjes së gatimit të bukës dhe dollapeve. Përballë është vatra, ndërsa në mure janë hapur dollapë, pjesa e sipërme e të cilëve është e hapur dhe e zbukuruar me elemente druri të gdhendur. Brezi qendror i faqeve të dhomës, që përfshin dritaret e dollapit është qarkuar me fashatura dërrase, sipër të cilave janë vendosur «policet» ose sergjenet, për të mbajtur enët e guzhinës.



Fig. 4

Ambienti ndriçohet nga dritare të mëdha që dalin në çardak. Hapësirat e ndriçimit janë të përbëra prej kanatit të xhamit dhe kanatit të plotë prej dërrase, të dyja njëpjesëshe. Ato hapen me rrëshqitje horizontale, duke u futur në hapësirën ndërmjet dy pareteve të çatmasë. Nga ana e çardakut dritaret mbroheshin nga kafazë druri (Fig. 4).

Hajati përmban në ballë një radhë kollonash druri me qoshe të gdhendura dhe të kurorëzuara me jastëkë druri të daltuara. Ndërmjet tyre ngrihet një parapet i ulët i ndërtuar me binarë vertikalë (Fig. 5, 6). Hajati është shtruar me dysheme dërrase, por nuk



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

është i pajisur me tavan. Përveç shtyllores së hajatit, përkujdesje e veçantë i është kushtuar përpunimit të faqes së murit ndarës së hajatit me ambientin e banimit e cila merr pjesë në formulimin e jashtëm. Dera e hyrjes kurorëzohet nga një hark dërrase. Dritaret që dalin në çardak rrethohen me fashatura dërrase dhe, duke e vazhduar këtë kornizim gjatë gjithë faqes, krijohet një bllok i tërë, ku shkëmbehen pjesët e zbrazta, dritaret, me pjesët e plota e të bardha të muraturës. Trajtimi dekorativ këtu fuqizohet edhe me thyerjen e ngjyrës së bardhë të muraturës së plotë me ngjyrën e ngrohtë të elementeve të drurit.

Të dhënat gojore, të cilat mbështeten plotësisht edhe nga elementet e shumtë të zbuluar gjatë punimeve të restaurimit, dëshmojnë se banesa ka qënë dykatëshe. Kompozimi planimetrik i katit të sipërm përsëriste atë të katit përdhe. Shkallët prej druri të vendosura në hajat, dilnin në çardakun e katit të sipërm. Elemente të zbuluar si kollona, kapitele, pjesë strehe, fashatura etj. na japin mundësi të rindërtojmë dhe trajtimin e këtij kati. Konstruksioni mbajtës i çardakut dhe strehët e çatisë kanë qënë të zhveshura, të formuara me elemente druri të gdhendur. Edhe trajtimi arkitektonik e dekorativ i ambienteve ka qënë i një karakteri me atë të katit përdhe, por me një përpunim më të kujdesshëm të elementeve përbërës.

Përveç këtyre të dhënave, në faqen e jashtme të murit verior ruhen gjurmët e një oxhaku me kamare anash si dhe gjurmë muresh të cilat dëshmojnë për praninë e një ambienti banimi. (Tab. III).

Punimet e restaurimit të ndërmara në këtë banesë,[10] u udhëhoqën nga fakti i rëndësishëm se kishim të bënim me një shembull, i cili, ndonëse i fragmentuar, ruante të paprekur mjaft elemente kompozicionalë dhe të trajtimit arkitektonik e dekorativ. Për këtë arsye punimet u përqëndruan në konsolidimin statik të elementeve mbajtës, të muraturës, të çatisë, dyshemesë, si dhe në pastrimin dhe evidentimin e elementeve të tjerë arkitektonikë e dekorativë, duke bërë zëvëndësime dhe plotësime të pjesëshme të tyre (Fig. 7).

Ndonëse rikonstruksioni i katit të sipërm mund të kryhej sipas të dhënave të zbuluara, ai nuk u bë, mbasi një veprim i tillë do të cënonte në mënyrë të ndjeshme vërtetësinë edhe të pjesës së vjetër ekzistuese. Në këtë mënyrë u la pothuajse e paprekur pjesa e vjetër, si dëshmi autentike e këtij tipi në qytetin e Korçës, duke krijuar mundësinë edhe për krahasime me shembuj të tjerë.

10. Punimet e restaurimit u kryen nga Ateljeja e Korçës në vitin 1979-1980, sipas projektit të autorit.

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

Përsa i përket ambientit të rëzuar në katin përdhe, ai u rindërtua për nevojat e familjes, por duke përdorur materiale e teknikë të sotme. Përjashtim bën rindërtimi i murit lindor, i cili duke qënë në vazhdim të murit ekzistues të banesës dhe në pamje të jashtme, u krye në teknikën e vjetër për të mos prishur unitetin stilistik të kësaj pamjeje.

Banesa Nr. 3 (Rr. Mihal Grameno, Nr. 4)[11]. Kishte arritur në ditët tona në një gjendje krejtësisht të transformuar (Fig. 8, 9). Gjatë punimeve të restaurimit u zbuluan të dhëna të rëndësishme dhe elemente të shumtë, që e bënin mjaft të lehtë kthimin e saj në gjendjen fillestare.[12]

Gjendja para restaurimit (Tab. IV). Banesa ishte dykatëshe. Hyrja bëhej në katin përdhe dhe përfundonte në një korridor të ngushtë. Kati përdhe përmbante dy ambiente. Ambienti verior shërbente si dhomë ndjenjie, ndërsa i dyti në anën jugore si kuzhinë. Në koridor ishin vendosur gjithashtu shkallët prej druri që lidhnin dy katet. Platforma mbi hapësirën e shkallëve në katin e dytë ishte trajtuar në formë qoshku. Kompozimi planimetrik i katit të dytë ishte i njëjtë me atë të katit përdhe. Ai përbëhej nga dy ambiente banimi, dhomës së pritjes dhe dhomës së gjumit. Trajtimi dekorativ i ambienteve ishte i ndryshëm. Ai verior kishte trajtim të thjeshtë, i pajisur me dritare të mëdha në dy faqet e jashtme dhe me tavan të rrafshët prej suvaje. Në të mungonin musandrat dhe dollapet e murit. Përkundrazi ambienti i dytë ruante një përpunim më të pasur. Tavani prej suvaje përmbante një rozetë katërfletëshe në plan, të thelluar në formë kubeje. Pjesa qendrore e muraturës ishte e kornizuar me fashatura dërrase, ku përfshihej dhe një dollap në mur me pjesë të gdhendura. (Fig. 10).

Ndryshim vërehej edhe në teknikën e ndërtimit. Pjesa jugore e banesës ishte ndërtuar me gurë të lidhur me baltë dhe breza druri. Pjesa e sipërme e muraturës ishte e ndërtuar me qerpiç. Në ndryshim nga kjo, e gjithë pjesa veriore kishte një ndërtim me skelet druri e mbushur me tulla. Niveli i kësaj pjese ishte më i ulët nga ai i oborrit, gjë që kishte sjellë dëmtime serioze në strukturën e muraturës dhe të dyshemesë.

Punimet e restaurimit. Ndryshimi i qartë i teknikës së ndërtimit dhe i trajtimit të pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe ndarja e të dy pjesëve me një fugë vertikale, e bënte të padyshimtë përcaktimin e dy fazave kryesore të ndërtimit. Fazës së parë i përkiste pjesa veriore, me nga një ambient në çdo kat, ndërsa fazës së dytë pjesa jugore. Mbetej për të sqaruar se çambiente të tjerë kishte faza e parë, përmasat e tyre dhe në se kishim të bënim këtu me një ndërtim të mbyllur apo të hapur.

Konstruksioni i çatisë na dha përgjigjen e parë. Çatia origjinale vazhdonte tej kufirit ndarës të dy fazave, ndërsa shtesa e çatisë për fazën e dytë da-



Fig. 11

11. Banesa ka qënë e patriotit të Rilindjes Kombëtare, Heroit të Popullit, Mihal Grameno.
12. Punimet u kryhen nga Ateljeja e Korçës në vitin 1978-1979 nën drejtimin e autorit.

DO NOT COPY

llohej shumë qartë. Një shtyllë druri me qoshe të gdhendura dhe e kurorëzuar me kapitel gjithashtu të gdhendur, e murosur në murin lindor të fazës së dytë, ishte një dëshmi e qartë, e cila, jo vetëm që përforconte të dhënat e përfituara nga çatia për përcaktimin e përmasave të fazës së parë por ajo nuk linte dyshim se këtu kishim të bënim me një banesë të tipit të hapur.

Sondazhet dhe zhveshjet e mëtejshme saktësuan edhe më tepër mendimin e mësipërm dhe na dhanë material të vlefshëm për rivendosjen e kompozimit dhe të trajtimit arkitektonik e dekorativ fillestar.

Nën kollonën e murosur kalonte një tra ose brez druri në drejtimin gjatësor, me buzën e poshtme të gdhendur, ndërsa në të, trarë tërthorë me funde gjithashtu të gdhendur (Fig. 11). Këto të dhëna tregonin se kollona ndodhej e palëvizur në pozicionin fillestar. Ajo ishte kollonë e ballit të çardakut të hapur, brezi mbante shtyllaren e tij, ndërsa trarët tërthorë ishin trarët e dyshemesë së çardakut. Kllapat në faqen e jashtme të trarëve dëshmonin se balli i çardakut dilte konsol tej rrafshit të hajatit në katin përdhe.

Zhveshjet e suvasë në murin verior të ambientit të fazës së parë nxorrën në dritë dy dritare, prej nga ndriçohej ky ambient dhe që dilnin në çardak. Kasat e dritareve ishin të palëvizura, gjë që e bënte të qartë konstruksionin dhe elementet përbërës të tyre. Ato kishin kanatin prej xhami, kapakun e plotë prej dërrase, ndërsa vrimat e hapura në kasë dëshmonin për praninë e një kafazi mbrojtës prej druri dhe na jepnin mundësi për të përcaktuar diametrin dhe hapin e shufrave.

Gjatë punimeve në çati u gjetën të ripërdorura mjaft binarë me funde të gdhendura, të cilat ishin «makazet» (binarët) e çatisë fillestare, dalja e të cilave formonte radhën e dytë të strehës. Pjesë të radhës së parë ruheshin të paprekura në konstruksionin e çatisë, ndërsa disa fragmente të gdhendur përfaqësonin binarin ndarës të dy radhëve të strehës.



Fig. 12



Fig. 12/1



Fig. 12/2

DO NOT COPY

Fragmente trarësh të murosur ose të ripërdorur bënin të mundur riformulimin e shkallëve si konstruksion dhe pjerrësi. Ato përbëheshin prej dy trarëve të thjeshtë mbajtës, ndërmjet të cilave, të futura në kllapa, ishin vendosur shkelësat prej dërrase. Fragmente të tjera mundësonin riformimin e elementeve të tjerë. Ndër to u gjetën pjesë parmaku të çardakut, pjesë fashaturash, pjesë elementesh të gdhendur që zbukuronin kamaret e musandrave etj.

Duke patur një material të tillë në dispozicion nuk ishte e vështirë rivendosja e saktë e gjendjes fillestare. Një arsye tjetër që na shtyu në një vendim të tillë ishte dhe fakti se faza e dytë e ndërtimit kishte pësuar dëmtime të tilla sa që do të duheshin ndërhyrje mjaft të thella restauruese, praktikisht një rindërtim i saj, gjë që nuk justifikohej me vlerat e këtij ndërtimi të ri. Rivendosja e gjendjes fillestare të fazës së parë u bë duke respektuar në çka ishte e mundur materialin e vjetër, qoftë duke e ripërdorur atë ku ishte e mundur, qoftë duke e kopjuar atë gjatë plotësimeve, por gjithnjë duke lënë të dallohet e reja. Përjashtim bëjnë elementet e humbur plotësisht, si oxhakët e musandrat. Meqënëse banesa ishte e paracaktuar për ekspozim, u vendos që këto elemente të ribëheshin në analogji me banesat e tjera të të njëjtit tip dhe periudhë, për të ruajtur unitetin stilistik të ambienteve dhe karakterin didaktik të tyre (Fig. 12).

Në planin tipologjik banesa bën pjesë në grupin e banesave të hapura. Ajo ka hajatin në katin përdhe dhe çardakun në katin e sipërm (Tab. V). Secila njësi lidhet me një ambient banimi: ai i katit përdhe përdorej si shtëpi zjarri, ndërsa i sipërmi si dhomë ndenje. Përbri tyre ka dy të ndara të vogla si shtojca. Gjurmët e themeleve përreth banesës nga ana jugore e lindore, si dhe të elementeve të tillë, si oxhakë, kamare etj. të ruajtura në një fragment muri në anën lindore, dëshmojnë për praninë e ambienteve të tjerë përngjitur banesës. Por në gjendjen e sotme të të dhënave nuk jemi në gjendje të përcaktojmë në se këto gjurmë i përkisnin banesave të familjeve të tjera, të cilat në Korçë për arsye të ekonomizimit të truallit të ndërtimit banesat i ndërtonin ngjitur me njera tjetrën, apo banesa në studim kishte dhe ambiente të tjerë.

Në planin arkitektonik e dekorativ banesa e vjetër karakterizohet nga trajtimi i pasur i pamjes veriore. Volumet e hapura të hajatit dhe çardakut zbulojnë konstruksionin e tyre prej druri por pa lënë pasdore përpunimin e elementeve në pamje. Kështu bishtat e strehës, kapitelet, kollonat, kokat e trarëve dhe binarët ose trarët mbajtës përmbajnë gdhendje të thjeshta, të cilat u japin këtyre elementeve konstruktivë dhe vlera dekorative. Përkujdesja në trajtimin arkitektonik shfaqet në daljen e lehtë të çardakut mbi hajatin, për të vlerësuar më mirë pjesën e sipërme me trajtim arkitektonik e dekorativ më të pasur (Fig. 12/1). Kujdes i veçantë është treguar dhe në trajtimin e faqes që del në çardak, me brezin qendror karakteristik të qarkuar me fashatura dërrase që përfshin dritaret dhe sipërfaqet e plota të muraturës.

Në kompozimin e interiereve karakteristike janë musandrat si dhe trajtimi i muraturës në të njëjtën mënyrë me atë të faqes së jashtme. Trajtimi i ambientit pasurohet dhe nga punimi dekorativ i tavanit, ndonse këtu ai është i suvatuar.

Në një fazë të mëvonëshme pranë kësaj banese u ngrit një ndërtim i ri, i cili shërbente si shtëpi miqsh ose, siç quhej nga vendasit «mysafirhane». Krijimi i kompleksëve të tilla, të përbëra nga banesa e familjes dhe shtëpia e miqve, ishte një dukuri që u përhap në familjet në gjendje, gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të gjysmës së dytë të shekullit XIX, në lagjen e vjetër të qytetit. Këto familje për të plotësuar kërkesat në rritje të tyre, filluan të ngrenë ndërtime të tilla, zakonisht përpara banesës së familjes dhe me dalje përgjithësisht në rrugë. Mënyra e ndërtimit dhe ambientet e përfshira në të, shprehin më së miri destinacionin dhe nivelin ekonomik të familjes (Tab. VI).

Hyrja për në shtëpinë e miqve bëhet nga rruga dhe përfundon në një korridor të hapur, që shërben për ndërlidhje me banesën e familjes. Në katin përdhe kemi vetëm një ambient banimi, «dimëroren», me dritare të pakta e të vogla. Shkallët prej druri të nxjerrin në një sallon që ndërlidhet me ambientin



Fig. 13

DOKUMENT PDF

DO NOT COPY



Fig. 14

e pritjes, me përmasa të mëdha, që del konsol mbi katin përdhe në anën veriore dhe i paisur me dritare të shumta në anën veriore dhe jugore. (Fig. 12/2).

Banesa Nr. 4 (Rr. Shpresa Palla, Nr. 14). Është pak e futur nga rruga, me pamjen veriore paralel me të. Pamja kryesore e banesës sheh nga perëndimi. Oborri rrethohet me mure të ulët. Në të janë ndërtuar ngrehina të vogla, si ambient sanitar, kuzhina verore, depo etj.

Gjendja para restaurimit (Tab. VII, VIII; Fig. 13). Në vijat e saj themelore banesa ruante kompozimin planimetrik fillestar, me disa ndarje të reja provizore, lehtësisht të dallueshme si shtesa, ndërsa në trajtimin arkitektonik ajo kishte humbur nga zhdukja dhe mbulimi i disa elementeve fillestarë.

Banesa është dykatëshe. Gjatë gjithë ballit të katit përdhe, nga ana perëndimore, shtjellohet hajati i hapur, me kollona druri. Nëpërmjet një të ndare të ngushtë, që shërbente si koridor dhe depo, kalohej në ambientin e vetëm të katit përdhe, që përmbushte funksionet e kuzhinës dhe të dhomës së ndenjes. Ai është shtruar me dysheme dhe i pajisur me tavan të thjeshtë dërrase. Ndriçohet nga tri dritare të mëdha në faqen jugore. Në faqen lindore ishte oxhaku, ndërsa përballë blloku i musandrave, që përmban hambarin me magjen e bukës dhe dollapët.

Në hajat janë vendosur shkallët e thjeshta prej druri të mbështetura mbi dy basamakë prej guri, të cilat nxjerrin në çardakun e katit të dytë. Hapësira e tyre në çardak rrethohet me një parapet të ulët druri. Kati i dytë përbëhej nga dy ambiente banimi dhe një depo e sajuar nga zvogëlimi i sipërfaqes së njerit prej ambienteve.

Çardaku zë vend në një krah të banesës. Ai është i hapur nga veriu dhe perëndimi, ku dalin kollona druri. Një parapet i ulët mbyllte pjesën e hapur. Çardaku ishte i pajisur me dysheme dhe tavan të thjeshtë dërrase. Faqet e mureve që dalin në çardak ishin të kornizuara me fashatura dërrase, të cilat qarkonin dhe portën e hyrjes për në ambientin kryesor, të punuar në formë harku me daltime të thjeshta me motive bimore.

Ambienti kryesor i katit të sipërm ndriçohej nga një dritare e madhe, e hapur në faqen jugore. Oxhaku në faqen lindore ishte i transformuar, ndërsa ruheshin të paprekura kamaret dhe dollapet e hapura në mur, në të dy krahët e oxhakut. Kamaret dhe dollapet qarkoheshin me fashatura dërrase, të cilat vazhdonin në të gjitha faqet e mureve. Tavani prej dërrase, përmbante në pjesën qendrore një rozetë tetëkëndëshe me elementë druri të daltuar me motive bimore, ndërsa në qoshet trekëndësha të thjeshta.

Ambienti i dytë, më i vogël, ngrihej në vazhdim të çardakut, mbi hajat. Ai kishte formë trapezoidale në plan. Ndriçohej nga një dritare të hapur në faqen perëndimore, ndërsa një e dytë dilte në çardak. Dyshemeja ishte e lartësuar në krahasim me atë të çardakut. Trajtimin dekorativ e kishte më të thjeshtë nga ai i ambientit kryesor. Tavani ishte i suvatuar ku ruheshin disa gjurmë të një përpunimi të thjeshtë dekorativ, ndërsa në muret kalonin fashaturat prej dërrase, që kornizonin dhe dritaret.

Teknika e ndërtimit ishte e rëndomtë. Muratura, me gurë të papërpunuar, lidhej me baltë e breza druri. Në ndarjet e brendshme të katit të dytë, madje dhe në muret e jashtme nga ana jugore e perëndimore, ishte përdorur teknika me çatma. Ato formoheshin nga një skelet druri, i mbushur me rripa të hollë dërrase, të mbërthyera me gozhdë kovaçi. Suvatimi realizohej me një shtresë të trashë balte, të punuar me fije kashte, dhe nga një dorë e dytë mjaft e hollë gëlqereje. Çatia ishte ndërtuar me një sistem, që mjeshtrat e quajnë «me ura». Urat shërbenin si breza për të shkurtuar hapësirën e «makaseve» ose binarëve që mbajnë mbulesën. Zgjatimi i trarëve të tavanit dhe i makaseve krijonin strehën e gjerë dyfishe, me dalje rreth 1 m për mbrojtjen e mureve me lidhës të dobët balte dhe ato prej çatmaje.

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16

Punimet e restaurimit.[13] Siç e vumë në dukje më sipër, shtesat dhe ndarjet e reja ishin lehtësisht të dallueshme, kështu që kompozimi planimetrik fillestar, nuk ishte i vështirë të rivendosej. Ai përbëhej në katin përdhe nga hajati i hapur dhe një ambient banimi i paraprirë nga një korridor i ngushtë. Në katin e sipërm përfshiheshin çardaku i hapur, ambienti kryesor me përmasa të mëdha, edhe ky i paraprirë nga një korridor dhe ambienti i dytë i banuar mbi hajat, që del në ballë të banesës (Fig. 14).

Me interes ishin të dhënat që u pëfituan gjatë punimeve të restaurimit, përsa i përket saktësimit të ndarjeve dhe të trajtimit arkitektonik e dekorativ. Gjithashtu nga sondazhet dhe zhveshjet u zbuluan elemente të fshehur ose të mbyllur gjatë meremetimeve të mëvonëshme të banesës.

Në strukturën e tavanit dhe në dyshemenë e ambientit kryesor, ruheshin gjurmët e ndarjes fillestare të murit verior dhe elemente që lejonin të mendohej për ekzistencën në këtë faqe të bllokut të musandrave. Por duke mos patur të dhëna të mjaftueshme, nuk u pa i arësyeshëm rikonstruksioni i këtij elementi kompozicional të interierit të ambientit kryesor.

Zhveshjet në faqen jugore zbuluan gjurmët e



Fig. 17

13. Punimet e restaurimit u kryen nga Ateljeja e Korçës, në vitin 1979-1980 nën drejtimin e autorit.

DO NOT COPY



Fig. 18

qarta të dritareve dhe konstruksionin e tyre. Në gjendjen fillestare kishte tri dritare të mëdha, që përmbanin kanatin e xhamit dhe kapakun e plotë në anën e brendshme. Ato hapeshin duke rëshqitur horizontalisht dhe duke u futur në hapësirën ndërmjet



Fig. 19

dy faqeve të çatmasë. Zhveshjet në faqen perëndimore evidentuan plotësisht kornizimin me fashatura të muraturës dhe zbuluan një dritare, e cila dilte në çardak. Dritarja kishte të njëjtat përmasa, elemente dhe ndërtim si të dritareve në faqen jugore, duke patur më tepër nga ato një kafaz prej druri, të vendosur nga ana e çardakut, elementë të të cilit ruheshin të paprekura. Gjatë kërkimeve u zbuluan dhe pjesë parapeti të ballit dhe të hapësirës së shkallëve, të cilat na lejuan riformulimin e tyre.

Ambienti mbi hajat, ndonëse le të mendohet për një fazë të dytë ndërtimi e cila zvogëlonte sipërfaqen e çardakut, gjatë restaurimit nuk dha ndonjë element që ta mbështeste këtë mendim. Trajtimi i këtij ambienti ishte i njëjtë me atë të ambientit kryesor. Në faqen perëndimore u zbuluan dy dritaret origjinale dhe një tjetër në faqen jugore. Ato kishin të njëjtin ndërtim si dritaret e tjera, si dhe të njëjtin punim dekorativ, të përfshira në brezin qendror të kornizuar. Mënyrë të njëjtë trajtimi kishin dhe pamjet e jashtme perëndimore e jugore me konstruksion çatmaje, ku dritaret, nëpërmjet qarkimit të tyre me fashatura dërrase, krijonin një bllok të vetëm, të alternuar me pjesët e plota të murit (Fig. 15, 16).

Ndryshe nga ambientet e tjerë të pajisur me tavan dërrase, tavani i kësaj kthine ishte me suva. Megjithatë edhe këtu ndjehej një farë përkujdesje për një trajtim dekorativ. Përreth tavanit kalonte një kornizë me qoshe të lakuara, të formuara nga rakordimi i tre harqeve.

Një problem tjetër i restaurimit ishte konsolidimi i strukturave konstruktive të dëmtuara. Në këtë rast u veprua me rindërtimin tërësor të disave prej tyre, duke përdorur materiale dhe teknikë të sotme. Të tillë ishin muri lindor dhe ai verior i katit të dytë si dhe muret ndarës të ambienteve nga korridoret. Ndërsa strukturat në pamje, si pjesë të muraturës në katin përdhe, konstruksioni i çatmave në anën jugore dhe perëndimore, çatia, strehët, tavanet, etj., u konsoliduan ose u plotësuan duke përdorur materiale dhe teknikat tradicionale. Në këto raste u ruajtën ose u ripërdorën maksimumi i mundshëm i elementëve origjinalë, sidomos atyre në të cilat ndjehej më tepër dora e mjeshtrit. Ndër to mund të përmendim kasa dritaresh, fashatura dekorative, korniza, dyer, dollapë, pjesë kafazi, parapeti, tavani, bishta të gdhendur të strehës së çatisë, kollona, kapitele etj. (Fig. 17).

Banesa Nr. 5 (Rr. Spiro Ballkameni, Nr. 5). Arkitektura dhe restaurimi i kësaj banese është bërë objekt i një trajtimi të veçantë[14], kështu që këtu do

14. P. Thomo, **Restaurimi i banesës së «Piktorit të Popullit» Vangjush Mio në Korçë,** Monumentet, 18, 1979, f. 5-28.

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

të japim në mënyrë të përmbledhur disa përfundime kryesore që na interesojnë për problemin në studim. (Tab. IX).

Banesa kishte arritur deri në ditët tona me ndryshime të thella, të cilat ja kishin tjetërsuar pamjen e saj fillestare dhe, nga ana tjetër, ajo vuante nga dëmtime serioze të gjendjes statike (Fig. 18). Punimet e restaurimit të ndërmarra në këtë banesë nxorrën në shesh të dhëna të rëndësishme, të cilat plotësonin dëshmitë gojore dhe ato dokumentare dhe na jepnin mundësi të merrnim vendimin për t'i rikthyer në gjendjen fillestare ato elemente kompozicionale dhe arkitektonike, për të cilat të dhënat e zbuluara ishin më të plota. Njëkohësisht u respektuan fazat kryesore të ndërtimit, të cilat hidhnin dritë mbi ndryshimin e koncepteve ndërtimore në kohë.

Punimet e restaurimit nxorrën në shesh se kishim të bënim me një banesë të hapur, me hajat në katin përdhe dhe me çardak të ngushtë në katin e dytë. Banesa kishte kaluar nëpër tre faza kryesore ndërtimi, pa marrë parasysh ndryshimet dhe meremetimet e kryera pa ndonjë përkujdesje, kryesisht gjatë këtij shekulli, si p.sh. mbyllja e çardakut, dritareve, prishja e erkerit ose qoshkut etj.

Fazës së parë i përket pjesa perëndimore e banesës e përbërë prej ambientit të pritjes me çardakun përpara në katin e dytë, hajatit dhe dhomës së dimrit në katin përdhe dhe qilarit gjysmë të futur në tokë. Gjatë fazës së dytë banesa ka pësuar një rikonstruksion, i cili preku thellësisht trajtimin e ambientit lindor ose «studion» dhe, pjesërisht, dhomën e pritjes. Ky rikonstruksion duhet të lidhet me vitin 1841, datë e zbuluar në dekoracionin e pikturuar të rozetës



Fig. 22

së dhomës së miqve. Fazës së tretë i përket dhoma e ngritur mbi hajat, në krahun verior të banesës, i cili ruan një formulim arkitektonik të ndryshëm nga dy ambientet e tretë.

Skema kompozicionale e dy fazave të para është tipike e banesave me çardak. Dy ambientet e banimit ndërlidhen me çardakun duke nxjerrë në të dyert dhe dritaret. Kompozimi i ambienteve ka si përbërës kryesorë bllokun e musandrave me parahyrjen, oxhakun, kamaret dhe dollapet në mur. Dritaret e shumta, qarkimi dhe kornizimi i mureve me fashatura e korniza dërrase, që përfshijnë dritaret, kamaret, dollapet e musandrat, janë veçoritë e formulimit arkitektonik e dekorativ të interiereve.

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 24



Fig. 25

Në trajtimin arkitektonik të jashtëm theksohet transparenca nëpërmjet çardakut të hapur, leximit të faqeve që dalin në të dhe konstruksionit të zbuluar e të dekoruar. Pamjet e jashtme gjallërohen nga dritaret e shumta dhe erkeri që ri pezull mbi rrugë, ndërsa kontrasti i materialeve të përdorura, alternimi i planeve të plota e të bardha me hapësirat e dritareve, thyerja e tyre me fashaturat prej druri që i qarkon ato, kanë krijuar efekte të ndjeshme dekorative (Fig. 19, 20).

Banesa Nr. 6 (Rr. Mihal Grameno, Nr. 17). Sipas një mbishkrimi në mur, ndërtimi i banesës i përket vitit 1842. Banesa ka një kompozim dhe trajtim të veçantë nga banesat e mësipërme, por megjithatë përmban elemente të tillë që na lejojnë ta grupojmë së bashku me banesat e hapura.

Banesa është mjaft e futur nga rruga, me një oborr të gjerë përpara. Në një kohë më të vonë, nga fundi i shekullit XIX, pranë saj u ndërtua një ndërtesë



Fig. 26

e lartë trekatëshe, e cila përdorej si shtëpi pritjeje ose «mysafirhane». Në këtë periudhë kjo familje kishte arritur një fuqizim të konsiderueshëm ekonomik, sa që mund t'i lejonte vetes një ndërtim të tillë kaq të kushtueshëm dhe të ndryshëm nga modelet e ndërtuara në qytet për këtë qëllim. Pikërisht nëpërmjet katit të poshtëm të hapur të kësaj ndërtese hyhet në oborrin e banesës.

Banesa e vjetër e familjes është dykatëshe me një shtrirje të madhe planimetrike (Tab. X; Fig. 21, 22). Hyrja qendrore në katin përdhe është theksuar nga një arkadë me tre harqe, e cila kufizon një portik të vogël e të futur. Më tej, nëpërmjet një porte të madhe të harkuar kalohet në sallonin qendror, ku dalin dyert e ambienteve që ndërlidh. Në katin përdhe përfshihen katër ambiente, dy prej të cilave përdoreshin për banim dhe dalin në ballë të ndërtesës, ndërsa dy të tjerat në pjesën e mbrapme kanë qënë përdorur si katoje e depo.

Ambienti i majtë ruhej në gjendje të mirë. Ai është i shtruar me dysheme dhe i pajisur me tavan dërrase. Anash derës janë ndërtuar dollapë, në formë musandrash, ndërsa në murin perëndimor dalin tri dritare të mëdha, që shohin në oborr. Përballë portës dikur ishte oxhaku, ndërsa në mure ishin hapur kamare e dollapë. Prania e një sqolli në një kënd të dhomës si dhe pajisja e saj, lenë të mendohet se ky ambient ka shërbyer si dhomë ndenjie dhe gatimi.

Ambienti i dytë në krahun tjetër ka pësuar ndryshime. Ai ka përmasa më të vogla, ndërsa në hapësirën e tij është veçuar një korridor i ngushtë, për hyrjen e re të banesës së hapur në murin jugor.

Dy ambientet e mbrapme, katojtë, janë me përmasa të mëdha, pa tavan dhe me dysheme më të ulët nga ai i korridorit. Ato kanë qënë përdorur për depozitimin e ushqimeve (zahireve), për gatitjen e tyre, depozitimin e druve etj.

Hyrja për në katin e dytë është zgjidhur në mënyrë të veçantë. Shkallët prej druri, të vendosura në

portikun e ngushtë të hyrjes, dalin në sallonin qendror të katit të dytë. Një zgjidhje e tillë e shkallëve nuk përshtatet me formulimin disi monumental të hyrjes në katin përdhe.

Skema planimetrike e katit të dytë përsërit atë të katit përdhe, por me funksione të tjera dhe me trajtim arkitektonik e dekorativ më të pasur. Të katër ambientet e katit shërbenin për banim. Edhe këtu në anën jugore është hapur një hyrje e re nga jashtë dhe është sajuar një korridor i ngushtë në dëm të sipërfaqes së ambientit të banimit. Salloni qendror përbëhet prej dy pjesëve. Pjesa e parë ndërlidh ambientet, aty dalin dhe shkallë nga kati i poshtëm. E shkëputur nga kjo nëpërmjet trajtimit dhe disnivelit (Fig. 23), ngrihet pjesa e dytë, e pastër nga rrymat e kalimit, e cila vazhdon tej mureve perimetrale dhe del konsol, në formë qoshku, mbi portikun e hyrjes.

Ndryshimet e pësuara në kohë dhe punimet e restaurimit[15]. Përveç hapjes të hyrjeve të reja në anën jugore, banesa kishte pësuar ndryshime të tjera, të cilat ja kishin tjetërsuar pamjen fillestare. Një nga ndryshimet më të rëndësishme ishte mbyllja e çardakut dhe kthimi i tij në një qoshk të mbyllur ose erker, i paisur me dritare të mëdha. Punimet gjatë restaurimit nxorrën në dritë formën dhe konstruksionin fillestar të ballit të qoshkut. Materiali dhe teknika e çatmasë së kësaj pjese ndryshonte nga ajo e pjesëve të tjera, ku është zbatuar konstruksioni i çatmasë. Po kështu ndryshonin dhe dritaret, qoftë në konstruksion ashtu edhe në përpunim. Konstruksioni i ri i çatmasë kishte fshehur elemente të çardakut që dilnin në pamje. Këto ishin kollonat e ballit, të cilat ruanin të njëjtin hap dhe përpunim me atë të ndarjes së dy njësive të sallonit qendror, si dhe parapeti mbrojtës ndërmjet kollonave (Fig. 24).

Kollonat e vjetra të zbuluara ishin me qoshe të gdhendura, të kurorëzuara me jastëkë, gjithashtu të gdhendur. Parapeti mbrojtës ishte i ulët dhe i plotë, i përbërë prej një dërrase të kornizuar me fashatura të gjera, të përpunuara. Gjatë mbylljes së çardakut elementet e parapetit ishin goditur me sqepar, për ta bërë të mundur qëndrimin e suvatimit (Fig. 25).

Ndryshime me rëndësi ka pësuar banesa me rastin e ndonjë meremetimi të përgjithshëm edhe në strukturën planimetrike e konstruktive. Muri verior është rindërtuar, duke zhdukur me këtë rast oxhakët e vjetër në dy ambientet ballorë të këtij krahu. Ndërsa prishja e murit jugor tjetërsoi kompozimin planimetrik, mbasi rindërtimi i tij nuk u krye në vendin e përparshëm, duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme



Fig. 27



Fig. 28



Fig. 29

DO NOT COPY

15. Punimet e restaurimit u kryen nga Ateljeja e Korçës, në vitin 1979-1980 nën drejtimin e autorit.



Fig. 30

sipërfaqen e ambienteve të këtij krahu (Fig. 26). Për shtrirjen fillestare në plan të banesës na dëshmojnë dy elemente të zbuluar. Së pari brezi i muraturës së ballit është lënë i paprekur gjatë rikonstruksionit dhe del tej konturit të banesës. Së dyti, në bashkimin e çatmasë së ballit me murin jugor u gjet e paprekur një kasë dritareje, që dëshmonte se ambienti jugor ka patur tri dritare në pamjen kryesore dhe jo dy, siç ishte në gjendjen ekzistuese (Fig. 27).

Ndryshimet e tjera në kohë të banesës nuk patën atë shtrirje dhe ndikim në zgjidhjen e përgjithshme të banesës. Ato kishin të bënin me disa ndarje të lehta të ambienteve të katit të dytë për të krijuar anekse e musandra, me zvogëlimin dhe mbylljen e dritareve të ambientit ballor jugor, me hapjen e dritareve të reja në faqen jugore mbas rikonstruksionit të kësaj pjese, me hapjen e hyrjeve të reja në anën jugore, me mbylljen e portikut të hyrjes në katin përdhe (Fig. 28), me prishjen të një pjese të mirë të strehës dyfishe të çatisë etj.

Mbas vjeljes së këtij materiali faktik mbi ndryshimet që kishte pësuar banesa në kohë nuk ishte e vështirë të rivendosej gjendja fillestare. Por punimet e restaurimit prekën vetëm ato pjesë, ku të dhënat ishin më të plota e më të sigurta, duke rivendosur gjendjen fillestare me anë të çlirimit nga shtesat e mëvonëshme dhe të plotësimit të elementeve pjesërisht të humbur. Njëkohësisht u bë konsolidimi dhe ripërtëritja e elementeve në gjendje të keqe statike (Tab. XI).

Kështu në grupin e parë të ndërhyrjeve, në ato të çlirimit nga shtesat e mëvonëshme, u ndërmorrën këto punime: u hoqën ndarjet e mëvonëshme të ambienteve, si ato që kishin shërbyer për ndarjen e ambienteve për anekse dhe korridore, perden që ndan të dy njësitë e çardakut të katit të dytë, muraturën që mbyllte arkadën e katit përdhe, u hapën dritaret e mbyllura në ambientin ballor të anës jugore, si dhe u çlirua balli i çardakut nga mbyllja e mëvonëshme. Rivendosja e strukturës planimetrike fillestare në anën jugore, megjithëse ekzistonin të gjitha të dhënat, në këtë fazë të restaurimit nuk u pa e arsyeshme të bëhej.

Në procesin e plotësimit të pjesëve munguese u përqëndrua në plotësimin e strehës dyfishe për të gjithë ballin e banesës, në rivendosjen e shkallëve që ndërlidhnin dy njësitë e çardakut, sipas gjurmëve të ruajtura në dysheme, në pajisjen me dritare të ambientit ballor jugor.

Punimet e konsolidimit dhe ripërtëritjes përfshinë fragmente muresh, çatinë, dyshemetë e tavanet, suvatimet, elementet e drurit të degraduar, si fashatura, parapeti i çardakut, dritare etj. Gjatë këtyre punimeve u orvat të ruhej maksimumi i mundshëm i elementëve të vjetër. Gjithashtu disa elemente në pamje, si suvatimi i ballit, dritaret, strehët, kornizat etj., u riformuluan sipas materialit dhe teknikës tradicionale.

Mbas studimit dhe restaurimit të banesës mund të vlerësohet më mirë pamja fillestare e saj. Banesa shquhet për një karakter të qartë simetrik të kompozimit si në plan, ashtu dhe në hapësirë (Fig. 29). Në qendër të kompozimit janë vendosur sallonet, të cilët ndërlidhnin ambientet në të dy katet: dy ambiente ballorë anash dhe dy të tjerë radhazi, mbrapa tyre. Në pamjen kryesore perëndimore theksimi kompozicional bëhet në pjesën qendrore. Në katin përdhe realizohet nëpërmjet portikut të përpunuar në formë harkade treshe, me harkun qendror më të lartë e më të gjerë, ndërsa në katin e sipërm nga dalja përpara e çardakut dhe përpunimi i tij. Karakteri i hapur i pjesës qendrore në katin e sipërm nuk kontraston shumë me dy planet që e kufizojnë atë. Ato janë të ndërtuara me konstruksion çatmaje, të suvatuara rrafshët dhe të hapura nga dritare të mëdha. Kornizimi i dritareve me fashatura dërrase ndihmon në njësimin e ballit të katit dhe i japin atij një karakter të lehtë e të pasur. Në të kundërt një karakter më masiv e më monumental ka kati përdhe, me dritare

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 31

më të vogla, i ndërtuar tërësisht me gurë, me sipërfaqe të ashpër që formohet nga mbyllja e fugave me llaç dhe lënia në pamje të sipërfaqeve të gurëve. Këto dy trajtime të ndryshme arkitektonike e dekorative shkëputen qartazi nga një kornizë dërrase, e cila bën që çdo plan të vlerësohet më vehte.

Një skemë e tillë planimetrike na kujton variantet e banesave me çardak në qendër, të përhapur në qendrat e tjera të vendit[16], me ndryshim që në këtë banesë çardaku qendror shkëputet dhe del tej rrafshit të dy krahëve të plotë. Por megjithëse banesa ruan ende skemën kompozicionale të banesave me çardak, si dhe shumë elemente arkitektonikë e dekorativë të tyre, këtu fillojnë të ndjehen mjaft të forta prirjet për përpunime dhe krijime mënyrash të reja shprehjeje. Ndër trajtimet tradicionale mund të përmendim ruajtjen e teknikës së ndërtimit dhe, sidomos ruajtjen e karakterit të zhveshur të konstruksionit. Kështu streha mbetet e hapur, zbulon konstruksionin e saj dhe, si e tillë, ajo shquan për përkujdesje edhe në trajtimin dekorativ: elementet e saj përbërës janë të gdhendur. Të njëjtin përpunim kanë dhe strukturat mbajtëse të ballit të çardakut, në kollonat e kapitelet dhe të konsolit të tij, të formuar nga mbivendosja e shkallëzuar e dy rradhë trarëve me funde të gdhendur (Fig. 30).

Ndërsa në elementet e mësipërm ndjehen ende të forta trajtimi i trashëguar, elementët e tjerë shkëputen nga trajtimi tradicional. Mbyllja e hajatit në katin përdhe është fillimi i një procesi, i cili do të vazhdojë më tej dhe do të prekë më vonë edhe çardakun e katit të sipërm. Dekoracioni në dru, në musandrat, dyert, tavanet, dollapet e murit, ndonëse edhe në shembujt e mësipërm ishte i pangarkuar, këtu është mjaft i thjeshtëzuar. Edhe në trajtimin e pamjes së jashtme, në konstruksionin dhe përpunimin e dritareve futen koncepte të reja. Ideja e qarkimit me dru të sipërfaqeve, këtu përçohet në sipërfaqe më të mëdha. Ato përfshijnë gjithë sipërfaqen e muraturës me konstruksion çatmaje, nga streha



Fig. 32



Fig. 33

16. E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet Nr. 4, 1972; **Banesa popullore në disa qendra të Shqipërisë së Mesme,** Monumentet 5-6, 1973; **Banesa popullore në qytetin muze të Beratit,** Monumentet Nr. 21, 1981.

DO NOT COPY



Fig. 34



Fig. 36



Fig. 35

deri në kontaktin me muraturën e gurtë të katit përdhe dhe nga shpatullat e gurta të mureve anësore, deri në pjesën qendrore të hapur. Brenda këtyre sipërfaqeve dritaret nuk formojnë më një bllok të vetëm, por shkëputen nga njera tjetra, duke patur secila përpunim më vete. Ato qarkohen me korniza dërrase, nga të cilat ajo e kreut është më e gjerë dhe përfundon me një kornizë të dalë. Si konstruksion dritaret bëhen dy pjesëshe, me rëshqitje vertikale.

Së fundi skema simetrike kompozicionale, theksimi i pjesës qendrore, dalja konsol e qoshkut në katin e sipërm dhe karakteri monumental i hyrjes, janë të reja të rëndësishme që hyjnë në konceptimin arkitektonik të banesës.

Banesa Nr. 7 (Rr. Pjetër Bogdani Nr. 9). Ruhet e fragmentuar nga që ndërtimi pranë saj i një banese në vitin 1883 ka prishur një pjesë të saj. Megjithatë pjesa e mbetur është e mjaftueshme për të gjykuar mbi pamjen fillestare të banesës (Tab. XII; Fig. 31).

Banesa duhet të jetë ndërtuar në dhjetëvjeçarët e parë të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Ajo është dykatëshe dhe del me një faqe në rrugë. Muratura e katit përdhe vazhdon nga ana perëndimore, duke formuar kështu murin e rrethimit të oborrit të vogël përpara banesës, në anën veriore. Gjatë gjithë gjatësisë së katit përdhe hapet në oborr hajati, i cili paraprin ambientet e banimit. Nga ata ka mbetur në gjendjen fillestare vetëm një. Ai ndriçohet nga dy dritare që dalin në hajat, është i paisur me musandra dhe oxhak në faqen perëndimore. Ky ambient ka shërbyer si dhomë dimri, për qëndrim e gatim. Ekzistenca e nikeve dhe kamareve të oxhakut në muret e

DO NOT COPY



Fig. 37



Fig. 38

ambientit të dytë të cunguar dëshmojnë se dhe ky përdorej për banim. Në një pjesë të katit përdhe shtrihet bodrumi, me hyrje nëpërmjet një qepeni të hapur në dyshemenë e hajatit.

Hyrja për në katin e dytë bëhet me shkallë të jashtme druri, që përfundojnë në një çardak të hapur. Ndryshe nga hajati, çardaku nuk shkon gjatë gjithë ballit të katit, por ze vend në një krah të tij. Ai ndërpritet nga një ambient i vogël i cili shkëputet dhe del konsol në dy anë, duke krijuar një të ndarë të vogël në formë qoshku. Ai është i pajisur me dritare të shumta që shohin në oborr dhe në rrugë, fundet e të cilave janë të mbrojtura me parmakë druri. Poshtë dritareve, përqark mureve kalon një platformë e ngritur, që shërbente për ndenje.

Çardaku ndërlidhet dhe me ambiente të tjerë, nga të cilët ashtu si dhe në katin përdhe, njeri ruhet në gjendjen fillestare ndërsa i dyti i zvogëluar.

Karakterin e zhveshur të konstruksionit, tipik për banesat e hapura të mësipërme, këtu shohim të ruhet vetëm në kolonadën e hajatit (Fig. 32). Shtyllat prej druri, kurorëzohen me kapitele druri të gdhendura. Ky karakter ka humbur plotësisht në katin e sipërm. Konstruksioni është fshehur nga një strukturë çatmaje e suvatuar. Kështu kollona e çardakut është e veshur me dërrasa, e zënë në pjesën e poshtme nga parapeti i mbyllur, ndërsa sipër kurorëzohet nga një arkadë e punuar me teknikën e çatmasë (Fig. 33). Me një teknikë të tillë janë përpunuar streha e çatisë dhe konsoli i qoshkut. Muratura e lehtë me konstruksion çatmaje e qoshkut kornizohet me fashatura dërrase, që përfshin brenda tyre dritaret, të përpunuara si njësi më vete. Linjat e drejta e natyrale të konstruksionit të zhveshur të shembujve të mësipërm, këtu zëvendësohen me linja të kurbëzuara me profile të shumëllojshme, si rezultat i një teknike që lejonte të shprehej më lirshëm fantazia dhe shija e mjeshtrit. Në këtë banesë shkoi gjithashtu më tej thjeshtimi i trajtimit të brendësisë së ambienteve, duke mos përdorur asnjë element druri për këtë qëllim.

Punimet e restaurimit[17]. Në gjendjen ekzistuese banesa i ruante të gjitha elementet fillestarë, por mjaft të degraduar. Strukturat mbajtëse ishin dëmtuar duke sjellë deformime dhe inklinime të konsiderueshme të gjithë banesës (Fig. 34). Kështu që problemi kryesor i restaurimit përqëndrohej në konsolidimin e qëndrueshmërisë statike të banesës. Për këtë qëllim mbasi banesa u çlirua nga pesha e çatisë dhe e lidhjeve të tjera, me anë të krikove u ngrit struktura e çatmasë së katit të dytë dhe konstruksioni mbajtës i hajatit, duke eleminuar cedimin vertikal. Në të njëjtën kohë me anë të tërheqjes me tirante horizontale, strukturat u sollën në vertikalitet, duke eleminuar sa të ishte e mundur mënjanimet e tyre. Mbasi banesa u fiksua në pozicionin e saj fillestar, filloi procesi i dytë i restaurimit, ripërtëritja e elementeve të degraduar statikë dhe arkitektoniko-dekorativë. Zëvendësimi i elementeve u bë i pjesshëm dhe i shkallëzuar. Një mënyrë e tillë veprimi jepte mundësinë e një qëndrimi sa më besnik konstruksionit dhe formave fillestare, meqënëse nga e

17. Punimet e restaurimit u kryen nga Ateljeja e Korçës, në vitin 1976, nën drejtimin e autorit.

DO NOT COPY



Fig. 39

vjetra diçka mbetej dhe se në çdo moment mbahej parasysh modeli origjinal ende i paprekur (Fig. 35, 36, 37).

Banesa Nr. 8 (Rr. Vasil Trebicka, Nr. 12). Pasqyron ndryshimet e ndodhura gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX në banesat e hapura. Gjatë kësaj periudhe të rëndësishme për historinë e zhvillimit të banesës në qytetin e Korçës vihet re një proces i vrullshëm rikonstruksioni të banesave të vjetra, që konsiston kryesisht në mbylljen e njësive të hapura dhe në ndryshimet e trajtimit arkitektonik e dekorativ të tyre. Por, në fillimet e kësaj periudhe, edhe banesat e reja me çardak të mbyllur nuk mundën të tjetërsonin kompozimin planimetrik të trashëguar nga banesat e hapura.

Banesa e sjellë për ilustrim përfaqëson një nga shembujt e thjeshtë kompozicionalë, që përsëritnin skemën e vjetër (Tab. XIII). Ajo ka dalje të drejtpërdrejtë në rrugë, linja e kurbëzuar e së cilës ka kushtëzuar dhe një planimetri të çrregullt të banesës. Banesa ka një kat të banuar dhe qilarët gjysëm të futur në tokë. Hyrja nga rruga përfundon në një korridor të ngushtë, i cili lidhet me çardakun e mbyllur të katit. Gjatë çardakut janë rreshtuar dy ambiente banimi, të cilat nxjerrin në çardak dyert dhe dritaret e tyre. Ambientet kanë përmasa të vogla dhe pajisje të thjeshtë. Një trajtim më të kujdesshëm ka faqja e jashtme e murit ndarës të ambienteve me çardakun. Dyert e dritaret që dalin në çardak janë përpunuar me korniza dërrase dhe të pajisura me skara mbrojtëse metalike, në mënyrë të njëjtë me ato të pamjeve të jashtme, ose të faqeve që dalin në çardakët e hapur.

Në këtë banesë çardaku është i mbyllur me mur të trashë guri, ku janë hapur tri dritare, të vogla, të cilat nuk e ngopin me dritë çardakun dhe, nëpërmjet tij, ambientet e banimit. Trajtimi i pamjes së jashtme të banesës është mjaft i varfër dhe jo i zakonshëm, për banesat e Korçës me dalje në rrugë. Siç duket kjo pamje do të jetë si rezultat i ndonjë meremetimi të mëvonëshëm.

Banesa Nr. 9 (Rr. Llazo Jorganxhi, Nr. 1). Në këtë shembull banesat e reja me çardak të mbyllur kanë arritur një trajtim arkitektonik më të pasur[18]. Kompozimi planimetrik fillestar i saj të kujton ato të banesave të hapura (Tab. XIV). Në katin përdhe hyhej në hajatin pjesërisht të hapur, i cili ndërlidhte ambientet e banimit. Në të ishin vendosur shkallët e thjeshta prej druri që të nxirrnin në çardakun e mbyllur të katit të dytë. Gjatë çardakut reshtoheshin dy ambiente banimi, që merrnin dritë nëpërmjet çardakut. Balli i çardakut është i mbyllur me konstruksion çatmaje, duke lënë në të një numër të madh dritaresh (Fig. 38). Trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme është arritur nëpërmjet gjallërimit të tyre me dritare, përpunimit të tyre si dhe të gjithë sipërfaqes së katit të sipërm me anë të kornizave me fashatura dërrase.

Banesa Nr. 10 (Rr. Fan S. Noli, Nr. 11). Paraqet një nga shembujt më të zhvilluar të banesave me çardak të mbyllur. Kompozimi planimetrik i saj është i ngjashëm me skemën e njohur të banesave me çardak në një krah (Tab. XV; Fig. 39).

Hyrja kryesore e banesës në katin përdhe përfundon në një hajat të mbyllur me përmasa të mëdha. Në të dy krahët e tij janë vendosur tre ambientet, nga të cilët dy përdoren për banim dhe i treti si qilar. Ambienti perëndimor, i cili del përpara në pamjen kryesore veriore, ngrihet në një nivel më të

18. Banesa është restauruar nga Ateljeja e Korçës në vitin 1973 sipas projektit të B. Strazimirit. Meqënëse banesa ndodhej brenda Zonës Muze të qytetit dhe konsiderohet si monument i kategorisë së dytë, në të janë bërë ndryshime në strukturën e brendshme për t'ia përshtatur nevojave të sotme të banimit, duke lënë të paprekur formulimin arkitektonik të jashtëm.

DOKUMENT

lartë, për të krijuar mundësinë e ndërtimit të një qilari poshtë tij. Qilari tjetër është i thelluar në tokë dhe ka fituar lartësi të madhe, gjë që ka bërë të mundur ndarjen e tij në dy nivele. Ambientet e banimit kanë trajtim të thjeshtë. Ato janë të pajisura me dysheme dërrase, tavan, oxhak dhe me bllokun e musandrave. Hajati është i shtruar me pllloça guri dhe pa tavan. Në të janë vendosur shkallët e drurit mbi disa këmbë shkallë guri, që përfundojnë në çardakun e mbyllur të katit të dytë.

Skema planimetrike e katit të dytë përsërit atë të katit përdhe. Gjatë çardakut reshtohen dy ambiente banimi, njeri prej të cilëve nxjerr dritaret në çardak, ndërsa përbri tij, në krahun e djathtë të banesës, është vendosur ambienti i tretë. Trajtimi i brendësive të ambienteve mbetet i thjeshtë. Në dhomën e miqve, në krahun e djathtë të banesës, poshtë dritareve kalon një podium i ngritur që shërbente për ndenje. Ai ndriçohet bollshëm nga dritare të shumta që zenë të gjithë faqen veriore dhe perëndimore. Trajtim të pasur ka dhe çardaku, i cili arrihet nëpërmjet gjallërimit të tij me dritare të shumta dhe përpunimit, si të atyre që dalin në faqen e jashtme, ashtu dhe të dyerve e dritareve të ambienteve që dalin në çardak.

Në trajtimin arkitektonik të jashtëm një kujdes më i madh është treguar në pamjen kryesore, të orientuar nga veriu. Muratura e gurtë e katit përdhe dhe shpatullat e mureve anësore, kufizojnë një sipërfaqe të gjerë e të rrafshët me konstruksion çatmaje të suvatuar, e hapur nga një numër i madh dritaresh. Streha e gjerë e çatisë formohet prej pjesës së poshtme të lakuar, të realizuar me teknikën e çatmasë së suvatuar dhe pjesës së sipërme të drejtë, të veshur me dërrasa. Ndonëse me më pak elemente përkujdesja nuk ka munguar dhe në trajtimin e katit përdhe. Ajo shfaqet në punimin e pastër të muraturës, në fugatimin e saj të lehtë dhe, mbi të gjitha, në përpunimin e portës dhe dritareve. Ato kanë shpatulla guri të latuar, ndërsa si arkitra elemente druri të gdhendura. Në pamjet e tjera ndonëse më të thjeshta e më të varfëra, ndjehen përpjekjet për një punë të pastër e të kujdesshme.

Mbi disa kritere të përdorura në restaurimin e banesave të hapura. Për restaurimin e banesave të këtij tipi vinë në konsideratë disa faktorë: **së pari,** gjendja e tyre e degraduar, **së dyti,** shtesat dhe transformimet që kanë pësuar në kohë dhe, **së treti,** numri i pakët i ekzemplarëve të ruajtur deri në ditët tona. Në varësi të intensitetit të veprimit të faktorëve të mësipërm është bërë dhe ndërhyrja restauruese. Në qoftë se do t'i gruponim ndërhyrjet sipas karakterit të tyre, do të kishim punime ku mbizotëronte: a) rivendosja e qëndrueshmërisë statike, b) çlirimi i pjesshëm nga shtesat e mëvonëshme, c) rivendosja e gjendjes fillestare me ndërhyrje më të thella çlirimi. Për probleme të veçanta, si plotësimi i pjesëve munguese, ripërtëritja e elementeve të degraduar, etj. që u hasën në tre grupet e mësipërm u përdorën kritere të njëjta.

Në grupin e parë mund të përmendim punimet që u kryen në banesën nr. 2, 7 dhe, në pjesën më të madhe, në banesën nr. 4. Në rastin e banesës nr. 2 kishim të bënim me një monument, i cili ndonëse i fragmentuar, ruante të paprekur elemente fillestarë në kompozim dhe trajtim, duke qënë në këtë mënyrë një përfaqësues mjaft autentik i banesave të hapura në Korçë. Duke i evidentuar këto elemente kryesisht me anë të pastrimit të tyre, duke plotësuar ndonjë fragment të pakët mungues dhe duke ripërtërirë ndonjë tjetër të degraduar, u arrit të ruhej ky monument i rëndësishëm sa më pranë gjendjes së tij ekzistuese, duke u kthyer në një pikë të sigurtë referimi për shembujt e tjerë.

Një ndërhyrje e tillë nuk mund të kryhej në banesën nr. 7 për vetë gjendjen mjaft të degraduar të saj. Por ndërhyrja në të bëhej e domosdoshme për të shpëtuar dhe dokumentuar një fazë të rëndësishme të zhvillimit të banesave të hapura. Për ta realizuar këtë në fillim u veprua për eleminimin e cedimeve dhe mënjanimeve të konstruksionit, për fiksimin dhe konsolidimin e tij në gjendjen fillestare pa e prishur atë. Pas kësaj u kalua në zëvendësimin dhe ripërtëritjen e pjesëve të dëmtuara, duke patur parasysh ruajtjen në maksimum të elementeve të vjetër.

Banesa nr. 4, përveç vlerave në rrafshin tipologjik, barte në vetvete dhe vlera arkitektonike e dekorative. Pikërisht këto kërkonin nga restaurimi konsolidimin statik të konstruksionit nga njera anë dhe nga ana tjetër rikthimin e këtyre vlerave të humbura. Për këtë qëllim bëhej e nevojshme rivendosja e elementeve të fshehur ose të zhdukur nga meremetimet pa kriter të mëvonëshme. Këtu hynin kryesisht hapja e dritareve origjinale dhe plotësimi i elementeve të trajtimit dekorativ, për të cilat gjurmët, përmasat dhe modelet ekzistuese ishin mjaft të qarta.

Nga kjo pikëpamje ndërhyrjet në këtë banesë, si dhe në banesën nr. 6, i përkasin grupit të dytë të ndërhyrjeve pjesore çliruese. Në banesën nr. 6, përveç shtesave dhe ndarjeve të mëvonëshme, me rëndësi ishte mbyllja e çardakut dhe kthimi i tij në një qoshk të mbyllur, duke ja tjetërsuar pamjen fillestare banesës. Para dy zgjidhjeve: të ruhej gjendja ekzistuese, që shprehte një kontribut të fazave të mëvonëshme, apo të nxirej në pah gjendja fillestare, si shembull i vetëm i një varianti dhe faze të veçantë të zhvillimit, jo më i një banese, por i një tipi të caktuar banese në Korçë, zgjodhëm këtë të fun-

dit. Ruajtja e elementeve fillestarë brenda veshjes së mëvonëshme e bënte më të lehtë zbatimin e një vendimi të tillë.

Dy banesat e tjera të restauruara, banesat nr. 3 dhe 5, kishin arritur në ditët tona në gjendje mjaft të transformuar. Ndryshimet që ishin kryer, sidomos në banesën nr. 5, nuk dalloheshin nga ndonjë koncept i qartë arkitektonik, duke e çvleftësuar plotësisht atë. Studimi i imtësishëm i banesës dhe i materialit të zbuluar, si dhe sasia e mjaftueshme e këtij materiali, mundësonin rikthimin e vlerave të humbura, duke respektuar njëkohësisht tre fazat kryesore të ndërtimit, të cilat dokumentonin rrugën e zhvillimit dhe përpunimit të mëtejshëm të koncepteve arkitektonike e dekorative.

Restaurimi i gjendjes fillestare të banesës nr. 3 ishte i shtyrë edhe nga dy arësye të tjera: nga gjendja mjaft e dëmtuar e shtesës së re dhe nga vlera e dyshimtë arkitektonike e saj. Rivendosja e qëndrueshmërisë statike të kësaj pjese do të kërkonte ndërhyrje të thella, të cilat nuk përligjeshin nga vlerat që ajo përmbante. Nga ana tjetër heqja e saj do të nxirrte në dukje pamjen fillestare të banesës dhe do të shtonte në këtë mënyrë fondin e banesave të hapura, ende mjaft i pakët në qytetin e Korçës.

Në të tre grupet e ndërhyrjeve kriteret për mjaft procese restaurimi ishin të njëjta. Kështu p.sh. për ripërtëritjen e elementeve të dëmtuara të konstruksionit dhe plotësimin e pjesëve munguese arkitektonikë e dekorativë u veprua në mënyrë të diferencuar, duke i dhënë rëndësi edhe ruajtjes së unitetit stilistik dhe krijimit të një aspekti arkitektonik të kohës së ndërtimit. Në pjesët e fshehura si themele, muraturë, dysheme, pjesërisht në konstruksione me skelet dhe çati, etj. u përdorën materiale dhe teknika të kohës së sotme. Ndryshonte puna me elementet në pamje si disa suvatime, fugatime, pjesë murature etj. të cilat u ripërtërinë me materiale e teknika tradicionale. Në të njëjtën mënyrë u veprua dhe me plotësimin e pjesëve munguese, si strehë, kollona, kapitele, parmakë, fashatura e korniza, dritare etj. Në këtë rast vetë materiali i ri i përdorur, për një sy të kujdesshëm do të dëshmonte për restaurimin.

Në mjaft raste kur të dhënat për rikonstruksionin e elementeve të zhdukur ishin të pamjaftueshëm, u parapëlqye lënia e tyre në gjendjen ekzistuese ose mosplotësimi i tyre. Të tillë elemente ishin vatrat, oxhakët, dollapët, musandrat, shkallët, kompozimet fillestare etj., të cilët e analizuan gjatë analizës së shembujve të veçantë. Përjashtim nga ky rregull bën banesa nr. 3 ku, për arësye të vizitueshmërisë, u riformuluan disa elemente si oxhakë e musandra, në analogji me elementet e banesave të tjera të së njëjtës periudhë e tip.

Karakteri i përgjithshëm i banesave të hapura dhe ndryshimet e tyre. Analiza e shembujve më tipikë të banesave të hapura në qytetin e Korçës dhe rivlerësimi i disa prej tyre mbas punimeve të restaurimit, bëjnë të mundur karakterizimin e tyre të përgjithshëm. Këtë gjë e lehtëson gjithashtu dhe fakti se shembujt e ruajtur përfshihen në një periudhë kohe të kufizuar që kap disa dhjetëvjeçarë, gjatë së cilës është arritur një tipizim i theksuar si në zgjidhjen kompozicionale ashtu dhe në trajtimin arkitektonik, dekorativ e konstruktiv. Megjithatë edhe gjatë kësaj periudhe të ngushtë kohore vihet re një zhvillim me prirje për kërkim të formave të reja shprehëse, për të arritur në mënyrë të natyrshme në mbylljen e njësive të hapura.

Banesat e hapura të Korçës zakonisht rrethohen nga një oborr i vogël. Ndërtimi i ngjeshur dhe shpesh i përngjitur në lagjen e vjetër të qytetit ku takohen këto banesa, ekonomizimi i truallit të ndërtimit, kanë bërë që orientimi i banesës të mos jetë i zgjedhur, por në disa raste i detyruar. Kështu përveç orientimit të tremeve të hapura nga jugu e perëndimi, gjejmë banesa të orientuara me këto njësi drejt veriut, orientim ky i pazakontë për banesat e këtij tipi.

Banesat e hapura të Korçës dallohen nga një skemë përgjithësisht e thjeshtë kompozicionale. Zakonisht ato janë dykatëshe, me një ose dy ambiente të rrjeshtuara gjatë tremeve të hapura në të dy katet. Sipërfaqet e njësive të hapura janë të kufizuara. Ato lozin më tepër rolin e ndërlidhjes së kateve dhe ambienteve dhe të një farë mbrojtjeje për këta të fundit, se sa si sipërfaqe të mirëfillta qëndrimi e pune. Vendosja më e zakontë e tremeve është gjatë gjithë ballit të banesës. Por ndonëse me një repertor të kufizuar, takohen variante të ndryshme të banesave të hapura, si ato me çardak në një krah dhe me çardak në qendër. Gjithashtu për nga thjeshtësia e skemës kompozicionale ato variojnë nga banesa me nga një ambient banimi në kat, në banesa me katër të tillë.

Këto variacione të kompozimit planimetrik, përveç treguesit të shtresëzimit shoqëror të popullsisë, janë gjithashtu dhe tregues të një zhvillimi të brendshëm të banesës, i cili shprehet më i plotë, po të ndiqen dhe ndryshimet që ndodhen në përbërësit e tjerë, në trajtimin arkitektonik e dekorativ të banesës.

Në banesat më të vjetra të këtij tipi (banesa nr. 1), e cila duhet të jetë e fundit të shekullit XVIII, bie në sy një kontrast i theksuar ndërmjet pjesëve të hapura dhe të mbyllura që dalin në ballë. Pjesa e mbyllur është një ndërtim krejtësisht prej guri, me trajtim të thjeshtë dhe elemente arkitektonikë e dekorativë të

DO NOT COPY

kursyer. Ajo përmban dritare të vogla e të harkuara, të mbrojtura me kafazë druri.

Futja e teknikës me skelet druri dhe përdorimi i saj i gjerë gjatë shekullit XIX ndikoi për një trajtim më të lirshëm të banesës. Kolonada dhe parmakët që mbyllnin pjesën e poshtme të tyre, të lehta e transparente, lënë të duket faqja e brendshme, së cilës i kushtohet një kujdes i madh. Ajo gjallërohet nga dyert e dritaret e ambienteve, që dalin në çardak. Sipërfaqen zakonisht të bardhë të murit e përshkon një brez qendror, i qarkuar me fashatura dërrase, që përfshin plane të zbrazta, dritaret, të shkëmbyera me plane të plota. Nga ana e tyre dritaret mbrohen me kafazë druri, ndërsa dyert kurorëzohen me harqe druri, që shpesh përmbajnë gdhendje dekorative. Të njëjtin trajtim kanë dhe pamjet e jashtme të banesave me ballin e katit të sipërm të ndërtuar me çatma.

Një trajtim i tillë e bën më të kapshme ndjenjën e lehtësisë së konstruksionit, kur këto mbështeten në kolonadën e hajatit (banesat nr. 4, 7) ose krijon një kontrast të goditur dhe në përshtatje me funksionin e ambienteve, kur ngrihet mbi masën e plotë e të gurtë të katit përdhe, (banesat 5, 6, 7). Trajtimet e ndryshme të kateve diferencohen me anë të shkëputjes së tyre të lehtë nga njeri tjetri ose të ndarjes së tyre. Kështu në banesat nr. 3, 5, çardaku del lehtë tej planit të hajatit, ndërsa në banesat e tjera ndarja e kateve mbyllet nga një kornizë dërrase.

Në mënyrë të njëjtë trajtohen dhe interieret, ku ndeshet i njëjti parim, kombinimi ose thyerja e sipërfaqeve të bardha e të plota me sipërfaqe druri. Blloku fundor me musandrat, dritaret, dollapet e mureve krijojnë brezin qendror të kornizuar, i cili ndërpritet në faqet më të plota me fashatura vertikale, duke formuar një rrjet kuadratik. Në disa ambiente sipërfaqet e drurit mbizotërojnë duke patur edhe tavanet, shpesh me pjesë të daltuara, të cilat ja shtojnë vlerat dekorative.

Një tipar tjetër dallues i këtyre banesave është dhe nxjerrja në dukje e konstruksionit. Strehët e gjera dyfishe, konstruksioni mbajtës i çardaqeve, hajateve, qoshqeve janë të gjitha të zbuluara. Por megjithatë rreptësia e konstruksionit zbutet nëpërmjet përpunimit të elementeve të tyre, duke fituar në këtë mënyrë dhe vlera dekorative. Një trajtim i tillë i pasur arkitektonik e dekorativ i jep banesës një aspekt të ngrohtë e piktoresk.

Gradualisht me kalimin e kohës fillojnë e ndryshojnë disa nga konceptet e mësipërme. Me rëndësi janë, së pari, ndryshimet që takohen në banesën nr. 6. Në zgjidhjen kompozicionale ajo karakterizohet nga sipërfaqja e mbyllur e hajatit të katit përdhe duke lënë përpara vetëm një hapësirë të vogël të hapur e të përpunuar në formë arkade. Në katin e sipërm çardaku ze vend në pjesën qendrore, duke u shkëputur dhe dalë mbi hyrjen e poshtme, ndërsa në të dy krahët kufizohet nga ambientet, që nxjerrin në ballë dritaret e shumta të tyre. Është krijuar në këtë mënyrë një kompozim simetrik në plan e hapësirë. Në trajtimin e pamjes kryesore një theksim të qartë merr pjesa qendrore, nëpërmjet hyrjes së përpunuar në formë arkade dhe të shkëputjes në formë ballkoni të çardakut.

Ndryshime pësojnë dhe elementet e tjerë. Kështu interieret thjeshtëzohen, pakësohet në mënyrë të ndjeshme prania e elementeve të drurit, e sidomos e atyre të gdhendura. Sipërfaqet e mureve dhe tavanet suvatohen pastër, ndonjëherë duke kaluar ndonjë kornizë të lehtë mbi to. Në dritaret përdoret një formë e re, me kanate xhami dypjesëshe, me rëshqitje vertikale mbi njera tjetrën. Ato fitojnë gjithashtu një përpunim të ri. Tashmë brezi qëndror në fasadë, që përmblidhte në një bllok të vetëm dritaret, zëvendësohet me kompozimin e sipërfaqeve më të mëdha, që kapin të gjithë faqen e katit të sipërm prej çatmaje ndërmjet muraturës së gurtë. Në këtë sipërfaqe vendosen dritaret e veçuara nga njera tjetra dhe të përpunuara si njësi më vete, por, duke qenë afër dhe me përmasa të mëdha, ruajnë ende frymën e trajtimit të parë. Ndryshimet në përpunimin e elementeve shtyhen më tej, deri në mbylljen ose maskimin e konstruksionit. Strehët e mbyllura konsolet e qoshqeve ose të erkereve realizohen me teknikën e çatmasë, ku mbizotërojnë linjat e kurbëzuara.

Zhvillimi i vrullshëm i qytetit të Korçës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, forcimi i tipareve qytetare të jetës dhe i natyrës tregëtare-zejtare të qytetit, sollën kërkesa të reja edhe ndaj banesës. Kështu gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të kësaj periudhe vihet re i njëjti proces si dhe në qytetet e tjera[19], procesi i rikonstruksionit të banesave të hapura, që konsistonte kryesisht në mbyljen e njësive të hapura. Krahas këtij procesi u ndërtuan gjerësisht dhe banesa të reja, të cilat në fazën e parë ruajtën ende të paprekur kompozimin planimetrik të banesave paraardhëse, duke patur tremet e mbyllura dhe duke ndjekur trajtimin arkitektonik e dekorativ të kohës.

Këto ndryshime në aspektin e përgjithshëm të banesës nuk ishin të parëndësishme. Nga njëra anë

19. E. Riza, **Banesa qytetare shqiptare prej gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth fillimit të shek. XX,** në Monumentet nr. 20, 1980.

DOKUMENT

ato iu përgjigjën ndryshimeve të mënyrës së jetesës, nga ana tjetër përbënin një fazë përgatitore për krijimin e një tipi të ri banese me tipare më të avancuara. Kompozimi simetrik, theksimi i qendrës kompozicionale të banesës, nota e monumentalitetit të hyrjes së banesës, krijimi i qoshqeve ose erkereve të dalë, trajtimi i pasur i ballit me dritare të shumta, veshja e konstruksionit dhe mbizotërimi i linjave të kurbëta dhe, së fundi, thjeshtëzimi i trajtimit të interiereve, lanë gjurmë të rëndësishme në tipologjinë e banesës korçare të periudhës pasuese.

Banesat e hapura të Korçës lidhen me një periudhë historike, që karakterizohej nga një stad ende i ulët i zhvillimit, kur ende qyteti nuk kishte arritur të shpërthente plotësisht guackën e një ekonomie të mbyllur feudale, dhe marrëdhëniet e ngjashmëritë me fshatrat përreth ishin ende të forta. Nuk është e rastit p.sh. që skema të tilla kompozocionale takohen edhe në banesat fshatare të krahinave përreth, si në Opar, Dardhë, Boboshticë etj. Nuk është gjithashtu e rastit që ndërtimi i një «çifçihane», ndërtesë ku banonin bujqit gjatë kohës së punëve në bujqësi, që ndodhej pranë arave të qytetit të vjetër, është ndërtuar pikërisht sipas kësaj skeme kompozicionale. Ndër dokumentat prania e banesave me çardak përmendet relativisht herët. Në një testament të vitit 1725, i ati i le djalit si trashëgim një shtëpi me çardak, me oborr dhe me pus[20]. Gjatë gjithë kësaj periudhe duket se banesa e hapur në Korçë duhet të ketë qënë një tip mjaft i pëlqyer dhe mjaft i përhapur, siç dëshmohet nga gjurmët e qarta të zbuluara në banesa të shumta e të rikonstruktuara në faza të mëvonëshme, si dhe nga qëndrueshmëria e skemës kompozicionale tipike të tyre edhe në banesat e mbyllura, të ndërtuara gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të gjysmës së dytë të shekullit XIX, përpara se tipi i ri i banesës korçare të kësaj periudhe të kristalizohej dhe të zinte vend plotësisht.

Banesa e hapur në qytetin e Korçës, nuk është një shfaqje e re në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare. Ajo plotëson kuadrin e shtrirjes dhe të tipareve specifike që pati ky tip banese mjaft i përhapur në vendin tonë.[21] Megjithatë në zgjidhjen funksionale dhe kompoziconale banesat e hapura të Korçës, paraqesin disa tipare specifike. Përdorimi i katit përdhe për banim, duke patur shpesh dhe qilar nën të, ishte një dukuri e zakonshme për Korçën, në një kohë kur në qendrat e tjera katet përdhe u përdorën zakonisht si katoje. Lidhur me këtë zgjidhje funksionale në Korçë u parapëlqyen skemat e thjeshta kompozicionale, të cilat arrinin edhe me nga një ambient banimi në çdo kat. Për nga arritjet në planin arkitektonik e dekorativ banesat e hapura të Korçës gjejnë paralele me banesat e Elbasanit dhe me shembujt e thjeshtë të banesave me çardak të Beratit e të Shkodrës, por mbetet mbrapa shembujve të zhvilluar të këtyre të fundit. Banesat e hapura në Korçë, mbeten gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre si banesa të arritshme dhe të përdorshme nga shtresat e gjera të popullsisë.

DO NOT COPY

20. P. Pepo, **Kodiku i Mitropolisë ...**, dok. 47.
21. E. Riza, **Artikuj të cituar.**

DO NOT COPY


BANESA Nr.1
Rr."S.PECI„ Nr 23 - KORÇE
O B O R I
PLANIMETRIA E KATIT TE I
PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
PRERJE A-A
'PAMJE KRYESORE
0 1 2 3m.

DO NOT COPY


BANESA Nr.2
Rr."JERONIM DE RADA" Nr.5 - KORÇE
PAMJE KRYESORE
PARA RESTAURIMIT
0 2,5m
FAQJA "A"
ÇARDAKU
Qepen
PLANIMETRIA E KATIT I
(PAS RESTAURIMIT)
PODRUMI
0 2 M
PAMJE KRYESORE (PAS RESTAURIMIT)

DO NOT COPY

BANESA Nr. 2

Rr. "JERONIM DE RADA" Nr. 5 - KORÇE



PRERJE TERTHORE (PAS RESTAURIMIT)



DETAJ I STREHES SE ÇARDAKUT



DETAJ "JASTEKU"



PAMJE NGA MBRAPA (PARA RESTAURIMIT)



DOLLAPE MURI



DETAJ I "PARMAKLLEKUT"



DEKORE PORTASH



DEKORE PORTASH

DO NOT COPY

BANESA Nr. 3

Rr. "MIHAL GRAMENO" Nr. 4 - KORÇE

(PARA RESTAURIMIT)



PAMJE ANESORE





ELEMENTE TE ÇARDAKUT TE RIPERDORUR



KATI I I

0 1 2M



KATI PERDHE

DO NOT COPY

BANESA Nr. 3

Rr. "MIHAL GRAMENO" Nr. 4 - KORCE

(PAS RESTAURIMIT)



PRERJE "A-A"



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT I



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

0 1 2M

DO NOT COPY

BANESA Nr. 3 (MYSAFIRHANIA)

Rr." MIHAL GRAMENO„ Nr. 4 - KORÇE



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT I



PLANI I VENDOSJES



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

0 1 2 3M

DO NOT COPY


BANESA Nr. 4
Rr. "SHPRESA PALLA" Nr. 14 - KORÇE
PLANIMETRIA E KATIT TE I (PARA RESTAURIMIT)
PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (Para restaurimit)
PLANIMETRIA E KATIT I. (PAS RESTAURIMIT)
PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (Pas restaurimit)
0 1 2 3M
B
B
KONSTRUKSIONI I ÇATISE
DETAJ I STREHES
PRERJE B-B

DO NOT COPY

BANESA Nr. 4

Rr. "SHPRESA PALLA" Nr. 14 – KORÇE



PAMJE KRYESORE (PARA RESTAURIMIT)



PAMJE KRYESORE (PAS RESTAURIMIT)



PAMJE NGA MBRAPA (PAS RESTAURIMIT)



0 1 2 m

PRERJE A–A (PAS RESTAURIMIT)



PAMJE NGA BRENDA



0 2 m.



PAMJE E HAMBARIT DHE E MUSENDRES

DO NOT COPY

BANESA Nr. 5

Rr. SPIRO BALLKAMENI Nr. 5 – KORÇE



PAMJE LINDORE (PAS RESTAURIMIT)



PAMJE LINDORE (PARA RESTAURIMIT)



PLANIMETRIA E KATIT I
(PAS RESTAURIMIT)



PRERJE A–A
PARA RESTAURIMIT



PLANIMETRIA E KATIT I
(PARA RESTAURIMIT)



PRERJE A–A (PAS RESTAURIMIT)

DO NOT COPY

BANESA Nr. 6

Rr. "MIHAL GRAMENO" Nr. 17
KORÇE

GJENDJA PARA RESTAURIMIT



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT I



PAMJE E BALLIT TE ÇARDAKUT NGA BRENDA





DRITARE E KATIT I



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE

DO NOT COPY

BANESA Nr. 6

Rr. "MIHAL GRAMENO" Nr. 17
KORÇE

GJENDJA PAS RESTAURIMIT



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT TE I



PAMJE NGA BRENDA E ÇARDAKUT



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



DETAJ I KOLLONES
SE ÇARDAKUT

DO NOT COPY

BANESA Nr. 7

Rr. "PJETER BOGDANI" Nr. 9 - KORÇE



PLANIMETRIA E KATIT I



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PAMJE E ÇARDAKUT





PRERJE VERTIKALE E DRITARES SE QOSHKUT



PRERJE A"A

DO NOT COPY


BANESA Nr. 8
Rr. "VASIL TREBICKA" Nr. 12 - KORÇE
PRERJE A-A
PAMJE KRYESORE
PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
0 1 2 m.
PLANIMETRIA E KATIT I
A
A

DO NOT COPY

BANESA Nr. 9

Rr LLAZO JORGANXHI Nr 1 - KORÇE



PAMJE ANESORE



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA E KATIT
PERDHE



PLANIMETRIA E KATIT I

0 1 2 3m

DO NOT COPY

BANESA Nr. 10

Rr. FAN NOLI Nr. 11 - KORÇE



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANSORE



PLANIMETRIA E KATIT I



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PLANIMETRIA E PODRUMIT



PRERJE A-A

0 1 2 3m.

Pirro THOMO

DO NOT COPY

LES HABITATIONS OUVERTES DANS LA VILLE DE KORÇA ET PROBLEMES DE LEUR RESTAURATION

RESUME

Le nouveau matériel mis à jour ces dernierès années, les nombreux témoignages issus durant les travaux de restauration nous donnent la possibilité de mettre en évidence ce type de construction très répandue dans la ville de Korça, durant une période historique très avancée de développement de cette ville, qui remonte à la moitié du XIXème siècle.

Durant cette période Korça gardait les traits d'un petit centre, soit par le nombre de ses habitants, que par son étendue et son activité. La ville était formée de trois noyaux principaux, très distincts l'un de l'autre, en deux ensembles habités, nommés Varosh et Kasaba et du centre d'artisans ou autrement dit Le marché de la ville.

Située dans une position géographique favorable, la ville de Korça durant cette période a dû garder son importance en tant que centre administratif de la région tout autour.

L'aspect de la ville de cette période ne doit pas avoir changé beaucoup des autres centres citadines de l'époque. La partie la plus peuplée, celle de Varosh était divisée en mëhallë (quartier), qui portait le nom des familles les plus aisées. L'ensemble était très serré en constructions. Il était parcouru de petites ruelles serpenteuses, d'une largeur de 2 à 4 mètres. Les petites constructions généralement d'un étage, se trouvaient l'une près de l'autre, créant ainsi un massif compact. Les cours, également petites, étaient rarement construites devant la maison, et même dans des cas pareils elles étaient entourées d'un petit mur, qui ne cachait pas la vue de la construction. Plus fréquemment une ou deux faces des habitations donnaient sur la rue, l'animant cette dernière par la riche décoration, leurs balcons et erkeret qui se penchaient sur la rue.

Le marché de la ville était également très mouvementé. Il se trouvait de part et d'autre de la rivière de Morava. On y faisait l'échange des produits agricoles contre les produits de l'artisanat. Durant cette période on comptait à Korça certaines organisations esnafore qui avaient une grande influence dans la vie économique et sociale de la ville.

C'est dans ce cadre général économique social et urbanistique architectonique, que connut une extension un type caractéristique d'habitation, l'habitation à treme, dont les traits étaient conformes à ce stade de développement.

De telles habitatioins, comme en témoignent les exemplaires conservés et les traces découvertes, ont été nombreuses dans la ville de Korça. Nous analyserons dans cet article certains d'entre eux, qui représentent en soi les traits essentiels de ce type, et reflètent la voie de développement et des changements subis dans le temps et qui dernièrement ont été soumis aux importants travaux de restauration.

L'habitation Nr. 1. *C'est une des habitations les plus anciennes qui survit de ce groupe et doit appartenir à la fin du XVIIIème siècle.*

L'habitation Nr. 2. *Bien que très fragmentaire cette habitation représente de l'intérêt pour l'étendue des habitations ouvertes à Korça et particulièrement sur le plan de la composition et de la procédure architectonique et décorative, durant une période bien précise de leur développement, qui est comprise dans les premières décennies du XIX siècle.*

L'habitation Nr. 3. *Cette sorte d'habitation nous est parvenue dans une situation tout à fait transformée. Durant les travaux de restauration, des données importantes furent mises à jour et bien des éléments qui rendaient possible sa transformation telle qu'elle était.*

Plus tard il fut construite une nouvelle habitation, qui servait comme maison d'amis ou comme elle est nommée par les habitants eux mêmes «Mysafir hane». La construction de tels complexes, composés de la maison de la famille et de la maison des amis, était un phénomène qui vit le jour chez les familles aisées, durant les premières décennies de la seconde moitié du XIXème siècle, dans le vieux quartier de la ville.

L'habitation Nr. 4. *Dans les lignes principales l'habitation gardait la composition planimétrique initiale, avec quelques séparations provisoires, légèrement distinctes comme des annexes, mais quant au procédé architectonique, elle avait changé à cause de la disparition de quelques éléments initials.*

L'habitation Nr. 5. *L'architecture et la restauration de cette habitation est devenu l'objet d'une analyse particulière. Ainsi nous donnerons d'une manière recueuillie certaines conclusions qui nous intéressent pour notre étude.*

L'habitation Nr. 6. *D'après une souscription sur un mur,*

DO NOT COPY

la construction de cette habitation date de 1842. L'habitation a une composition et une construction particulière et distincte des habitations précitées, mais pourtant elle contient des éléments tels qui nous permettent de la regrouper dans les habitations ouvertes.

L'habitation Nr. 7. Elle est partielle à cause d'une autre construction près d'elle en 1883 qui a détruit une bonne partie. Cependant la partie qui reste est suffisante pour nous permettre de porter une jugement sur sa forme initiale.

L'habitation doit être construite dans les premières décennies de la seconde moitié du XIXème siècle.

L'habitation Nr. 8. Elle reflète les changements effectués durant la seconde moitié du XIX ème siècle dans les habitations ouvertes. Durant cette période importante pour l'histoire du développement de l'habitation de la ville de Korça, on remarque un grand essor de reconstructions des vieilles habitations, qui consiste essentiellement dans la fermeture des parties ouvertes et dans les changements effectués dans leur conception architectonique et décorative. Mais au début de cette période, même les nouvelles habitations à çardak fermé ne purent prendre la composition planimétrique des habitations ouvertes.

L'habitation en question représente un des exemples simplement compositionnels, qui reprennent le vieux schéma.

L'habitation Nr. 9. Ici les nouvelles habitations à çardak fermé disposent d'une conception architectonique plus riche. La composition planimétrique initiale rapelle celle des habitations ouvertes.

L'habitation Nr. 10. Elle représente un des exemples les plus répandus des habitations à çardak fermé. Sa composition planimétrique est semblable au schéma connu des habitations à çardak d'un seul côté.

Sur certains critères dont on s'est servi pour la restauration des habitations ouvertes. Pour la restauration de cette sorte d'habitation nous devons considérer certains facteurs: d'abord, leur état détérioré, ensuite les modifications et les transformations subies dans le temps et après, le nombre rare des exemplaires parvenus jusqu'à nos jours. C'est en rapport avec l'intensité de l'action de ces facteur que s'est effectué le travail de restauration. Si l'on regroupait ces travaux de restauration d'après leur nature nous aurions des travaux où prédominerait: a) la restauration de la solidité statique, b) l'élémination partielle des annexes tardifs, c) la restauration de l'état initial avec de plus grandes interventions. Pour des problèmes particuliers, comme le complétement des parties absentes, le renouvellement des éléments détériorés, etc. que l'on rencontre dans les trois groupes on s'est servi des mêmes critères.

Dans le premier groupe nous pouvons citer les travaux effectués dans les habitations nr. 2 et 7, et, en plus grande partie dans l'habitation nr. 4. Dans le cas de l'habitation Nr. 2, nous avions affaire à un monument, qui bien que fragmentaire, gardait intacte des éléments initiaux en composition et en conception, étant ainsi un témoignage authentique des habitations ouvertes à Korça. Mettant en évidence ces éléments surtout à l'aide des nettoyages, complètant quelque fragment et restaurant quelque autre en plus mauvais état, on réussit à conserver ce monument tellement important dans sa forme existante, devenant ainsi un exemple sûr et comme point de repaire pour les autres.

Une telle intervention ne pouvait se faire avec l'habitation nr. 7 à cause de son état dégradé. Mais une intervention devenait possible et indispensable pour sauver et documenter une période importante du développement des habitations ouvertes. Pour y parvenir, au début on tenta d'éléminer des détériorations et des inclinaisons de la construction, pour le remettre en son état d'origine, sans l'endommager. Ensuite on passa au remplacement et au renouvellement des parties les plus endommagées, tout en faisant une attention de ne pas abimer les éléments antiques.

L'habitation nr. 4, outre ses valeurs d'ordre typologique, se distingue pour ses valeurs architectoniques et décoratives. Cela précisément posait comme tâche aux restaurateurs de consolider d'une manière statique la construction d'une part, et de rendre ses valeurs disparues de l'autre part. A cette fin il devenait nécessaire le rétablissement des éléments cachés ou disparus des réparations sans critères postérieures à cette construction. On peut regrouper ici l'ouverture des fenêtres originales et la restauration des éléments de la conception décorative, dont les traces, les dimensions et les modèles existants étaient très clairs.

Sous cet angle les interventions dans cette sorte d'habitation, ainsi que dans l'habitation nr. 6, appartiennent au second groupe des interventions partielles. Dans l'habitation nr. 6, outre les annexes et les séparations postérieurs, d'une grande importance était la fermeture du çardak et sa transformation en un coin clos, modifiant l'aspect initial de cette habitation. Face à l'alternative de garder à tout prix la situation existante, qui reflétait une contribution des périodes postérieures, ou de mettre en évidence l'aspect initial comme un exemple unique de cette variante et de cette phase du développement, non pas d'une seule habitation, mais d'un type caractéristique d'habitation de Korça, nous avons choisi cette dernière. La conservation des éléments initiaux dans le cadre des changements effectués par la suite rendait plus facile l'exécution d'une telle entreprise.

Les deux autres habitations restaurées, le nr. 3 et 5 sont parvenues jusqu'à nos jours complètement transformées. Les modifications effectuées, surtout dans l'habitation nr. 5, ne se distinguaient pas d'une conception architectonique claire. L'étude minutieuse de l'habitation et du matériel découvert, ainsi que la quantité suffisante de ce matériel, donnaient la possibilité de lui redonner les valeurs perdues, respectant en même temps les trois phases de la construction, qui documentaient la voie du développement et de traitement ultérieur des conceptions architectoniques et décoratives.

Dans les trois groupes des interventions, pour bien de travaux de restauration, les critères furent les mêmes. Ainsi

NO COPY

p. ex. pour le renouvellement des éléments détruits de la construction et pour compléter les parties architectoniques et décoratives qui manquent on procéda d'une manière différenciée, donnant de l'importance aussi à la conservation de l'unité stylistique et à la création d'une conception architectonique de l'époque où elle fut construite. Dans les parties cachées, comme dans les fondements, les murs, le plancher, partiellement dans les constructions avec échafaudage et dans le toit etc. on se servit du matériel de notre époque. Il n'en était pas de même pour des éléments d'aspect extérieur tels que crépissage, jointoiement, parties murales etc; qui furent retravaillés avec un matériel et une technique traditionnels. Il en fut ainsi pour la restauration des avant-toits, des collones, des chapitaux, des rampes, des bordures des fenêtres etc.

Dans bien des cas quand les données pour la reconstruction se revélaient insuffisantes et avaient disparues, il fut trouvé préférable de les laisser dans leur état actuel et de ne pas y toucher.

Le caractère général des habitations ouvertes et leurs changements. L'analyse des exemples les plus typiques des habitations ouvertes de la ville de Korça et leur revalorisation de certaines d'entre elles après la restauration, rendent possible une caractérisation générale. Cela devient aussi plus facile par le fait que les exemples qui nous parviennent sont compris dans une période relativement limitée qui comprend seulement quelques décennies, durant laquelle on a bouti à une typisation accentuée tant pour sa réalisation sur le plan de la composition que sur celui de la conception architectonique, décoratif et de construction. Pourtant même durant cette période limitée on remarque un développement à tendance vers les nouvelles formes d'expression, pour arriver à une solution naturelle de la fermeture des unités ouvertes.

Les habitations ouvertes de la ville de Korça sont généralement couvertes d'une petite cour. La construction serrée et souvent très près l'une de l'autre dans le vieux quartuer de la ville, où l'on rencontre ces habitations, l'économie du sol de la construction, ont fait que l'orientation de l'habitation ne soit pas recherchée, mais souvent obligée par ces circonstances. Ainsi outre l'orientation des tremeve ouverts du sud et de l'ouest, on trouve des habitations du même genre orientées vers le nord, orientation peu commune pour de telles constructions.

Les habitations ouvertes de Korça se distinguent par un schéma simple compositionnel. Elles sont généralement d'un étage, d'un ou deux ambiances rangées autour des vestibules ouverts des étages. Leur superficie des unités ouvertes est limitée. La place habituelle des vestibules est généralement en face de l'habitation. Mais bien que d'un répertoire limité, on constate des variantes différentes des habitations ouvertes, comme celles «à çardak», de côté et au centre.

Ces variations de la composition planimétrique, outre l'indice des couches sociales de la population, sont aussi un indice d'un développement interne de l'habitation, qui est exprimé pleinement, si l'on suit les changements qui eurent lieu dans les autres parties dans la conception architectonique et décorative de l'habitation.

Dans les plus vieilles habitations de ce type (habitation nr. 1.), qui doit appartenir à la fin du XVIIème siècle, c'est un contraste qui frappe entre les parties ouvertes et les parties fermées qui se trouvent en face de l'habitation. La partie fermée est entièrement d'une construction en pierre, d'une conception simple et d'éléments décoratifs et architectoniques peu nombreux. Les fenêtres sont petites et arquées, protégées par des bordures en bois.

L'apparition de la technique avec une armure de bois et la large utilisation durant le XIXème siècle influa à une conception plus libre de l'habitation. Les collones et les rampes qui fermaient la partie intérieure, légères et transparentes, permettent de voir à l'intérieur, que l'on attache une grande importance. Elle se ranime par les fenêtres et les portes des pièces, qui sortent sur le çardak. La superficie, généralement blanche du mur est traversée par une partie centrale, ornée de planches de bois, qui comprend des plans vides, les fenêtres, alternées à des plans pleins. D'autre part les fenêtres sont protégées par des bordures de bois, tandis que les portes sont couvertes d'arcs de bois, qui dans bien des cas ont des sculptures décoratives. De la même conception sont même les parties extérieures des habitations avec le devant de l'étage supérieur construit en cloisons.

Une telle conception rend plus facile l'idée de l'allégement de la construction, quant elle est appuiée sur les collonades du porche (les habitations 4 et 7) ou crée des contrastes réussis et conforme à la fonction des pièces, quand elle est construite sur le massif en pierre du rez-de-chaussée, (les habitations 5, 6, 7). Les conceptions différentes des étages se distinguent par leur détachement léger l'un de l'autre ou de leur séparation. Ainsi dans les habitations nr. 3 et 5 «Le çardak» dépasse légèrement le porche, tandis que dans les autres constructions, la division des étages se ferme par une quadrature de planche en bois.

De la même manière sont conçus les intérieurs, où l'on rencontre le même principe, la combinaison ou la coupure des espaces blancs et complets par des superficies de bois. Le bloc final avec les placards, les fenêtres, les armoires contre le mur, crée la partie centrale de quadrature, qui est rompue par les parties complètes avec des bordures verticales, formant ainsi un réseau quadratique. Dans certaines pièces les superficies en bois prédominent ayant même les plafonds, souvent sculptés, qui lui ajoutent les valeurs décoratives.

Un autre trait distinctif de ces habitations est la mise en évidence de la construction. Les avants-toits larges et doubles, la construction d'appui des «çardak», des porches, des «qoshks» sont toutes découvertes. Mais toutefois la rigueur de la construction s'adoucit par le traitement de leurs éléments, reprenant ainsi des valeurs décoratives.

Graduellement avec le temps elles commencent à changer certains de ces conceptions -là. De grande importance sont,

d'abord, les modifications subies dans l'habitation nr. 6. Dans la solution compositionnelle elle se caractèrise par une superficie fermée du porche du rez-de-chaussée, laissant devant seulement une petite partie ouverte et travaillé sous forme d'arcade. Dans l'étage supérieur le «çardak» occupe la place centrale, se détachant et sortant au dessus de l'entrée du dessous, tandis que des deux côtés il est limité par les pièces, avec leurs nombreuses fenêtres en face. Il a été créée de la sorte une composition symétrique en plan et en espace. Dans la conception de la façade, la partie centrale est plus apparente par l'entrée travaillée sous forme d'arcade et par l'écart en forme de balcon du «çardak».

Même les autres éléments subissent des modifications. Ainsi, les intérieurs se simplifient, et diminuent d'une manière sensible la présence des éléments de bois, et surtout de ceux sculptés. Les superficies des murs, des plafonds, sont crépies proprement, parfois avec une légère bordure tout autour. Pour les fenêtres on se sert d'une nouvelle forme, avec des volets doubles de vitres, à glissement vertical, un sur l'autre. Elles prennent ainsi une conception nouvelle dans leur traitement architectonique. Les modifications dans la conception des éléments vont plus loin, jusqu'à la fermeture ou de déguisement de la construction. Les avant-toits fermés les consoles des «qoshks» ou des erkere se réalisent avec la technique de la cloison, où prédominent les lignes courbées.

Le grand essor de la ville de Korça durant la seconde moitié du XIXème siècle, la consolidation des traits citadins de la vie et de la nature commerciale et artisanale de la ville, apportèrent de nouvelles perspectives pour ces habitations. Ainsi durant les premières décennies de cette période on constate le même processus que dans les autres villes, le processus de la reconstruction des habitations ouvertes, qui consistait essentiellement à la fermeture des unités ouvertes. Parallèlement à ce processus on construit beaucoup d'autres habitations, qui gardaient encore intacte la composition planimétrique des habitations existantes, ayant treme fermé et suivant la même conception architectonique et décorative de l'époque.

Ces changements dans l'aspect général de l'habitation ne furent pas sans importance. D'une part ils répondirent aux changements dans le mode de vie, et d'autre part, ils constituaient une phase préparatoire pour la création d'une nouvelle sorte d'habitation à des traits plus avancés.

Les habitations ouvertes de Korça se rattachent à la période historique qui se caractérise encore d'un stade de développement relativement bas, quand la ville n'avait pas encore réussi à sortir du cadre étroit d'une économie fermée féodale, et les rapports et les affinitées avec les villages autour étaient encore solides. D'après les documents, la première apparition des habitations date de 1725. Durant toute cette période il semble que l'habitation ouverte de Korça a du être un type à la mode, comme en témoignent les traces découvertes dans maintes habitations reconstruites par la suite ainsi que la stabilité du schéma compositionnal typique même dans les habitations fermées, construites durant les premières décennies de la seconde moitié du XIXème siècle, avant que le nouveau type de l'habitation de Korça de cette période ne se cristallise et ne prenne place définitivement.

L'habitation ouverte dans la ville de Korça, n'est pas une manifestation nouvelle dans la typologie de l'habitation de la ville albanaise. Elle vient compléter le cadre de l'étendue et des traits spécifique que connut ce type d'habitation tres répandue dans notre pays. Cependant ces sortes d'habitations présentent aussi certains traits spécifiques quant à leur conception fonctionnelle et compositionnelle. Une caractéristique pour l'habitation de Korça était la mise en service du rez-de-chaussée pour y habiter, ainsi que la préférence pour un schéma compositionnel simple. De par les réalisations sur le plan architectonique et décoratifs, les habitations ouvertes de Korça ressemblent à celle d'Elbasan et quant à leur conception simple d'habitation à «çardak» à celles de Berati et de Shkodra, mais restent en arrière quant aux différents types plus nombreux de ces derniers. Les habitations ouvertes à Korça ont été durant toute la période comme bien réussies et habitées par les larges couches de la population.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

DO NOT COPY

Valentin VOSHTINA

KULLA ME MURE RRETHUES NË MAT

Krahina e Matit njihet tashmë si krahina më tipike për ndërtimin e banesës së fortifikuar të tipit kullë, Gjurmimi dhe studimi i saj ka filluar afërsisht para 15 vjetëve dhe në një sërë artikujsh janë trajtuar problemet e funksionit dhe ndërtimit të saj.[1] Krahas banesave të fortifikuara të tipit kullë, dhe atyre me sharapoll në krahinën e Matit ndodhet edhe një lloj banese e fortifikuar, e cila është e qarkuar me mure rrethues, duke u emërtuar nga vendasit «Kullë kala»[2]. Kulla me mure rrethues është një banesë që u shtri në zonën e fshatrave të Lisit, Vinjollit, Derjanit, Klosit dhe në disa të tjerë.

Në përgjithësi kulla me mure rrethues përfaqëson ndërtimin e një banese të tipit kullë të rrethuar me mure. Siç dihet kati përdhe i kullës (burgu) shërben si ambient për bagëtinë, në katin e parë vendoset shtëpia e zjarrit, ndërsa në katin e dytë vendoset oda e miqve. Ky ambient ashtu si dhe tek tipet e tjerë paraqitet i paisur me të gjithë elementët përbërës si çikmatë, sheshinat, frengjitë e shumta etj. E paisur me këto elemente, kulla përfaqëson një ndërtim mjaft të fortifikuar. Për ta rritur më tej fortifikimin e saj, kësaj kulle i shtohen muret rrethues. Edhe muret rrethuese u paisën me frengji të shumta. Për komunikimin me ambientin e jashtëm, me mure, u lanë vende për porta. Zakonisht në muret rrethues gjenden dy porta përballë njera tjetrës. Porta e hyrjes është i vetmi element i trajtuar si nga pikëpamja e fortifikimit, ashtu dhe nga pikëpamja estetike. Në qoshet e portës ka frengji. Porta është e përbërë nga dy kanata të rëndë, të cilët natën dhe në kohë të pasigurtë sigurohen me dy shula hekuri.



Fig. 1

Fillimet e hershme të kësaj kulle i takojmë në fshatin Lis, pranë një blloku banesash që shtrihen në të djathtë të rrugës automobilistike që të shpie në Qafë Murrë. Në majë të një kodrine, në të djathtë të rrugës këmbësore që të çon në këtë bllok, ndodhet kulla më e vjetër. Ajo ka qënë rrethuar krejtësisht me mure. Nga të dhënat gojore, del se muret rrethues janë ndërtuar njëkohësisht me kullën. Kulla fillestare (më vonë bashkëngjitur u ndërtua edhe një tjetër) ndodhet në mes të oborrit të krijuar nga muret rrethues. Muret janë të ndërtuar me gurë dhe të lidhur me llaç balte. Çdo 0,70 m janë vendosur breza druri. Trashësia e murit është 0,50m dhe lartësia e tij

1. P. Thomo, B. Strazimiri, **Kulla e Matit,** Monumentet, 1, 1971, f. 149-165 P. Thomo, **Banesat me qoshk në Shqipërinë e Veriut,** Etnografia shqiptare VIII, f. 191-236, 1976.
2. D. Kurti, **Vëzhgime mbi kullën e Matit,** Bashkimi, dt. 7.9.1972.

2,10 m. Dikur muri rrethonte këtë ansambël nga të gjitha anët. Sot ai është pjesërisht i rrënuar. Përgjatë tij vihen re kamaret e frengjive të vendosura 80 cm nga toka dhe 250 cm latrg njeri tjetrit. Komunikimi me ambientin e jashtëm bëhej me anën e dy portave. Sot ruhet vetëm njera prej tyre, porta kryesore (fig. 1). Ajo ka përmasa 1,80 x 2,00 m dhe është e trajtuar thjeshtë. Mbyllja bëhet me dy kanata druri prej lisi. Për sigurimin e saj përdoren dy shufra metalike të varura në shpatullat anësore të portës, të cilat futen në dy unaza metalike të vendosura për këtë qëllim në kanatat e portës. Sipër porta mbulohet me një pullaz. Thjeshtësia e trajtimit tregon se kemi të bëjmë me një nga rastet më të hershëm të shfaqjes së mureve rrethues.

Në muraturën e kullës të ndërtuar më vonë, që i bashkëngjitet kullës së vjetër vërejmë një portë të murosur (fg. 2) jo të zakonshme përsa u përket përmasave të mëdha për hyrjet e kullave. Ajo ngjason shumë me portat e mureve. Ndoshta dikur ajo mund të ketë qënë e tillë, e më vonë, kur u ndërtua kulla e dytë, u shfrytëzua për ndërtimin e saj një pjesë e murit rrethues duke përfshirë edhe portën në të. Në krahasim me portën e parë kjo dallohet për zgjidhjen e punimin e saj. Ajo është e gjerë, e punuar me gurë të gdhendur dhe e mbyllur sipër me një hark rrethor. Ai formohet prej tre gurë të daltuar (fig. 2). Guri i kyçit të harkut shënon datën e ndërtimit vitin



Fig. 2



Fig. 3

1824. Pak më poshtë në këtë bllok ndeshim në një rast tjetër të «kullës kala». Tashmë kemi dy kulla (Tab. 1/a), të ndërtuar rreth mesit të shek. XIX dhe të vendosura përkundrejt njera tjetrës. Ato qarkoheshin me të njëjtët mure rrethues. Në planin e përgjithshëm muri rrethues është vazhdim i mureve mbi të cilët ngrihen kullat. Ato janë ndërtuar në dy qoshet e katërkëndëshit të formuara nga muri rrethues. Komunikimi me ambientin e jashtëm dhe këtu kryhet nëpërmjet dy portave të vendosura kundrejt njera tjetrës në plan. Vendosja e kullave pranë njera tjetrës ishte menduar e tillë vetëm që të rritej sa më shumë sistemi mbrojtës i tyre. Përkujdesja për mbrojtje në këto dy kulla, që janë të së njëjtës familje, ka bërë që komunikimi ndërmjet tyre të bëhet me një urë kalimi, që ngrihet mbi portën e hyrjes të oborrit. Ky është një ambient i mbyllur i ndërtuar mbi murin rrethues i cili lidhte të dy katet e para të kullave. Kjo zgjidhje paraqet një rast të veçantë me interes nga pikëpamja e fortifikimit. Në gjendjen e sotme ruhet vetëm muri rrethues që bashkon të dy kullat së bashku me portën e hyrjes për në oborr (fig. 3), ndërsa ambienti ndërlidhës është shkatrruar. Në të dy faqet përkundrejt kullave, duken gjurmët e portave tashmë të murosura të cilat lidheshin me këtë ambient. Muri rerthues në këtë fragment arrin lartësinë 6 m. Gurët në të janë të lidhur me llaç gëlqereje. Porta

DOI OTCOK

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

e hyrjes ka një hapësirë 2,0 m, dhe lartësia e saj në kulmin e harkut arrin 2,30 m. Harku i portës është rrethor me rreze 0,80 m. Ai mbështetet mbi dy ancakë guri, të profiluar, të cilët qëndrojnë mbi shpatullat anësore të portës. Këto të fundit janë të punuara nga një gur i vetëm. Për ndërtimin e portës janë përdorur gurë shtufi. Porta ka një prag prej 15 cm. Porta tjetër përballë si dhe muret që lidheshin me të nuk ruhen më.

Në vazhdim të gjurmimit të kësaj kulle ndeshemi me bllokun e «kullave kala» në fshatin Vinjoll. Ky është një bllok i shtrirë fare pranë rrugës automobilistike, në të djathtë të saj. Pranë njera tjetrës janë vendosur katër të tilla. Në fund të këtij blloku gjëndeshin dy kulla, të cilat dikur kanë qënë të rrethuara me të njëjtin mur rrethues (Tab. I, b). Më e vjetra ndër to, është një kullë me sharapot. Kulla ka qënë trekatëshe dhe sharapoti ngrihej një kat sipër.[3] Kemi patur këtu një nga tipat më interesant të kullës me sharapot. Në këtë bllok gjëndet dhe një tjetër ndërtim i tillë. Këto ndërtime të gjysmës së dytë të shek. XIX, sot paraqiten me ndryshime të theksuara. Pranë kësaj kulle nga fundi i shekullit të kaluar u ndërtua dhe një kullë tjetër. Me këtë rast për fortifikimin e të dyja kullave u ndërtua dhe muri rrethues. Është një rast i ngjashëm me dy kullat e Lisit. Por ndryshe nga ato këtu kullat ndodhen në qoshet që formohen nga muri përballë portës kryesore të hyrjes (Tab. 1/b). Ato janë të tërhequra nga muri i përparmë. Muri rrethues me trashësi 0,65-0,70 m., është i ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Lartësia e tij është e barabartë me lartësinë e portës së hyrjes. Ajo çka të tërheq më tepër vëmëndjen në këtë ndërtim është porta e hyrjes. Kjo portë përfaqëson të vetmin element ku vërehet përkujdesje trajtimi, element i cili rrit në mënyrë të konsiderueshme vlerat arkitektonike të murit rrethues (fig. 8).



Fig. 6

3) V. Voshtina, «**Dy kulla me sharapot në rrethin e Matit**», «Monumentet», 18, 1979.

Në zhvillimin e përgjithshëm planimetrik, vërejmë se kjo portë, një nga më të arriturat e këtij lloji, nuk është e vendosur simetrikisht larg të dy kullave. Ndoshta, kjo ka qënë e lidhur deri në një farë mase me ndërtimin e kullës së dytë. Në të dy anët e portës, faqet e jashtme të murit rrethues ndërpriten për të formuar dy vende ndejtje, ose siç quhen nga vendasit sofate. Ato ngrihen 0,65 m nga toka. Në plan, kjo ndërprerje, paraqet një formë jo të rregullt të dy brinjëve të cilat rakordohen me një hark. Sipër sofateve muri vjen duke u mbyllur në formë harku me rreze 1,50 m, me qendër në qendrën e harkut të portës. Në dy pjesët e kurbëta që lartësohen mbi sofate ndodhen dy frengji me hapje 3 x 25 cm (fig. 4). Në plan ato ndodhen në dy qoshet që formohen nga muri dhe mbështetëset e portës. Në pjesën e brendshme të oborrit, frengjive u korespondojnë dy kamare.

Ndërsa nga ana e jashtme muret ndërpriten për të formuar sofatet, në pjesën e brendshme ato vazhdojnë tashmë nën një kënd të drejtë, duke lënë për portën një hapësirë prej 2 m. Në shpatullat e portës është vendosur karkasi prej druri i portës. Hapësira dritë e portës është 1,60 m. Mbyllja e saj bëhet me një hark rrethor, të ndërtuar me gurë të gdhendur. Diametri i harkut është më i vogël se gjerësia e portës. Harku formohet prej tre gurësh, që mbështeten mbi dy ancakë të punuar që dalin nga shpatullat anësore të portës.

Në karkasin e portës janë të fiksuara kanatet. Ato janë bërë nga dru lisi. Për t'i bërë ato sa më solide në nyjet më delikate të kanatës është përdorur mbërthimi me kllaposje metalike. Kllapa metalike është formuar nga hekur pjatë, i rrahur, me trashësi 6 mm që mbërthen kanatin nga të dy anët. Në distancë 0,75 m nga fundi i kanatit duken një sërë gozhdësh me kokë të madhe, të vendosura në një vijë të drejtë, të cilat pasurojnë pamjen. Në secilin kanat është vendosur trokitsja metalike me paftën dhe unazën metalike. Kjo e fundit është e mbërthyer në karkas. Pafta është e punuar me shije. (fig. 5).



Fig. 7

Kanati e kryen lëvizjen rrotulluese nëpërmjet dy nyjeve (Fig. 6). Nyja e poshtme, metalike, është e formuar nga një hekur pjatë i rrahur. Është pikërisht kjo pjesë që kryen lëvizjen rrotulluese në folenë e formuar në gurin poshtë saj. Nyja e sipërme është e formuar nga një pjesë druri në formë cilindrike. Nyja e sipërme shërben kryesisht për ekuilibër dhe për të lehtësuar rrotullimin. Për të mposhtur forcën e fërkimit, perimetri i nyjes së sipërme është veshur me një unazë hekuri. (Fig. 6). Rrotullimi sipër kryhet në një fole druri, të lënë në traun e drurit që shërben për pullazin e portës.

Mbyllja e portës sigurohet nga dy çengela metalikë të varur në muret mbështetës. Fiksimi i tij bëhet në një unazë të ngulur në një tako druri 15 x 15 cm e vendosur kjo midis rreshtave të gurëve të murit mbështetës. Fundi i çengelit i kthyer në formë harku futet në unazat e montuara në kanatet e portës për këtë qëllim. Një sistem i tillë siguron plotësisht mbylljen e portës. Mbi dy muret mbështetës janë vendosur trarë pranë e pranë. Në ta, është montuar një drushtë e dhëmbëzuar që shërben për fiksimin e kanatit të hapur. Pullazi ka qënë i mbuluar me tjegulla në formë lugu. Në pjesën e brendshme janë ndërtuar disa basamakë guri, të cilët shoqërojnë terrenin gjithmonë në rënie, duke lehtësuar në këtë mënyrë lëvizjen gjatë hyrjes dhe daljes.

Porta është e zgjidhur bukur. Ajo është punuar me gurë të gdhendur dhe mbyllja e sofateve në formë harku është në unitet me tërësinë e portës. Harmonia e linjave të lakuara e rrit plasticitetin e saj. Druri i përdorur për formimin e kanateve, së bashku me elementet metalikë, funksionalë e estetikë, i rrisin më tepër vlerat e kësaj porte.

Më vonë me ndarjen e familjeve, për mbrojtjen e kullës së vjetër u ndërtuan mure të rinj, të cilët e rritën sipërfaqen e oborrit. Për t'i shërbyer familjes së ndarë, në muret rrethues u ndërtuan dy porta përkarshi njera tjetrës. Sot ruhet vetëm porta kryesore, e cila datohet në vitin 1904. Edhe kjo është një portë me hark, gjysmë rrethore. Të dy ancakët e gurit mbi të cilët mbështetet harku janë të profiluara bukur. Vetë harku i qemerit është i punuar me një motiv të thjeshtë, që shoqëron formën e tij. Sofatet nuk i gjejmë. Në ndryshim nga rasti i parë, këtu muret mbështetës janë më të shkurtër dhe të lartë sa lartësia

POZITIVE COPY

e portës. Muret në të dy anët e portës janë të paisur me frengji. Për të bërë sa më të lehtë lëvizjen në pjesën e brendshme janë ndërtuar pesë këmbë shkallë që shoqërojnë terrenin gjithmonë në rënie. Porta sipër është e mbuluar me pullaz.

Po në këtë grup banesash, në afërsi të rrugës automobilistike ndeshim përsëri një kullë me mure rrethues, nga muret e së cilës kanë mbetur vetëm gjurmët e rrënojave. Pak më lart gjënden një pjesë muresh që kanë rrethuar dikur një kullë me sharapot si dhe një portë me hark.

Te kulla me mure rrethues që ndodhet në të dalë të fshatit Lis kur shkon për në Qafë Murrë, muret rrethues datohen të vitit 1935 datë që lidhen dhe me ndërtimin e kullës së re, që i bashkëngjitet të vjetrës. Muret rrethojnë pjesën e oborrit nga hyhet për në kullë. Edhe këtu portat e hyrjes janë dy, duke ruajtur trajtimin e njohur. Shpatullat e qemeri janë të punuara me gurë mermeri.

Në Zenisht gjendet një kullë tjetër e hershme, por rrethimi i saj me mure është bërë në vitin 1934 (Tab. I, c). Në proporcion me madhësinë e oborrit relativisht të madh është dhe zgjidhja e portës së hyrjes. Porta me hark, është 200 cm e gjerë dhe 250 cm e lartë. Muret mbështetës të saj janë të spostuara 60 cm nga shpatullat anësore, duke krijuar mundësinë e ndërtimit të sofateve të brendshëm po me këtë gjerësi. Harku i portës përbëhet nga 15 gurë. Shpatullat e saja, dhe guri i kyçit të qemerit janë të gdhendura me motive të ndryshme. Ancakët mbështetës janë me motive. Porta është e punuar me gurë të gdhendur. Në ndryshim nga portat e tjera, mbi qemerin gjëndet e ndërtuar një kornizë guri.

Këto ishin disa nga shembujt që kemi gjurmuar, për të ilustruar ndërtimin e kullës me mure rrethues në periudha të ndryshme. Rrethimi me mure të lartë dhe të shëndoshë nga pikëpamja konstruktive, krijoi mundësi të reja fortifikimi. U krijua kështu një mur me funksione mbrojtëse i paisur me frengji të shumta, mjaft rezistent dhe i vështirë për t'u kaluar. Porta, i vetmi vend i mundshëm kalimi, është trajtuar me mjaft kujdes në drejtim të fortifikimit. Në të gjitha rastet muret rrethues janë ndërtuar në vijim të mureve të kullave. Është patur kujdes që porta e murit rrethues të jetë përballë çikmave me frengji të shumta, duke krijuar në këtë mënyrë një mbrojtje të dyfishtë të saj. Muret janë ndërtuar me gurë dhe lidhur zakonisht me llaç gëlqereje. Ato janë të punuara thjeshtë, duke i dhënë në këtë mënyrë përparësi trajtimit të portës së hyrjes, si i vetmi moment interesant i rrethimit. Në të gjitha rastet, porta, gjendet paksa e tërhequr nga faqet e jashtme të mureve.

Muret rrethues janë një dukuri e njohur prej shekujsh si në rrethin e Matit, ashtu dhe në mbarë vendin tonë, si në ndërtimet mbrojtëse edhe në banesat, prandaj, kjo dukuri është një shfaqje e kushtëzuar nga kërkesat për mbrojtje.

Përdorimi i mureve rrethues nuk i ndryshoi asgjë kompozimit planimetriko-volumor të kullës si dhe mënyrës së saj të fortifikimit. Ajo mbetet e njëjtë si nga ana funksionale po ashtu dhe në trajtimin arkitektonik.

DO NOT COPY

DO NOT COPY





Fig. 8



Zenisht



DO NOT COPY

Valentin VOSHTINA

DO NOT COPY

LES KULLAS A DES MURS FORTIFIES A MAT

RESUME

Les habitations fortifiées du type de «Kulla» dans la région de Mati, généralement, ne sont pas fermées de murs tout autour, mais il y a des cas où l'on les rencontre même avec des murs fortifiés. Par les indigènes ces types d'habitation sont nommées «des Kullas chateaux.» Nous pouvons voir ces exemples dans les villages Lis, Vinjoll, Derjan, Klos etc. Dans ces cas l'habitation ne présente pas de différences par rapport à la typologie de l'habitation en question. Ce qui est nouveau consiste dans le fait qu'elle est fortifiée de murs qui viennent renforcer sa fortification. Ses murs sont équipés de plusieurs meurtrières. Il y a toujours la porte d'entrée, de deux battants qui est renforcées par des barres en fer. Même ici il y a des meurtrières car la porte est le point le plus faible de la fortification. La place de la porte est telle, qu'elle ne nuise pas à la défense de l'habitation, aussi sa construction en face des çikmave, avec beaucoup de meurtrières est une construction fréquente. Généralement on fait une grande attention à la construction des portes en mettant des arches et construisant des deux côtés deux places pour monter la garde. On trouve ces sortes d'habitations construites en même temps que les murs, mais parfois les murs sont construits après la Kulla.

Ces sortes d'habitations furent construites uniquement par les classes aisées de la population paysanne, dans les conditions d'une époque incertaine et des contradictions de classe au sein de la société paysanne de l'époque.

monumentet

Abdulla BIRAÇI

PROBLEME DHE ASPEKTE TË ÇVENDOSJES, RIVENDOSJES DHE TË RESTAURIMIT TË NJË TYMTARI

Shkak për këtë shkrim u bë ekspozita lokale e kulturës popullore që u hap në Shkodër në Maj të vitit 1981. Në këtë ekspozitë kërkohej të vendosej një tymtar si një shëmbëllesë që do të përfaqësonte artin e bukur të gipsoplastikës. Ky tymtar i punuar në stuk relief të bardhë u gjend dhe u vendos në pavionin e gurit dhe të qeramikës. Për gjetjen e tij u desh të gjurmohej për një kohë të gjatë pasi ai nuk duhej hequr nga ndonjë banesë e shpallur «Monument kulture». Tymtari i kërkuar (Foto 1) u gjet në një shtëpi shkodrane (lagja «Ndoc Mazi» Rruga «11 Janari» Nr. 24) arkitektura e pamjes kryesore të së cilës nuk të jepte të kuptoje se banesa ishte shumë e vjetër dhe në të mund të fshiheshin vlera të larta artistike. Dhe kjo e ka shpjegimin e saj.

Kjo banesë, sipas disa të dhënave gojore, u ndërtua rreth viteve 1810-1820 nga i biri i Andrea Shirokës, Anton Shiroka, i lindur në Shkodër në vitin 1781. Duke qënë shumë vëllezër dhe kurorat rriteshin nga viti në vit dhe duke mos patur mundësi të përballonin këtë rritje në mjediset e banimit ekzistues, Antoni u nda nga i ati dhe e ndërtoi këtë shtëpi për të cilën po flasim. Por shpejt vendosi ta shiste. Shitja u bë me konditë që dhoma e zbukuruar të mos prekej nga blerësit që kërkonin të bënin meremetime.

Në të vërtetë nuk kaluan shumë kohë dhe pronarët e rinj rrënuan shtëpinë e vjetër, mbi themelet e së cilës ngritën një shtëpi të re të punuar nga usta Dana, ndërsa sipas fjalës së dhënë dhomën e zbukuruar nuk e prekën, ajo mbeti në gjendjen fillestare dhe ruajti të pa prekur trajtimin origjinal të brendisë.

Nga studimet e bëra në vend rezulton se tymtari i përket një kohe relativisht më të vonë se vitet 1810-1820 dhe konkretisht mesit të shekullit XIX. Këtë e faktojnë edhe të dhënat gojore që bëjnë të ditur se banesa pësoi mjaft dëmtime nga tërmeti i fuqishëm i vitit 1855, pra del si konkluzion që tymtari u ndërtua pas këtij viti, por datimi i saktë sot për sot ka mbetur i panjohur. Ai, është vepër e Mehmet Metanit të mbiquajtur «usta Meta» një ndër mjeshtrit



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY

më me zë që shquhej për stukrelief të oxhaqeve e të tavaneve.[1]

Ky tymtar si element dekorativ i zbukurimores së dhomës karakteristike shkodrane të shekujve XVIII--XIX të quajtur «oda e miqve», lidhet me mikpritjen të cilën shqiptari e ruajti në shekuj. Këto dhoma janë trajtuar me tërë kujdesin si në zgjidhjen e trajtimin e motiveve në dru (tavan, trapazan, sergjen, rafte murore etj). ashtu edhe në plastikën e tymtarit, në përputhje me gjendjen ekonomike të pronarit të banesës.

Këto motive janë kryesisht lulëzore që trupëzohen artistikisht si në lëndën e drurit ashtu edhe në allçi. Tymtari kishte në vetvehte dy funksione, ishte element dekorativ e zbukurues, por kishte edhe vlerë praktike e përdoruese. Në të nuk ndizej zjarr, ai shërbente për kalimin e tymrave e gazrave helmuese të qymyreve që në atë kohë, në Shkodër, përdoreshin shumë. Këtë e vërteton edhe një dritare e vogël e hapur brenda tymtarit, pak lart vatrës që shikon jashtë e cila shërbente për futjen brenda të ajrit të pastër dhe shtytjen e gazrave.

Tymtari në fjalë është me volum gjysmë prizmatik me shtatë pano të zbukuruara me bisqe të drejta. Foto 2. Ai paraqitet i shkallëzuar me një ballor të dytë, i cili përfshin edhe ai shtatë faqe të zbukuruara gjithashtu me bisqe. Foto 3. Tymtari mbështetet në mur me dy këmbëza të valëzuara.

Çvendosja, mbartja dhe rivendosja e tymtarit në ekspozitë u muar përsipër nga sektori i artit, i Ateljesë së Shkodrës, e cila krijoi menjëherë grupin e punës që përbëhej nga skulptori, një specialist murator dhe dy punëtorë. Në fillim u krye dokumentacioni i nevojshëm grafik dhe fotografik, u vrojtua për të nxjerrë në pah dëmtimin e tymtarit në përgjithësi; shkaqet e dëmtimit, pjesët e dëmtuara dhe ato që mungonin, si dhe u bë analiza e allçisë. Zmontimi dhe rivendosja e tij në ekspozitë shtronte probleme dhe detyra që kërkonin zgjidhje të shpejtë, pasi dhe koha nuk priste. Gjatë zmontimit të tymtarit u përpoqëm që ai të zbërthehej duke pasur parasysh edhe mbërthimin pjesë-pjesë të bërë nga vetë autori. Gjatë zmontimit u vu re se tymtari paraqitej mjaft i dëmtuar sidomos në pjesët që lidheshin drejt me patinaturën e murit të realizuar me gëlqere dhe me pambuk, si dhe të zbukuruar me gjurmë zymbylash në relief të thelluar. Vështirësi paraqiste sidomos çmontimi i rozetave anësore, që ishin mjaft të dobësuara jo vetëm nga punimi i hollë i tyre por edhe nga dëmtimi për shkak të pranisë së lagështirës. Vlen të theksohet konstruksioni mjaft i thjeshtë, por shumë i fortë i këtij tymtari, i cili përballoi me sukses dy tërmetet e forta të vitit 1905 dhe të 15 Prillit 1979. Ballori mbështetës lidhej me murin në të dy anët me nga katër gozhda kovaçi, Foto 4 pastaj me copa tjegullash me llaç e allçi, të cilat krijonin konstruksion të fortë.

Pas çmontimit pjesët u vendosën me kujdes në

1. F. Shkupi, **Dekoracioni i arkitekturës popullore në qytetin e Shkodrës,** «Monumentet» 1976, nr. 12, f. 202

tokë sipas radhës së tyre, kurse copat që ishin thyer u ngjitën përkohësisht me një armaturë të vogël teli dhe allçie. Kur pastrohej tymtari nga shtresat e gëlqeres bashkë me këto shtresa binte dhe allçia së bashku me telin. Kjo mënyrë na dha rezultate të kënaqshme pasi u ruajtën të gjitha copat e vogla, gjithashtu u vendosën nëpër vendet e tyre pa u ngatërruar me njera tjetrën, për vetë kompozimin simetrik të tymtarit. Me përfundimin e zmontimit u fotografua dhe u analizua vendvendosja e tij. Pjesët u çuan në sallën e ekspozitës ku do të rivendosej tymtari sipas shënimit të pjesëve të hequra gjatë zmontimit. Pasi u sollën të gjitha pjesët e tymtarit, u piketua vendi dhe u hartua plani i rivendosjes së tij. U hap suvaja dhe u vendosën hekurat ku do të kapej armatura e ballorit, e cila ish përgatitur që më përpara. Ajo përbëhej prej hekurash vertikale dhe horizontale, që krijonin një rrjetë, e cila iu vesh ballorit nga brenda duke e lidhur me allçi. Në këtë mënyrë pjesët e thyera të ballorit u lidhën përfundimisht. Pas forcimit, ballori u vendos në vendin e tij, dhe hekurat horizontalë të lënë pak jashtë u lidhën me hekurat e vendosur në mur. Vendet e hapura të suvasë dhe lidhjet e hekurave u mbyllën me allçi. Ballori mbështetës ruan në pjesën përpara një motiv gjethesh si flakë. Foto 5. Në pjesën e sipërme ruan spreth të azhuruar me drethka. Sprethi mban mbi krye shtatë bedena të dhëmbëzuara prej gjethesh lisi. Ne i gjetëm mjaft të dëmtuara madje vetëm njera prej tyre ishte e plotë. Foto 6. Gjithashtu mjaft të dëmtuara qenë dhe dy nga faqet e zbukuruara të ballorit të dytë. Montimi i këtij ballori na nxori mjaft punë, pasi gjurmët e tij mbi spreth nuk lexoheshin se edhe vetë sprethi u nda në pjesë gjatë çmontimit. Në krye u vendos shatorja me një tufëz gjethesh mbi të cilat qëndron një topth. Foto 6. Në të dy anët e shatores mbi sipërfaqen e kurorës pesëllapëshe dukeshin motive gjethesh të vazhduara. Në të dy anët e kurorës, u vendosën dy rozetat ku shihen dy motive helike bashkëqendrore me gjethe që zhvillohen në drejtim rrethor por me kahe të kundërta, të cilat bashkohen në qendër ku është plazmuar një lule katërpetalëshe. Foto 6. Përpara vendosjes së rozetave iu vesh, si sfond, kartaspanjë (fletë e hollë bronxi) e cila nxjerr në pah më mirë motivet që mendohet se janë modeluar me dorë. Këto rozeta i rrethon një kordon si litar ku zhvillohen gjethëza trefletëshe të cilat e rrethojnë duke rrëshqitur mbarë tymtarin dhe lidhen me dy gjysmë shtyllëzat, të cilat janë të përshkuara nga dy thellime si litartha, që përfundojnë me dredhëse të zhvilluara në të dy krahët. Sipër dy gjysmë shtyllëzat mbajnë një tufëz gjethesh mbi të cilën pushon një topth. Foto 6. Në hapësirën midis rozetave dhe topthave janë plazmuar dy fletë të



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

gjera si shqiponja njera prej të cilave ishte pak e dëmtuar. Ajo u modelua me dorë ashtu si dhe mjaft pjesë të tjera të tymtarit që ishin shpërbërë ose që mungonin fare. Kështu p.sh. u bënë pothuaj krejt të reja kurora e bedenave të dhëmbëzuar, dy gjysmë shtyllëzat së bashku me topthat dhe një numër i madh gjethëzash trefletëshe.

Pas përfundimit të rivendosjes i cili zgjati rreth tri javë filloi faza tjetër e restaurimit, që u përqëndrua në pastrimin e tymtarit nga shtresa e gëlqeres të lyera gjatë kohës, plotësimin e pjesëve që mungonin ose ishin të shpërbëra dhe përforcimin e tymtarit. Ky ishte mbuluar i gjithë me disa shtresa gëlqereje shumë ngjyrëshe që ishin mjaft të qëndrueshme. Dalluam 6 deri 8 shtresa, të cilat gjatë pastrimit u ndanë në dy pjesë. Pjesa e parë që përfaqësonte shtresën e jashtme (2-3 mm) paraqiste më pak vështirësi për pastrim se sa shtresa e brendshme (1-2 mm), e cila lidhej me allçinë. Ajo në disa vende gjendej e fortë e në disa të tjera e shpërbërë, në formë mielli, si rezultat i pranisë së vazhdueshme të lagështirës. Pastrimi i tymtarit nga shtresat e gëlqeres kërkonte kujdes të veçantë. Pas pastrimit të krejt tymtarit u bënë stukimet në plasaritjet që dolën si edhe u krye përforcimi në vendet e dëmtuara dhe të dobësuara.

Duke i qëndruar besnik vendit nga u muarr edhe këtu në të dy anët e tymtarit u hapën kamare harkore, kurse faqja e murit ku u vendos tymtari u vesh me patinaturë të realizuar me granil (pluhur guri) e gëlqere e stazhionuar. Anës kamareve dhe këndeve të mureve u vendosën gjurmë zymbylash Foto 7, të realizuara me një formë të derdhur me përzierje plumbi dhe kallai. Vatra u punua prej katër pllakash tulle malteze (40 x 40), të cilat u gdhendën dhe u zbukuruan me një motiv të thjeshtë. Foto 7. Tymtari u ngjyros në të bardhë, që të evidentoheshin më mirë motivet, ndërsa faqja e murit u lye me një nuancë gri në të kaltërt. Foto 8. Pas përfundimit të krejt punimeve të cilat zgjatën rreth një muaj e gjysëm, u krye në vend dokumentacioni i plotë përfundimtar.

DO NOT COPY

Abdulla BIRAÇİ

DO NOT COPY

PROBLEMES ET ASPECTS DU DEPLACEMENT, DE L'INSTALLATION ET DE LA RESTAURATION D'UNE CHEMINEE

RESUME

La cheminée en question, en tant que élément décoratif de la décoration de la chambre caractéristique de Shkodra, appelée aux XVIIIe et XIXe siècles «chambre d'amis», se rattache à l'hospitalité que l'albanais conserva au cours des siècles.

Ces chambres sont traitées avec beaucoup de soin aussi bien en ce qui concerne la solution que le traitement, les motifs en bois (plafond, trapazan, dressoir, placard etc.) l'art plastique de la cheminée en conformité avec la situation économique du propriétaire de l'habitation.

Ces motifs sont essentiellement de fleurs et font corps artistiquement avec la matière en bois ainsi qu'avec celle en plâtre. La cheminée remplissait en elle-même deux fonctions, elle était décorative et en même temps avait une couleur pratique et d'usage. On n'y allumait pas de feu mais elle servait de passage aux fumées et aux gaz toxiques des charbons beaucoup utilisés en ce temps-la, à Shkodër. Cela est attesté même pour une petite fenêtre aménagée à l'intérieur de la cheminée un peu au-dessus du foyer, laquelle donnait sur la partie extérieure et servait à introduire dedans l'air pur et à passer les gaz.

La cheminée en question est de volume demiprismatique avec sept pans ornés de petits rameaux droits. Elle se présente échelonnée d'une seconde partie frontale, laquelle comprend elle aussi sept pans ornés aussi de petits rameaux. La cheminée s'apppuie contre le mur au moyen de deux pieds ondulés.

Le déplacement, le transport et l'installation de la cheminée dans l'exposition furent faits par le secteur d'art de l'atelier de Shkodra.

Tout d'abord, on a préparé la documentation graphique et photographique requise et l'on a fait l'analyse du plâtre. Pendant le démontage de la cheminée on a essayé de la démonter en tenant en considération même le montage effectué pièce par pièce par l'auteur même. Durant le démontage on s'est aperçu que la cheminée était très endommagée surtout dans les parties liées directement au crépi du mur préparé d'une mixture de chaux et de coton et ornés de traces de jacinthe en relief. Il faut souligner la construction assez simple mais forte qui a fait face aux puissants tremblements de terre des années 1905 et du 15 avril 1979.

Après le démontage, les pièces furent soigneusement rangées sur terre selon leur ordre, tandis que les parties cassées furent collées provisoirement au moyen d'une petite armature de fils et de plâtre. Après avoir apporté toutes les parties de la cheminée, on a piqueté l'endroit et l'on a établi le plan d'installation. On a troué le crépi et planté les fers où s'attacherait l'armature de la partie frontale qui était d'avance. La partie frontale d'appui conserve sur sa face un motif de feuilles comme une flamme.

Après l'achèvement de l'installation qui dura trois semaines environ, commença la phase de la restauration concentrée sur le nettoyage de la cheminée des couches de chaux appliquées le long des années, le complètement des parties manquantes ou démantelées et le renforcement de la cheminée. Après l'achèvement de tous les travaux qui durèrent un mois et demi environ, on a établi la documentation finale complète.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KRONIKA E PUNIMEVE RESTAURUESE PËR VITET 1980-1981

THEATRI I BYLISIT

Vitet e fundit Bërthama Arkeologjike e rrethit të Fierit kreu gërmime në theatrin e Bylisit (Hekal të Mallakastrës). Nga gërmimet doli se shkallaret e teatrit janë të gdhendura në shkëmbin e kodrës dhe kanë qënë të veshura me blloqe të punuar. Gërmimet kanë nxjerrë disa nga fronat e radhës së parë të shkallares. Së bashku me to kanë dalë edhe fragmente arkitekture, kolona, kapitele, korniza etj. Po kështu në të dy krahët e teatrit u zbuluan hyrjet dhe muret ballorë të shkallares. Në pjesën më të madhe blloqet e mureve ishin të rrëzuar, ndërsa ata që ishin në mur kishin lëvizur duke e prishur drejtimin e tij.

Gërmimet arkeologjike u kombinuan me punimet e restaurimit. Para se të lëvizeshin, blloqeve të rrëzuara u gjendej vendi që kanë patur në mur duke u vendosur në të përkohësisht. Në këtë mënyrë nuk pengoheshin gërmimet e mëtejshme.

Mbas gërmimit të plotë u pa se themeli nuk e ruante drejtimin fillestar. Blloqet e vendosura përkohësisht u hoqën nga muri, u drejtuan ato të radhës së parë duke i vendosur në vendin fillestar, pastaj në bazë të skicës dhe numrave të vendosur në secilin bllok u ngrit muri, në atë masë që lejonte materiali i gjetur.

Në murin e terracimit të hyrjes veriore u vunë re gjurmë që tregonin se ky mur mund të ishte i rindërtuar. Ky mur nuk lidhet me murin ballor të shkallares, por mbështetet në kontrafortin e tij. Gjatë zbërthimit, në brendësi të kontrafortit u vu re se në të ishte vendosur një bllok i punuar mirë në ndryshim me të tjerët, gjë që dëshmon se ai është i ripërdorur. Në hyrjen jugore muri i terracimit është më i ulët. Po në këtë anë aty ku muret e teatrit bashkohen me muret e rrethimit të qytetit, gërmimet nxorën një grumbull blloqesh të rrëzuara që i takonin një trakti ballor të murit të terracimit, të teatrit. Blloqet e rrëzuara u pastruan me kujdes nga dherat dhe u zbulua bazamenti i murit, të cilit i takonin këto blloqe. Blloqet u vendosën në vendet e tyre, në tre katër radhë lartësi. Gjatësia e tij nuk i kalon 5-6 m, mbasi në pjesën veriore doli një furrë gëlqereje, ndërtimi i së cilës kishte dëmtuar themelin dhe blloqet e murit të rrëzuar. Në këtë furrë janë kthyer në gëlqere, përveç blloqeve të murit, edhe shumë pjesë arkitektonike të teatrit. Furra është ndërtuar në antikitetin e vonë, atëhere kur doli nevoja e ndërtimit të një muri të ri rrethues të lidhur me llaç. Në vendet ku u kryen këto punime u vu re se blloqet e radhës së parë mbështeten në tokë dhe faqet e tyre janë të punuara si ato të radhëve të sipërme.

Punime restaurimi u kryen edhe në murin që mendohet të jetë i agorasë së qytetit. Në mozaikët e kishës paleokristiane, që duhet të jetë vendosur mbi mbeturinat e një tempulli të periudhës antike, u kryen punime konsolidimi. Forcimet me llaç u bënë në vendet e dëmtuara në një masë të vogël duke menduar që në një të ardhme të afërt në to të kryhen punime të plota restaurimi. Kombinimi i gërmimeve arkeologjike në monumentet e arkitekturës antike me punimet e konsolidimit dhe restaurimit tregoi se kjo është një praktikë që duhet forcuar më tej.

L. Papajani

MUR TARRACIMI NË DIMAL

Nga gërmimet e përparshme arkeologjike një pjesë e murit të tarracimit, me gjatësi 10-13 m doli e mënjanuar jashtë. Me kalimin e kohës, nën presionin e dheut, mënjanimi shkoi duke u zmadhuar, aq sa u rrezikua shembja e kësaj pjese të murit.

Shembja do të paraqiste vështirësi për restaurimin, mbasi anët e gurëve, rrasa të mëdha deri 1,3 x 0.13 – 0.25 m nuk korrespondonin me njëri tjetrin dhe fugat qenë të theksuara. Për të mënjanuar rrezikun e dëmtimit të tij, ishte e nevojshme ndërhyrja.

Pasi u krye skicimi dhe gurëve iu ven-

dosën numra, muri u zbërthye dhe gurët u rivendosën në vendin e parë.

Përveç kësaj, punime konsolidimi u kryen edhe në pjesë të tjera të këtij muri. Njëkohësisht u pastruan monumentet e tjerë të zbuluar nga gërmimet arkeologjike.

L. Papajani

TERMAT E STACIONIT AD QUINTUM (BRADASHESH-ELBASAN)

Në Shkurt-Mars të vitit 1980 në termat dhe nymfeun e stacionit Ad Quintum të rrugës Egnatia u kryen punime me karakter pastrimi, konsolidimi dhe restaurimi. Ndër to u ndërtua harku i portës që lidh ambientin e zhveshjes me ambientin e ngrohtë, në shpatullat e së cilës ruheshin gjurmë të thembrës. Muri ekzistues së bashku me harkun dhe pjesët e mureve që u plotësuan shërbejnë dhe si kontrafort për murin që i mbështetet kodrës, i cili nga presioni i dheut dhe lëvizjet e tërmeteve ka pësuar një çarje horizontale në brezin e tullave.

Për ndërtimin e tij u përdorën tulla të reja, të të njëjtit format me origjinalet të lidhura me llaç bastard. Për të marrë ngjyrën e llaçit të vjetër, fugat e llaçit u pudrosën në gjendje të njomë me pluhur të llaçit ekzistues. Në të dy krahët e harkut boshllëku u plotësua me muraturë. Në pjesë të tjera ku muri kishte pësuar dëmtime, ato u konsoliduan me materialet e vetë murit.

L. Papajani

MURET RRETHUES TË BERATIT

Gjatë kësaj periudhe punimet u përqëndruan kryesisht në zonën e kështjellës. Gjatë tyre u arrit pastrimi përfundimtar nga hedhurinat dhe zbulimi i elementeve arkitektonike, të shek. XVI-XVIII. Ju përmbajtëm këtij niveli pasi shtresat më të thella siç e kanë treguar gërmimet arkeologjike, ndonse janë të pasura me material arkeologjik janë të mangëta lidhur me gjurmët arkitektonike, të dëmtuara e të prishura në dobi të ndërtimeve më të mëvonëshme. Sidoqë të jetë kjo është një etapë ndërmjetëse që nuk e shmang gjurmën e vlerave më të hershme në këtë pjesë. Strukturat e ndërtimeve të zbuluara, kryesisht të mbuluara me qemer, pjesa e sipërme e të cilëve shërbente dhe si shteg kalimi u konsoliduan me llaç bastard duke i shtuar vetëm 1-2 radhë gurë pjesëve të rrëzuara. Lidhur me qemeret u plotësua vetëm pjesa ngjitur me muret, në një gjerësi 0.70 m, e cila ruhej dhe më mirë dhe lejon kalimin afër murit. Tabani i kështjellës u nivelua dhe u rrafshua duke iu përmbajtur pikërisht nivelit të shek. XVIII. Gjatë këtyre punimeve doli në dritë dhe një shtesë e fortifikimit të III dhe porta e tij me vend-rojet. Në këtë mënyrë kjo zonë përpara e rrënuar me grumbuj gurësh e bimësi të pa kriter, sot është e vizitueshme.

Njëkohësisht gjatë vitit 1981 nisi dhe pastrimi i anës së jashtme lindore të kështjellës, që rizbuloi muret dhe vlerat e kësaj ane të kështjellës.

Në vitin 1981 filloi dhe restaurimi i murit jugor të kalasë. Në pjesën e sipërme të këtij muri gjoksmbroja e dhëmbëzuar dhe shtegu i kalimit qenë mbushur në një kohë të vonë, rreth fillimit të shekullit tonë, me muraturë duke e humbur pamjen origjinare. Për ta shmangur këtë dhe për të risjellë pamjen e parë muret u çliruan nga mbushjet e vona. Në ato pak vende ku mungonte gjoksmbroja ajo u plotësua sipas pjesës ekzistuese.

A. Baçe

MOZAIKU I ELBASANIT

Punimet në mozaikun e Elbasanit ishin vazhdim i punimeve të vitit 1979. Mozaiku i takon shekullit të VI të e.s. dhe i përket dyshemesë së nefit qendror të një bazilike paleokristiane. Kompozimi ka një zgjidhje të pa përsëritur të paktën në mozaikët e zbuluar deri tani në vendin tonë. Dyshemenë e ndan në katër sektorë një koridor në formë kryqi me pllaka kuadratike.

Kompozimi me mozaik i njerit nga katër sektorët, sektorit D, u zhvendos në vitin 1979 me prerje në fragmente përafërsisht 1 x 1 m gjithmonë duke shoqëruar formën e motivit, pa e dëmtuar kompozimin në përgjithësi. Rivendosja e tij u realizua në vitin 1980. Rivënia e tij ndoqi metodën e aplikuar si në tre sektorët e tjerë.

Panelat mbajtëse të vetë kompozimit u derdhën në një trashësi prej 5 cm. Struktura e tyre përbëhet prej dy shtresash. E para (2 cm) nga harasani që mban dhe ekspozon kompozimin, me veti që të mbaj teselën, por njëkohësisht edhe ta lirojë atë po ta dojë nevoja (gjithmonë pa dëmtuar teselën). Harasani i përdorur përmban granil, pluhur tjegulle, gëlqere dhe pak çimento të bardhë. Shtresa e dytë (3 cm) është beton arme me rrjetë metalike e cila lejon transferimin e mozaikut nga një vend në tjetrin. Duke u nisur nga parimi për të ruajtur sa më shumë elemente, përveç shtresës së parë të mozaikut, që u gjet e degraduar, nënshtresat e tjera u ruajtën plotësisht.

EKSPEDITTA E MESAPLIKUT

Kërkesa për një mozaik të periudhës së vonë antike në Muzeun Kombëtar si dhe vendndodhja e tij në një zonë të largët në malësi të Vlorës, qenë faktorët që vendosën për zhvendosjen pikërisht të këtij mozaiku. Ai i përket një bazilike paleokristiane të shek. VI të e.s. me përmasa të mëdha. Të gjitha ambientet e saj janë të shtruara me mozaikë (rreth 80 m2). Të dy aniatat anësore ruajnë një shtrojë me mozaik në gjëndje të mirë, kurse naosi dhe altari i ka të dëmtuar rëndë sidomos në qendër të dyshemesë.

Muret e bazilikës u gjetën pothuajse të rrafshuara me përjashtim të absidës dhe dy fragmente muri në dyert e ikonostasit.

Puna filloi me konsolidimin e tërë sipërfaqes me mozaik. Në zona të tëra teselat ishin shkëputur nga tabani, të gufmuara gati në shkatërrim. Së pari u rregulluan teselat duke u gjetur vendin e

DO NOT COPY

DO NOT COPY

tyre gjithmonë pa humbur karakterin kompozicional dhe vizatimin e figurës.

Krahas punës për konsolidimin e veprës u bë rilevimi i tij i plotë dhe i saktë në shkallën 1:5 Çvendosja e tij u bë në fragmente me dimensione përafërsisht 1 x 1 m. Për këtë, u shfrytëzua zgjidhja kompozicionale e veprës. Të dyja aniatat që janë edhe më të ruajtura ndihmuan për shkuljen me këtë metodë. Në qendër të kompozimit të tyre në një sfond të qartë vizatohet rozeta, katrori si dhe forma e trapezit ku ndërthurret motivi gjeometrik, me figurat zoomorfe dhe antropomorfe. Të tërë kompozimin e mbështjell rreth e qark një gërshet me trashësi rreth 1 metër.

Ndarja e tyre në fragmente u bë në këtë mënyrë: Rozetat u ndanë më vete, trapezat më vete, gërsheti rrethues më vete. Kjo ndarje ishte zgjidhja më e mirë. Mbas çvendosjes vazhdoi procesi i pastrimit të anës së prapme të mozaikut nga harasani i degraduar. Të gjitha fragmentet u amballazhuan me kujdes në arka dërrase me faqe kartoni të butë të valëzuar.

O. Curri

MIRËMBAJTJE OBJEKTESH KULTI

Në kishën e manastirit të Shën Mërisë në Kameno të Delvinës u krye revizionimi i mbulesës së çatisë. U zëvendësuan rrasat e thyera të gurit në çatinë e saj si dhe u kompozua në gjithë linjën e saj korniza me rrasa guri e strehës së çatisë e dëmtuar vende vende. Në bazilikën e Shëne Premtes në Selckë (Gjirokastër) u kryen punime në revizionimin e mbulesës me rrasa guri të çatisë. Në kishën e Shën Mërisë në Peshkopi të Sipërme (Gjirokastër), kishë e rëndësishme e periudhës bizantine, u kryen punime në revizionimin e mbulesës me rrasa të çatisë si dhe punime pastrimi.

Në kishën e manastirit të Shpërfytyrimit në Mingul (Gjirokastër) u kryen punime konsolidimi në konstruksionin e drunjtë të çatisë së narteksit si dhe u revizionua mbulesa me rrasa e korpusit qendror të kishës. Në Katedralen e Mitropolisë – Gjirokastër, e cila është menduar të kthehet në muze ikonash për rrethin, punimet filluan në fundin e vitit 1981 për të përfunduar gjatë vitit 1982. Gjatë vitit 1981 u kryen punime në revizionimin e mbulesës me rrasa të çatisë, në riparimin e dyshemesë me rrasa guri, në riparimin e suvasë në brendësi, në zëvendësimin e dritareve të kalbura etj.

Në bazilikën e Shën Mërisë në Zervat, e cila ruan faza ndërtimi të periudhës bizantine, u kryen punime në zëvendësimin e mjaft rrasave të dëmtuara në mbulesë.

Veç këtyre nga ana e Degës së Gjirokastrës u kryen dhe punime të tjera në kishat e Pecës, Shën Anës Dervican dhe në Kardhikaq ku u riparuan dyert, u kryen punime revizionimi në çati etj.

Në bazilikën tre nefshe të Shën Mëhillit (Vithkuq) me pikturë murale, u kryen punime konsolidimi nga Ateljeja e Korçës në kupolat e çatisë ku u injektuan me beton nga sipër çarjet e ndryshme. Pas kësaj u restaurua qemeri cilindrik që i mbulon këto kupola, i cili është dëmtuar vende vende. Në fund mbi patavra druri u vendos shtresa me rrasa e mbulesës së çatisë.

Po nga kjo Atelje në kishën e Shën Kollit e Shën Thanasit në Voskopojë u riparuan muret e avllisë, u mbushën zgavrat në muret e hajateve, u zëvendësuan rrasat e thyera të çative etj.

Ura e Mirakës. Në këtë urë të ndërtuar në vitin 1715 u kryen punime sistemimi e mbrojtjeje. Në bregun e djathtë për mbrojtjen nga gërryerja u ndërtua një mur guri mbrojtës me brez betoni sipër, i cili lidhet me murin e urës, në skajin e djathtë. Po në këtë anë ku terreni i bregut ishte i ulët e gjatë prurjeve të mëdha të Shkumbinit ura shkëputej shpesh nga bregu se uji kalonte mbi urë, u rrit parapeti me mur guri. Boshllëku ndërmjet dy parapeteve u mbush me zhavorr duke e rritur kështu nivelin e kalldrëmit. Rrjedhimisht kjo pjesë nuk përmbytet më duke siguruar kështu mos shkëputjen e urës nga bregu gjatë prurjeve të mëdha të lumit.

Ura e Glinës. Ura gjendet mbi lumin Kseropotamos buzë rrugës nacionale Gjirokastër-Jergucat, sapo kthen rruga për në Glinë. Në këtë urë u plotësuan disa pjesë të dëmtuara të kalldrëmit, me gurë pllakë me trashësi 10-15 cm të vendosur këllëç.

V. Shtylla

AFRESKET E KISHËN SË SHËN KOLLIT NË MANASTIRIN E ARDENICËS.

Në muajin Shtator të vitit 1980 sektori i artit i Institutit të Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me studentët e Institutit të Lartë të Arteve, kryen disa punime konservuese-restauruese në kishën e Shën Kollit në manastirin e Ardenicës. Kishës iu bë fillimisht dokumentacioni grafik i pikturës në shkallën 1:10 si dhe ai përshkrimor. Fillimisht në faqen perëndimore u bë heqja e merleve të vjetra me ujë të ngrohtë. U përforcuan borduret e afreskeve me llaç. Në faqen lindore dhe në atë jugore u bënë injektime të xhepave të afreskut me kazeat gëlqereje. Faqja perëndimore dhe ajo jugore u pastrua me ujë dhe amoniak.

A. Devolli

AFRESKET E KISHËS SË SHËN KOLLIT NË FSHATIN KOZARË TË (BERATIT).

Punimet në Maj të vitit 1980 u përqëndruan në faqen lindore dhe në atë jugore, të cilat paraqiteshin më të dëmtuara si pasojë e një tërmeti. Fillimisht u krye qepja e murit jugor i cili ishte çarë gjatë gjithë gjerësisë, në mes të lartësisë së tij, pastaj u përforcuan borduret e afreskut me llaç sidomos në faqen lindore, që paraqitej tepër e dëmtuar. Në zona të ndryshme të faqes lindore u bënë injektime të xhepave të afreskut me kazeat gëlqereje.

A. Devolli

AFRESKET E KISHËS SË SHËN TODRIT NË FSHATIN KADIPASHAJ (LUSHNJË).

Si pasojë e kullimit të ujërave piktura paraqitet e dëmtuar nga lagështia kapilare. Prej lagështisë së madhe, në pjesën

DO NOT COPY

më të madhe afresku ka rënë dhe në faqen lindore dhe anën perëndimore arriçio e tija është dobësuar shumë. Për këtë arsye fillimisht u hap një drenazhim rreth e qark monumentit.

Për të parandaluar dëmtimet e mëtejshme në të u ndërmorrën një varg punimesh konservuese. Pas dokumentacionit grafik në shkallën 1:20 u krye përforcimi i bordurave të afreskut me llaç. Në faqen lindore dhe në atë perëndimore u bënë injektime me kazeat gëlqereje.

A. Devolli

IKONA.

Gjatë vitit 1981 u kryen punime në 10 ikona.

Fillimisht u bë dokumentacioni përshkrimor dhe ai fotografik. Më tej u bë dizinfektimi i tyre me sulfur karboni, në laboratorin kimik dhe u përcaktua në mënyrë laboratorike struktura e grundit. Në pjesët ku grundi së bashku me pelikulin e ngjyrës ishte shkëputur nga sipërfaqja e drunjtë e panelit duke krijuar xhepa, u bë injektimi i tyre me xhelatinë, duke i presuar me letër higjenike. Për të krijuar unitet në kompozimin e ikonës në vendet ku grundi mungon u bë plotësimi i tij me kretë dhe xhelatinë.

Për heqjen e vernikut të vjetër dhe të oksiduar u përdorën sipas rastit solucione të ndryshme, si dimitid fermamid dhe amil açetat, aceton, alkool dhe terpentinë etj.

Në vendet e plombuara me kretë dhe xhelatinë u bë intergrimi i pikturës.

A. Devolli

AFRESKAT E KISHËS SË SHËN MËHILLIT – VITHKUQ.

Punimet u kryen në dy etapa në Korrik të vitit 1980 dhe Korrik-Gusht të vitit 1981. Punimet u përqëndruan kryesisht në kupolat e nefit jugor dhe verior të cilat paraqiteshin shumë të dëmtuara si pasojë e tërmetit. Në fillim u bë qeoja dhe mbushja e kupolave nga sipër. Pastaj u krye heqja e merleve me ujë të ngrohtë si dhe e pajantimeve me kompensato të cilat kanë qënë vënë para shumë vitesh. Më tej punimet u përqëndruan në konsolidimin e afreskave duke përforcuar bordurat e tyre me llaç special dhe duke injektuar me kazeat gëlqereje. Pas injektimit u bënë pajantime me kompensato dhe pambuk në mënyrë që kazeati të mos ushtronte peshë nga sipër. Të tilla punime u kryen edhe në nefin qendror, në faqen lindore, jugore, perëndimore, veriore si dhe në faqen lindore të narteksit dhe hajat.

M. Arapi

TAVANI I TEQES HELVETIVE – BERAT.

Në Shtator të vitit 1981 së bashku me studentët e Institutit të Lartë të Arteve u organizua nga sektori i artit një ekspeditë, mbi punimet në tavanin e teqes Helvative. Detyra dhe puna jonë ishte që të konsolidonim shtresën pikturale e vendosur në dërrasa që formojnë tavanin. Ngjyra dhe petat e arta ishin shkëputur nga baza duke u plasur, çarë dhe përdredhur.

Së pari u bë dokumentacioni grafik i gjithë tavanit në shkallën 1:20 ku u pasqyruan të gjitha dëmtimet që ka pësuar dërrasa, grundi dhe ngjyra. Pastaj u bë dokumentacioni fotografik me ngjyra dhe bardhë e zi. Ai u krye edhe për elemente të veçantë të arkitekturës. U pastrua nga sipër i gjithë tavani nga pluhurat e shumtë, dhe pas kësaj u kalua në disinfektimin e tij të përgjithshëm duke përfshirë edhe skeletin mbajtës dhe konstruktiv të tij. U konsolidua në dorën e parë gjithë shtresa e ngjyrës duke përjashtuar vetëm rozetën qëndrore, shumë të dëmtuar. Në anën perëndimore filloi konsolidimi i thellë që konsiston në shtrirjen e pelikulit të përdredhur dhe të copave të arta, edhe këto të përdredhura. Kështu u arrit që të konsolidohet një pjesë e anës perëndimore të tavanit. Puna në këtë objekt është disa vjeçare dhe do vazhdojë në të ardhmen.

E. Sopi

PIKTURA MURALE E KISHËS SË MALIGRADIT (KORÇË).

Në Maj deri në Qershor të vitit 1981 u punua për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale në Maligrad. Ekspedita e organizuar nga Sektori i artit kishte në përbërjen e saj edhe një grup studentësh të Institutit të Lartë të Arteve. Në këtë monument punimet kanë nisur që më parë. Puna konsistoi në pastrimin e pikturës murale dhe në fiksimin e saj. Kështu u pastrua e gjithë faqja e jashtme nga papastërtitë, pluhurat dhe nxirjet. Punime pastrimi u kryen edhe brenda kishës. Në faqen perëndimore u pastrua e gjithë skena e «fjetjes së Shën Mërisë», në faqen lindore e gjithë absida dhe dy faqet anësore të saj, deri në nivelin e frontonit si dhe skena e «hyrjes së Krishtit në Jerusalem». Të gjithë këto sipërfaqe dhe disa zona të vogla u fiksuan.

Njëkohësisht u bë i gjithë dokumentacioni fotografik dhe grafik në shkallë 1:10 ku u shënuan të gjitha sëmundjet dhe dëmtimet që ka pësuar piktura murale dhe të gjitha ndërhyrjet tona.

E. Sopi

BANESA E LUIGJ GURAKUQIT NË SHKODËR

Kjo banesë ruhet për vlerat e dyfishta arkitektonike-historike. Ajo i përket tipit të njohur të banesës me çardak. Në gjendjen e sotme monumenti vjen i cunguar në pjesën veriore por pjesa që ruhet ruan mirë skemën planimetrike origjinale Vlera të rëndësishme ruajnë çardaku, me dy qoshqe, si dhe oda e miqve me ornamentikë të pasur.

Gjendja teknike e monumentit nuk paraqitej mirë, veçanërisht e paqëndrueshme ishte gjendja statike e konstruksionit të çatisë, ndërsa oda e miqve, kishte ulje të theksuara të cilat kishin shkaktuar deformacione të tavanit dhe kompleksit musandër-trapazan. Punimet e restaurimit së pari u përqëndruan në restaurimin e konstruksionit të çatisë. Gjatë kësaj pune u tregua veçanërisht kujdes në ruajtjen e strukturës origjinale në pjesën e çatisë

DO NOT COPY

mbi çardak. Strehët dyfishe në shumicën e tyre ishin shkurtuar. Simbas gjurmëve origjinale ato u rindërtuan plotësisht. Tavani i odës së miqve i llojit me kazan, është i ndërtuar pjesërisht me dru dhe pjesërisht me suva. Për të rivendosur atë në nivelin horizontal u bë me kujdes ngritje e tavanit gjatë këtij operacioni, disa suvatime u dëmtuan, kështu që u desh të bëhej rindërtimi i pjesshëm, apo riparimi i tyre. Gjithashtu u bë edhe nivelimi i kompleksit musandër-trapazan. Tamburi i oxhakut u pastrua mekanikisht nga shtresat e shumta të gëlqeres, ndërsa elementet e drurit të lyer me bojë vaji u pastruan dhe u lyen me vaj lini.

Sh. Prifti

BANESA E MUZEUT TË KULTURËS POPULLORE – GJIROKASTËR.

Banesa në fjalë është një nga shembujt më të zhvilluar të banesës gjirokastrite. Ajo është e variantit me dy krahë, ndërtuar në vitin 1829. Banesa është e ngritur mbi një truall relativisht të rrafshët, duke mundësuar kështu zhvillimin e barabartë sipas kateve.

Banesa ka dy oborre. Në gjendjen e sotme oborri i jashtëm nuk ruhet. Kompozimi i banesës zhvillohet rreth ambienteve ndërlidhës të nëndivanit, divanit të patit dhe atij të sipërm. Ambientet ndihmëse në katin përdhe, dhe ata të banuarit, në të dy katet e tjerë qarkojnë ambientet ndërlidhës sipas kateve. Si rast i rrallë, banesa ka dy palë shkallë për në katin e parë, një palë shkallë të jashtme, të tjerat të brendshme, të cilat pastaj bashkohen në një rampë të vetme që të çon në çardakun e katit të dytë. Banesa shquan për pasurinë e madhe të ornamentikës në dru jo vetëm në ambientin e odës së miqve, por dhe në ambiente të tjera. Ajo ka pësuar ndryshime të pakta në kohë, ku për të përmendur është ai i odës në krahun lindor.

Banesa u vendos të shërbente si muze lokal i kulturës popullore të rrethit. Lidhur me këtë funksion, i cili i përshtatet mirë vlerave të rëndësishme të këtij monumenti, u bë e nevojshme kryerja e disa punimeve restauruese. Për vetë gjendjen e mirë të këtij monumenti, veçanërisht në pjesët konstruktive të tij, këto punime prekën kryesisht elementet veshës të ambienteve të ndryshme, si dhe u bë rindërtimi i disa pjesëve të dëmtuara pjesërisht apo plotësisht, në ambientin e oborrit. Në radhë të parë duhet të përmendim punët e pastrimit të mureve në odën e miqve, për nxjerrjen në pah të pikturës murale. Aty u bënë dhe disa punime të vogla plotësimi në ornamentikën në dru. Në disa ambiente banimi u krye prishja dhe rindërtimi i dorës së dytë të suvatimeve, duke përdorur teknikën origjinale me përzierje gëlqere dhe leshi. Të gjitha dritaret fikse prej skelet allçije që vendosen në brezin e sipërm të mjaft ambienteve të banimit u rindërtuan, sipas skemës së një dritareje origjinale. Në disa ambiente u krye rindërtimi i pjesshëm apo tërësor i shtresës së dyshemesë. Punime restaurimi u kryen dhe në disa pjesë të strehës ballore. Në oborr u konsoliduan dhe plotësuan muret rrethues, dhe shtresa me pllaka guri. Porta e jashtme e rrënuar, nuk ruante asnjë gjurmë, prandaj në vendin e saj u vendos një portë e ruajtur mirë dhe e punuar me kujdes e marë nga një banesë gjirokastrite e transformuar rëndë. Pas këtyre punimeve në këtë monument u vendosën eksponatet e krijimtarisë popullore të rrethit, duke marrë kështu monumenti një destinacion mjaft të përshtatshëm.

E. Buka

BANESË NË FSHATIN ZVARRISHTË – – KORÇË

Në fshatin Zvarrishtë të krahinës së Gorës, në rrethin e Korçës është vënë në mbrojtje shtetërore një banesë relativisht e rrallë me kullë. Banesa ngrihet dykatëshe, ndërsa kulla ngrihet pjesërisht mbi katin e parë. Skema planimetrike e kateve është e thjeshtë, në qendër të kompozimit janë vendosur ambientet ndërlidhës dhe anash tyre respektivisht nga një ambient. Vetëm pjesa fundore e ambientit ndërlidhës mban sipër volumin e kullës prej një kthine të vetme. Ndërlidhja me kullën arrihet nëpërmjet shkallëve të brendshme që fillojnë prej divanit të katit të banuar. Kulla është e paisur me frengji të shumta, të ndërtuara poshtë dritareve dhe veçanërisht të shpeshta në pjesët më të pambrojtura të banesës. Kulla përveç funksioneve mbrojtëse, shfrytëzohej edhe për banim. Gjendja teknike e monumentit, para fillimit të punimeve restauruese, paraqitej jo e mirë. Krahas dëmtimeve në konstruksionin e çatisë, shqetësuese paraqitej gjendja e një pjese të mirë të muraturës fundore dhe pjesërisht anësore të kullës, e cila kishte pësuar shmangie të theksuara nga vertikaliteti. Në këto kushte u bë e nevojshme ndërhyrja restauruese në këtë monument. Punimet e restaurimit në radhë të parë prekën konstruksionin e mureve mjaft të dëmtuar të kullës. E vetmja rrugë e mundshme duke parë gjendjen e mureve në fjalë, qe rindërtimi pjesor i tyre. Gjatë këtij rindërtimi u përfshinë jo vetëm volume të thjeshta murature por edhe elemente të tillë si dritare, frëngji dhe pjesërisht oxhaku i ambientit të kullës. Krahas këtyre punimeve u krye rindërtimi i strukturës së çatisë së kullës si dhe i një pjese të mirë të çatisë që mbulonte të dy krahët e banesës. Punime në shtresat prej druri dhe dritaret në ambientet e banuara, si dhe të shkallëve të brendshme i siguruan monumentit qëndrueshmërinë.

E. Harxhi

BANESA NË FSHATIN DHOKSAT

Në qendër të fshatit Dhoksat të rrethit të Gjirokastrës është ndërtuar një banesë me kompozim të zhvilluar e cila për vlerat e saja është vënë në mbrojtje shtetërore si monument kulture. Banesa është e datuar në vitin 1860. Banesa ka një zhvillim planimetrik të pabarabartë karshi pjesës qendrore të kompozimit të formuar nga dy ambiente në secilin kat. Anash tyre zhvillohen të dy krahët me shtrirje të pabarabartë, duke u mbyllur me mur rrethues, për të krijuar një oborr i cili kufizohet në pjesën më të madhe nga vetë banesa. Me interes është trajtimi i divanit të katit të banuar, i cili ka në ballin e tij një qoshk

PO-FOTOCOPY

me daljen karakteristike në formë erkeri. Kompozimi dhe trajtimi i kësaj banese flet qartë për ndikime të spikatura nga banesa qytetare gjirokastrite.

Në prag të punimeve restauruese shiheshin disa dëmtime, të cilat u bënë shkas për ndërhyrjen restauruese. Në përgjithsi konstruksionet e mureve kryesore, ishin në gjendje të mirë. Kjo gjë nuk mund të thuhej për muret me skelet druri të qoshkut dhe faqes së prapme të divanit të katit të parë. Elementet prej druri, gjithashtu kishin pësuar në mjaft raste degradime të rënda. Gjithashtu konstruksioni i çatisë paraqiste dëmtime të rënda. Projekti i restaurimit synonte në ruajtjen e të gjithë elementeve origjinalë, duke kaluar në rindërtim vetëm në rastet kur degradimi kishte arritur kufij tepër të theksuar. Sipas projektit në këtë monument u bë rindërtimi i plotë i dy faqeve ballore dhe fundore të divanit të katit të parë, konstruksioni prej skelet druri i të cilave ishte në prag të rrënimit. Kuptohet se gjatë rindërtimit u ruajtën rigorozisht si skemat konstruktive ashtu edhe trajtimi arkitektonik. Rindërtimi i dyshemesë u krye në divan, në odën e miqve dhe në ambientin fundor të krahut të djathtë. Mjaft dritare të ambienteve të ndryshëm u ribënë, krahas plotësimeve të ndryshme të elementeve të tillë si kapakë dollapesh, kapakë dritaresh etj. si dhe punime të plotësimit në disa tavane, musandër etj. Gjithashtu edhe shkallët prej druri u rindërtuan. Konstruksioni i çatisë, thuajse u rindërtua plotësisht duke zëvendësuar një merametim të mëvonshëm me tjegulla, me pllaka guri, siç ka qënë krejt mbulesa origjinale. U krye edhe rindërtimi i murit rrethues, si dhe çatia e portës së jashtme. Punimet e restaurimit u kryen nga Dega e Monumenteve të Kulturës e Gjirokastrës gjatë viteve 1980-1981.

E. Harxhi

BANESË NË FSHATIN XERJE TË OPARIT – KORÇË

Është një shembull me mjaft interes në grupin e «banesave me kullë». Banesa është dykatëshe, me nga dy ambiente në çdo kat, të cilët krijojnë një thyerje të lehtë në plan. Kati përdhe përdoret si katua. Secili ambient ka hyrje të veçanta nga jashtë, njëkohësisht ato ndërlidhen nga brenda me njëri tjetrin. Shkallët për në katin e dytë janë vendosur në njërin nga ambientet e katit përdhe. Në katin e sipërm përfshihen dhoma e miqve dhe «asheti». Ky i fundit ka dhe një hyrje të veçantë nga jashtë. Trajtimi i ambienteve është i thjeshtë. Një përkujdesje më e madhe duket në dhomën e miqve, e cila është e paisur me tavan, dollapë muri dhe me një ballkon të hapur, që nga vendasit quhet qoshk, e cila del mbi portën e hyrjes. Elementet prej druri të qoshkut janë të përpunuara me gdhendje. Në pjesën e prapme ngrihet «kulla», edhe kjo dykatëshe, por për arësye të terrenit të pjerrët, kati i dytë i kullës del mbi çatinë e banesës. Në një fazë të dytë kulla është zgjeruar dhe përshtatur për banim.

Me përjashtim të kullës, banesa ruhej e paprekur nga ndryshime të mëvonëshme, por ajo vuante nga dëmtime serioze në strukturat mbajtëse si në muraturë, çati, dysheme etj. Këto dëmtime e kishin kthyer në një gjendje praktikisht të pabanueshme krahun e banesës që përmbante dhomën e miqve. Nga ana tjetër mjaft elemente të paisjes së brendshme të dhomës së miqve dhe të qoshkut ishin dëmtuar.

Punimet e restaurimit në këtë banesë u përqëndruan kryesisht në konsolidimin statik të strukturave të dëmtuara dhe në plotësimin e elementeve mungues në dhomën e miqve dhe në qoshk. Në këtë fazë të restaurimit nuk u pa e arsyeshme të kalohej në rivendosjen e gjendjes fillestare të pjesëve të transformuara më vonë, sidomos në kullë.

P. Thomo

BANESË NË RRUGËN «PANDELI CALE», nr. 12.

Banesa është e datuar në vitin 1866. Ndonëse mban një datë relativisht të hershme, ajo përfaqëson një fazë tashmë të formuar të tipit të ri të banesës korçare, duke na dhënë kështu një dokument të vlefshëm mbi vendosjen kohore të këtij tipi banese.

Banesa është dykatëshe me qilaret gjysmë të futura në tokë, të dy katet përdoren për banim. Skema kompozicionale është e thjeshtë: në qendër të çdo kati ndodhen sallonet e mëdhenj, të cilët ndërlidhin ambientet e banimit, nga një në çdo krah. Në pjesën qendrore del jashtë në katin e sipërm erkeri i mbajtur me shtylla druri.

Banesa është ndërtuar me gurë të lidhur me baltë e breza druri. Sipërfaqja e jashtme e muraturës ishte e fugatuar me llaç gëlqereje. Erkeri është ndërtuar me teknikën e çatmasë. Në trajtimin arkitektonik banesa shquhet për numrin e madh të dritareve dhe përpunimin e kujdesshëm e dekorativ të shkallëve, hyrjes së banesës në katin përdhe, dritareve të qoshkut, qoshet e muraturës etj. Interieret janë të thjeshtë e të pangarkuar. Anash dyerve janë sajuar musandra në mure.

Banesa ruhej e plotë përsa i përket skemës kompozicionale, por në të janë bërë disa shtesa në një periudhë të mëvonë. Gjithashtu ajo i përmbante të gjithë elementet dekorativë e arkitektonikë, ndonëse disa prej tyre si p.sh. një pjesë e dritareve të katit të sipërm ishin murosur. Problem për këtë banesë ishte gjendja e saj e dëmtuar nga ana statike. Dëmtimet më serioze viheshin re në murin jugor dhe atë lindor. Gjithashtu pjesë të ndryshme të muraturës kishin pësuar çarje, ndërsa erkeri një cedim të lehtë, që vinte nga degradimi i shtyllave mbajtëse prej druri.

Duke u nisur nga kjo gjendje, punimet e restaurimit u përqëndruan në rivendosjen e qëndrueshmërisë statike të banesës. Në këtë drejtim u rindërtua muri jugor dhe një pjesë e atij lindorit, duke ruajtur qoshet e vjetra. U konsoliduan çarjet e muraturës dhe u ngrit erkeri në pozicionin fillestar duke zëvendësuar njëkohësisht dhe konstruksionin mbajtës. Përsa i përket trajtimit arkitektonik u riformulua erkeri duke hapur dritaret e mbyllura më vonë. Dritaret e tjera të murosura të banesës u lanë në atë gjendje por duke e theksuar formulimin e tyre të jashtëm në mënyrë që të dallohet qartë ekzistenca e

tyre dhe mbyllja e mëvonëshme. Pjesët e shtuara më vonë, sidomos në pjesën e prapme të banesës ndonëse e cënojnë pastërtinë kompozicionale të tipit, në këtë fazë të restaurimit u lanë paprekur.

P. Thomo

ZONA-MUZE RRETH SHTËPISË SË PARTISË.

Në rrugën e Formimit të Partisë gjendet shtëpia ku më 8 Nëntor 1941 u themelua Partia Komuniste Shqiptare. Ajo është kthyer në një shtëpi-muze që përkujton këtë ngjarje të shënuar. Për të evidentuar më mirë këtë monument historik përreth Shtëpisë u krijua një zonë-muze, me ndërtesa karakteristike njëkatëshe të fillimit të shekullit tonë. Si shtëpia ku u formua Partia, ashtu edhe këto ndërtime janë ngritur kryesisht me qerpiç dhe dërrasë, ndërsa çatitë mbulohen me tjegulla vendi. I gjithë ky kompleks i shërben mendimit që Partia Komuniste Shqiptare u formua në gjirin e popullit punëtor dhe patriot.

Qysh prej vitit 1978 filloi restaurimi në këtë kompleks. Ato vazhduan edhe më 1979; por në vitet 1980 dhe 1981, në kuadrin e 40 vjetorit të Partisë, ndërhyrja restauruese u intensifikua në mënyrë të ndjeshme dhe në vitin 1981 punimet e restaurimit të zonës-muze përfunduan.

U rikrijuan shumë vlera arkitektonike të humbura në bazë të dokumentacionit ekzistues, si dhe disa mjedise që me kohë ishin prishur dhe transformuar sipas nevojave të atyre që banonin në to. Kështu i gjithë ky kompleks fitoi në mënyrë të ndjishme duke u pasuruar me elemente të vlefshme arkitektonike dhe etnografike.

R. Ballauri

SELIA E OGANIZATËS «BASHKIMI»

Në qytetin e Tiranës, në rrugën Xhorxhi Martini gjendet Selia e Organizatës Demokratike «Bashkimi», ku është zhvilluar edhe një veprimtari e shquar patriotike gjatë viteve 1920-1924. Pjesa që del në ballin qendror është restauruar vite përpara. Dilte e nevojshme të shikohej edhe pjesa tjetër e banesës ku ishin dukur shenja të degradimit të strukturave dhe cedime në një muraturë mbajtëse jo periferike. Me që të dy pjesët përbënin Monumentin historik të vënë në mbrojtje shtetërore, dhe duke qënë nën po atë kulm, u vendos që gjatë vitit 1981 të fillonin punimet restauruese në pjesën e prapme të banesës. Fillimisht duke shkarkuar strukturat vertikale dhe horizontale doli në pah se konstruksioni i mureve perimetrale dhe të mjedisit ishte me skelet druri të mbushur me muraturë qerpiçi dhe disa herë me tulla. Nga teknika e ndërtimit rezultoi të jetë një ndërtim i fundit të shekullit të kaluar. Si arkitekturë një banesë trekatëshe ndeshet rrallë në qytetin e Tiranës, për kohën kur është ndërtuar. Punimet e restaurimit do të vazhdojnë edhe në vitin 1982.

R. Ballauri

BANESË NË STARAVECKË TË SKRAPARIT

Në vitin 1944 në Staraveckë para dhe gjatë zhvillimit të Kongresit të Përmetit, u vendos centrali telefonik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo godinë u shpall Monument historik, por me kalimin e kohës filloi të paraqesë shenja të një paqëndrueshmërie në muret perimetralë. Kështu që u bë e nevojshme ndërhyrja restauruese. Banesa është dykatëshe, ku kati i parë është në nivelin e terrenit. Si ndërtim ai duhet t'i takojë viteve 20 të shekullit tonë. Struktura e mureve është me gurë të punuar të lidhur me baltë përzier me byk. Punimet e restaurimit u bënë në dy faza: në konsolidimin e muraturës dhe në zëvendësimet e strukturave të prishura. Ato filluan në vitin 1979 dhe përfunduan më 1981. Banesa në Staraveckë është e vizitueshme dhe aty ruhet dhoma si dhe paisjet e centralit telefonik të dikurshëm.

R. Ballauri

BANESA E HAXHI QAMILIT

Në fshatin Sharrë afër Tiranës, ruheshin rrënojat e banesës së Haxhi Qamilit, njerit prej udhëheqësve të kryengritjes së fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të vitit 1915. Pas shtypjes së kryengritjes, Haxhi Qamili u ekzekutua dhe shtëpia e tij në Sharrë u dogj. Mbi ato gërmadha ishte ngritur një ndërtim i thjeshtë njëkatësh, që kohët e fundit shërbente si shkollë fshati. Për vlerat e saja u vendos që mbi gjurmët e rrënojave të bëhej rikonstruksioni hipotetik i banesës. Për këtë një ndihmë të madhe kanë dhanë njerëzit e afërt të familjes së Haxhi Qamilit, që me dokumentacionin dhe me kujtimet e tyre për anën funksionale dhe arkitektonike të banesës ndihmuan në hartimin e projektit. Për këtë ndihmoi edhe banesa popullore e Sharrës, sidomos në konceptimin dhe trajtimin e shumë elementeve dhe përbërësve arkitektonikë, siç janë ballkonet e katit të parë të hapur dhe të mbyllur (telizi), strehët e çatisë, interierët etj. Realizimi i projektit u krye gjatë viteve 1979-1980 dhe sot në ballë të kodrave të Sharrës mund të soditet shtëpia e Haxhi Qamilit që harmonizohet me mjedisin rreth e rrotull të ndërtimeve popullore.

R. Ballauri

NJË BANESË TREKATËSHE NË QYTETIN E KORÇËS

Brenda zonës-muze të Korçës në rrugën «Mihal Grameno nr. 17, ngrihet një ndërtim masiv trekatësh me muraturës guri, me qoshe me gurë të latuar, që si kohë ndërtimi i takon gjysmës së dytë të shekullit XIX. Bashkë me vlerat arkitektonike, inxhinierike dhe të teknikës së ndërtimit, kjo banesë dhe godina tjetër përbri saj, ndërtim i një kohe më të herët, u destinuan të strehojnë Muzeun e ardhshëm të Kulturës Popullore të Korçës.

Ndërtesa me kohë kishte pësuar mjaft ndryshime, si rezultat i shtimit të familjeve që banonin në të. Po ashtu me kohë, shumë struktura kishin filluar të degradoheshin, duke u zëvendësuar nga të tjera. Edhe lëkundjet sizmike të vitit 1931 kishin shkaktuar një shkëputje të murit perimetral nga pjesa e çatisë. Kështu me t'u përfunduar projekti, në vitin 1979 filloi restaurimi i cili përfundoi më 1981, duke i kthyer banesës të gjitha vlerat arkitektonike dhe artistike.

R. Ballauri

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

CHRONIQUE DES TRAVAUX DES RESTAURATION POUR LES ANNEES 1980 – 1981

LE THEATRE DE BYLISE

Ces dernières années Le Centre Archéologique de la région de Fieri a fait des fouilles dans le théâtre de Bylise (à Hekal de Mallakastër), il en résulte que les marches sont sculptées sur le rocher de la colline et ont été couvertes de blocs taillés. Ils furent découverts des deux côtés les entrées et les murs de façade des marches. Les blocs des murs étaient en plus grande partie détruits, et ceux qui s'y trouvaient encore n'étaient pas en leur place et avaient changé de direction.

Les fouilles archéologiques furent suivies de travaux de restauration. Avant de commencer le travail, on faisait bien attention à trouver la place exacte des blocs en pierre tombées, et cela provisoirement. De la sorte on ne nuisait pas aux travaux des fouilles ultérieures.

Après avoir effectué des fouilles complètes, il fut constaté que les fondements ne gardaient pas le sens initial. Les blocs installés provisoirement furent enlevés de nouveau, furent placés comme ceux de la première rangée, dans les limites du matériel dont on disposait.

7. A. Meksi, **Apolonia**, fig. 2.
8. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.**, Abb. 26.
9. Rilevimet grafike që po botojmë në këtë shkrim janë të autorit, F. Guralumit, A. Qyshka dhe A. Delvinës. Rilevimi topografik është bërë nga Ing. M. Bezhani. Shkalla e rilevimit është 1:200 gabimi $\frac{1}{8\,000}$.
10. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.**, 58, shën. 12.
11. **Po aty**, fig. 10.
12. A. Meksi, Apollonia, fig. 1, Tab. III.
13. Bushhausenët mendojnë se pjesa lindore e murit në dukje të paraklisit gjendet në pjesën e poshtme pjesë e murit të skevofilakionit (fq. 71). Kjo nuk është e vërtetë. Muri i paraklisit duke u ndërtuar më vonë, i puthitet atij të skevofilakionit.
14. H. und H. Bushhausen, **Vep. cit.** 77, Tab. XIII-38, 43.
15. A. Meksi, **Apollonia**, 104-105.

BOTOJME

dhënë saktë në tekst. Kjo pjesë jepet në vija të përgjithëshme sakt tek Bushhausenët. Duhet shtuar se absida në anën e brendshme është më e thellë se rrezja e rrethit me të cilin është ndërtuar. Për këtë ajo dhe sinthroni në të vinë lehtësisht duke u mbledhur, në pjesën e fillimit të tyre.

Për t'u saktësuar në format e tyre janë të gjitha portat dhe portikët. Kështu është pjesërisht e murosur porta veriore e naosit, lidhja me ambientin e jashtëm në të cilën bëhet me dy këmbë shkallë. Kjo portë në pjesën e saj të vjetër mbulohet me hark rrethor në anën e jashtme dhe me arkitra të rrafshët në anën e brendshme. Shpatullat e kësaj porte nuk janë të rrafshta por me paturë. Këto elemente të përbashkët për të pesë portat që lidhin kishën me oborrin e manastirit, i gjejmë në planimetrinë tonë të parë, por jo në atë të Bushhausenëve. Duke qënë terreni rreth kishës në nivel më të lartë nga dyshemetë e saj dhe toka në anën jugore në nivel më të lartë se në anën veriore, zbritja në kishë bëhet me disa këmbë shkallë, sipas vendit. Bën përjashtim vetëm hyrja veriore për në ekzonarteks e cila nuk ka asnjë këmbë shkallë. Me një prag më të ngritur nga dyshemeja janë dhe dyert që lidhin naosin, narteksin dhe ekzonarteksin.

Përsa i përket portikëve, në formën e tij të parë ruhet vetëm portiku verior i narteksit. Ai përbëhet nga dy gurë tërthor murit, që kanë të gdhendur mbi to dhe bazamentin e kolonave. Fusha ndërmjet tyre është shtruar me pllaka guri gëlqeror. Mbi bazament janë kolonat të marra nga rrënojat antike. Këtë e vërteton më së miri kolona më nga lindja, e cila është më e shkurtër se sa duhet, duke krijuar një boshllëk ndërmjet kapitelit dhe gurit konsol mbi të. Mbi këtë gur konsol ngrihet mbulesa e sipërme e portikut, me qemer cilindrik në pjesën e brendshme dhe faqe vertikale e çati të pjerrët në anën e jashtme. Harku në dukje i qemerit, mbas çveshjes së suvasë së vonë, rezultoi i ndërtuar me tulla dhe gurë, që këmbehen me njëri tjetrin siç shihet dhe nga fotografitë e vjetra që botohen në librin në fjalë.[16]

Në këtë anë veriore, nga portiku që i takon hyrjes për naos, kanë mbetur vetëm gurët me bazamentet e kolonave dhe dyshemeja ndërmjet tyre, si dhe mbulesa me gurët konsol. Pra janë larguar në një kohë të dytë, me shumë gjasë kur është rindërtuar paraklisi i Shën Mitrit, sepse pengonin lëvizjen dhe hyrjen në paraklis.

Në anën jugore ruhet gjithashtu i plotë portiku për në naos, me të njëjtën mënyrë ndërtimi si portikët e tjerë. Nga katër kolonat që ndodhen aty, vetëm dy janë të vjetra. Të tjerat dy kolonat pranë murit, janë vendosur më vonë për të mbajtur gurët konsol të portikut që janë të çarë në faqe të murit. Siç duket për to janë përdorur pjesët e mbetura të portikut jugor të narteksit kur ai është rrënuar. Kolona më nga jugu, pjesën e sipërme e ka prej betoni dhe të suvatuar më vonë. Pra, këto të dyja nuk duhen paraqitur në planimetri si të fazës së parë të ndërtimit. Formën e dikurshme të dyshemesë së portikut dhe të gurëve me bazamentet e kolonave e nxorrëm në dritë nëpërmjet gërmimit sepse ishin mbuluar prej kohësh me një shtresë të hollë dherash.

Siç e përmendëm më lart portiku jugor është rrënuar duke mbetur prej tij vetëm njëri nga gurët konsol (ai më nga lindja) dhe gjurmët e harkut në murin e kishës. Porta e dikurshme është murosur dhe është lënë në të një dritare e vogël kuadratike, të cilën e kemi paraqitur drejt në planimetrinë tonë të parë, ndërsa është paraqitur në mënyrë të gabuar nga Bushhausenët. Ne gërmuam në pjesën e dyshemesë së portikut dhe gjetëm në të vetëm gurin lindor me bazamentin e kolonës.

Kemi vërejtur më parë,[17] nëpërmjet një sondazhi se në anën perëndimore të narteksit nuk ka pasur në ndërtimin e parë të kishës ndonjë portik si në katër hyrjet e tjera. Një gjë të tillë ne e patëm menduar se mund të ishte dhe e paraqitnim në rikonstruksionin hipotetik botuar në shkrimin tonë të parë.[18]

Krahas rilevimit të dyshemesë së naosit, ndërtuar me gurë të marra nga ndërtesat antike, e cila ruhet tërësisht dhe në formën e saj të parë, kryem dhe një sërë vrojtimesh. Rozeta qëndrore përbëhet nga tre rrathë bashkëqendrorë dhe një figurë të veçantë në pjesën e mesit. Rrethi i parë është me pllaka guri të prera sipas rrezeve, rrethi i dytë me gurë të vendosur në rombe me trekëndësha qeramike në qoshet, kurse rrethi i tretë me gurë të prerë sipas rrezeve. Figura qendrore në rrethin e jashtëm ka gurë mermeri drejtkëndorë, dhe ndërmjet tyre pllaka qeramike që në anën e qendërs përfundojnë me vija gjysmë rrethi. Sipërfaqja e mesit, e mbetur në këtë mënyrë, është një copë, prej guri gëlqeror, dhe ka formën e një rrote me tetë dhëmbë. Mbasi është dëmtuar, ajo është meremetuar keq, duke vënë në pjesën e mesit një pllakë drejtkëndore.

16. H. und H. Buschhausen, **vep. cit.**, fig. 4.
17. A. Meksi, **Mbi disa probleme të kishës së manastirit të Apollonisë,** Monumentet 12, 1976, 233.
18. A. Meksi, **Apollonia,** Tab. V, 2. Aty gjithashtu (f. 108) shtonim se një hipotezë e tillë do të sqarohej përfundimisht, po të sondohet nën suvanë që mbulon murin perëndimor të narteksit.

Dritëz

Nën të dallohen pjesë të gurit të vjetër ku është hapur një gropë deri nën fundin e pllakës. Trashësia e kësaj të fundit është rreth 17 cm, duke qënë e vendosur drejt e mbi truallin e ngjeshur.

Ndërmorrëm gjithashtu një sondazh nën dysheme, në pjesën që i takon ambientit këndor verilindor të naosit. Edhe aty nën pllakat 17 cm të trasha, fillonte shtresa e dheut. Gërmimin e vazhduam deri në tabanin e themelit. Themeli rezultoi të ishte i ndërtuar me gurë të mëdhenj shtufi të vendosur në të thatë njëri mbi tjetrin.

Sondazhe që paraqisnin gjithashtu interes për të sqaruar ndërtimin e themeleve dhe thellësinë e vendosjes së tyre u kryen në qoshen juglindore të kishës dhe në fugën e takimit të kishës me ekzonarteksin në anën veriore. Sondazhi i parë tregoi se themelet janë të ndërtuar me gurë të mëdhenj shtufi në një thellësi rreth 90 cm nën dsyhemenë e naosit. Muri mbi tokë ngrihet drejtpërdrejt mbi themel duke patur aty sipas nevojës ndonjë fragment tulle lidhur me llaç për të krijuar rrafshin horizontal. Nën themel u gjet tokë sterile argjilore, ngjyrë okër, e përzierë me gurë të vegjël. Sondazhi i dytë tregoi se themeli ka dhe ai një fugë të ndarjes narteks-ekzonarteks. Themeli i narteksit shkon deri në thellësinë 90 cm dhe është me gurë shtufi të lidhur në të thatë. Themeli tjetër është i lidhur me llaç dhe pas një fragmenti rreth 90 cm të gjatë që shkon nga fuga në drejtim të perëndimit fillon të thellohet, me sa duket nga që jemi pranë cisternës së ujit.

Në narteks, në anën jugore të tij, ndodhet mbi një shtyllë dorike një kapitel dorik me diametër pak më të madh, së cilës i mungon abaku, ajo shërben për pagëzimin e besimtarëve. Këtë gjë e kemi paraqitur në planimetri. Nuk jemi në gjëndje të shprehemi se kur është vendosur kjo vaskë pagëzimi, sepse dyshemeja është shtruar kohë më parë me një shtresë çimentoje dhe ruan vetëm një fragment pllake antike me një mbishkrim greqisht në të.

Mendimi i autorëve se kupola nga kërkimet shqiptare mendohet e ndërtuar në shek. XIX ne nuk na rezulton në botimet të cilave iu referohen autorët.[19] Këtu duhet të shtojmë se kupola ka 12 faqe apo nike të harkuara dhe jo 10 siç shprehen autorët kur korigjojnë Dyselienë.[20] Për përcaktimin e formës së vjetër të mbulesës së narteksit u futëm nën çatinë e re me strukturë druri. Çatia e re është rreth 1 m mbi qemerin e vjetër, i cili është ndërtuar me tulla të vendosura sipas rrezeve. Nën çatinë e re duken qartë pjesët e reja të shtuara në muret verior e jugor në kohën e ndërtimit të ekzonarteksit për të krijuar çatinë në një nivel më të lartë. Nga këta ai veriori dallohet qartë si shtesë dhe në anën e jashtme,[21]) sepse në anën jugore kemi të bëjmë me një meremetim që shihet mjaft mirë në anën e brendshme. Të dy këta mure, si të vjetrit ashtu dhe të rinjtë janë 70 cm të trashë.

Çatia e dikurshme e narteksit ishte mbi strukturë druri. Këtë na e dëshmojnë dy vrima për trarë në muret verior dhe jugor në afërsi të murit perëndimor të naosit. Këto vrima janë rreth 20 cm nën dritaren e krahut perëndimor të kryqit e cila fillimisht nuk mbulohej. Kjo dritare është mbuluar pjesërisht duke u murosur vetëm në anën e jashtme dhe jo në tërë gjeresinë e murit siç e korigjojnë këtë detaj Bushhausenët.[22]

Gjatë kësaj ngritje në lartësi të çatisë është ngritur dhe muri perëndimor i narteksit, i cili kufizon dhe ekzonarteksin. Ky mur i ri, me një rresht gurësh në pjesën e poshtme dhe më lart me tulla, ka një lartësi rreth 80 cm. Në anën e jashtme ky mur është suvatuar dhe ne vrojtuam një pjesë në këndin verior që e çveshëm nga suvatimi. Gurët e rreshtit të poshtëm janë të ripërdorur. Në njerin prej tyre ruhen fragmente mjaft të vogla pikture. Niveli i fillimit të murit të ri është 3.90 m nga dyshemeja dhe i njëjtë me fundin e gurit të skuadruar që del tej fugës narteks-ekzonarteks në anën veriore e jugore. Duket se mbi këtë nivel duhej të dilte korniza me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre.

Mbi këtë mur të ri është vendosur dhe këmbanorja që sipas mbishkrimit greqisht në anën perëndimore, në një gur të vendosur pak më thellë se sipërfaqja e murit, del të jetë ndërtuar në vitin 1778 (data është shënuar me shifra arabe dhe në mënyrë të qartë). Në këtë mënyrë mendojmë se përfundimi i Bushhausenëve që ta paraqisnim këtë si të fazës ori-

19. Studime historike 1, 1967, 137-144; V. Puzanova–D. Damo, **Njekotorie pamjatniki monumentalnoj zhivopisi 13-14 vekov v Albanij,** Studia Albanica 2, 1965, 155 ku thonë vetëm se kishën e rindërtoi Androniku i II. Vetëm në artikullin e parë të V. Puzanovës, **Manastiri «Shën Mëria e Apollonisë në Pojan,** B.U.SH.T. seria Sh. Sh. 3, 1961, 148, gjejmë mendimin se «arkitektura e saj e sotme është karakteristike për tempujt e shek. XVIII në Ballkan», kjo si rezultat i rindërtimeve të shumta, por në të nuk thuhet shprehimisht se kupola është ndërtuar në shek. XIX.
20. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.** Kjo gjë mund të kontrollohet lehtë po të kemi parasysh që ndërmjet çdo çifti dritaresh ka dy nike boshe.
21. A. Meksi, **Apollonia,** 107, Tab. V, 1.
22. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** fig. 9.

Download

gjinale në rikonstruksionin tonë na duket i pa bazë.[23] Madje një gjë e tillë ishte e qartë dhe më parë për nga teknika e ndryshme me gurë të vegjël të skuadruar dhe ndonjë copë tulle në të si dhe për vetë formën e vonë të këmbanores që haset dhe në kisha të tjera të vendit tonë të kësaj periudhe.

Sondazhin e fundit në pjesën që i takon naosit e bëmë prapa dy reliefeve, në mbushjen e çatisë që i takon ambientit këndor jug-perëndimor. Pllaka me shqiponjë ka një trashësi rreth 15 cm, ajo në anën e pasme është e rrafshtë. Pllaka me kryqin ka trashësi rreth 19 cm dhe nuk është aq e pastër në anën e pasme.

Së fundi lidhur me naosin duhet të përsërisim, çka e kemi vërejtur më parë[24], se kisha është ndërtuar me gurët e theatrit antik. Ky fakt është me rëndësi për të gjykuar për mjeshtërinë e gurëgdhendësve që ndërtuan kishën, të cilës i jepet një rëndësi e veçantë nga autorët.

Le të kalojmë tani në të dhëna të vrojtimeve dhe sondazheve tona që lidhen me ekzonarteksin. Fuga e dallueshme lehtë në takimin e tij me kishën, flet qartë se ekzonarteksi është ndërtim më i vonë. Vumë re gjithashtu se kjo fugë është dhe në themelet e mureve.

Së pari kryem rilevimin e cisternës e cila ndërsa shtrihet në tërë gjerësinë e ekzonarteksit, ze në gjatësi vetëm një pjesë të tij. Kjo dëshmon deri në një farë mase për ndërtimin e saj më vonë se kisha. Me sa duket ndërtuesit iu shmangën afrimit me murin perëndimor të kishës i cili ishte mjaft i cekët (0.90 m). Cisterna rezulton me përmasa të planit përafërsisht 9.00 x 3.20 m. Fundi i saj, dikur i shtruar me pllaka të skuadruara guri, sot nën një shtresë llaç çimentoje hidroizoluese, ndodhet 4.43 m nën nivelin e dyshemesë së ekzonarteksit. Cisterna është mbuluar me hark të mprehtë me lartësi 1.80 m. Harku është me tulla të trasha antike të ripërdorura, Kyçi i të cilit është 55 cm nën nivelin e dyshemesë.

Në cisternë hyhet nga dy vrima që ndodhen në brendësi të ekzonarteksit, të paraqitura drejt nga ne në planimetrinë e parë. Nga to ajo më e madhja, ndërtuar me një fragment kolone dorike, shërben si grykë e pusit nga mirrej uji, me gjurmë të shumta të tragave të litarëve në faqen e brendshme. Në dysheme të cisternës në këtë zonë ka një pjesë më të tellë për mbushjen e kovës e kullimin e papastërtive. Vrima e dytë është në anën jugore. Ajo është punuar në të njëjtin gurë me një nga pllakat e dyshemesë, dhe ngrihet 20 cm nga kjo e fundit. Duket se kjo vrimë ka shërbyer si vrimë kontrolli apo pastrimi. Bushhausenët në mënyrë të gabuar janë të mendimit se këto vrima i kemi vizatuar shumë afër mesit të dhomës[25] dhe bëjnë për këtë korigjimin përkatës për vrimën e grykës të pusit. Ndërkohë, nuk paraqesin në vizatim vrimën më të vogël.

Cisterna, i vetmi burim uji për manastirin, furnizohet me ujin e shirave, që futet në të nëpërmjet tre vrimave të cilat dalin me bordura kuadratike në muret verior, jugor dhe perëndimor të cisternës. Kjo e fundit mbledh ujërat e çatisë së kishës nëpërmjet ullukut të pjerrët mbi kolonadën perëndimore dhe kanalit në brendësi të pilastrit qendror të kësaj arkade. Dy vrimat e tjera mbledhin ujërat e konakëve të manastirit. Për ta sqaruar këtë ne sonduam në anën e jashtme të murit jugor. Në drejtim të aksit të vrimave, që është dhe aksi i cisternës, në një thellësi rreth 50 cm nga xokoli i themelit ishte mbulesa me tulla e kanalit me llaç që furnizonte cisternën. Një kanal i tillë me tuba ka dalë vite më parë në anën veriore gjatë punimeve të kryera në atë zonë.

Sonduam gjithashtu pranë murit perëndimor të ekzonarteksit për të sqaruar lidhjen e pilastrit qendror me murin bazament të kollonadës si dhe ndërtimin e themeleve. Themeli i murit në pjesën anash pilastrit është i ndërtuar me gurë shtufi të mëdhenj e të skuadruar. Ai shkon në një thellësi që lëviz nga 50 cm në qoshen jugperëndimore në 60 cm në afërsi të pilastrit. Ndërsa në anën jugore ka një xokol rreth 20 cm, në anën perëndimore xokoli mungon.

Themeli i pilastrit është me gurë të vegjël të çrregullt e ndonjë fragment tullash e tjegullash të lidhur me llaç në pjesën nën pilastër, e menjëherë anash tij, dhe pa llaç më larg tij. Kjo mund të tregojë se në ndërtimin e bazamentit të arkadës dhe pilastrit qendror është përdorur një themel që ishte më i hershëm. Por ne mendojmë se themeli është i njëkohëshëm me bazamentin dhe harkadën dhe pjesa e tij nën pilastër është lidhur me llaç sepse në brendësi të pilastrit kalon tubacioni i ujit për në cisternë. Gjithashtu në anën në jug të pilastrit, një gurë shtufi i themelit është mbi gurët me llaç të pjesës nën pilastër. Me rëndësi të veçantë është një fragment qeramike që u gjet direkt nën gurët e themelit të pilastrit. Fragmenti në fjalë është me zmalto ngjyrë të gjelbër, të toneve të çelura dhe të errëta, që datohet në shekujt XIV-XV, çka përbën për ne një provë të pakundërshtueshme për vendosjen në kohë të harkadës dhe pilastrit.

Duke qënë se e mendonim mjaft të mundshëm një rindërtim të ekzonarteksit gjatë ngritjes së kolonadës, vrojtuam në brendësi të mureve anësore dhe

23. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.**, 68.
24. A. Meksi, **Mbi disa probleme**, 233, 65.
25. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.**, f. 58, shën. 42.

DOKTORATË

në disa vende ku pamë që në sipërfaqen e gurëve ka fragmente të vogla me afresk të ngjyrosur. Ndonjë prej tyre është dhe në vende ku normalisht nuk duhej të kishte figura si në murin verior nën pllakën që del nga muri dhe pak mbi tokë. Po kështu në murin jugor, në dy gurë që i takojnë shpatullës së arkadës ka fragmente mjaft të vogla pikture. Edhe guri në anën e brendshme të bazamentit që i takon pilastrit ka gjurmë të tilla, madje dhe të një bordure konturuese që mund të shpjegohen, si dhe rastet e mësipërme, me atë që këta gurë janë të ripërdorur[26] dhe mund të jenë gurë të muraturës së një ekzonarteksi më të vjetër. Kujtojmë këtu sidomos gurin e ripërdorur me gjurmë afresku mbi nivelin e murit të vjetër perëndimor të narteksit. Shtojmë gjithashtu se bazamenti i kolonadës nuk është aq i gjerë sa e paraqesin Bushhausenët.[27]

Duke i vrojtuar më se një herë muret anësore të ekzonarteksit, nuk kemi arritur të dallojmë gjurmë të ndryshme ndërtimi të tij. Gjithashtu na rezulton që bazamenti i harkadës lidhet natyrshëm me muret veriore e jugore dhe me pilastrin qendror. Vështirësia e dallimit të ndryshimeve të muraturës mund të shpjegohet në dy mënyra. Së pari, që në formën e sotme rindërtimi është tërësor dhe bashkë me ngritjen e çatisë së narteksit dhe naosit më të vjetër, së dyti, që për shkak të fugave mjaft të vogla ndërmjet gurëve të mëdhenj dhe mjeshtërisë së muratorëve (çka duket tek kolonada), një gjë e tillë nuk vrojtohet. Mendojmë se ka të ngjarë që të jetë më afër së vërtetës zgjidhja e parë. Ndërtimi i cisternës mund të ketë zhdukur gjurmët eventuale nën tokë.

Autorët në fjalë mendojnë se fillimisht ekzonarteksi ka qënë i mbuluar me qemere cilindrike me formuese veri-jug dhe me nervatura të harkuara të cilat mbështeten në pilastrin qendror dhe pilastrat në mes tij dhe mureve verior e jugor, që ata e mendojnë të njëjtë me galerinë e mbyllur të kishës San Benedeto në Brindizi.[28] Për këtë ata quajnë të mjaftueshëm dhëmbëzimet që ofrojnë për mbështetje të tre pilastrat. Por këto janë në nivel më të ulët se sa fundi i vjetër i murit lindor të ekzonarteksit, që do të përbënte nivelin më të ulët të thembrave të harqeve në këtë mur. Në të njëjtën kohë, si dhe në Brindizi, që qemeri të përballohej nga harkada e lehtë, duhet që ai të mbështetej mbi një mur pak a shumë të lartë, për të cilin nuk ka vend, po të gjykohet mbi bazën e pamjes së jashtme të arkadës, që nga lidhja e rregullt e gurëve dhe kornizës-ulluk mbi të, duket qartë se përfundonte në atë nivel. Kapiteli i zbukuruar me serina vendosur në anën e jashtme të pilastrit është mbi një fragment guri direkt mbi pilastër dhe i vënë njëkohësisht me të tjerët. Duhet të shtojmë se në muraturën e ekzonarteksit janë përdorur fare pak gurë të marrë nga rrënojat e theatrit antik gjë që tregon se ndërkohë ajo nuk shërbente më si kavo gurësh të gatshëm, pra ndërmjet ndërtimit të tyre ka kaluar një kohë pak a shumë e gjatë.

Me rëndësi është gjithashtu vrojtimi se nën afreskun e Paleologëve ka një shtresë tjetër më të vjetër të pikturuar.[29] Këto gjurmë janë në dukje në pjesën e sipërme të tablosë perandorake, atje ku përfundon shtresa e saj, në disa vende të vogla ku kjo ka rënë si dhe në gurë të veçantë që ndodhen deri në nivelin më të lartë të murit të vjetër. Po kështu në këtë pjesë në murin verior pranë si dhe në anën më në jug të portës për në narteks, ka mbi gurët pika boje të rëna gjatë pikturimit të suvasë mbi të. Kjo tregon se ky mur ka qënë i pikturuar në të dy anët e portës edhe përpara se të vihej piktura e Paleologëve. Nxjerrja në dritë e pikturës më të vjetër, në vartësi të shkallës së ruajtjes, paraqet interes të veçantë për studimin e monumentit. Gjithashtu mendojmë se kjo pikturë do të ketë qënë e mbuluar në ndonjë mënyrë e cila sot mbetet e panjohur për ne, ndryshe dëmtimi i shpejtë i saj ka ndodhur për shkak të veprimit të drejtpërdrejtë të agjentëve atmosferikë.

Përsa i përket brezit zbukurues në stukoreliev që ruhet në dy ekstremet jugore e veriore të murit lindor të ekzonarteksit vërejtëm se ato janë të vendosura në një kohë të dytë, pas pikturimit të tablosë perandorake dhe kur ajo ishte e dëmtuar. Kështu shtresa mbajtëse e pllakave të parapërgatitura me reliefin mbulojnë të dy shtresat e pikturës, madje hyjnë në zonën e figurave.[30] Kjo gjë si dhe në kishën e Labovës së Kryqit duhet t'i takojë fundit të shek. XVIII fillimit të shek. XIX.[31]

26. H. Nallbani, **Të dhëna të reja rreth pikturës së kishës së manastirit të Apollonisë,** Monumentet 11, 1976, 98-99.
27. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** fig. 10. Gjithashtu kolonat janë 8 faqëshe dhe jo 6 faqëshe (Vep. cit. 106).
28. **Po aty,** 105-107, fig. 11-12 (prerja dhe planimetria e kishës në fjalë).
29. H. Nallbani, **Vep. cit.,** 98, 102; A. Meksi, **Mbi disa probleme...,** 233-234.
30. Shih për këtë H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** Abb. 101, 104.
31. Nuk jemi dakort me Bushhausenët të cilët këtë dekor e quajnë të një kohe me pikturën e shekullit XIII, **Vep. cit.,** 145, duke ju referuar për kishën e Labovës Pallasit **(Rbk,** 315) i cili nuk e trajton këtë problem, ndërsa Vokotopullos e mendon këtë dekor si të mbivënë padyshim nga koha e ritrajtimit të brendësisë së kishës rreth vitit 1806 **(Vep. cit.,** 90).

Problemi i datimit të kishës së Apolonisë paraqitet i vështirë për mungesë të të dhënave mbishkrimore, apo burimore që të lidhen me themelimin e saj. Siç është tashmë e qartë, në kishë ka pesë mbishkrime të cilat ndihmojnë deri në një farë mase për këtë problem të rëndësishëm.

Mbishkrimi i parë ai i vitit 1250, shënon vdekjen e një murgu, gdhendur në një gur për të cilin jemi shprehur në artikullin tonë të parë, se është pjesë e murit të kishës[32] dhe jo i vendosur më vonë aty.[33] Kemi të bëjmë pra, siç themi aty mjaft qartë, me një **terminus ante quem** për ndërtimin e kishës. Ky mbishkrim është më i vjetri nga të tjerët, që gjithashtu janë **terminus ante quem** dhe që në këtë rast nuk bien saktësime për problemin në fjalë.

Bushhausenët duke interpretuar drejt ndodhitë historike i lidhin mbishkrimet në portretin perandorak me ngjarjet e viteve 1281-1282 kur perandori Mihali i VIII Paleologu[34] lufton në tokat shqiptare me anzhuinët. Ndër to duket qartë përmendja e një krisobule të panjohur të perandorit Manuel I Komneni. Lidhur me të dimë se në vitin 1149 ai ka qënë në Vlorë, pas fushatës së bizantinëve për çlirimin e Korfuzit nga normanët, prej nga perandori mendonte të hidhej për në Itali.[35] I penguar dy herë nga deti ai qëndroi në Vlorë për një farë kohe, prej nga në fund të verës kaloi në Pelagoni[36] për të shtypur revoltën e serbëve. Me sa duket gjatë këtij qëndrimi perandori do të ketë dhuruar të holla për ndërtimin e kishës apo të manastirit. Dy vërejtje mund të bëhen këtu. Së pari që mund të jetë fjala për ngritjen e kishës, së dyti, që të jetë fjala për ndërtime të tjera në këtë manastir përpara ngritjes së kishës që ekziston sot. Për mendimin tonë, në gjëndjen e sotme të të dhënave nuk mund të thuhet asgjë e sigurtë. Mendimet e autorëve se këtu është fjala për perandorët pararendës nuk gjejnë mbështetje në mbishkrim. Madje kjo gjë nuk do të thoshte se kisha u ndërtua në kohën e Aleksit I Komnenit (1081-1118).

Për ne është e qartë që ky kalim i bërë nga Bushhausenët ka dalë i nevojshëm për ti bërë vend mendimit se kisha u ndërtua nga artistët normandë nga Pulia në vitet 1081-85, gjatë fushatës së Robert Guiskardit.[37]. Argumentimi i kësaj teze bëhet nëpërmjet plastikës së kapiteleve të naosit dhe portikëve,[38] mënyrës së punimit të gurëve paralelopipedik të mureve të kishës[39], harqeve të mprehta të dritares së absidës dhe portave për në narteks[40] dhe pas këtyre, dhe me atë që kishës nuk i gjehen as paralele as pararendëse midis kishave të Epirit.[41]

Duke e shqyrtuar këtë çështje të fundit, autorët janë të mendimit se ky tip ka hyrë që në shek. X në Epir dhe për këtë mbështeten tek datimi i kishës së Peshkëpisë së Sipërme si e shek. X,[42] ata mendojnë që e kësaj kohe është dhe kisha e Marmiroit, pa prurë asnjë argument.[43] Sipas tyre kisha e manastirit të Apolonisë mund të ketë ngjashmëri me një sërë kishash të Argolidës dhe Atikës të shek. XI, që sipas tyre prap se prapë janë ndërtuar me një teknikë tjetër muri. Për ta nga Greqia vjen vetëm idea e tipit, ndërsa shkolla e ndërtimit ka qënë tjetër. Ne nuk mund të kuptojmë se si «idea d.m.th. plani i ndërtimit» ti jetë nënrenduar gurëgdhendësve normandë sidomos po të ishin këta në shërbim të bizantinëve. Për ne është e kuptueshme që disa nga mjeshtrat, ata sekondarë, të kenë lënë elemente të veçantë të dallueshëm nga tërësia arkitekturore por jo që të ndodhë e kundërta. Në të njëjtën kohë do deshim të kujtonim këtu që gurët janë marrë të gatshëm nga teatri antik dhe për përpunimin e tyre për kishën nuk është treguar ndonjë mjeshtri e veçantë që do ta kishin vetëm gurgdhendësit normandë. Ato dallohen menjëherë që janë punuar pa kujdes të veçantë që të mos u duke ju prish vetëm dhëmbi origjinal që kishin nga antikiteti. E veçantë këtu është se përdorimi i gurit ka qënë kushtëzuar edhe nga bollëku në material thuajse të gatshëm ashtu si dhe nga parapëlqimi i tij për arsye, estetike apo ndikime perëndimore të cilat këtu vërehen. Kujtojmë këtu se e shek. XIII është dhe kisha e Mesopotamit pjesa e

32. A. Meksi, **Apollonia,** 109. Autorët e pranojnë këtë në tekst (f. 58 shën, 42) por në trajtimin e veçantë të tij (f. 74) e lidhin me studiuesit e tjerë që ose janë shprehur në të kundërt (shih artikullin e shënimit më poshtë), ose nuk e kanë trajtuar fare këtë problem.
33. **Studime Historike,** 1, 1967, f. 142.
34. U. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** 104.
35. F. Chalandon, **Les Comnenes,** V. II, Paris 1912, 333.
36. **Po aty,** 385.
37. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** 74-75.
38. **Po aty,** 81.
39. **Po aty,** 77-81.
40. **Po aty,** 84, dhe jo vetëm ai i portës veriore.
41. **Po aty,** 74.
42. Shih për këtë diskutimin tonë për këtë problem (në këtë numër).
43. A. Meksi, **Restaurimi i kishës së Marmiroit,** Monumentet 2, 1971, flitet për një ndërtim të shek. XIII e më përpara.

DOKUMENT

aty gjithnjë dhe pjesa e poshtme e murit të mos jetë prekur gjatë rindërtimit, ose të jetë ripërdorur. Lidhur me kapitelin e nëntë të përdorur pranë pilastrit ujëmbledhës të kolonadës që rezulton i tepërt, ne mendojmë se ai është bërë nga gdhendësi i të tjerave i cili i ardhur në Pojan ka për çdo rast një kapitel më tepër që u vendos në vendin më të përshtatshëm. Një gjë e tillë do të ndodhte kur artisti të kishte ardhur nga larg.

Fundi i shek. XIV paraqet mjaft të dhëna në të mirë të shpjegimit të lidhjeve të bregdetit dalmatin me zonën ku ndodhet Pojani. Me rënien e sundimit të shtetit serb të Stefan Dushanit, mbas pak kohe zona hyn në mbretërinë e Balshajve.[61] Kështu nga viti 1371 deri në 1385 ajo ndodhet nën Balshën e II Balshaj i cili vritet në betejën e Savrës ku ndeshet me trupat turke të Hajredin Pashës.[62] Në politikën e tyre ndaj kishës ortodokse kemi dy raste kur Balshajt bëjnë dhurime. Njeri është epitafi i Glavenicës i vitit 1373[63] i dyti një ungjill që ruhej akoma në vitin 1399 në manastirin e Shën Kollit të Pentahondisë (Perondia).[64] Koha nga viti 1381, koha e gdhendjes së gurit të varrit deri në 1385 mbase është e vogël dhe kolonada mund të jetë bërë edhe më vonë. Rrethanat historike nuk e përjashtojnë këtë gjë. Me vdekjen e Balshës, Vlora dhe Kanina me zonat përreth janë akoma nën gruan e tij Komnena, e më vonë nën bijën e tij Rugjina që martohet me Mërksha Zharkoviçin që i mban këto qendra deri në vitin 1417 kur i pushtojnë turqit.[65] Kjo periudhë vazhdon të jetë një kohë marrëdhëniesh të mëdha tregtare ndërmjet Raguzës dhe Vlorës e zonës pranë Semanit (Pirgu). Në të tilla rrethana historike fare mirë, artistë nga veriu mund të kenë krijuar kolonadën. Çereku i fundit i shek. XIV është për ne koha më e mundshme e ndërtimit dhe e krijimit të kapiteleve. Për këtë është dhe datimi i fragmentit të keramikës së gjetur drejtpërdrejt nën themelin e pilastrit qendror e që i takon shekujve XIV-XV.

Në këtë kohë siç kemi thënë edhe më lart, rindërtohet ekzonarteksi, duke ngritur në nivelin e sotëm çatinë e pjerrët që mbulon pjesë të çatisë së vjetër të anës perëndimore të naosit dhe atë të narteksit. Në këtë kohë murosen në anën jugore dy relievet skulpturale.

Kisha e manastirit të Apollonisë mbetet një ndër godinat më me vlerë të arkitekturës mesjetare shqiptare, vepër e mjeshtrave vendas, në të cilën ndikimet janë në vartësi të marrëdhënieve të vendit tonë me vendet fqinje, dhe të rrethanave politike të kohës së krijimit të saj. Në numrin jo të vogël të ndërtimeve të kohës që ruhen, ajo ze një vend të rëndësishëm dhe për këtë përbën objekt të një përkujdesje të veçantë.

Nga periudha para pushtimit turk në manastirin e Apollonisë ruhet edhe trapezaria. Ajo shtrihet në aksin më të gjatë veri-jug disa metra më në perëndim të kishës. Shkrimi ynë për të[66] nuk pat rënë në dorë të autorëve gjatë përgatitjes së librit, në të cilin lidhur me trapezarinë ka mjaft pasaktësira.

Trapezaria ruan qartë gjithë elementet e vjetër. Nga ajo gjatë rindërtimit të konakëve të manastirit, më shumë gjasë në gjysmën e dytë të shek. XVIII, është përfshirë një pjesë në këto konakë. Nga muret e vjetër ruhen qartë gjithë muri verior, pjesa në veri e të cilës që mbaron me një fugë vertikale është e përfshirë në muret e konakëve. Në brendësi të ambientit pranë konakëve ruhen gurë të mëdhenj të qoshes që dalin tej faqes së brendshme të murit. Sigurisht që nën dysheme duhet të ruhen themelet e murit të vjetër verior të trapezarisë dhe pjesës së murit perëndimor të zhdukur. Nuk jemi të një mëndje me Bushhausenët të cilët mendojnë se muri verior ekzistues është i vjetër.[67] Që ata gabohen duket qartë nga teknika e tij e ndërtimit nga lidhja me pjesën e re të murit perëndimor, nga vendndodhja në planimetri. Fuga e çrregullt në murin perëndimor që ndan murin e vjetër mjaft të pjerrur, me konakët e reja ndërtuar me gurë, në asnjë mënyrë nuk mund të themi se kufizon qartë trapezarinë.[68] Përse u gjymtua trapezaria është vështirë të thuhet, ashtu si nuk jemi në gjendje të dimë çka patur në këtë anë përpara këtyre konakëve. Nga një sondazh në absidën perëndimore nën themelin e trapezarisë nuk rezulton ndonjë ndërtim më i vjetër, mbi të cilin të jetë ngritur ajo.

61. G. Gelçiç, **La Zedda e la dinastia dei Balsidi,** Spalato 1899, 82.
62. **Historia e Shqipërisë,** Tiranë 1959, v. I, 227: A. Ducellier, **La façade...,** 488, 491-492.
63. **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** v. II, shek. VIII-XV, Tiranë 1962, 194.
64. **Dokumente të periudhës bizantine për Historinë e Shqipërisë (shek. VII-XV),** Tiranë 1978, 105.
65. A. Ducellier, **La façade...,** 502-507.
66. A. Meksi, **Dy ndërtime të tipit trekonkësh,** Monumentet 7-8, 1974, 234-237, fig. 4-5, Tab. IV-V.
67. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** 54-56.
68. **Po aty,** 54, 191.

BOTIMET

PO KOPJE

Nga forma e vjetër e trapezarisë është ndryshuar dhe absida jugore dikur e prishur dhe e murosur rrafsh me murin lindor të sallës. Formën e sotme e ka marrë gjatë restaurimit të viteve 1960-1962 duke rikrijuar në brendësi formën absidale gjysmë rrethore. Prishja e kësaj abside duhet të ketë ndodhur kur janë rindërtuar konakët dhe në anën veriore të trapezarisë u ndërtua një dysheme që e ndante në dy kate këtë vëllim. Në katin e sipërm hyhej nëpërmjet derës së hapur më vonë, siç e dokumenton qartë fotografia e vjetër e Paçit.[69] Hapja e kësaj dere të vonë ka prishur dhe një dritare të vjetër, e cila nga gjurmët e qarta në brendësi ku në shpatullën veriore ruhen dhe gjurmë afresku, duhet të ketë qqënë mbuluar me arkitra guri.

Një problem tjetër që duhet të shqyrtohet është edhe mendimi i shprehur nga autorët se trapezaria i takon dy fazave ndërtimore. Sipas tyre ndërtimi më i vjetër është pjesa e poshtme me gurë të mëdhenj duke patur sipas vendit dhe copëra tullash të vendosura në mes tyre, ndërsa pjesa e sipërme, me kluasonazh është një rindërtim serb i kohës së Car Miljutinit. Studimi i kujdesshëm i mureve, si në anën e jashtme ashtu dhe në brendësi në pjesët e pa suvatuara, tregon qartë se muret i takojnë një periudhe ndërtimi. Lidhja e brezave me të dy teknikat bëhet sipas vendit, pa një nivel të qartë shkëputje në kohë e në materiale duke ruajtur për pjesën e sipërme më dekorative dhe me më shumë dritare teknikën e kluasonazhit me një rresht tullash horizontale dhe dy tulla vertikale. Një vendosje e tillë të cilën e takojmë në kishat e Kalasë së Beratit[70] dhe në kishën e Sopit[71] pranë Pojanit, bëhej ndër të tjera dhe për të kursyer tullat duke përdorur një material më të lehtë për t'u siguruar siç është guri. Kjo mënyrë pra është e zakonshme në pellgun e Myzeqesë.

Me interes, në favor të këtij shpjegimi është edhe fakti se edhe absidat perëndimore e jugore janë të ndërtuara në pjesën e sipërme, kur ka dritare e nikje, me tulla. Si në këto zona, ashtu dhe në brezin e sipërm me pesë dritare të mureve, përdorimi i gurëve do të ishte i vështirë dhe pa vlera dekorative.

Trapezaria veç ndryshimeve të mësipërme ka pësuar dhe të tjera si hapjen e tre dritareve të vogla, në pjesën e poshtme të murit perëndimor, dhe dëmtimin e pjesëve të sipërme të mureve (në gjëndjen e sotme kornizat janë të restauruara).

Problemi i datimit të trapezarisë është bërë nga të gjithë studiuesit nëpërmjet marrjes së pikturave murale si **terminus ante quem** për ngritjen e ndërtesës. Për to fillimisht V. Puzanova ishte përmbajtur datimit të shek. XI[72] më vonë së bashku me Dh. Dhamo janë shprehur si kohë e pikturimit të trapezarisë për fundin e shek. XIII e fillimin e shek. XIV,[73] ndërsa në duke u nisur nga kjo si dhe nga veçoritë e sipërpërmendura të teknikës së ndërtimit kemi menduar si datë të mundshme të ndërtimit të trapezarisë fundin e shek. të XIII apo fillimin e shek. XIV. Në recensionin e saj librit të Bushhausenëve, M. Tashiq–Gjuriq duke e konsideruar pikturën e trapezarisë më primitive se ajo e shkollës së Car Miljutinit, priret për një datim rreth viteve 80 të shekullit XIII.[74] Ndërsa K. Valter mendon se duhet t'i takojnë periudhës së Stefan Dushanit.[75]

Autorët e librit për datimin e pikturës të cilën e quajnë punë të shkollës serbe, të fillimit të shek. XIV më saktë në vitet e fundit të mbretërimit të Car Stefan Uroshit II Milujtinit (1282-1321), mundohen të gjejnë në tërësinë e ndodhive historike të kësaj periudhe mundësinë e shtrijes së sundimit serb në këto anë. Sipas tyre kjo duhet të ketë ndodhur rreth vitit 1318. Por, siç thonë dhe vetë autorët, ky problem nuk është i qartë.[76] Nuk ka asnjë provë his-

69. **Po aty,** Abb. 4, Tab. IV, 53. Këtë fakt na e kumton dhe V. Puzanova, **Vep. cit.,** 151.
70. A. Meksi, **Tri kisha bizantine të Beratit,** Monumentet 4, 1972; Shën Mëri Vllaherna, 59-63, fig. 1-5, Tab. I-III; Shën Triadha, fig. 6-19, Tab. IV-VIII.
71. A. Meksi, **Disa kapela bizantine të vendit tonë,** Monumentet 10; 1975, 85-86, Tab. I.
72. V. Puzanova, **Vep. cit.,** 158.
73. V. Puzanova–D. Damo, **Vep. cit.,** 158, V. Puzanova–Dh. Dhamo, **Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë shek. XIII-XIV,** Studime historike 2, 1967, 107; Dh. Dhamo.
74. M. Tashiq–Gjuriq, **Vep. cit.,** 78.
75. Ch. Walter, **Vep. cit.,** 314.
76. H. und H. Buschhausen, **Vep. cit.,** 219. Deshëm të shtojmë se letra e cituar prej tyre e 17 Qershorit 1319, është letra që papa Joan XXII dërgon nga Avinjoni mbi një njoftim të dhënë nga peshkopi Andrea i Krujës dhe jo letër e këtij të fundit. Gjithashtu nuk mund të shprehemi kurrë me siguri që meqënëse Matarangët në 1297 kishin Apoloninë duhet ta kishin dhe në 1318, përderisa zotërimet e tyre njihen rreth Shkumbinit deri në Seman. Në dokumentin në fjalë (A. Alb. 528) thuhet qartë «Matarangi de Caravastasi».

torike për një fakt të tillë. Në vitin 1319 është fjala për një aleancë të princave katolikë ose të feudalëve të lidhur me princa të tillë përëndimore kundër zgjedhës serbe, aleancë në të cilën marrin pjesë edhe duka i Durrësit, Filipi i Tarantos, mbreti i Hungarisë, Cari i Kroacisë.[77] Vetë fakti që papës njoftimet i vinë nga Kruja, flet qartë që pushtimi serb në çerekun e parë të shek. XIV nuk u shty kaq në jug.

Me të tilla të dhëna do të ishim të prirur ta shihnim trapezarinë e Manastirit të Pojanit si një ndërtim të fundit të shek. XIII.

Në këtë shkrim u munduam të kthjellojmë problemet që lidhen me arkitekturën e kishës dhe trapezarinë e Manastirit të Apolonisë duke parashtruar fillimit të dhënat që ofron vetë monumenti, duke u ndalur në çka jepet jo saktë nga Bushhausenët si dhe të dhëna të reja të përftuara kryesisht nga sondazhet, dhe më tej në përfundimet që nxirren prej tyre, sidomos në drejtim të vendosjes në kohë, që lenë gjithnjë vend për saktësime të mëtejshme apo vështrime të reja si rezultat i problematikës komplekse që shtron para studiuesit monumenti.

DO NOT COPY

77. Shih për këtë edhe A. Ducellier, **La façade...**, 333-334.

PLANIMETRIA



DO NOT COPY

DO NOT COPY

PRERJE GJATESORE

DO NOT COPY



PRERJA GJATSORE SIPAS H - H. BUSCHHAUSEN



PLANIMETRIA SIPAS H-H. BUSCHHAUSEN

DO NOT COPY

Pamje JUGORE



Pamje VERIORE





KISHA E SHEN MERISE – Kosinë

0 1 2 3 4M



TRAPEZARIA E MANASTIRIT TE Apollonisë

0 1 2 3 4M

DO NOT COPY

Nr. 1 1982

monumentet

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

H. und H. BUSCHHAUSEN, DIE MARIENKIRCHE VON APOLLONIA IN ALBANIEN, BYSANTINER, NORMANEN UND SERBEN IN KAMPF UM DIE VIA EGNATIA.

Wien 1976, Verlag der Osterreichisschen Akademia der Wissenschaften (avec 246 pages et 50 tableaux).

RESUME

L'église du monastère de Shën-Mëri en Apolonie ainsi que sa trapézerie de par leur importance, depuis près d'un siècle sont devenues l'objet de diverses études pour l'architecture, la peinture et les inscriptions qui s'y trouvent. Le dernier d'entre ces études et la plus volumineuse d'entre elles est la monographie des chercheurs autrichiens Haide et Hellmut Buschhausen «L'église de Shën-Mëri à Apolonie de l'Albanie» avec le sous-titre» les bysantins, les normands et les serbes dans la lutte pour la voie Egnatia». Elle est composée de 5 chapitres, outre l'introduction et les conclusions: L'histoire (19-42), L'architecture (43-98) Exonartexte (99-140) Le portrait de l'empereur (141-182) et la trapézerie (183-232). Les deux derniers traitent de la peinture murale, mais analysent aussi les problèmes de l'architecture des deux constructions et de l'époque où elles furent construites.

Leurs thèses principales qui sont exposées brièvement dès leur introduction, et qui sont présentées partout dans cette étude portent sur le fait que l'église du monastère d'Apolonie fut construite durant le règne d'Alex Comnene (1081 — — 1118) et plus exactement durant le séjour en Albanie des normands (1081 — 1085). Avec la seconde occupation normande 1107 — 1108) se rattache l'exonarthexe, tandis que le tableau de l'empereur a été peint dans les années 1281-82. Avec le tzar Miliutin (1282-1331) se rattachent les peintures de la trapézerie et une reconstruction, que les auteurs y constatent.

Le livre, comme nous en sommes informés jusqu'à ce jour a été vu par bien des chercheurs, dont nous allons présenter les idées selon le cas.[1]

Dans le présent article nous allons exprimer notre point de vue sur l'architecture et l'époque de la construction de ces deux monuments (église et trapézerie) ainsi que sur autres monuments de l'architecture médiévale dont il est question dans cette étude.

Les auteurs tiennent une attitude face à toute la documentation graphique publiée par divers chercheurs sur l'église à commencer par Paçe[2] *qui donne une planimétrie schématique qui est reproduite par Pallas*[3] *et jusque chez nous, dans notre première étude qui n'a pas l'intention de donner une vue globale de l'église et de sa documentation graphique*[4]*. Nous allons commencer par cela, considérant tout d'abord la valeur scientifique de la documentation du monument ainsi que le fait que les deux relevés publiés par eux une planimétrie et une*

1) M. Tashiq–Gjuriç dans «Zograf», 9-1978, 77-78; A. Ducellier, dans «Cahiers de civilisation médiévale» 88-XXII, 1979, 375-376. Ch. Walter, dans «Revue des études byzantines» 35, 1977, 313-314;
R. Nikollajeviç dans «Starinar» XXVIII-XXIX, 1977-78, 314-315.
2) B. Paçe, **Frustuli illirici,** dans «Anuario reale scuola archeologica di Atene (III 1916-1920) 288-290, fig. 147.
3) D. Pallas, **Epiros** Rbk, Band II, 1971, 317.
4) A. Meksi, **Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apolonisë,** Monumentet, 1, 1971, 103-110, Tab. I-IIV (plus loin: A. Meksi, **Apolonie**).

coupure en longueur,[5] les auteurs pensent remplacer la documentation actuelle en lui réparant les défauts, qui, selon eux, ont trouvé refuge dans les publications précédentes.

Notre remarque est que la construction planimétrique de l'église n'est pas celui d'un rectangle, mais il tend vers un parallélogramme. Ce fait qui n'est pas accepté par les auteurs du livre en question, est très frappant et se comprend en regardant la trassée des murs du sud et du nord en les comparant avec la construction du plancher, par des plaques de pierre calcaire établies normalement sur le mur de l'ouest du naos, phénomène que nous avons déjà vu auparavent[6]. Cette déformation si sensible se reflète même dans la forme planimétrique de la base du tambour avec la coupole, ce qui se distingue nettement même dans les photos publiées par nous,[7] et par les Buschhausen[8]. Pour être très précis nous répétâmes de nouveau le relevé topographique de la partie extérieure de l'église en relevant l'intérieur du plancher.[9] De par ce relèvement nous nous sommes efforcés de présenter avec une grande précision tous les détails dont exige aujourd'hui le niveau des études. En général, le résultat en est le même. Ainsi l'angle de l'écart de la forme de l'angle droit est de 6° 36' (de l'échelle à 360° du cercle). Evidemment il y a de quoi s'étonner d'une telle forme, mais il est difficile d'en donner l'explication d'une telle solution.

Quant au changement des lignes parallèles des murs de l'ouest du nartexe et de l'exonartexe que remarquent les Buschhausen[10] il est uniquement de 6 centimètres (523 cm le côté du nord et 517 cm le côté du sud).

En ce qui concerne la façon de la couverture de skevophytakion, que ne nous donne pas dans notre planimétrie, elle est faite de voûte à berceau et pas une voûte croisée sur une pièce carrée sur le plan.[11] Cette pièce a plus long le côté nord-sud. Il faut reproduire plus exactement aussi la fenêtre agrandie plus tard, que nous indiquions seulement dans la façade de l'église et non pas dans la planimétrie,[12] où elle devait figurer également. Les fenêtres bouchées du paraklis de Shën – Mitri qui sont seulement dans une partie de la largeur des murs anciens ne sont pas présentées exactement dans la planimétrie. Nous les avons présentées seulement dans la partie du nord et de l'ouest, tandis que dans cette dernière planimétrie nous allons les présenter plus exactement. La partie d'entrée dans le paraklis est présentée sans embrasures, ce qui n'est pas correct. Ici il convient de dire que le coin du nord-est n'est pas ancien, mais uniquement construit avec de grandes pierres.[13]

Dans les deux planimétries il manquent le menau de la fenêtre à deux battants de l'abside qui est surmontée à l'extérieur de deux petits arcs, sculptés sur la même pierre qui s'appuit à son tour sur la colonne. La colonne unitaire avec sa coupure en biais représente un rectangle à l'intérieur de l'abside et 7 des 8 côtés de l'octagone du côté extérieur. A l'espace de la fenêtre en pierre, entière sur la colonne, se trouve sculptée une figure humaine, un buste, les mains ouvertes et levées vers le haut qui portent, selon les Buschhausen, deux barres de fer. Les parties qui sortent au delà des mains se distinguent tout de suite qu'elles ont été construites plus tard, ce qui fait penser qu'ils peuvent être même des serpents, car la partie qui devait appartenir à la queue devient plus petite. Aussi sommes – nous de l'avis qu'il y a lieu de faire des recherches ultérieures quant à l'interprétation de cette figure de la part des auteurs, comme le briseur de fer,[14] motif du Xe siècle.

Aussi convient-il de préciser la façon de la couverture des deux annexes de la pièce de l'autel qui appartiennent au prothésis et au diakonikon. Le dessin que nous avons fait est inéxact car il les présenté avec une couverture de coupole sphérique, bien que dans le texte il soit souligné qu'elle sont couvertes de voûte à berceau.[15] Cette erreur est constatée aussi dans la planimétrie des Buschhausen. Conformément aux objectifs de notre première étude afin de ne pas surcharger les dessins, la construction interne de bema est présentée simplement, fait qui a été donné avec précision dans le texte. Cette partie est présentée d'une façon générale exactement par les Buschhausen. Il faut ajouter que l'abside dans sa partie intérieure est plus profonde que le fayon du cercle avec lequel elle a été construite. Pour cette raison elle et le Synthrone viennent légèrement se rétrécir au commencement.

A préciser sont toutes les portes et les portiques. Ainsi la

5) H. und H. Buschhausen, **Oeuvre citée,** fig. 9 et Fig. 10.
6) A. Meksi, **Apolonia,** 105.
7) A. Meksi, **Apolonia,** fig. 2.
8) H. und H. Buschhausen, **Oeuvre citée,** Abb. 26.
9) Les relévations graphiques que nous publions dans cet article sont des auteurs, F. Guralumi, A. Qyshka et A. Delvina. La relévation topographique a été faite par l'ingénieur M. Bezhani. L'échelle de la relévation est de 1:200 et l'erreur 1 dë $\frac{1}{800}$
10) H. und H. Buschhausen, Oeuvre citée, 58, note 2.
11) Ibid, fig. 10.
12) A. Meksi; **Apolonia,** fig. 1, Tab. III.
13) Les Buschhausen pensent que la partie de l'est du mur côté visible du paralixe est dans la partie inférieure, partie du mur skevophylakion (P. 71). Cela n'est pas vrai, elle vient se joindre à celle de skevophylakion.
14. H. und H. Buschhausen, Oeuvre citée, 77, Tab. XIII – 38, 43.
15. A. Meksi, Apolonia, 104-105.

Document

DO NOT COPY

porte étant partiellement bouchée, le passage à l'exterieur se fait par deux marches d'escalier. Les culés de cette porte ne sont pas plates mais avec une embrasure. Ces éléments en commun pour les cinq portes qui relient l'église avec la cour du monastère, nous les trouvons même dans notre première planimétrie, mais pas dans celle des Buschhausen. Etant donné que le terrain autour de l'église est à un niveau plus haut que celui du plancher de l'église même et le sol dans la partie sud à un plus haut niveau que celui de la partie nord, la descente dans l'église se fait par des marches d'escaliers selon le terrain. Fait exception seulement l'entrée du nord pour l'exonarthexe, qui ne dispose pas de marches. D'un bord plus élevé que le plancher sont les portes qui relient le naos, le narthexe et l'exonarthexe.

